

UNIVERSITETI SHTETËROR I TIRANËS  
INSTITUTI I HISTORISE DHE I GJUHËSISË  
SEKTORI I ETNOGRAFISË

# ETNOGRAFIA SHQIPTARE



III

TIRANË  
1966

398

395. UNIVERSITETI SHTETËROR I TIRANËS  
INSTITUTI I HISTORISË DHE I GJUHESISE  
SEKTORI I ETNOGRAFISE

LIBRARY OF THE STATE UNIVERSITY  
INSTITUTE OF HISTORY AND LANGUAGE

38814

39287

# ETNOGRAFIA SHQIPTARE

III



TIRANË, 1966

### **REDAKSIA**

Rrok Zojzi (Kryeredaktor), Abaz Dojaka (sekretar i kolegju-  
mit), Andromaqi Gjergji, Fiqri Haxhiu, Hasan Qatipi.

---

Tirazhi: 2000 kopje

Formati 70x100/16

Stash: 2204-65

---

Shtypur në N.I.S.H. Shtypshkronjave «MIHAL DURI» — Tiranë

## GUNA

# **NE VESHJET TRADICIONALE TE POPULLIT SHQIPTAR DHE TE POPUJVE TE TJERË BALLKANIKE**

Larmia dhe njësia në trashëgiminë kulturale të popujve të Ballkanit u bënë tanimë të njoitura dhe të pranuara nga të gjithë. Shkencëtarë të ndryshëm të Ballkanit dhe të vendeve të tjera që merren me studimet historike të këtyre popujve e kanë përqëndruar vëmendjen në këto dy anë të traditave të kulturës dhe po përpilen të gjurmojnë shkaqet dhe të gjejnë arësyet e tyre.

Si larmia ashtu edhe njësia në trashëgiminë kulturale të popujve të Ballkanit çsaqen në çdo aspekt të kulturës, por në asnjë vend nuk paraqiten në formë më të qartë dhe më bindëse se në veshjet e tyre tradicionale, në të cilat rascyrohen me forma të gjalla e konkrete elementet e kulturës që i afrojnë ose i largojnë këta popuj me njeri-tjetrin.

Po t'i marrim në studim veshjet e ndryshme që popujt e Ballkanit i kanë patur në përdorim të përditshëm jo më shumë se gjysmë shëkulli përpara, do të mahnitësh'm me larminë e madhe të tyre. Jo vetëm çdo krahinë, por shpesh edhe çdo fshat, bile kishte raste që edhe një grup i veçantë ekonomiko-sosial brenda tij, kishte një veshje të vetën. Me qindra, ndoshta edhe me rrija qenë llojet e veshjeve që përdornin ata. Kombinime interesante materialesh, ngjyrash, formash, dekorësh, etj. përftonin veshje krejt 'ë ndryshme, që në një vështrim të parë duken pa lidhje dhe pa asnjë pikë takimi në mes tyre. Por po t'ja nënshtronin ato një analize të shkencore, duke i lënë si një kategori në vete materialet e ndikimit oriental, qoftë si veshje të plota, qoftë si pjesë të veçanta (ato hynë në përdorim në disa krahina, dhe sidomos në qytetet e Ballkanit), do të shohim se në to ka disa elemente të përbashkëta dhe me interes të madh shkencor. Këto elemente të përbashkëta e pika takimi nuk vihen re vetëm në disa aspekte të tijeshta, si në materiale, forma, ngjyra, dekorë, etj., të cilat mund të janë edhe të rastit, por në strukturën morfollogjike të tyre, që nuk mund të jetë e rastit. Dhe në fakt, po t'i analizojmë veshjet e ndryshme të popujve të Ballkanit nga ana e njësisë morfollogjike, do të shohim se të gjitha kanë një vijë të përbashkët ndërtimi: një këmishë që mbulon trupin, një palë tirqe që mbështjejlin këmbët, një gunë përsipër në formën e një palltoje të zakonëshme, një brez në mes që përmbledh trupin; ndërsa te

gruaja kemi edhe përparësen<sup>1)</sup>. Këto elemente të përbashkëta përftojnë një tip themelor të përbashkët veshjeje, aq sa një ballkanas mund të dallohet lehtë edhe nga veshja nga një banor i viseve të tjera të kontinentit.

Në qoftë se i analizojmë veshjet nga ana e larmisë së tyre, do të shohim se një pjesë e këmishës, diku është punuar me pëlburë leshi, diku me pëlburë liri dhe diku me pëlburë pambuku; herë është më e gjatë e herë më e ngushtë; në disa raste më e gjatë, në disa të tjera më e shkurtër; disa janë të stolisura në gjoks, në grykë, në mëngë dhe disa të pastolisura fare; në disa raste ajo përdoret mbi pjesët e tjera të veshjes, në disa të tjera mbrenda tyre, etj. Kështu edhe tirqet, guna, brezi, përparësja dhe çdo pjesë tjetër e veshjes ka dallimet e veta. Dhe janë pikërisht këto nuanca që përftojnë variantet lokale të veshjeve.

Është për t'u vënë në dukje se në disa raste këto veshje i largohen pak më tepër tipit të përbashkët dhe përftojnë ndryshime mjart të ndjeshme. Këto ndryshime e kanë burimin kryesisht në zhvillimin jo paralel të pjesëve të ndryshme të veshjeve. Kështu, p.sh., kur një pjesë e veshjes del mbi të tjerat, i jep asaj një formë të re. Këto çfaqje të ndryshme përbëjnë derivatet, të cilat, historikisht, lidhen me tipin e përbashkët.

Që të kemi të qartë karakterin e veshjeve të popujve të Ballkanit, elementet e përbashkëta e të ndryshme dheshkaqet e arësyet e këtyre, duhet të analizohet çdo pjesë përbërëse, duke studiuar strukturën dhe funksionin morfologjik të saj në kompleksin e veshjes. Një punë e tillë në kushtet e sotme është e pamundur, pasi mungojnë të dhënat.<sup>2)</sup> Megjithatë, po përpinqemi të analizojmë vetëm «gunën»<sup>3)</sup>, që është pjesa më karakteristike dhe përcaktuse e veshjes së këtyre popujve<sup>4)</sup>.

Në përgjithësi shkencëtarët ballkanikë, duke u nisur nga bazat kombëtare, e kanë analizuar këtë problem në një rrëth të kufizuar dhe

1) Në vija të përgjithëshme kjo është struktura morfollogjike e veshjeve të popullit shqiptar. Po këtë strukturë paragjen edhe **Boris Zdenciu — Paul Petrescu** dhe **Tancred Banateanu** për veshjen e popullit rumun («L'Art Populaire en Rumanie», Bucurast, 1946). Po këtë strukturë paraqet edhe **Maria Veleva** për veshjet e popullit bullgar («Le Costume National Bulgare à double tablier», Sofje, 1963). Edhe për popujt jugosllavë e grek, siç shihet në leteraturën ilustrative të përmëndur në vijim të këtij studimi, kjo është struktura e veshjes së tyre.

2) Ky problem mund të zgjidhet në një mënyrë përfundimtare vetëm kur të kemi një atllas etnografik të Ballkanit. Nga sa jemi informuar, në disa vende të Ballkanit po bëhen përpjekje për hartimin e një atllasi të tillë, por që këto atllase të veçanta të koordinohen në një të përbashkët, duhet të ndiqen kritere, metoda e forma pune të përbashkëta. Me zhvillimin që kanë marrë studimet e Evropës jugëlindore, shpresojmë se së shpejti do të merret edhe një iniciativë e tillë.

3) Nga kuptimi i saj fillestar fjala gunë mori kuptime të dyta; diku me këtë fjalë kuptojmë veshjen e përditëshme prej leshi në formë palltoje që përdoret në çdo stinë, diku veshjen e rëndë dimërore që përdoret vetëm për t'u mbrojtur kundër shirave dhe të ftohtit, etj. Në këtë punim është përdorur vetëm për pallton e leshtë që vishet në çdo stinë — në verë mbi këmishë dhe në dimër nën mbulojën e rëndë dimërore.

4) Që guna është pjesa më me rëndësi e veshjes popullore, pjesa determinante e saj, dëshmojnë shprehje të ndryshme popullore, si: «shikoji punën dhe jo gunën», në të cilën guna përfaqëson krejt veshjen. Edhe në Jugosllavi në ishullin Mljet, me emrin «gunj» kuptojmë krejt veshjen (Br. Gušić, vep. e cit., Nr. 6).

jo në tërësinë e tij. Për shembull. G. Opresku u përpoq të gjurmonte origjinën e gunës rumune<sup>5</sup>); Br. Gushiçi, duke u marrë me veshjen e ishullit Mljet të Dalmacisë, u ndal në gunën që përdorej këtu dhe, për nevoja studimi, në disa raste u shtri edhe në studimin e gunës së popujve të tjerë të Jugosllavisë<sup>6</sup>); M. Veleva, duke studiuar veshjen bullgare me prapanik e paranik, analizoi edhe gunën e saj dhe, për nevoja krahasimi, studioi edhe gunën bullgare në përgjithësi<sup>7</sup>); Rr. Zojzi, në një studim mbi veshjet e popullit shqiptar, gjurmoi edhe origjinën e gunës së tij<sup>8</sup>), etj. Megjithatë në këto punime, me gjithëse me një bazë të kufizuar u zbrit mjaft thellë në disa probleme që lidhen me këtë objekt, por nuk u arrit në përgjithësimë në shkallë ballkanike.

Veç këtyre, edhe autorë të tjerë, kryesisht autorë jo ballkanas, u morën me studimin e këtij problemi në një formë më të nërrajithëshme, në një bazë ndërkombe. Ndërmjet këta përmendim Fisherin,<sup>9</sup> Batalian,<sup>10</sup> Nopcen<sup>11</sup>, Shuhardin<sup>12</sup>, Haberlandin<sup>13</sup>, Rozen-Przeworsken<sup>14</sup>, etj., punimet e të cilëve, përmungesë materialesh, nuk kanë qënë gjithnjë të plota; si rriehim, edhe përgjithësimet e tyre nuk kanë qënë gjithnjë të sigurta<sup>15</sup>.

Sot, që bazat materiale të punës shkencore përpunuat e Ballkanit janë siç uruar pranë institucioneve përkatëse dhe që janë botuar materiale e studime të veçanta, mund të themi se kanë filluar të krijohen mundësítë përmendim studime shkencore në një shkallë më të gjérë, duke i analizuar objektet në të gjitha aspektet e tyre. Pra, duke u nisur nga gjithë këto, ne po studiojmë në mënyrë të veçantë gunën ballkanike. Por para se t'a analizojmë këtë, mënyrë shkencore, do të shqyrtojmë shtrirjen e saj teritoriale dhe disa veçori të përgjithëshme të saj.

Objekti që po studohet, ku në një formë e ku në një tjetër, ku me një ngjyrë e ku me një tjetër, përdoret në të gjithë popujt e Ballkanit.

Në Shqipëri, me përjashtim të disa grupeve të popullsisë brenda alpeve të Veriut dhe të atyre që kanë zbritur prej tyre në fushat bregdetare, guna ka qenë përdorur në të gjithë vendin<sup>16</sup>). Deri në mesin e shekullit të kaluar ajo përdorej në Dukagjin (Shalë, Shosh, etj.), Mer-

5) G. Oprescu — «L'art du paysan Roumain». Botim i Akademisë rumune, Bucureşti, 1937.

6) Br. Gušić — «Starinsko ruho na otoku Mljetu». Zagreb, 1930.

7) M. Veleva — «Le costume national à double tablier». Sofje, 1963.

8) Rr. Zojzi — në «Studime Historike», viti 1964; Nr. 4.

9) E. Fischer — «Die Haar — und kleidertracht vorgeschiedlicher Karpather und Balkanvolkerkunschaften», 1909.

10) R. Battaglia — «L'Europa Danubiano-Balcanica». (mikrofilm pranë sektorit të etnografisë).

11) Fr. Nopcsa — «Albanien» (Bauten, Trachten und Geräte Nordalbaniens). Berlin u. Leipzig, 1927.

12) C. Schuchard — «Die germanischen Mäntel und das Ilyrische Röckchen», Berlin, 1936 dhe «Die Uralyrier und ihre Indogermanisierung», Berlin, 1937.

13) M. u. A. Haberland — «Die Völker Europas und Ihre Volkstumliche kultur». Stuttgart, 1928.

14) J. Rosen-Przewerska — «Spoleczna Funkcja adziezy». Varshavë, 1949.

15) Përveç këtyre, mund të ketë edhe autorë të tjerë, si nga të parët ashtu edhe nga të dytët, botimet e të cilëve nuk patëm rast t'i kemi.

16) Për materialet shqiptare u mbështetëm kryesisht në fondet e Muzeut Etnografik të Tiranës e të muzeve lokale të rrëtheve, si dhe në botimet e ndryshme ilustrative.

tur. Berishë. Has, në qytetin e Shkodrës dhe vazhdon të përdoret në Postripë, Pukë, Mirditë, Lumë (Terthore) Dibër, Mat, Martanesh, Gollbërde, Çermenikë, Shëmil, Labinot, në malësi të Leshës, Kurbin, Fush-Krujë, Shpat, Polis, Bërzeshtë, Dervend, Mokër, si dhe në pjesën tjetër të rrëthit të Pogradecit; ka qënë përdorur gjithashtu në qytetin dhe fushën e Korçës, kurse në malësinë e saj dhe në pellgun e Prespës vazhdon të përdoret akoma; përdorej në Myzeqe, në një kohë më të largët edhe në Labëri e në Rrëzë të Tepelenës; përdoret edhe në Lunxhëri, Zagori, Pogon, Dropull, Vurg. në malësinë e Delvinës; gjithashtu, ka qënë përdorur edhe në Çamëri<sup>17)</sup>, etj.

Në Jugosllavi guna ish thuaise në përdorim të përgjithshëm deri në fundin e shekullit të kaluar dhe në shumë raste përdoret edhe sot. Atë e përdorin si burri ashtu edhe gruaja në Mal të Zi, Likë, Hercegovinë;<sup>18)</sup> fshatarët e Kanalit, Ublinskxit, Shebenikut dhe qytetarët e Risanoš. Ajo përdoret nga gruaja në Krivosie e Krushevicë dhe nga burri e gruaja në Gornja Krajina (Pirot), Gilan, Zladovçe (Kriva-Palanka) e Kumanovë; përdoret nga gruaja në rrëthet e Shkupit e Manastirit, nga burri e gruaja në Trebinjë e Liçevicë (Split), nga gruaja në Djurdjevac (Osjak), etj.<sup>19), 20)</sup>

Në Rumani guna përdoret në krahinat e Transilvanisë e Marmurës. Në Moldavi<sup>21)</sup>, në viset perëndimore dhe në ato jugëlindore,<sup>22)</sup> në Romavat (Kraiova), ajo përdoret nga burrat. Kurse në Timisoare, në krahinën e Bukureshit<sup>23)</sup>, sidhe në Ruteni<sup>24)</sup> guna përdoret si nga burri, ashtu edhe nga gruaja.

Edhe në Bullgari e ndeshim këtë objekt.<sup>25)</sup> Atje përdoret nga gruaja në Belogradçik, Plevnje, Provadia, Pomorie, Topolovgrad Maliko-Ternova, në rrëthe të Sofjes, në Samokov, Kiustendil, Noevrekop, etj., kurse në Vidin, Botevgrad, Trau, Haskove etj.<sup>26)</sup> përdoret nga burri.

Guna është përdorur edhe në Gregi. Në Athinë ajo mbahej si nga burri, ashtu edhe nga gratë. Në Atikë ajo përdorej nga gratë, dhe vajzat<sup>27)</sup>. Përdorej gjithashtu nga burrat në qytet dhe te fshatarët rrëthet Janinës, te barinj e baresha të Arkadies, e gra e fëmijë të rrëthit të Tebës, te gruaja e Delfit,<sup>28)</sup> te gruaja e Sulit,<sup>29)</sup> Eubes<sup>30)</sup>

17) Rr. Zojzi — Dh. Mborja — «Arti Popullor në Shqipëri», botim i Universitetit Shtetëror të Tiranës, 1959, faqet: 1, 4, 6, 8, 10, 14, 16, 18, 23.

18) Francesco Carrara — «La Dalmazia descritta». Zara, 1846.

19) W. Bruhn/M. Tilke — «Das kostumwerk», Berlin, 1941 f. 161, fig. 2, 7, 8, 11, 12.

20) Musée Ethnographique de Beograd — «Costumes nationaux jugosllaves», 1930. Fasc. I.

21) Adolf Rosenberg — «Geschichte des Kostüms», Berlin, vëll. V, f. 334.

22) Bruhn/Tilke, vep. e cit., f. 163, fig. 5, 8, 9, 10, 12.

23) «Costumes nationaux de la République Populaire Romaine», botim i Institutit të Rumanisë për marrëdhënie kulturale me botën e jashtëme.

24) Bruhn/Tilke, vep. e cit., f. 163.

25) Rosenberg, vep. e cit., vëll. V, f. 334, fig. 11.

26) Maria Veleva — Neva Tuzsyzov — Vener Naslednikov — Georgi Atanasov,

«Bulgarski Narodni Nosí Shevici», fig. 3, 8, 17, 20, 24, 31, 32, 34, 36, 37, 4, 6, 30, 41.

27) Rosenberg, vep. e cit., vëll. V, f. 336, fig. 1, 2, 3, 4, 5, 11.

28) O. M. De Stackelber — «Costumes et Usages des peuples de la Grèce Moderne», fig. 1, 3, 4, 6, 7, 9, 10, 16.

29) H. L. Pouqueville — «Voyage de la Grèce (skica të riprohuara nga autorët e ndryshëm) vëll. I, f. 1; vëll. II, f. 176, vëll. IV, f. 120, 294, 512, etj.

30) M. u. A. Haberland — «Die Volker Europes und ihre Volkstümliche kultur» (riprodhim nga Stackelberg), në f. 129, 144.

dhe Crigut<sup>31)</sup>, te shqiptarët e Greqisë,<sup>32)</sup> etj. Pra siç shihet, gjer në fundin e shekullit XIX guna qe një pjesë e përbashkët e veshjes për të gjithë popujt e Ballkanit të cdo vëndi dhe krahine. Edhe në qoftë se në ndonjë kënd të këtij gadishulli ajo mungon, la prapa vazhdën e saj, që dëshmon se në një të kaluar më të largët përdorej edhe aty<sup>33)</sup>.

Përveç përdorimit të gjërë të saj në cdo popull të Ballkanit, gunën e shohim që të përdoret edhe në cdo kategori të tyre, pa dallim seksi, moshe dhe gjëndjeje shoqërore: Ajo është në përdorim të mashkullit e të remrës, me ndryshimin se tek i pari ajo ka qenë më e thjeshtë, kurse tek e dyta më e zbukuruar. E gjejmë në përdorim nga cdo moshë, me ndryshimin se tek të rinjtë e pleqtë ajo paraqitet e thjeshtë, kurse te dhëndri dhe nusja shumë e stolisur. E gjejmë te i pasuri dhe te i varféri, me ndryshim se i pari e ka me material më të zgjedhur e punë më të mirë, kurse i dyti me material më të dobët dhe të punuar dosido. Pra, del qartë se guna shtrihet në të gjithë popujt e Ballkanit dhe në cdo kategori shoqërore të tyre, aq sa me të drejtë mund të quhet si një veshje e përbashkët e popujve Ballkanikë.

Por, nga ky gadishull, ajo u përhau edhe jashtë tij, veçanërisht në Evropën e cendrore<sup>34)</sup>. Ballkanasit e emigruar e mbajtën dhe e përdoren atë edhe në vise të tjera të kontinentit,<sup>35)</sup> ku ata emigruan. Etnografët e shquar M. e A. Haberland, të cilët u morën me percaktimin e arealit të këtij objekti, kanë shprehur mendimin se shtrirja territoriale e tij gjendet në lindje të vijës Adriatik-Vistulë<sup>36)</sup>.

Nga studimet e deri tanishme që i janë bërë gunës ka mendime të ndryshme, herë në pajtim dhe herë në kundërshtim në mes tyre, po për mungesë të dhëna të plota problemet e këtij objekti mbeten gjithnjë pezull.

Një ndihmë të madhe në zgjidhjen e tyre japin materialet shqiptare, të cilat deri tani ose nuk njiheshin, ose njiheshin përciptas. «Shqipëria enigmatike — thotë historiani gjerman Standmyler, — me materialet e saj përfaqëson pikën e Arkimedit për studime balkanologjike»<sup>37)</sup>; ose, siç shprehet më mirë historiani i madh kroat M. Shuflaj, «në Shqipëri paraqitet si në një pasqyrë i tërë Ballkani»<sup>38)</sup>. Pra, mungesa e materialeve shqiptare për këto studime ka qenë mjaft e ndjeshme. Por me që sot materialet shqiptare i kemi të mbledhura pranë sektorit të etnografisë dhe muzeve etnografike, po e marrin në studim problemin.

31) A. L. Castellan «Lettres sur la Morée», Paris, 1808, vell. I, f. 39, 79, vell. II, f. 96.

33) Janë shumë të pakta vëndet në të cilat të mos ketë gjurmë që të dëshmojnë se guna nuk është përdorur në të kaluarën. Bile edhe ato të pakta janë si ishuj të vëgjël në mes të detit të hapur të gunës. Për shembull, në disa lugina të alpeve shqiptare të veriut nuk ka asnjë gjurmë që të dëshmojë se gruaja e ka përdorur këtë objekt, ndërsa për burrin gjurmat e saj i gjejmë edhe në to.

34) Gjurmët e saj jashtë Ballkanit i gjejmë: në Hungari (shih) Rosenberg, f. 338, nr. 1, 2, 4, 10, dhe f. 339, nr. 2, 4, 5; gjithashtu, Bruhn-Tilke, f. 162, nr. 5, 6, 16, 17, 18; Në Austri (shih P. Geramb në «Steirische Trachtenbuch», Graz; por edhe në Çekoslovakia, Poloni, etj.

35) Për shembull, shqiptarët dhe grekët e emigruar e mbajtën këtë objekt edhe në Itali, ku e përdorën deri në mesin e shekullit të kaluar.

36) Haberland, vep. e cit., f. 560.

37) Stadtmyller «Forsehungen zur albanischen Früchgeschichte», 1941 (Hyrja).

38) Dr. M. Sufflay, etj. — Acta Diplomata I., f. 3. (Cit. nga Stadtmüller).

Gunën ballkanike po e analizojmë duke patur parasysh afërsisht 126 lloje të ndryshme të saj, të cilat, sigurisht, nuk përfaqësojnë tërë materialin, por një pjesë të tij. Nga këto, 37 lloje i kemi nga Shqipëria, 32 nga Jugosllavia, 24 nga Greqia, 18 nga Bullgaria dhe 15 nga Rumania. Materialet për këto, me përjashtim të atyre shqiptare u muarën kryesish nga leteratura illustrative që përmendëm.<sup>39)</sup>

Njësinë dhe larminë e gunës ballkanike e shohim në elemente kryesore të saj, si në emrin, në materialin e ndërtimit, ngjyrën, formën, dekoret, në funksionin morfologjik, etj. Disa nga këto elemente po i analizojmë në mënyrë të veçantë.

1) Elementi më i lëvizëshëm i objektit në analizë është emri: në çdo variant të gunës gjejmë një emër të ndryshëm. Si shembull marrim emërtimin e objektit në popullsinë shqiptare dhe në ndonjë popull tjetër të Gadishullit Ballkanik. Te ne gjejmë në përdorim të popullit këto emra: «zhgun»<sup>40)</sup> — në Shalë, Shosh, Mertur, Berishë; «shingun», «shangun», «shagun», etj., — te vllehat në përgjithësi, në krahinën e Prespës, në Vurgun e Delvinës, etj.; «gunë»<sup>41)</sup> — Lumë (Terthore), Martanesh, Myzeqe, Çamëri, në fshatra të Konispolit, kurse në malësi të Lezhës e quajnë «gunzë»;<sup>42)</sup> «xhupletë», «xhupetë»<sup>43)</sup> e quajnë në Kallmet; «xhup»<sup>44)</sup> e quajnë bajrakët e Ohrit, Mirditës, etj.; «cibun», «cipun» e quajnë në rrëthin e Pogradecit dhe në malësinë e Korçës, kurse «zobançë»<sup>45)</sup> e quajnë në Kërçisht (Peshkopi), Gollobordë, etj.; «xhokë»<sup>46)</sup> e quajnë në luginën e Shkumbinit; «dollamë», «dallamë» — në Shkodër e Postribë; «dolloma» e quajnë në qytetet e Korçës, Leskovikut, etj.; «nemtë», «nete», «nente» dhe «mentë» e quajnë në pjesën e ulët të luginës së Matit, në Kurbin, etj.; «deleshe», «leshe», «leshnik», etj.<sup>47)</sup> e quajnë në Malësinë e Madhe dhe në disa vise të malësisë së Dibrës etj.; «gozhup»<sup>48)</sup> e quajnë në Dukagjin; «çashe»<sup>49)</sup> — në fu-

39) Si burime illustrative kanë shërbyer kryesish ato që u përdoren për përcaktimin e shtrirjes teritoriale të objektit duke filluar nga shënim me numër 16 deri në atë numër 32.

40) Ky emër përdoret në të gjithë Veriun edhe për materialin e thurur në vë gjë, në katerliq dhe të shkelur ashtu në formën e papuuar: të paprë e të paqepur.

41) Ky emër përdoret edhe në Malësi të Madhe dhe në përgjithësi në Shqipërinë e Jugut, po për një objekt tjetër veshjeje, i cili nuk ka lidhje me objektin tonë, p.sh.: «gunë larë», «gunë çile» etj. (shih shën. Nr. 3).

42) Diminutiv i fjalës «gunë».

43) Kjo fjalë përdoret edhe në Malësi të Madhe, Dukagjin e Breg të Matës, po për një objekt tjetër. Te arbëreshët e Ukrainës përdoret për këpucët (shih: S. Islami, Bulletin për Shkencat Shoqërore, 1955, Nr. 2).

44) Edhe kjo formë është e përhapur në të gjithë Ballkanin dhe në Evropën Juhore, hyn rishtas në popullin tonë nga turqishtja me emrin «xhybe» dhe nga perëndimi me formën xhup, për pjesë të tjera veshjeje që nuk kanë lidhje me objektin në studim.

45) Jashtë çdo kompetence etimologjike, duke u mbështetur vetëm në ngjashmërinë fonetike, mendoj se ky emër ka lidhje me fjalën çoban, çopan, etj.

46) Kjo fjalë njihet edhe në Veri, ku përdoret në proverbin «herë me xhybe, herë me xhoke» — për njeriun e paqëndrueshëm, hipokrit.

47) Sigurisht, ky emër u muar nga materiali «lesh». Nga kjo prejardhje është edhe fjalë «delesh», «qelesh», etj. Fjala «leshnik» përdoret në Veri edhe në shprehjen popullore «hangre fikun — vesh leshnikun», ku termi leshnik ka kuptimin e veshjes së rëndë dimërore.

48) Me këtë fjalë në Dukagjin quajnë veshjen me lëkurë prej deleje.

49) Në Kurbi, me fjalën «tjashe» kuptojmë pëlhurën e leshtë të punuar në shtëpi nga grua.

shën e Dibrës; «pec» — në malësinë e Matit; «flokatë»<sup>50)</sup> e quan grua-ja labe, kurse «lëkurçe»,<sup>51)</sup> ajo, quan formën e vjetër të saj; «qesike»<sup>52)</sup> e quainë në fushën e Domosdovës; «shajake» — në disa fshatra të Vur-gut<sup>53)</sup>, «cohë» dhe «kadife» e quajnë në Lunxheri; «shita»<sup>54)</sup>, — në Dropull. Gunën e quajnë edhe me emra të tjerë, por këto kanë një për-hapje më të vogël. Edhe shqiptarët e emigruar që e ruajtën përdorimin e gunës krahas saj, e ruajtën edhe emrin kështu, p.sh. arbëreshët e Greqisë e quajnë «gunë»<sup>55)</sup>, ata të Italisë — «gunë», «gjibun» dhe «cohë»<sup>56)</sup>, të Ukrainës — «shijak»<sup>57)</sup>, kurse ata të Mandricës (Bullgari) — «gunë»<sup>58).</sup>

Edhe te populli bullgar gjemjë një tok emra të ndryshëm për këtë objekt: «kësak» e quajnë në Komarev (Plevnje), «dollaktanka» — në Podgorie (Llom), «dreha» — në Krushov (Teteven), «kiça» — në Rava (Provadiste), «koçak» — në Belogradciq, «kloshnik» — në Plevens-ko, «gluhçë» — në Oreslec, «sglobnica» — në Vidinsko, etj., «barnik» — në Nikopplsko, etj., «veba», «abiçka», «ulek», «zebun», «çokma», «xhubë» «menteto», «allaxha», etj. — në krahina lindore<sup>59).</sup>

Nga leteratura e shfrytëzuar, për variantet e këtij objekti dolën një tok emra të ndryshëm edhe në gjuhët jugosllave, rumune e greke.

Në mes të kësaj larmie të madhe emrash gjemjë forma krejt të ndryshme dhe forma të ngjashme që lidhen në mes tyre me një rrënje të përbashkët. Për shembull, emrin nemte që e gjemjë në shqipe, e gjemjë në bullgarishte,<sup>60)</sup> në vëndet jo Ballkanike, si edhe në hunga-rishten; emrat shigun, shangun, cibun, zonbun, etj. i gjemjë në përdorim të çdo populli ballkanik<sup>61)</sup>, etj. Këta emra me forma të ndrysh-me, të cilët kanë rrënje të përbashkët, bëjnë pjesë në fondin e përbashkët leksikor të popujve të Ballkanit.

Me qënë se për objektin në studim mungon një emër i përgjith-shëm, po përdorin emrin «gunë», pasi është më i përhapur dhe, siç do ta shohim më poshtë, edhe më i lashtë, kurse emrat e tjerë të veçantë do të përdoren si emra specifikë për variantet e tij.

Emrin gunë nuk e gjemjë vetëm në përdorim të popullit shqiptar, por edhe ndër të gjithë popujt e tjerë të Ballkanit. Siç u përmend edhe më lart, ashtu sikurse objekti u përhap edhe në popujt të tjerë jo ball-kanas, edhe emri u përhap, bile në një shkallë më të gjërë, në shumë popuj të kontinentit. Në gjuhën shqipe e gjemjë me format «gunë» dhe «gunzë», në bullgarishte — me format «guna» dhe «gunja»<sup>62)</sup>, në serbo

50) Me këtë emër quhet edhe «brruca» që përdor burri lab, por ky objekt nuk ka lidhje me objektin në studim.

51) Objektin të punuar me lëkurë.

52) Paraqet të njëtin objekt, por me formë të shkurtuar dhe të zvogëluar në përgjithësi.

53) Prej turqishtes «shajak» — pëlburë e leshtë.

54) Ndoshta rrjedh nga «hition» — i lashtë.

55) G. Meyer «Etymologisches Wörterbuch der Alb. Sp.», Strassburg, 1891, fj. gunë.

56) Prof. Ferrari — informata gojore.

57) Selim Islami — «Buletin për Shkencat Shqërore», v. 1955, Nr. 2, «Material gjubësor nga kolonitë shqiptare të Ukrainës», f. 179.

58) Dhimitër Shuteriqi — «Fshati shqiptar i Mandricës», në Studime Filologjike, v. 1965, Nr. 2, f. 158.

59) M. G. Veleva, vep. e cit., f. 59 dhe 107.

60) Menteto (shih M. G. Veleva), vep. e cit.

61) A. Boué — «La Turquie d'Europe», Paris, 1840, vëll. II, f. 184, 188, 213.

62) M. Vasmer — «Russisches Etymologisches Wörterbuch», Heidelberg, 1954, fjalë «gun».

kroatishte — me format «gunë», «gunj», «gunjina», «gunjac»,<sup>63</sup> në rume-nishten — «guna»,<sup>64)</sup>, në greqishten e re — «gun».<sup>65)</sup> Nga Ballkani u përhap sa në lindje e në perëndim aq edhe në veri të kontinentit<sup>66).</sup>

2) Një element tjetër mjafët lëvizës për këtë objekt është materiali me të cilin ajo pregetitet dhe që pasqyron më qartë se çdo element tjetër ekonominë dhe shkallën e zhvillimit të këtyre popujve.

Analizën e materialit nuk po e fillojmë nga shkalla e përhapjes së çdonjerit, por nga lashtësia.

Niё nga materialet më të lashta të përdorura për pregetitjen e gunës është lëkura e berrit. Gjithnjë del se ky është përdorur diku në gjëndje fare natyrore, diku gjysmë i përpunuar dhe diku i përpunuar në një nivel të lartë. Diku është përdorur me lesh nga jash-të, diku nga brenda, diku pa lesh fare. Në Shqipëri u bë shumë e rrallë guna me lëkurë, megjithatë disa çfaqje të saj, me sa dëshmojnë kujtesa e popullit dhe këngët e gravurat e ndryshme, del se në të kaluarën qe më e shpeshtë. Sot e gjejmë vetëm në Dukagjin me lesh përjashta<sup>67)</sup> dhe ndër barinj të Lumës me lesh përbrenda. Në kujtesën e pleqve ajo ruhet ende në Malësi të Madhe dhe në Labëri<sup>68)</sup>. Ndërsa gravura të ndryshme e gjejmë në shumë autorë, por kryesisht në punimet e Shtakelbergut<sup>69)</sup>. Gunën me lëkurë e gjejmë edhe ndër popuj të tjerë të Ballkanit, si në Gregi<sup>70)</sup>, Jugosllavi<sup>71)</sup>, Rumani<sup>72)</sup>, etj., si dhe jashtë gadishullit të Ballkanit si në Hungari<sup>73)</sup>, etj. Sigurisht, ky qe materiali më i lashtë, materiali fillestar i ndërtimit të këtij objekti.

Një material tjetër, gjithnjë i rrallë dhe që gjenetikisht duhet të vijë pas lëkurës, kurse teknikisht duhet të jetë i ardhur pas zhgunit, është «flokja». Flokja është material i punuar prej leshi të thurur në shtëpi nga gruaja dhe që në sipërfaqe i lihen flokë<sup>74)</sup>. Guna e pregetitur me këtë material quhet «flokatë». Fokatën e gjejmë te gruaja labe me flokë përjashta (shajak) dhe te ndonjë grua plakë e Dardhës, Bradvicens, etj. me flokë përbrenda (floçkë). Me gjithë që guna me flokë sot është e rrallë, kujtesa e pleqve dhe disa ekzemplarë nga fshatrat e Kolonjës dhe Vakëfeve që ruhen në muze dëshmojnë se në të kaluarën, vëcanërisht në Shqipërinë jugëlindore, përdorej gjérë. Më rrallë ajo pë-

63) D. E. Berneker — «Slavische Etymologisches Wörterbuch», Heidelberg, 1924; po ashtu edhe G. Meyer, M. Vasmer, në vep. e cit.

64) G. Meyer, vep. e cit., shih fj. «gunë».

65) G. Meyer, po aty.

66) Këtë emër, përvetës në gjuhët ballkanike, e gjejmë në fjalorët e të gjitha gjuheve të pellgut të Mesdheut: nga lindja në Turqi, nga perëndimi në Itali, Portogali; gjithashtu, nga veriu u përhap në Hungari, Çeki, Slovaki e Poloni dhe u shtri në lindje edhe në Ukrainë e Lituanë, por jo gjithkund me kuptim të njëjtë, siç do ta vemië në dukje në vazhdim të këtij punimi.

67) Rr. Zojzi — Dh. Mborja, vep. e cit., f. 2.

68) Guna me lëkurë në Dukagjin quhet «gozhup», në Lumë — «kozhup», në Malësi të Madhe — «delesh», në Labëri — «lëkurçe». Ende sot dëgjohet në Labëri: «... e dua nusen të kuqe (prej Kuçit) — që më vij me lëkurçe...»

69) Stackelberg, vep. e cit.

70) Bruhn-Tilke, vep. e cit., f. 164, Nr. 11, 12, dy gra me lëkurçe.

71) Ami Boué, vep. e cit. vëll. II, f. 179-235.

72) B. Zdercius, etj., vep. e cit., f. 36.

73) Rosenberg, vep. e cit., vol. V, f. 338, Nr. 1, 2 dhe 4.

74) Me flokë punohen edhe bruca e Labërisë, velenxa të ndryshme e të tjera objekte, por që, veç materialit të përbashkët, nuk kanë lidhje tjetër me gunën.

75) Muzeu Etnografik i Tiranës — objekte me numër 6800, 5680, 3541.

dorej ndër popujt e tjerë të Ballkanit<sup>76)</sup> dhe u zhduk fare jashtë tij<sup>77)</sup>. Ka të ngjarë që flokata të jetë një imitacion i lëkurës së berrit dhe se është pasardhëse e saj, me gjithë që, nga ana tekniqe, duhej të vinte pas zhgunit. Për lidhjen e saj me lëkurën e berrit është shprehur edhe G. Hahni<sup>78)</sup>.

Një material i tretë me të cilin pregetitet në përgjithësi ky objekt është zhguni, i punuar në shtëpi nga gruaja me lesh në vegjën e zakonëshme, me katërliq dhe i shkalun. Ky-material, veç pak përjashtimeve, mund të quhet material i përgjithshëm i përdorur për gunën në Shqipëri dhe në të gjithë Ballkanin. Nga 126 ekzemplarët e gunës që kemi përpara, 88 (sa kujtojmë nga ilustrimet) janë të punuara me zhgun. Edhe ky material duhet të jetë shumë i vjetër, pasi thurja ka qenë mjaft e zhvilluar që në kohë të lashta në Shqipëri dhe në të gjithë Gadishullin<sup>79)</sup>.

Gjithashtu kemi dha guna të punuara me cohë të një industrie të ngritur, të importuara nga vendet jashtë Gadishullit të Ballkanit. Guna të tilla janë përdorur nga aristokracia e qyteteve më të zhvilluara, ose në krahina që kishin lidhje të ngushta me botën e jashtëme. Nga 126 gunat e analizuara, vetëm 18 janë të punuara me cohë. Përdorimi i cohës për gunë filloi, së paku, që në shekullin XIII, kur filloi të importohet coha.<sup>80)</sup> Që atëherë guna filloi të quhej «cohë».<sup>81)</sup>

Si material më i ri dha jo shumë i përhapur ka qenë edhe «kadifeja», e cila në Shqipëri është përdorur vetëm në Lunxheri. Për viset e tjera të Ballkanit nuk mund të dallohet nga ilustrimet. Kadifeja hyri në përdorim gjatë shekullit XIX dhe shkoi duke zëvëndësuar cohën. Edhe guna e pregetitet me këtë material filloi të quhet «kadife».

Përveç materialeve të rënda, për gunën u përdoren edhe materiale të lehta, si «manica», «allaxhia», etj. Këto i shohim në dollomanë e burrit të Korçës<sup>82)</sup> dhe në atë të gruas të krahinës së Rodopit (Bullgari<sup>83)</sup>). Këto materiale hynë në përdorim për gruan të paktën që në shekullin XV<sup>84)</sup>). Guna e punuar me allaxhë filloi të quhet «allaxhia».

Nga materialet e përdorura për pregetjen e gunës shohim se më të vjetrat dhe më të përgjithëshmet janë prodhime me burim nga blegtoria, si lëkura dhe leshi. Kjo na vërteton se ky objekt duhet të ketë një prejarchje prej popujsh blegtore. Të dhënat e shumta mbi pregetjen e materialit dëshmojnë se në fillim ky qe prodhim i ekonomisë natyrore. Më vonë, kur filloi shkëmbimi i mallrave, shohim se materiali shitet ose i papregatitur, ose i pregetitur në vënd, ose dhe i importuar.

76) Maria Valéva, etj. — Në veprën e cituar paraqitet vetëm një grua nga Pomerie (Bullgari) me gunën me flokë dhe asnjë ekzemplar tjetër.

77) M. Vasmer, në veprën e cituar, thotë se në Çeki quajnë «houne» një stofë me flokë.

78) G. Hahn — «Albanesische Studien», Jenë, 1854 — Lib. 1, shënim 39.

79) Vegla të ndryshme të përdorura për thurje, si rotlla boshti, pesha vegje, etj., të cilat i përkasin mijëvjeçarit të dytë para erës sonë, u gjetën kudo në Ballkan. Arkeologët tanë zbuluan edhe copa të vogla zhguni të peirifikuara që i përkasin mijëvjeçarit të parë. Iliërët ishin të famshëm për thurje, thotë K. Patsch.

80) Act. Dipl., vëll. I, f. 149, dok. nr. 498. «... Maria accepit mihi tres gonellas de xocna...» (1285).

81) Act. Dipl., vëll. II, f. 179: «... la mia cocha nova cum capuço...», (1399).

82) Një ekzemplar ndodhet në muzeun lokal të Korçës.

83) Maria Valeva, etj., vep. e cit.

84) Br. Gušić, vep. e cit., shënim 78: «... gunela de pano...» (1501) dhe shënim 79: «... tre guni de raga...» (1515).

3) Gjithnjë interesante dhe me mjaft nuanca është edhe ngjyra e këtij objekti<sup>85)</sup>. Guna në popujt e ndryshëm paraqitet me një shkallëzim shumë të madh ngjyrash, të cilat përmblidhen në disa grupe kryesore.

Në të shumtën e rasteve ajo paraqitet me ngjyrë të bardhë pak të përlyer. Sigurisht, ngjyra e bardhë përfaqëson ngjyrën fillestare të këtij objekti, ajo është ngjyra natyrore e materialit. Nga 126 ekzemplarët e marrë në analizë, 68 janë të bardhë.

Por krahas ngjyrës së bardhë, gjatë shekujve kanë hyrë në përdorim edhe ngjyrat e tjera. Koha kur filloj përdorimi i këtyre ngjyrave nuk dihet,<sup>86)</sup> por guna me ngjyra të ndryshme kishte filluar të kishte një përdorim të gjërë<sup>87)</sup> të paktën qysh në shekullin e XVI.

Sot shohim se, pas ngjyrës së bardhë, më e përdorur është ngjyra e zezë. Nga 126 gunat e ndryshme që kemi në shqyrtim, rreth 26 kanë ngjyrë të zezë.

Edhe ngjyra blu duket mjaft e përdorur. Nga materialet në analizë me këtë ngjyrë kemi rreth 16 ekzemplarë, nga të cilët 14 me ngjyrë blu të errët (ngjyrë deti) dhe dy me blu të hapur (ngjyrë qielli).

Nga të 126 ekzemplarët, ngjyrat e tjera më pak të përdorura janë e kuqja, me të cilën kemi katër ekzemplarë (dy në Shqipëri, një në Bullgari dhe një në Greqi); ngjyra kafe, me të cilën kemi tre ekzemplarë (në Jugosllavi); ngjyra gri- një ekzemplar dhe e gjelbërtë po një (në Jugosllavi), etj.

Nga kjo analizë që iu bë ngjyrave të gunës pamë se ngjyra natyrore e materialit ishte ngjyra fillestare e saj; ngjyrat e tjera hynë në përdorim kohë pas kohe, duke u bërë me mjete primitive<sup>88)</sup>, më parë brenda ekonomisë natyrore. Me importimin e cohës, kjo solli me vete edhe ngjyrat e saj. Më vonë ngjyra e materialit filloj të hyjë në duar të mjeshtërve kazazë dhe të bëhej me pagesë. Gjatë shekullit të kaluar hynë në përdorim ngjyrat kimike, të cilat i banë nuancat e ngjyrave të gunës të shumëfishoheshin.

4) Por mbi të gjitha, ajo që i jep gunës më tepër ndryshime dhe që përfton një shkallëzim të pakufi nuancash është forma e saj. Për të shqyrtuar variantet e ndryshme të formës, duhet të shkëputen pjesët e qepura dhe të merren në analizë të veçantë një nga një, pasi rolin kryesor në formën e objektit e luan prerja e materialit. Por me që nuk i kemi të gjitha materialet, po mbështetemi vetëm në materiale shqiptare.

Prerja e pjesëve përbërëse të gunës ka qënë gjithnjë e varur nga dimensionet e materialit. Lëkura kishte dimensione të kufizuara, si në gjërsësi ashtu edhe në gjatësi, prandaj ajo detyronte që copat të bashkoheshin në të dy drejtimet; zhguni, që kishte gjatësi të pakufizuar, detyronte bashkimin e copave vetëm në drejtim të gjërsisë kurse me cohën që kishte gjërsësi dhe gjatësi të mjaftueshme, mund të zhdukej edhe kjo vështirësi.

85) Përcaktimi i ngjyrave nga materialet illustrative është punë mjaft e vësh-tirë, për arsyet e nuancave të tyre, të mundësive të piktorit dhe të shtypit për t'u pasqyruar ato.

86) Po të mendojmë se që në shekullin XII filloj importimi i cohës për guna dhe se coha ishte me ngjyra të ndryshme, duhet të pranojmë se të paktën që nga ajo kohë filloj të përdorej guna me ngjyra të ndryshme.

87) Br. Gušic, vep. e cit., shënim 108, 100, 103, 109: «... quattro gialli, due tinti et due bianchi...» (1601); «... tre tinti et uno bianco grigio...» (1610); «... quattro gialli, due bianchi et due tinti...» (1610); «... dieci gani tinti...» (1610), etj.

88) Rrok Zojzi, «Buletini i Institutit të Shkencave» v. 1950, Nr. 1-2, f. 99.

Duke qenë se zhguni është material më i përhapur, analizën tonë po e fillojmë nga gunat të cilat janë pregetitur me këtë material.

Gjërësia mesatare e zhgunit sillet rreth 30 cm., pra e pamjaftueshme për të mbështjellë krejt trupin, prandaj u nevojiten tri gjërësi, të cilat bëjnë 90 cm. (fig. 1). Nga këto tri gjërësi, njera u përdor për shpinë, e dyta për dy përparëse dhe e treta për dy kindë anash<sup>89)</sup>.






Fig. 1



A



A


Fig. 2 (a, b)

Prerja e gunës është e bërë në këtë mënyrë:

Shpina: një fletë zhguni në të gjithë gjërësinë e saj (fig. 2 A) e ngrënë pak në zverk (a) dhe në krah (b).


Dy përparëse: një fletë e dytë zhguni në të gjithë gjërësinë e saj (fig. 3 B) e prerë diagonalisht dhe e ngrënë në gjoks (a) e në krah (b).

<sup>89)</sup> M. Vélez (vep. e cit.) thotë se edhe guna bullgare ka po këtë prerje.



**Fig. 3 (a, b)**

Dy kindat e anshëm: dalë nga fleta e tretë e zhgunit në të gjithë gjërësinë e saj fig. 4 C) e prerë vertikalisht.



**Fig. 4 (C)**

Këto tri pjesë (një teke e dy çifte) përbëjnë pjesët themelore të çdo gune. Edhe kur hyri në përdorim coha, që kishte gjërësi më të madhe dhe lejonte prerje më të thjeshta, prap se prap forca e traditës bëri që të zbatohej forma e vjetër e prerjes.

Bashkimi i copave bëhet si në fig. 5.




Fig. 5

Megjithë që këto janë vijat themelore të gunës, shohim se gjatë shekujve në mes tyre u përfuan ndryshime të mëdha. Këto ndryshime, të cilat po i përbledhim në tri grupe (fig. 6), sipas paraqitjes të tyre të jashtëme, po i quajmë: guna cilindrike (A), guna trung-konike (B) dhe guna hiperboloide (C).




Fig. 6 (a,b,c.)

Po të marrim në analizë këto tri variante të gunës, do të shohim se nga pjesët përbërëse të tyre, shpina dhe përparëset janë të pandryshueshme në çdo variant, ato janë kudo të njëlllojta. Ndryshimet që çfagen i përfton vetëm kindi, me anën e të cilit përftohen variantet e gunës si formë.

a) **Varianti cilindrik i gunës**, në të gjitha çfaqjet e tij, kindat i




Fig. 7

evituar humbjen e copave a) në fig. 9. Këtë formë e shohim ende sot te gruaja e Librazhdit, Çermenikës, fushës së Domosdovës dhe ndër paka të disa fshatrave të Mokrës. Ndjenja estetike për një fund sa më të gjérë erdhi gjithnjë duke urritur dhe, krahas saj, edhe numri i kindave, siç shihet në fig. 10, erdhi duke u shtuar. Kështu u arrit që kindi të përbëhet nga 3, 4, 5, trapeza. Për t'i dhënë gjerësi edhe më të madhe, lindi një formë e re, duke bashkuar pa u prerë dy apo tri fletë të zhgunit, të cilat u prenë





Fig. 8

90) Fondet e Sektorit të etnografisë: Koleksioni shqiptar, Nr. 467.


91) Fondet e Sektorit: Koleksioni shqiptar Nr. 4039.

92) Fondet e Sektorit: Koleksioni i shqiptarve jashtë kufive Nr. 260.

93) Fondet e Sektorit: Koleksioni shqiptar, Nr. 2947.



**Fig. 9**



**Fig. 10**

diagonalisht, duke shërbyer njera pjesë për njerin kind dhe tjetra për kindin tjetër. (Fig. 11).

Kindi me formë trekëndëshi është më i rrallë dhe paraqet vetëm dy shkallë zhvillimi: me një trekëndësh të mprehtë, siç shihet në fig.





Fig. 11




Fig. 12

12. a), dhe me dy trekëndësha këndrejtë të bashkangjitur, siç shihet në fig. 12 b). Të dyja këto forma shihen te gruaja e disa fshatrave të krahinës së Delvinës dhe te sharku i gruas labe<sup>94)</sup>). Procesi i kalimit nga

<sup>94)</sup> Fondet e Sektorit: Koleksioni shqiptar, Nr. 2138.

forma e parë në të dytën dhe arësyet e tij janë po ato që u vunë në dukje për kindin me dy trapeza.

C) **Varianti hiperboloid i gunës** është një formë edhe më e zhvilluar, pasi, në vazhdim të kërkësës së parë, doli edhe kërkesa e elegancës me një ngrënie të theksuar në ijë. Kësaj iu arrit me katër mënyra: me kindin hiperboloid, me kindin dy-trapezoid, me kindin dy-trekëndësh dhe me kindin një-trekëndësh.

Forma me kindin hiperboloid është më pak e përdorur. Ajo ka vëtëm dy nuanca, të cilat përdoren po në një vend (fig. 13). Formën e parë a), të ngjashme me trapezoidin, por të ngrënë pak në anët, e shohim të guna e grave plaka të disa fshatrave të Vurgut (Delvinës); formën e dytë b), të ngjashme me të parën, por me një shëtësi në një cep, e cila i ep gjërsë edhe më të madhe se një fjetë zhguni, e përdorin të nuset dhe te të rejat po të fshatrave të Vurgut.




Fig. 13

Por më e përhapura nga të gjitha format e variantit hiperboloid është ajo dy-trapezoide, e cila kalon në disa fazë zhvillimi. Në disa raste e shohim me dy trapeza njëri mbi tjetrin, si në fig. 14, a). Të sipërmirë e këtyre e quajnë «sqetullar», kurse të poshtëmin «skungjillë». Ky variant përdoret në Lumë (Térthore), në disa fshatra të rrëtheve të Matit, Peshkopisë, Mirditës, etj.<sup>95)</sup> Në disa raste të tjera kindin e shohim të ndarë në dy pjesë (shih fig. 14b). Këtë e vemë re në xhehengun e Mirditës, në Çermenikë, në krye të luginës së Shkumbinit, në pellgun e Pogradecit, etj.<sup>96)</sup>; ose anasjelltas, si në Kërçovë, etj.<sup>97)</sup>; kurse në mjaft raste e shohim të ndarë në shumë pjesë, si në fig. 15: me tre kindë (a), si në fshatin Pëdhanë, në Kurbi, në fshatrat e Fush-Krujës; ose me

95) Fondet e Sektorit: Koleksioni shqiptar, Nr. 3259.

96) Fondet e Sektorit: Koleksioni shqiptar, Nr. 400, 3562, 7390, 8002, 5998, 7638, 4989, 4290, etj.




Fig. 14




Fig. 15

katër kinda (b), si në krahinat e Zerqanit, Bulqizës, etj.<sup>98</sup>). Në një formë tjetër të gunës hiperboloidë e cila përdoret në Mirditë, malësi të Lezhës, etj. hyn në mes të sjetullarit dëhe kindit një copë e tretë kënddrejtë (fig. 16).




Fig. 16

Forma e tretë e variantit hiperboloid është ajo e dy trekëndëshve njëri mbi tjetrin, si në fig. 17. Kjo formë kaloi në disa faza zhvillimi: atë me trekëndëshe izoshele, të vendosura njëri mbi tjetrin, si në formën a), të cilën e gjejmë në Shëngjergj, Shëmil (te xhokja e bardhë<sup>99</sup>), etj.; kurse në Ballçisht (Tetovë), në Maqedoni, etj. e gjejmë si te forma e sipërme, por me ndryshimin që kindi është i ndarë në dy pjesë, si te forma (b); ndërsa me kindin e sjetulluar dy pjesësh **me formën c)** e gjejmë në malësinë e Dibrës.




Fig. 17

97) Fondet e Sektorit: Koleksioni i shqiptarëve jashtë kufive, Nr. 344.

98) Fondet e Sektorit: Koleksioni shqiptar, Nr. 7191, 7652, 3552, 4631, 36, 2710, 3925.

99) Fondet e Sektorit: Koleksioni shqiptar, Nr. 7420.




Fig. 18

Forma e katërt e variantit hiperboloid e cila përbëhet nga një trekëndësh i vetëm, si në fig. 18 kaloi nëpër disa fazat zhvillimi. Në disa krahina shohim se trekëndëshi ndahet në dy pjesë, si në formën a). Në këtë formë janë gunat e fshatrave të Prespës, të Dropullit e të tjera<sup>100)</sup> të cilat përdoren nga plakat, të fshatrave të Dardhës, Qytezës, Sinicës, etj.<sup>101)</sup> Në disa të tjera trekëndëshit i bëhet një shtesë në një cep (shih formën b), për të shtuar gjérësinë e bazës. Një formë të tillë e shohim te floçkat e Dardhës, Qytezës, Sinicës, etj.<sup>102)</sup> Një formë tjeter është edhe kur skungjilli paraqet formën e një trekëndëshi kënddrejtë, si në fig. 19. Këtë formë e gjejmë në përdorim të gruas së Lunxherisë, Zagorisë, e Pogonit, në Volkovë (Tetovë) si dhe në dy ekzemplarë të Kovosës<sup>103).</sup>

Përveç këtyre ndryshimeve që përftoi kindi në formën e gunës,





Fig. 19

100) Fondet e Sektorit: Koleksioni i shqiptarëve jashtë kufive, Nr. 360 dhe 169.

101) Fondet e Sektorit: Koleksioni shqiptar, Nr. 2343, 7488, etj.


102) Fondet e Sektorit: Koleksioni shqiptar, Nr. 6800, 5686, etj.

103) Fondet e Sektorit: Koleksioni shqiptar, Nr. 90, 1905.




a

Fig. 20




b



a

Fig. 21



b

pavarësish nga pjesët e tjera përbërëse të saj, ai krijoj edhe ndryshime më të thella, duke ndikuar edhe në pjesët e tjera të formës, si në shpinën ashtu edhe në përparësen.

Që t'i jepej fundit të gunës gjerësi më e madhe, kindi u shtri edhe mbi shpinën, si në fig. 20 a) e b) në disa raste në përparësen, si në fig. 21 a) b), ose në të dyja, si në fig. 22.




Fig. 22

Në këto raste kindi fitoi mundësi të mëdha zhvillimi. Forma e tij si në fig. 10 mori një numër të pakufizuar trapezash; kështu p.sh. forma e paraqitur në fig. 11 u pasurua me disa fletë të reja materiali. Veç këtyre, lindi edhe një formë e re e kindit (fig. 23), sic e shohim te «guna me rrëke» e lalëve të Myzeqesë,<sup>104)</sup> ose tek ajo e vlehet e asaj krahine, ku materiali kthehet në drejtim horizontal.




Fig. 23

Por roli i kindit te guna nuk u kufizua me kaq. Në disa raste ai u zhvillua aq tepër sa zëvëndësoi krejt pjesën e fundit të shpinës, (Fig. 24). Zëvëndësimi u bë me katër forma: ose duke u shtuar aq tepër kin-




Fig. 24

104) Fondet e Sektorit: Koleksioni shqiptar Nr. 90, 1905.

105) Fondet e Sektorit: Koleksioni shqiptar, Nr. 4048.

dat e fig. 10) sa ato të njerës anë të përpiqen me të tjetrës duke neutralizuar krejt shpinën, si në gunën e burrit të Oparit<sup>105</sup>) (foto Nr. 25).



Fig. 25. Guna e Myzeqes.  
(fondet sekt. Nr. 2115).



Fig. 26. Guna e burrit nga Opari.  
(fondet sekt. Nr. 4048)

ose duke u shtuar fletët e materialit në formën e fig. 11, ose duke iu shtuar edhe një kind i tretë (fig. 22), duke u lidhur tre kinda bashkë, si në formën e re që mori guna me rrëke e Myzeqesë<sup>106</sup> siç shihet në foton nr 26, ose duke u rudhur materiali si në gunën e Leskovikut,<sup>107</sup> etj, siç shihet në foton nr. 25. Ndoshta me këtë proces lidhet edhe koreti i Zadrimës.

Këto janë disa nga ndryshimet në formën e gunës që përftohet nga kindi. Në çdo çfaqje, përvèç dy rasteve të fundit, shpina dhe dy përparrëse qëndrojnë të pandryshuara.

Duke u nisur nga thjeshtësia teknike në punimin e gunës dhe nga kërkesat më të thjeshta që kishte përdoruesi, arrijnë në përfundimin se guna me formën cilindrike përfaqëson formën fillestare të këtij objekti, forma trung-konike një formë më të zhvilluar kurse forma

106) Fondet e Sektorit: Koleksioni shqiptar, Nr. 2145.

107) Fondet e Sektorit: Koleksioni shqiptar, Nr. 5177, 5382, 5052.



Fig. 27. Guna (pirpiri) e gruas nga Leskoviku.  
(fondet sekt. Nr. 1664)

rëndësishme të gunës, aq sa mbështetet te ato për të bërë klasifikimin, duke theksuar se ka tri kategori gunash: gunë pa mëngë, me gjysmë mëngë dhe me mëngë<sup>108)</sup>. Më duket se mëngët nuk janë gjithmonë pjesë të gunës, por shtesa të mëvonëshme. Për këtë arësy problemin e tyre po e analizojmë në një pikë të veçantë.

Nga 126 ekzemplarët, që kemi në analizë, 88 janë pa mëngë, kurse vetëm 38 duken me mëngë. Por nuk është numri i tyre që na bën të mendojmë se mëngët nuk janë pjesë fil'estare të gunës dhe se janë shtesa të mëvonëshme, por disa arësy dhe materiale të tjera. Për të vërtetuar këtë, duhet të shtrojmë në analizë edhe mëngët.

Në mes të gunave pa mëngë dhe të gunave me mëngë kemi edhe një kategori tjeter gunash me mëngë të aplikuara, të cilat janë të pregatitura në këtë formë:

hiperboloide shkallën e fundit të zhvillimit të saj.

Me interes të madh është edhe mënyra e pregetitjes së punës. Në shumë krahina të vëndit tonë, ajo pregetitet nga gruaja në shtëpi, pritet dhe qepet nga ajo me materialin e prodhuar në shtëpi. Në raste të tjera, guana pregetitet me materialin e blerë, e cila pritet dhe qepet nga gruaja në shtëpi, ose pregetitja e sajë bëhet me material të blerë të pregetitur dhe që pritet dhe qepet po në shtëpi. Në disa raste të tjera pritet dhe qepet nga gra specialiste në fshat, kurse në mjaft raste të tjera punohet nga zejtari shëtitës apo në treg.

5) Përveç këtyre tri pjesëve kryesore një teke dhe dy çifte) që përbëjnë çdo gunë, disa herë ndeshim edhe në një pjesë të katërt, e cila nuk është e zakonëshme dhe nuk është gjithnjë pjesë përbërëse e saj. Fjalën e kemi përmëngët.

Maria Veleva, në studimin e saj, i konsideron mëngët si pjesë të

<sup>108)</sup> Maria Véleva — «Le costume national bulgare à double tablier», f. 61, Sofje, 1963.

a) Një gjërsë maksimale e materialit e prerë sa gjatësia e krahut, e cila rrrotullohet në formë gypi, duke u kapur me filiq dy brinjët e gjatë në mes tyre, kurse njeri bri i shkurtër kapet po me filiq me cepin e supit të gunës. Mënga, sipas rastit, hiqet dhe vihet. Mëngë të tilla ka patur në gunat e Dukagjinit (fig. 28 a).




Fig. 28

b) E qepur në formë gypi, por që lidhet gjithnjë me filiq në cepin e jashtëm të supit të gunës, si në fig. 28 b), ashtu si forma e parë, që, sipas rastit, mund të përdoret ose jo.

c) E qepur në formë gypi dhe pjesërisht e kapur nga cepi i supit të gunës, në mënyrë që mund të vishet ose të lihet e zhveshur dhe e varur prapa, si në fig. 28 c).

ç) Krejt e qepur, formë kjo që nuk lejon heqjen dhe vënien e mëngëve. Kjo krijoj nevojën e dy gunave: një pa mëngë, që përdoret çdo ditë, dhe një me mëngë, që përdoret për sipër vetëm për dimër, ashtu si në Mirditë, Dardhë, etj. Në shumë raste emri i gunës së parë kaloi në këtë të dytën, ashtu si në përgjithësi në Shqipërinë jugë-indore.

Gunat me mëngë të aplikuara paraqesin fazat e ndërmjetme në mes gunës pa mëngë e asaj me mëngë dhe që dëshmojnë për formën fillestare pa mëngë.

Veç kësaj, ajo që na vërteton se në fillim mëngët nuk kanë qenë pjesë përbërëse të gunës, por copa të veçanta veshjeje, si kalcet, brezi, etj., janë edhe të dhënët nga dokumentat historike<sup>109)</sup>. Për këtë shprehët edhe Branimir Gushiç në studimin e tij.<sup>110)</sup>

Veç këtyre argumentave, kemi edhe prova të tjera që dëshmojnë se mëngët e gunës kanë qënë pjesë e veçantë e veshjes. Në rastin e mëngëve paraqitur në fig. 28 a) dhe b), që të mbulohen pjesët e trupit të mbetur zbuluar nga lidhjet, i aplikohet në cep të supit një copë së mbulesë. Të tilla copa në forma trekëndëshi i shohim edhe sot në krahinën e Dukagjinit dhe në Malësinë e Madhe, ku përveç këtyre copave

<sup>109)</sup> Br. Gušić, vep. e cit., shënimet Nr. 50, 52, 55, 56, 57, etj.: «... item de manegge, paro 1...» (1556); «... tre gugni... col le maniche...» (1597); «,, gugni col le maniche...» (1610); «... tre pare de manige...»; «... rukavi zenske...» (1642), etj,

<sup>110)</sup> Br. Gušić, vep. e cit., f. 24.

aplikohen edhe xhufka, të cilat mbulojnë krejt lidhjet (fig. 29). Këto copë i shohim jo vetëm në objekte ku aplikohet edhe sot lidhja e mëngëve, por edhe në ato ku nuk aplikohet. Këto copë, që quhen «latica» (fig. 29), ekzistojnë ende si mbeturina pa kuptim, si në gunën e Shpatit të Sipërm dhe të Ulët në formë të trekëndëshit (fig. 29 a), në gunën e Çermenikës me laticë në formë të trapezit me bazën e vogël lart (fig. 29 b), ose të Polosit me bazën e madhe (fig. 29 c), të Qukësit me laticë në formë të një segmenti (fig. 29 ç), ose të një peskëkëndëshi (fig. 29 d), në rrëthin e Gjirokastrës me dy këndrejtë (fig. 29 dh), etj., të cilat i varen në pjesën e sipërme të krahut, etj.




Fig. 29

Si rezultat, del e qartë se të gjitha gunat e ndryshme në përdorim të popujve ballkanas kanë ngjashmëri të madhe në mes tyre dhe se, nga ana gjenetike, që të gjitha lidhen me një prototip të vjetër të përbashkët. Ndryshimet në mes tyre u përfuan nga zhvillimi i brendshëm i vetë gunës, në përputhje me kushtet e vecanta të jetës dhe me shijen e vetë popullatës së një vendi ose të një tjetri.

\* \* \*

Analiza e objektit, pa gjurmuar zanafillën dhe format e para të tij, do të ishte pa qëllim. Më parë se të analizojmë prejardhjen e objektit, po analizojmë atë të emrit të tij.

Vumë në dukje se në përgjithësi objekti në studim njihet me emrin «gunë», por mbi prejardhjen e këtij emri dhe mbi kuptimin e tij fillestare nuk bëmë fjalë. Tani po e kundrojmë emrin nga kjo pikëpamje. Për të gjurmuar kuptimin dhe formën e tij fillestare na ndihmojnë mbeturinat e tij në leksikët dialektorë dhe në zonat periferike në të cilat janë përhapur ato.

Po té vemë re emrat e ndryshëm që përdoren pér këtë objekt, shohim se në përgjithësi ata rrjedhin nga materiali i përdorur pér pregatitjen e tij. Kështu kemi emrat «lëkurçe» dhe «gozhup»<sup>111</sup>), pér gunat e pregatitura me lëkurë; emrat «leshe», «deleshe» dhe «leshnikë», që e kanë burimin në materialet e përdorura pér të; «flokatë» dhe «flockë», nga materiali «flokë»; emrat «shjak» e «shajak»<sup>112</sup>), që vinë nga emri i materialit me të cilin pregatitet; emrin «çashe» që u muar nga materiali «tjashe»; emrin «cohë», që u muar nga materiali me të cilin guana është pregatitur; po ashtu, emrat «kadife» dhe «allaxhia», të prejardhur po nga materiali i objektit, etj. Kjo traditë e emërtimit të objektit me atë të materialit nuk është e kohëve të reja, por edhe e mesjetës<sup>114</sup>) dhe, sigurisht, do të ketë qenë edhe e kohës së lashtë. Pra, ka shumë të ngjarë që këtë rrjedhim të ketë patur edhe emri «gunë».

Emrin gunë e gjejmë në përdorim nga shumë popuj me kuptime të ndryshme. Përveç kuptimit të përgjithshëm, në dialektin kajkav të serbo-kroatishës me fjalën «gunë» kuptojmë një material të thurur prej leshi<sup>115</sup>); në Çeki me fjalën «houne» kuptojnë një material të thurur me flokë<sup>116</sup> që përdoret pér shtroje;<sup>117</sup>) edhe në Poloni me këtë emër kuptojnë një material të thurur pér shtroje<sup>118</sup>); në Lituani kuptojnë një mbulesë të thurur që i vihet sipër kalit<sup>119</sup>), nën shalë apo samar, e cila në vendin tonë quhet me fjalë turke «beleme».

Nga analiza e bërë del se emri gunë përdorej pér objekte të ndryshme, të cilat nuk kanë asnjë lidhje në mes tyre, por kanë të përbashkët vetëm materialin e pregatitjes: thurjen e leshtë. Nga kjo kuptohet se në fillim emri «gunë» përdorej pér pëlburën e leshtë të pregatitur në shtëpi. Kështu, duke hyrë ky material në përdorime të ndryshme, e ndoqi pas edhe emri i tij, ashtu siç ndodh me lëkurën, tashën, flokën, cohën, kadifenë, etj., që vumë në dukje më sipër. Kështuqë kuptimi pér thurjen e leshtë është primar, kurse pér objektit e rrjedhura prej saj është sekondar. Këtë mendim jep edhe Gushiçi në studimin e tij.<sup>120</sup>)

Në përdorim të popullit tonë gjejmë edhe format më arkaikë të emrit gunë. Në Shqipërinë e veriut, në përgjithësi, me emrin «zhgun» kuptojmë thurjen e trashë prej leshi të punuar në shtëpi në vegje, me katërliq e të shkalur, të paprërë e të paqeprur.<sup>121</sup>) Për shëmbull, themi 10-15,20 pashë zhgun. Po ketë emër, «zhgun», e gjejmë në përdorim të veçantë në Dukagjin. Për ketë objekt, siç e përmendëm, gjejmë në përdorim të popullit tonë edhe format «shingun», «shangun», etj. Nga kjo kuptohet se emri «gunë» është forma e shkurtuar, që ka rrjedhur nga emrat «zhgun», «shingun», «shagun», «shangun», etj., që ruhen në populin tonë.

111) «Gozhup» — fjalë me origjinë sllave: kozuh, koze.

112) «Shajak» — fjalë me origjinë turke: pëlburë leshi e thurur në shtëpi.

113) Shih shënimin Nr. 49.

114) Acta. Dipl., vell. II, f. 179: «... la mia çocha nova...» (1399).

115) Br. Gušic, vep. e cit., marrë nga Akad. Rj. fj. gunj.

116) M. Vesmer, vep. e cit., fj. gunj.

117) Shih Nr. 115.

118) Br. Gušic, vep. e cit., fj. gunë.

119) G. Meyer, vep. e cit., fj. gunë.

120) Br. Gušic, vep. e cit., f. 24.

121) Fjalor i Gjuhës Shqipe — Instituti i Shkencave, 1954, fj. zhgun.

Për të vërtetuar më mirë ato që thamë më sipër dhe për të përcaktuar më drejt kuptimin që i jep populli fjalës «gunë», do të vëmë në dukje edhe këtë: në asnjë rast populli ynë nuk quan gunë objektin e pre-gatitur në lëkurë, i çdo lloji qoftë ai. Gunë ai quan vetëm objektin e pre-gatitur me zhgun dhe në asnjë rast atë të punuar me cohë, kadife, allaxha, etj. 122) Pra, objekti në studim filloi të quhet zhgun, shingun, shangun, shagun, gunë, etj. që nga koha kur zhguni zëvendësoi lekurën dhe vazhdoi të quhet me ketë emër deri sa coha zëvendësoi zhgunin.

«Gjurmimi i formës primitive të gunës u bë sot mjaft i vështirë» 123); megjithatë, nëpërmjet elementeve që na jep analiza që i bëmë, mund të arrijmë në format e saj primitive.

Në mes të asaj larmie materia esh dhe ngjyrash që sot përdoren për ketë objekt, zhguni i leshtë dhe ngjyra natyrore e tij përfaqësojnë dy nga elementet fillestare të objektit. Giithashtu, në atë larmi tā mëdhe formash shohim se dy nga pjesët përbërëse të tij (një teke e një çifte) paraqiten në çdo ekzemplar dhe kudo me forma të pandryshuara, prandaj këto dy elemente përfaqësojnë elementet fillestare të saj. Pjesa e tretë, që është kindi, paraqet ndryshime, por në mes tyre kindi këndrejtë, përhieshtësinë e tij, përfaqëson formën fillestare. Kështu, me këto elemente kemi përcaktuar viat kryesore të formës fillestare të gunës.


Nga gunat e ndryshme në përdorim të popullit shqiptar shohim se ajo e Martaneshit ruan të gjitha këto elemente, prandaj i qëndron formës së vjetër më afér se çdo ekzemplar tjetër. Në fig. 30 kemi paraqitur një vajzë nga Martaneshi me gunën e saj tradicionale. Pjesët përbërëse të saj janë po ato të paraqitura në fig. 5.

Megjithëqë guna e Martaneshit përfaqëson një formë të vjetër të këtij objekti, nuk mund të themi se përfaqëson formën fillestare të tij. Prototipin e vjetër e kemi në një lashtësi më të herëshme.

Fig. 30). Dy vajza nga Martaneshi.  
(fototeka e sek. Nr. 312/27A)

122) Fjalës «gunë» në këtë punim i dhama një kuptim më të gjerë nga sa ka në të vërtetë, duke e konsideruar si emër gjenerik për të gjitha variantet që paraqet ky objekt dhe me çdo lloj materiali që të jetë ndërtuar.

123) B. Gušic, vep. e cit.



Ky gjurmim më i thellë e zgjeron bazën e kërkimeve, pasi kultura primitive bëhet e përbashkët për një rreth më të gjerë popujsh.

Për veshjet e vietra të popujve të Evropës kemi shumë pak të dhëna. Materiali i parë i veshjes së tyre mendohet të ketë qenë lëkura e kafshëve<sup>124)</sup>, e cila, prej kohëve më të vjetra deri në fillim të kohës së mesme, luaiti një rol me rëndësi si veshje e popuve të veriut dhe e barinjve të Evropës jug-lindore<sup>125)</sup>. Lëkura e kafshëve është e njojur edhe nga grekët e romakët si material veshjeje<sup>126)</sup>, por nuk u preferua prej tyre si material që nuk i përshtatej trupit. Grekët dhe romakët e vjetër preferonin pëlhurat e holla e të derdhura, të cilat i përshtateshin trupit me forma të ndryshme pa u prerë dhe pa u qepur, por vetëm të kapura me disa fibula të posaçme.<sup>127)</sup> Veshjen prej lëkure të prerë dhe të qepur grekët dhe latinët e quanin veshje të popujve barbarë<sup>128)</sup>.

Gjurmët e veshjes së vjetër të popujve barbarë të kontinentit jo vetëm si material, por edhe si forma përshtatjeje mbeten të errëta dhe të paqarta për kohën tonë. Ndonjë dritë të vogël lëshojnë zbu'imet e rralla arkeologjike dhe mbeturinat në veshjet e barinjve dhe të bujqve të kontinentit.<sup>129)</sup>

Për studimin tonë është e domosdoshme njojja e tyre. Pikërisht për ketë do të analizoimë të gjitha mundësitë praktike të përdorimit të lëkurës dhe të përshtatjes së saj trupit të njeriut.

Të vetmet mënyra praktike të përshtatjes së lëkurës trupit të njeriut janë: ose aolikimi i saj mbi shpinë dhe mbërthimi në grykë, duke lënë pjesën përparrë zbuluar, ose vendosja e saj mbi njerin sup dhe lidhja në tietrin, duke lënë njerën anë të trupit të zbuluar. Ndër veshjet e popujve të Evropës i shohim të dyja format.

Nopca<sup>130)</sup> shpreh mendimin se forma e hedhjes së lëkurës mbi shpinë duke u mbërthyer në grykë, siç shihet në shumë figurina antike — dhe si shembull ai sjell një, të cilën po e riprodrohimë (fig. 31), — kaloi shekuj me radhë, duke arritur në kohën tonë, siç shihet edhe sot në formë primitive në plaidin ballkanik, në strukën e Zadrimës, të Malësisë së Madhe e të Malit të Zi dhe në mantein apo pelerinën e përdorur kudo nëpër Evropë, e cila ka një formë të zhviluar. Edhe Gushiçi<sup>131)</sup> shpreh mendimin se nga vendosja e lëkurës në njerin sup u kalua në togën e klamiden klasike dhe prej këtyre në mantelet apo pelerinat e giera, të cilat, në shekullin VI të erës sonë, pëndoreshin nga perandorët bizantinë e suita e tyre, si dhe prej atyre në mantelat e pelerinat e sotme. Kështu, të dy autorët kanë arritur në mendimin e përbashkët se nga lëkura e hedhur mbi shpinë ose në një cep u kalua në mantelin e pelerinën dhe prej saj në gunën bal'kanike. Gushiçi përpinqet ta shpjegojë këtë kalim, duke arësyetuar se në mes të

124) H. Blümer — «Technologie und Terminologie... bei Griechen und Römern», Leipzig, f. 260; Haberland, vep. e cit., f. 542; «Realixikon der Vongeschichte».

125) A. u. M. Haberland, vep. e cit., f. 541.

126) Varro, II, 11; Prop. V (IV) 7, 11 (cit. nga Blumer, vep. e cit.).

127) M. Bieber — «Griechische Kleidung» (1928), f. 2-3.

128) M. Bieber, po aty.

129) A. u. M. Haberland, vep. e cit., f. 542.

130) Fr. Nopcsa, vep. e cit., f. 190.

131) Br. Gušić, vep. e cit.

copës u çel një vrimë për të futur kokën, duke u mbështetur mbi dy supët dhe duke u varur pjesërisht para e pjesërisht prapa për të mbrojtur gjoksin dhe shpinën, sic shihet në figurën që batoi Nopçë, të cilën po e riprodhojmë (fig. 32), dhe kështu, pak nga pak, u kalua në formën e gunës së sotme.



31). Figurë e lashtë prej bronxi.  
(Nopsca fig. 123).



32). Hermas. (Nopsca fig. 122)

Mendimi i dy autorëve se nga lëkura e hedhur mbi shpinë apo në një krah nga popujt primitivë u kalua në mantelet apo pelerinat me format e ndryshme që u përdorën gjatë shekujve, duket i drejtë; por nuk pajtoshem me mendimin se guna lidhet gjenetikisht me pelerinën dhe se njera është pasardhëse, apo një formë më e zhvilluar, e tjetrës. Mendoj se në mes pelerinës dhe gunës nuk ka asnjë lidhje jashtë materialit fillestar dhe se këto kanë burime të ndryshme, pikërisht për shkak të formës së përshtatjes së materialit në trupin e njeriut.

Është e çartë se pelerina, sic shihet në format e saj primitive në përdorim të barinjve austriakë (fig. 33) (marrë nga Shuhad-Die Urlyrier, etj., f. 4), ose në përdorim të popullit shqiptar (fig. 34), lidhet me figurën e broncit të paraqitur në fig. 31, por guna, në formën e saj primitive, sic shihet në fig. 35, në përdorim të popullit italian (marrë nga Haberland), dhe në fig. 36, në përdorim të popullit shqiptar, nuk ka asnjë lidhje gjenetike me pelerinën, as edhe me figurën 33. Në këtë pozim nuk arrijmë vetëm nga një përshtypje e parë vizuale, por edhe nga analiza e saj.

Për pelerinën, që nga struka, tallagani e deri tek forma më e zhvilluar, materiali përdoret gjithnjë në formë horizontale, kurse për gunën përdoret gjithnjë në drejtim vertikal. Prerjet ndryshojnë krejt në mes



Fig. 33. Barinj nga Friermark (1810).  
(Schuchard fig. 1).



Fig. 34. Burrë nga Labërija.

tyre dhe janë bërë në baza krejt të ndryshme, të cilat japid edhe forma të ndryshme. Pelerina synon të mbrojë krejt trupin, duke përfshirë edhe gjymtirët, kurse guna mbron vetëm trupin, duke lënë jashtë gjymtirët, për t'i mbrójtur me pjesë anekse. Gjithashtu, procesi i kalimit nga pelerina te guna paraqet këto vështirësi:

Në qoftë se materialit, lëkurës së berri, i bëhet një vrimë në mes sa për të futur kokën, ai do të zbulojë trupin dhe do të mbrojë vetëm supet dhe pjesën e sipërme të gjoksit e të shpinës.

Po të kishte ndodhur kështu, shpina dhe përparëset do të ishin të një copëta vazhdim i njera-tjetrës, siç duken te këmisha, kurse te guna këto dy pjesë nuk janë në asnje rast të njëcopëta. Edhe atëhere kur hyri në përdorim zhguni, që kishte gjatësi të pakufizueme dhe këto dy pjesë mund të bëhen lehtë të njëcopëta, si për traditë, shpina është bërrë veç dhe përparëset vec, siç e shohim edhe sot. Për këto arësy origjina e gunës do kërkuar gjetkë.

Siç e përmendëm më sipër, ndër popujt barinj të Evropës duhen gjurmuar elementet fillestare të veshjes së popujve të kontinentit tonë<sup>132)</sup> dhe në barinjtë e popullit tonë duhet gjurmuar zanafilla e gunës. Në Dukagjin gjejmë në përdorim të popullit gozhupin, i cili na duhet se përfaqëson një hallkë të ndermjeme, lidhëse, në mes lëkurës së

përdorur në formë primitive dhe gunës ballkanike (fig. 37). Për këtë element edhe Haberlandi shkruan se mund të cilësohet si një element i vjetër në përdorim të popujve të Ballkanit. Për rëndësinë e tij etnografike po e marrim në analizë të veçantë.



Fig. 35. Veshje nga San-Vita (Sardenje)  
(Haberland — fig. 324).



Fig. 36. Burrë nga Dukagjini.

Në Dukagjin, Pult, Nikaj, Mertur e krahina të tjera të alpeve të Veriut ende sot është në përdorim të gjerë lëkura e deles si veshje vetëm për stinën e ftohtë. Në të kaluarën, gozhupin e kishin si veshje të vazhdueshme për çdo stinë pleq e të rinj, plaka e nuse, në gjendje natyrore me lesh përjashta.

Pregatitja e materialit bëhet në mënyrë të thjeshtë: lëkura e berri fërkohet me krunde e kripë, mbështillet në formë gypi dhe lihet ashtu një javë. Pas një jave hapet në diell për tu tharë dhe kështu materiali bëhet i gatshëm për prerje e qepje.

Për preqitjen e një gozhupi janë të nevojëshme dy lëkura berri, pasi me një nuk arrin të mbështillet krejt trupi. I madh apo i vogël, i hollë apo i trashë qoftë njeriu, apo edhe fëmijë shtatë-tetëvjeçar, gjithnjë nevojiten dy lëkura.

132) M. u. A. Haberlandt, vep. e cit., f. 541-542.

Prerja e gozhupit bëhet duke marrë dy lëkura, të cilat ngjeshen njera mbi tjetrën me lesh nga jashtë dhe u priten ekstremitet. Njera nga të dyja pritet në mes për së gjati në dy pjesë dhe formon dy përparëse. Nga ekstremitetet nxirren dy kindat në formë këndrejtë, dy laticë në formë trekëndëshi dhe dredha ose oputa<sup>133)</sup> për qepjen e tyre. Qepja bëhet duke i bashkuar copat buzë për buzë dhe duke i përshkuar në formë ujrazi me 'dredhë (herë-herë edhe me penj leshi), si në fig. 37.




Fig. 37.

Në ketë objekt shohim qartë se forma fillestare e tij kanë qenë dy lëkura, njera prej të cilave i ngjeshej gjoksit dhe tjetra shpinës, të cilat përdoreshin të paqepura, por lidheshin me njera-tjetrën në supe dhe në ije. Më vonë, për të mënjanuar lidhjet e zgjidhjet sa herë që vishej e zhvishej dhe për të zhdukur hapjet që mbeteshin në vendet e bashkimit të copave, filluan të qepen në sup shpina me përparëset, kurse anët vazhduan të lidhen edhe për një kohë. Këtë formë të ndërmjetme në procesin e zhvillimit e shohim të ruajtur në dalmatikën, ilire,<sup>134)</sup> e cila gjendet ende në përdorim të kishës katolike. Në rrugën e zhvillimit të mëtejshëm të këtij objekti, për qëllime praktike, u hap në mes dhe u qepen dy anët, duke arritur në formën e gozhupit të sotëm. Kështu më duket se ky objekt na i jep të qartë gjenezën dhe procesin historik të zhvillimit të tij deri në këtë fazë. Këtë hipotezë e vërteton edhe figura e Hermes e paraqitur nga Nopca (fig. 32).

Tani mbetet për t'u provuar a lidhen format e zhvillimit të mëtejshëm të gunës me gozhupin.

Më sipër thamë se guna e Martaneshit paraqet formën më primitive të këtij objekti të punuar me zhgun, kurse më poshtë vumë në dukje se gozhupi i Dukagjinit paraqet formën më të zhvilluar të këtij objekti të preqatitur me lëkurë. Tani mbetet për të provuar kalimin nga gozhupi i Dukagjinit në gunën e Martaneshit.

Po t'i shqepim këto dy objekte dhe të analizojmë elementet përbërëse, do të shohim se kanë aq analogji në mes tyre sa po të përjashtojmë materialin, do të thoshim se ato janë të njillojta: të njëjtat copa

133) Si e shohim në përdorim të kishës katolike.

134) Dredhë — lëkurë e prerë 2-3 mm. hollë, e cila përdoret për qepje në vend të perit.

me të njëjtat forma i gjejmë te njëri objekt dhe te tjetri (fig. 30 dhe 37). Kështu nuk mbetet asnjë dyshim se këto lidhen aq ngushtë në mes tyre sa njëra mund të konsiderohet vazhdim i tjetrës.

Nga kjo analizë që i bëmë gjenezës së gunës mund të themi me një farë sigurie se ajo e ka fillimin me dy lëkurat e kafshës që njeriu primitiv i përdori për të mbuluar trupin para e prapa; nga ato pastaj u kalua në gozhupin e Dukagjinit, te i cili fillon të kristalizohet forma e saj; nga forma e gozhupit u kalua në gunën e Martaneshit, që përfaqëson shkallën fillestare të objektit të ndërtuar me zhgun, dhe nga kjo kanoi në format e shumta të popujve e vendeve të ndryshme.

Po ta analizojmë gunën në çdo shkallë të zhvillimit të saj, do të shohim se qëllimi kryesor i lindjes së saj dhe e mbajtjes në jetë gjatë shekujve ish mbrojtja e trupit nga temperaturat e ndryshme. Dhe dihet se guna është një veshje tipike për të mbrojtur trupin nga të ftohtit.<sup>135)</sup>

\* \* \*

Po të ndaleshim në gjenezën dhe formën fillestare të objektit në studim, pa marrë në shqyrtim edhe kohën e vendin e djepit të parë të tij, studimi ynë nuk do të ish i plotë, prandaj po e shqyrtojmë shkurtimisht edhe nga ky aspekt i saj. Por para se të marrim në shqyrtim djezin e vetë objektit, po shqyrtojmë atë të emrit të tij.

Mbi burimin e këtij emri është shkruar shumë dhe lidhur me këtë ka mjaft hipoteza. Nga përdorimi i gjërë i gunës në të gjithë Evropën jugore, që nga Gjibraltar e deri në Bosfor, dhe nga infiltrimi i saj në Evropën qëndrore deri në veri, po e ndjekim këtë fjalë deri në thellësi të shekujve.

Në vendin tonë këtë fjalë e ndeshim për të parën herë në vitin 1285 «...**gornellas de xocna...**<sup>136)</sup>»; si toponim — «**villa clamada Gunesi**» (1417) dhe si antroponim — «**Bitri Gunesi**», po atë vit. Në dokumentat sllave ndeshet për të parën herë në listën e Stefan Dushanit të vi-



Fig. 38. Veshje burri nga Kurbini.  
(fototeka e sekt. Nr. 33/29).

tit 1348: «**10 goun i 10 kozuh...**» dhe në Statutin e Raguzës, ku u jepe shin rojeve të qytetit «...**ogni anno tres Yperperos et unam sclavinam po gouno**<sup>138)</sup>». Në mesjetë e ndeshim në keltishten<sup>139)</sup> dhe në shekujt IV-V të kohës së re edhe në galishten,<sup>140)</sup> me formën «**gunna**». Gjith-

135) Të këtij mendimi janë shprehur edhe autorët Gušic dhe Veleva në veprat e cituara.

136) Act. Dipl. vol. I, f. 149.

137) Leka, v. XV (1943) nr. 2, f. 45.

138) Br. Gušic, vep. e cit., shën. 55.

139) M. Vasmer, vep. e cit., dhe Kretschmer (citat i N. P. Andriotis).

140) Treccani, Encycl. Italiana, fj. gonnella.

ashtu, këtë fjalë e gjejmë edhe në greqishten e re në dokumentat bizantine: «youva» dhe në latinishten e re: «gunnus»<sup>141</sup>). Në lashtësinë e herëshme gjurmat e saj humbin fare. Në gjuhët klasike, greke e latine, kjo fjalë nuk njihet.

Gustav Mejeri shkruan se origjina e kësaj fjale është e errët<sup>142</sup>). Shtrirja aq e gjërë e saj, në distanca aq të largëta dhe në popuj aq të ndryshëm, dëshmon për një origjinë mjaft të lashtë. Me të drejtë Gušicë mendon se kjo fjalë, e cila vetëm në mesjetën e hershme hyri në fondin leksikor të greqishtes e latinishtes, e ka origjinën në popujt barbarë.<sup>143</sup>)

Mbi origjinën e kësaj fjale mendimi kaloi në galishte<sup>144</sup>), në kel-tishë<sup>145</sup>), etj., ku është dukur për të parën herë në shkrim, por nuk ka gjetur qëndresë. Jokli shprehu mendimin se djepi i kësaj fjale do kërkuar ndër gjuhët e vjetra të Ballkanit<sup>146</sup>), mendim që gjeti më tepër aprovim.

Andriotisi, në fjalorin e tij të gjuhës greke, këtë fjalë e konsideron të huaj për greqishten dhe mendon se, ndoshta, është me origjinë sllave<sup>147</sup>). Por fakti që kjo fjalë qe në përdorim të galëve që në shekujt IV-V, e përjashton këtë mundësi. Lidhur me këtë Bernekeri u shpreh prerë se kjo nuk është kurrsesi një fjalë sllave<sup>148</sup>). Ndër këto hipoteza u pranua më tepër mendimi i Joklit se kjo fjalë i përket fondit leksikor të trakishtes e llirishtes së vjetër dhe se nga këta dy popuj të afërm në mes tyre u përhap në të gjithë pellgun e Mesdheut.

Nga gjurmimi që i bëmë origjinës së emrit të objektit në studim, po kalojmë në origjinën e vetë objektit. Kalimi prej përhapjes së gjërë të këtij objekti te djepi i tij ku lindi dhe prej ku u përhap, është një punë edhe më e vështirë, pasi sa më tepër shtyhem i nё kohët e vjetra, aq më tepër materialet vinë duke u bërë më të rralla.

Në hulumtimet që bëmë për emrin, gjurmët e tij na çuan që nga kohët e tanishme deri thellë në mesjetë, ndërsa në hulumtimet për objektin gjurmët nuk na çuan përtëj kohës së re. Për shekullin e kaluar autorë të ndryshëm, si Shtakelberg, Huges, Fovel (Fauvel), Robino (Robineau), Dypre, Karara, etj., na kanë lënë materiale të mjafta ilustrative që dokumentojnë përdorimin në një shkallë të gjërë në Ballkan të gunës dhe, në vija të përgjithëshme, edhe format e saj. Për shekullin XVIII, përvëç ndonjë kuadri të rrallë, si ai i mitropolisë së Korçës<sup>149</sup>), dhe ndonjë afresku të rrallë nëpër kisha të vjetra<sup>150</sup>), so

141) M. Vasmer, vep. e cit., fj. gouna.

142) G. Meyer, vep. e cit., fj. guna.

143) Br. Gušic, vep. e cit.

144) Treccani, Encycl. Italiana, gonella.

145) M. Vasmer, Vep. e cit. dhe Kretschmer (cit. i Andriotis).

146) Walde-Hoffmann — «Lateinische Etymologisches Wörterbuch», Heidelberg, 1938, fj. gouna.

147) N. P. Andriotis — «Dictionnaire Etymologique du Grec Modern», Athinë.

148) Dr. E. Berneker, vep. e cit., dhe M. Vasmer, vep. e cit.

149) Në një kuadër të punuar nga mesi i shekulit XVIII që ndodhet në mitropolinë e qytetit të Korçës, paraqiten tre burra me gunë. Te i mesmi, me veshje vospopojar, guna është prej cohe; te dy të tjerët, me origjinë të paidentifikuar, — prej zhguni. Një kopje e këtij kuadri ndodhet në fondet e Sektorit të etnografisë me numër 33.

150) Në kishën e Shën Thanasit në Voskopojë, e ndërtuar në vitin 1749, kemi afreskun e Shën Mëhillit dhe të një qytetari vospopojar, që të dy me veshje vendi, ku guna dallohet qartë. Elemente vendëse në veshjet e shënjtorëve shihen edhe në afresket e Onufrit në kishat e Shpatit (Elbasan). (Informata gojore nga Viktoria Puzanova).

për sot nuk kemi materiale të tjera. Kurse për shekujt më të lashtë materialet mungojnë fare<sup>151</sup>. Për materialet e ngajshme nga popujt e tjerë ballkanike të dhënët na mungojnë.

Nëqoftëse nisemi nga emri dhe nga kjo të mendojmë se pasi ai ka ekzistuar gjatë gjithë mesjetës ndër popujt të ndryshëm të Evropës jugore, duhet të ketë ekzistuar edhe objekti, gabohemi, pasi kemi shumë raste që emri ekziston, por përdoret për një objekt tjetër. Edhe në qoftë se do ta marrim sikur ka ekzistuar, sigurisht, forma e tij që na intereson ne nuk qe kjo e sotmja, por një tjetër. Në këtë situatë, para një zbrasësie kaq të madhe, siç thotë edhe Nopça, na mbetet vetëm një rrugë: të hidhemi drejt përdrejt, në vjetërsi dhe të bëjmë lidhjet e drejt-përdrejta të kohës së tanishmes me atë të kohës së lashtë.

Autorë të ndryshëm kanë çfarë mendimet e tyre mbi origjinën e lashtë të gunës. Në veprën e tij, *Pukëvili*<sup>152</sup>) thotë se guna e Shqipërisë së jugut dhe e mirditasve lidhet me veshjen e kavalierëve frantezë, të cilët e sollën këtej në kohën e Kryqezatave. Ami Bue shkruan se sërbët përdorin «une jupe courte albanaise, qui rappelle le kilt des Keltes et la jupe des soldats romains», <sup>153)</sup> ndërsa Baldaçi shkruan se ka një origjinë dake-kelte-alpine<sup>154)</sup>, etj. Por këto mendime janë përshtypje vizuale dhe jo rezultat i një analize shkencore. Sidoqoftë, e lashtë.

Një studim më të thellë shkencor gunës shqiptare i bën Nopca. Me gjithë që i mungojnë elementet për të argumentuar se ajo është një material parasllav në Ballkan, ai mendon se guna ka origjinë ilire<sup>155)</sup>. Gjithashtu, Shukard pas një analize më të thellë shkencore, arrin në përfundimin se guna është një objekt ilir<sup>156)</sup>.

Të dhënët e autorëve klasikë nuk na ndihmojnë në këtë drejtim, pasi ato janë të përcipta dhe tepër të përgjithëshme. I vetmi burim janë të dhënët arkeologjike të kohëve të lashta që u zbuluan.

Nga zbulimet arkeologjike në Spanjë, Ballkan, Kretë, Azi të Vogël, etj. u përcaktuan në vija të përgjithëshme karakteret e një qytetërimi Mesdheut. Vilke, sipas Nopçës, duke krahasuar në mes tyre figurat e zbuluara në shpellat e Spanjës me figurat keramike të zbuluara në Klisë Vogël, nxorri në dritë në vija të trasha veshjen e lashtë të popujve të Mesdheut.

Në kumtesën e saj në vitin 1949, etnografia polake Janina Rozen-Przeworska, duke u nisur nga studimi i sajë me temën «Rindërtimi i veshjeve të popujve të lashtë të Evropës», krahasoi figurat e zbuluara në pellgun e Mesdheut që hynë në inventarin e objekteve të kulturës së quajtur kreto-mikenase, ose mesdhetare, me veshjet e sotme të po-

151) Gravura të ndryshme mbi veshjet e vjetra të banorëve të vendit tonë gjegjë edhe në veprën e Coronellit «Albania, Città, Fortezze», etj., shtypur në Venedik në shekullin XIV, si dhe në përkthimin gjermanisht të veprës së Barletit «Historia e Skenderbeut», shtypur në Frankfurt, MDL — XXVII, por ka të ngjarë që në gravurat e tyre të ketë dhënë një kontribut të madh fantazia e autorëve.

152) Pouqueville — «Voyage de la Greces», Paris, 18, vëll. 2, f. 214-215.

153) Amie Boué, vep. e cit., vëll. II, f. 180-210.

154) A. Baldacci — «Itenerari Albanesi». Roma, 1917, f. 6.

155) Fr. Nopcsa — «Albanien», f. 228.

156) C. Schuchhard — «Der germanische Mantel und das Illyrische Röckchen», Berlin, 1936 dhe «Die Urillycier und ihre Indogermanisierung», Berlin, 1934.

punjve ballkanikë dhe arrin në përfundimin se guna e popujve bullgar, rumun, jugosllav, shqiptar dhe grek lidhet gjenetikisht me këtë shtresë kulture dhe se ajo përfaqëson zhvillimin e mëtejshëm të veshjeve të kësaj shtrese.<sup>157)</sup> Siç duket, autorja nuk i ka patur parasysh studimet e thella të Nopçës mbi ketë argument. Figurinat e kulturës së lashtë mesdhetare paraqesin veshjet e një populli jugor, apo me klimë të butë, të shkëputura pjesa e fundit nga ajo e sipërmja, fundi i mbyllur krejtësisht përpara, kurse sipër herë i zbuluar fare e herë i mbuluar me një pjesë të dytë, me strukturë tektonike dhe funksion morfologjik krejt të ndryshëm; kurse guna ballkanike paraqitet si veshje e popujve kontinentalë, që ka për qëllim mbrojtjen nga klima e ftohtë, fund e sipër prej një cope, e celur përpara që nga gryka e gjer poshtë dhe me strukturë morfologjike të ndryshme. Nopca shpreh mendimin se veshja e popujve të lashtë që përfaqësuan qytetërimin kréto-mikenas dhe që është veshja më e vjetër e popujve të Evropës, la gjurmata e veta në xhupletën e Malësisë së Madhe, që nuk ka kurrfarë lidhje me gunën ballkanike<sup>158)</sup>. Mendimi i Nopçës u aprovua edhe nga etnograffë e arkeologë etj. të njojur si Haberland, Battaglia, Baldacci etj.<sup>159)</sup>

Nga materialet e shumta të kulturës greko-romake që gjenden të përhapura në pellgun e Mesdheut, në asnje vënd nuk ndeshim në një veshje të ngashme me gunën, gjë që vërteton se ky objekt nuk i përkiste asaj kulture. Por fakti që nuk i përkiste kulturës greke e romake nuk përashton mundësinë që t'u përkiste popuje të tjerë më pak të zhvilluar që kishin pranë, por që kishin traditat e kulturës së tyre.

Opresku<sup>160)</sup>, në një studim mbi traditat e kulturës së popullit rumun, në basorelievet e kolonave të Trajanit që paraqesin përpjekjet e ushtarëve të Romës me popullin dak, thotë se ushtarët e Dakjes së vjetër ishin të gjithë të veshur me gunën prej lëkure berri. Gjithnjë i njëti autor thotë se në Akademinë e arteve rumune në Romë pa figurina të ndryshme dakësh dhe trakësh që të gjithë të veshur me gunë. Gjithashtu, shton Opresku, edhe gjatë pushtimit romak populli trak la skulptura të trasha që, në vija të përgjithëshme, tregojnë veshjen e barbarëve të Romës në fushat e Rumanisë. Nga këto të dhëna ai arrin në përfundimin se guna në popujt e Ballkanit është trashëguar nga kultura e popujve trak dhe dak. Këtë mendim e mbështetin edhe të tjerë autorë rumunë, si Nikolaesku, Dimitresku, Romulus Vuja, Vlorea Bobu Floresku<sup>161)</sup>, etj.

Zbulimet e reja arkeologjike në Shqipëri bënë që të përforcohej mendimi i Opreskut, por baza e origjinës së gunës u zgjerua edhe në popullin ilir. Në një stelë të gjetur në Drashovicë (në rrëthin e Vlorës), e cila u transportua në muzeumin lokal të Vlorës dhe që po e paraqesim në fig. 39, shihet i nxjerrë në basoreliev një artizan me një çekan në dcrë, në veshjen e të cilit nuk shihen tiparet romake. Në pamjen e përgjithëshme ai të jep përshtypjen e një skllavi ilir të Romës: me flokë të prerë, veshje të shkurtër, etj., dhe të i cili shihet qartë guna e punuar me zhgun, e ngashme me gunën e sotme.

157) Janina Rosen — Przeworska — «Spoleczma Funkcja Odriesy». Varshavë, 1949.

158) Nopcsa — «Albanien» etj. f. 215–218.

159) Në veprat e përmëndura në këtë punim.

160) G. Oprescu — «L'art du paysan Roumain», botim i Akademisë rumune. Parathënie.

161) Florea Bobu Florescu — «Genese du costume populaire roumain» Studie si cercetari di Istoria Artei, 1959, Nr. 1, f. 43.

Një zbulim të ri bëri më 1964 arkeologu ynë Burhan Dautaj në qytetin ilir Dimalum<sup>162)</sup>. Midis të tjerash, ai zbuloi edhe një skulpturë (fig. 40), ku shihet një grua ilire së cilës i dallohet fare qartë guna, e ngjajshme me gunën që shihet në stelën e Drashovicës dhe me atë që përdor sot populli ynë.

Nga këto të dhëna të dyanëshme vërtetohet në mënyrë bindësë sikur emri i objektit në studim i përket fondit teksikor të gjuhëve trako-ilire, ashtu edhe forma e objektit i përket fondit të kulturës trako-ilire dhe se nga këto i trashëguan popullsite e ndryshme të gadishullit.



Fig. 39. Foto e sekt. të Arkeologjis Nr. 4425.



Fig. 40. (B. Dautaj, Art. i cituar)

162) Burhan Dautaj — në «Studime Historike», viti 1965, Nr. 2.

\* \* \*

Gjurmimi i gjenezës së objektit nuk do të mjaftonte pa studjuar rrjedhjen dhe transformimin e tij gjatë shekujve si dhe pa shqyrtuar gjëndjen e tij në kohën e sotme.

Siq e vumë në dukje, guna në përgjithësi ka qënë një veshje po-pujsh blegtore, e cila kishte si qëllim kryesor mbrojtjen e trupit nga klima e keqe dhe temperatura e ulët. Me zbritjen e këtyre popujve nga vise të ftohta në vise më të ngrrohta, me kalimin nga blegtoria në bujqësi, nga kasollet e hapura në banesa të myllura, etj., u krijuan kushte të reja jete, të cilat u pasqyruan edhe në veshje. Guna e vjetër, që përmijra e mijra vjet i kishte mbrojtur popujt nga klimat ekstreme, fillojë të mos ishte më aq e nevojëshme dhe, dalngadalë, të delte jashtë përdorimit. Fazat e ndryshme të transformimit të saj i shohim ende sot, kurse rastet e zhdukjes janë aq të shumta sa që po bëhen të përgjithëshme.

Rugët e zhdukjes së objektit në studim janë dy: mospërdorimi gradual dhe lënia e përkohëshme në lënien e përherëshme. Këto dy rru-gë po i analizojmë më poshtë:

Forma e vjetër e gunës që e gjatë, gjerët e gjysmëtë kërcirit të këmbës, dhe e gjerë, sa e mbështillte mirë trupin. Sigurisht, kjo gjatësi e gjerësi kishin një qëllim: mbrojtjen sa më mirë të njeriut nga klimat e ftohta. Mbeturinat e kësaj forme i shohim në malësinë e Matit, në Dibër, etj., Edhe në gravuret e fillimit të shekullit XIX ajo kudo paraqitet me këtë madhësi. Por kjo gjatësi e gjerësi e bënte objektin të rën-dë dhe pengonte në punë e lëvizje.

Për të lehtesar lëvizjen, veçanërisht në ecje, të dy kindave anash poshtë iu bë nga një e çarë e vogël<sup>163)</sup>. Me hyrjen në përdorim të kë-mishës dhe të brekëve<sup>164)</sup>, ato çelën shtigje të shumta që guna të leh-tësorej e është më tepër, duke u përbledhur, në mënyrë që të rrinte përpara e hapur. Kështu filluan t'i palosin kindat anash, si në Mat, Fushë-Krujë, Mokër<sup>165)</sup>, etj.; po kështu edhe në Bullgari<sup>166)</sup>; ose ta palosin në mes shpinën, si në Dropull<sup>167)</sup>. Por në raste të shumta u shpërvjellët dy buzët anash nga jashtë prapa dhe u vu një rrip që i mbante përpëraset të hapura, siq e shohim në Lunxhëri, Vakëfe<sup>168)</sup>, etj. Këtë formë e shohim edhe në gunën bullgare<sup>169)</sup>, etj. Këto ndryshime, të cilat lehtesan përdorimin e gunës në punë e lëvizje, veçanërisht në ecje, duke e lënë të çelur përpara, u bënë të mundëshme vetëm në saje të këmishës që mbulonte pjesët e trupit.

Për të lehtesar peshën ky objekt fillojë të pësojë ndryshime si në gjëresi ashtu edhe në gjatësi, duke u transformuar krejtësisht. Më parë fillojë të shkurtohet nga kërciri deri në mes. Të gjitha këto fazat shkurtimi i gjejmë si në popullin tonë ashtu edhe në popujt e tjerë ballkanikë. Nga guna e Matit në gjysmëtë kërcirit u kalua në atë të Mirditës deri në gju, te ajo e Librazhdit deri në gjysmëtë kofshës, te e Zer-qanit deri mbi vithe, te e fushës së Domosdovës deri në mes (qesikja), duke u zëvendësuar, më në fund, me format e ndryshme të zhvillimit

163) Shih figurat Nr. 5 c), 7, 8, 9, 10, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18.

164) Këmisha dhe brekët janë elemente të reja në këtë kompleks.

165) Shih Fondet e Sektorit, Nr. 6002, etj.

166) M. Véléva, vep. e cit.

167) Shih Fondet e Sektorit, Nr. 2343, 7488, etj.

168) Shih fondet e Sektorit, Nr. 2364, 2363, 2360, 7340, etj.

169) M. Véléva, vep. e cit.

të këmishës apo të kofsharëve. Kështu guna e vjetër arriti të transformohet në një jelek apo xhamadan, që sot e gjejmë kudo në popujt ballkanikë si mbeturinë të gunës. Që jelekët e xhamadanët janë format e fundit të gunës, për këtë kemi mjaft prova: në gravurat e shekullit të kaluar, gjatë të cilët guna është përdorur më dendur, nuk vihet rë të jenë përdorur këto pjesë veshjeje. Edhe sot, në raste të shumta ku guna përdoret ende, nuk njihen këto forma të shkurtuara të saj. Edhe emrat «shkurtë» (Sulovë), «shkurtllashë» (Kolonjë), «skourtega» (Maqedoni<sup>170</sup>), etj., që përdoren për jelekë e xhamadanë, dëshmojnë se këto objekte përfaqësojnë formën e shkurtuar të një objekti më të gjatë. Në shënimet e Prend Sulit gjejmë shprehjen «herët kha (në Mirditë) vishin dallam shkurtit» (Korçelitë), etj.<sup>171</sup>; që dëshmon për këtë fakt. Edhe format e prerjes së gunës paraqiten të njëjtë me jelekë e xhamadanë, por në përpjetime të shkurtuara. Gjithashtu, të çarat që u bëhen shin kindave anash-poshtë për të lehtësuar në ecje, me shkurtimin e gunës nga poshtë-lart, u ngjiten edhe ato nga gjuri në kofshë, sipër kofshës. Dhe arritën, të çfagen edhe në mes në jerek e xhamadan, ku nuk kanë më kuptim. Në të gjitha krahinat në të cilat guna përdoret, shihet se vazhdon tendenca e shkurtimit: nuset gjithnjë i bëjnë më të shkurtëra se plakat, etj.

Me sa duket, guna nisi të shkurtohej në fillim të shekullit të kaluar dhe zona e parë ku filloj të bëhej kjo ka qënë krahina e Toskërisë (në kuptim të hershëm), ku u ruajt emri «shkurtë» e «shkurtllashë», prej nga u përhap edhe në Maqedoni me formën «skourtega». Për këtë edhe Prend Suli thotë si me tallje (për vendet që nuk e kishin shkurtuar) «dallam shkurtit». Për këtë jemi mbështetur edhe në fjalën e Ami Buesë se sërbët përdornin një xupe (gunë) të shkurtër shqiptare<sup>172</sup>.

Përveç rrugës së transformimit, kemi edhe atë të heqjes së plotë të këtij objekti dhe të lënies së tij jashtë përdorimit. Kjo rrugë u ndoq nëpërmjet disa fazave të ndërmjeme.

Nga një kohë që guna ishte pjesë veshjeje e pandarë e njeriut, me të cilën ai mbështillej dimër e verë, në shtëpi e jashtë, në punë e në festë dhe e konsideronte turp të mos paraqitej me të (veçanërisht gruaja), arriti që ajo të lihej krejt jashtë përdorimit. Më parë e lanë fëmija (djem e vajza); më vonë burri e hoqi në shtëpi, por e mbante jashtë, deri sa e flaku fare; gradualisht pastaj e hoqi gruaja, më parë në shtëpi, por jashtë nuk delte pa të; pastaj mbeti veshje ceremoniale për festa, më pas si veshje e domosdoshme vetëm për martesë dhe, në fund, u hoq fare.

Kështu sot, në Shqipëri e në Ballkan, në shumë vende kemi ende në përdorim gunën; në shumë të tjera e kemi të zëvendësuar me forma të shkurtëra; kurse në raste të shumta u la fare jashtë përdorimit.

#### RROK ZOJZI

170) A. Boué, vep. e cit., vëll. II, f. 213.

171) Prend Suli, rev. «Leka», viti 1937, Nr. 7-8, f. 395.

172) A. Boué, vep. e cit., vëll. II, f. 207.

## LA GUNA DANS LA TRADITION DES PEUPLES BALKANIQUES

En partant de l'unité et de la variété des traditions culturelles des peuples balkaniques, l'auteur observe que ces deux qualités ne sont reflétées plus clairement que dans leur habillement. Les vêtements des peuples balkaniques ont été jusqu'à ce jour étudiés en échelle nationale et ce n'est que fort rarement qu'on est passé à un examen général. Même quand on est passé à de telles observations, faute de renseignements, les résultats ont été incertains.

Les vêtements portés par les peuples des Balkans présentent une variété entre eux dans plusieurs points de vue. Partout dans les Balkans, chez l'homme et la femme, le riche et le pauvre, le jeune homme et le vieillard, nous voyons l'usage de la chemise, de la guna, d'une paire de caleçons, d'une ceinture, et chez la femme d'un tablier. Quoique ces éléments se présentent avec des matériaux, des couleurs, formes et décors variés, ils n'en accusent pas moins de lignes communes quant à la construction. Pour en donner la conformation, il faut faire l'analyse de chaque pièce de vêtement. Etant donné qu'un tel travail implique les matériaux concrets à analyser, l'auteur analyse la guna qui est la pièce la plus importante des vêtements des peuples balkaniques.

Il fait l'analyse de la guna en s'appuyant sur les 126 exemplaires du type albanais, yougoslave, roumain, bulgare et grec. Les sources des matériaux sont puisées dans la littérature illustrative.

Il en commence l'analyse par son nom, et ayant constaté que le terme «guna» se trouve dans tous les peuples des Balkans et même en Europe du Sud et du Centre, il revient à l'analyse du matériel et constate que d'après l'antiquité on a dû employer auparavant le cuir, la laine, l'étoffe, la toile et le velours. Ces matériaux ont dû avec le temps se céder la place l'un l'autre. Ensuite il en analyse les couleurs et arrive à la conclusion que la couleur blanche a devancé toutes les autres, puis vinrent successivement les autres couleurs. Il tend toujours à analyser la forme de la coupe qui fournit les éléments les plus sûrs de l'unité de l'objet. Sur 3 pièces composantes (2 pairs et un impair), il n'y en a qu'une qui diffère d'une guna à l'autre, tandis que deux autres ne changent pas. Il analyse ensuite la guna aux manches et sans manches et arrive à conclure que la forme originale a été sans manches.

Après cette analyse il arrive à une synthèse. En recueillant les éléments d'origine de la guna, nous voyons que sa forme première était en peau de mouton, et sans manches, comprenant 3 pièces. Puis il cherche quel est l'exemplaire actuel qui conserve les caractéristiques originales et arrive à la conclusion que le «gozhup» de Dukagjini conserva la forme originale.

Après cette constatation il observe la genèse de l'objet. Selon quelques données que conserve l'objet, l'auteur estime que l'origine doit être cherchée dans deux peaux que les hommes primitifs utilisaient pour se couvrir le corps en mettant l'une devant, l'autre sur le dos, et les rattachant sur les épaules et les deux côtes.

L'auteur fait tout d'abord l'analyse de son nom. En s'appuyant sur différentes étymologies, il prouve que le nom «guna» revient aux peuples traco-illyriens. Dans sa forme aussi, les matériaux moyenâgeux lui faisant défaut, il revient à l'antiquité et s'efforce de relever la liaison existante entre l'antiquité et la période actuelle. En s'appuyant sur les matériaux archéologiques existants, il conclut que cet objet appartient aux peuples antiques illyro-traces.

Après ces conclusions, l'auteur suit la dégénération de cet objet et sa mise hors d'usage à l'époque contemporaine.

## ГУНА В ТРАДИЦИЯХ БАЛКАНСКИХ НАРОДОВ

Исходя из единства и разнообразия в культурных традициях Балканских народов, автор отмечает, что нигде не проявляются более ярко эти два признака, чем в их одежде. До настоящего времени одежда балканских народов исследовалась в рамках национальной последовательности, редко прибегалось к обобщающему рассмотрению. И при обобщающем рассмотрении из-за недостатка сведений, не было достигнуто достоверных выводов.

Среди народов Балканов более чем с одной точки зрения можно отметить разнообразие в одежде, но это лишь при строгом контроле

морфологическом анализе. В действительности же, везде на Балканах у мужчин и женщин, у богатых и бедных, у молодых и старых, мы в стретимся с той же руоашкой, с той же гуной, (род бурки), с теми же гамашами, с тем же поясом и у женщин с тем же передником. Хотя они сшиты из разного материала, разными формами и украшениями, везде обнаруживаются некоторые черты. Это можно подтвердить лишь при анализе каждой части одежде. Вследствие того, что такая работа потребовала бы большого конкретного материала, автором проанализирована только гуна, представляющая собой более показательную часть одежды балканских народов.

Основу анализа составили 126 экземпляров из Албании, Югославии, Румынии, Болгарии и Греции.

В основном материалы извлечены из иллюстративной литературы.

Анализ начинается названием гуны, причем устанавливается, что слово это встречается у всех балканских народов, а за пределами Балканов и в Южной и Центральной Европе. При анализе материала установлена такая хронологическая последовательность: сперва использовалась кожа, а далее, шерсть, полотно и бархат. Далее анализируются цвета: Первым цветом был белый, позднее, вмешались другие цвета. Форма кройки даёт надежные элементы единства объекта. Из 3 составляющих частей (2 парных и 1 отдельной) лишь одна часть меняется от одной гуны к другой, а 2 остальных остаются неизменными. При рассмотрении гуны с рукавами и безрукавкой, установлено, что исходный тип был безрукавным.

После анализа переходится к синтезу. При сборке начальных элементов гуны, выявляется её исходная форма из овечьей шкуры, без рукавов, состоящие из 3 частей. Из обследования современных экземпляров делается вывод, что оригинальные характеристики сохранены в типе гуны области Дукагыни.

Прослеживается далее генезис объекта. На основании некоторых данных, сохраняющихся в самом объекте, автор полагает, что происхождение следует искать в тех двух овчинках, которыми первобытный человек облекал свое тело, прилагая одну спереди, другую сзади, связав их под плечами в двух местах.

Прослеживая происхождение объекта, рассматривается и его название. На основании данных разных этимологов, доказывается, что название гуна принадлежит древним трако-иллийским народам. В связи с формой так как недостает средневековых материалов, сделана попытка установить связи между древностью и настоящим. На основании существующих археологических материалов приходится к выводу, что этот объект принадлежал при древним трако-иллийским народам.

Далее автором рассматривается вырождение объекта и его изъятия и выход из употребления.

## VESHJA E VLLEHVE TË RRETHIT TË KORÇËS<sup>(1)</sup>

Këto vitet e fundit, shumë familje vllehësh nomadë janë vendosur grupë-grupe nëpër fshatra të rrëthit të Korçës, si p.sh. në Drenovë, Mborje, Boboshticë, Floq, Dardhë, Kamenicë, Voskopojë, Vithkuq, etj. Përveç fshatrave të rrëthit të Korçës, vllehet janë vendosur edhe nëpër fshatra të ndryshme të rrëthit të Gjirokastrës, në afersitë e Delvinës etj.

Duke qenë se jeta e vllehive po ndryshon në mënyrë rrënjosore, për shkak të ndryshimeve të thella që ngjanë në jetën e tyre ekonomike, edhe veshja e vjetër po ndryshon me shpejtësi, duke iu përshtatur kushteve të reja.

Në këtë artikull do të përshkruaj veshjen e vllehive të vendosur në fshatrat Drenovë e Boboshticë, duke u bazuar kryesisht në të dhënat e mbledhura në këto fshatra në tetor të vitit 1963, të plotësuara aty-këtu me materialet e koleksioneve të muzeut lokal të Korçës e të sektorit të etnografisë të Institutit të Historisë e Gjuhësisë.

Në anën tjetër, do të përpinqem të ve në dukje ngjashmëritë midis veshjes vllehe e asaj shqiptare dhe, së fundi, do të përpinqem të bëj një shtresim kronologjik të pjesëve të veshjes, duke dalluar elementet më të vjetra.<sup>(2)</sup>

### V e s h j a   e   g r a v e

Simbas informatave që muarëm deri rrëth vjetëve 30, veshja e grave vllahe përbëhej nga këmisha e gjatë, jeleku, cibuni, brezi dhe përparja prej shajaku.

1) Fotografitë që ilustrojnë artikullin janë bërë nga autorja, kurse vizatimet janë punuar nga Ikbale Bihiku, sipas skicave të autores.

2) Një përshkrim të saktë të veshjes së vllehive na ka dhënë G. Weigand në veprën e vet: Die Aromunen, ethnographisch-philologisch-historische Untersuchungen, Leipzig, 1895. Informata për veshjen e barinjve vllehë në filim të shekullit tonë gjenden, po ashtu, te A. J. B. Wace and M. S. Thompson: The Nomads of the Balkans, London, 1913, f. 60. Një përshkrim të veshjes së vllehive nomadë na ka dhënë gjithashtu edhe T. Capidan në veprën e tij «Farserotii», Bucuresti, 1931, f. 20-23. Këtë e ka përsëritur disi më të shkurtuar në veprën e tij të mëvonëshme: Les Macedo-Roumains, Bucarest, 1937, f. 15. Por ky autor nuk ka bërë asnjë përpjekje për të vënë në dukje ngjashmëritë ose edhe ndryshimet e veshjes së vllehive me veshjen e shqiptarëve. (Në faqen 82 të veprës së cituar fig. 42 mban diciturën: «Frashëriote nga Berati», kurse në të vërtetë ajo është një nuse nga Malësia e Madhe e veriu të Shqipërisë, e veshur me kostumin aq karakteristik të xhubletës). Të dhëna të vlefshme gjiejmë edhe te T. Papahagi: «Dictionnarul dialectului aromân», Bucuresti 1963, në zërat përkatëse për veshjet.

Së pari gratë vlehe vishnin një fanellë, që në të folmen e tyre e quajnë **koça**<sup>3)</sup>. Ajo pregetatet prej shajaku<sup>4)</sup> të zi ose blu të errët, punuar në vegël nga vetë gratë. Prerja bëhej si në fig. 1, duke iu përshtatur kryesisht gjërësisë së fletës së shajakut, që lëkundëj midis 28-30 cm. Në supet shajaku nuk pritej fare; në të dy anët i shtohej nga një kind i drejtë, baraz me gjysmën e gjërësisë së fletës së shajakut, dhe mënga kishte një fletë tjetër. Mund të shënojmë këtu se te gjoksi, atje ku kopsiteshin të dy fletët, fanella kishte një lapë të ngushtë e të gjatë shtuar anës së djathë, me qëllim që të siguronte një mbylli-je sa më të mirë për mbrojtjen e gjoksit nga era.

Mbi fanellë vishej **këmisha**, e cila pregetatet prej pëlhure pambuku të bardhë, të importuar. Ajo ishte e gjatë deri te pulpa e këmbës, me mëngë të gjata e të gjëra, të mbledhura me një dorëz të ngushtë te kyçi i dorës. Këmisha zbulurohej pak te jaka e te dorezat e mëngë-




Fig. 1

3) Kjo fjalë mungon në veprën e cituar të T. Papahagi.

4) Në këtë artikull fjalë **shajak** është përdorur gjithnjë për të treguar një pëlhurë leshi të punuar në vegël me katër lisa dhe të dërtilur.

ve. Shumë herë mëngët e saj nuk ishin të bardha, por të zeza ose blu. Këmishët e plakave nuk kishin asnjë zbukurim.

Pas këmishës vinte cibuni (**sheguni**, në të folmen e vlehvë) <sup>5)</sup> prej shajaku të zi (fig. 2) dhe mbi të një jek shajaku që ishte i terti i qendisur (fig. 3) me gajtan ngjyrë vjollce, të gjelbër e mavi, zbukruar aty-këtu edhe me pak fije tehri ari. Cibuni me gajtanët e tij ngjyrë vjollce në çiklamin të kujton cibunin e grave të Murzinës në rrethin e Delvinës. Motivet e zbukurimit të jekut paraqiteshin të njejtë me ato të çepkeneve të dikurshme të burrave të Devollit e të rrë-



Fig. 2




Fig. 3

5) T. Papahagi e shkruan «siguna» dhe «sigune»; vep. e cit. zëri përkatës.

thit të Korçës, megjithëse këto të fundit ishin të bardha e të qendisura me gjajtan të zi.

Si këmishën e gjatë ashtu edhe cibunin e jekun këta vlehäë kanë kohë që nuk i përdorin, kështu që as në Drenovë e as në Boboshicë nuk pashë ndonjë prej tyre. Ekzemplarët e fotografuar ruhen në fondet e muzeut lokal të Korçës<sup>6)</sup>. Këto pjesë veshjeje i kanë përshkruar edhe autorët e përmendorur në shenimin Nr. 1 Madje, ata shtojnë edhe një veshje tjetër dimri, sharkun (sarka) e grave, që tanë ka dalë krejt nga përdorimi. Ai ishte fare i ngjashëm me floken që vishnin dikur mbi cibun gratë e rretheve të Korçës, Kolonjës, etj.

Sot gratë vlehe pak të shkuara në moshë veshin mbi këmishën një fustan shajaku me trup të drejtë, me pala të gjëra nga mesi e poshtë, me mëngë të gjata, të zbukuruara te gjoksi te skajet e mëngëve dhe përfundi me një rrip kadifeje të zezë. Ky fustan, më prerjen e tij dhe mënyrën e zbukurimit me rripa kadifeje të sjell ndërmend fustanet prej shajaku të grave të Kolonjës.

Plaka Kostandina Trasha, nga katundi Drenovë, kishte veshur mbi fustanin prej shajaku një veshje të sipërme të gjatë gjer nën mes, pa mëngë dhe që në të folmen e vlehve quhet sérëkushte (me sa duket, një zvogëlim i fjalës sâri-câ). Kjo veshje ishte prej shajaku blu të errët, prerë e qepur me dorë nga vete gruaja shtëpijake, me penjë lesi dhe me nga tri radhë gjajtan të leshtë blu anëve. Trupi i sérëkushtes ishte i drejtë deri në 7-8 cm. nën sqetull dhe pastaj i vinte përfundi një si bordurë pothuaj 20 cm, e gjërë, e përbërë prej kindash në formë trapezi (me baza 7 cm. dhe 2 cm), të cilët, të qepur njeri pas tjetrit (rreth 40 kinda gjithsej), bashkoheshin me rudha me trupin e drejtë të sérëkushtes (shih

Fig. 4  
foton Nr. 4 dhe skicën Nr. 5.)

Sérëkushta, nga prerja e saj, afrohet me xhokën e kostumit të gruas së Malësisë së Madhe, që preqatitet prej shajaku të zi dhe në përgjithësi është më e zbukuruar se sérëkushta<sup>7)</sup>. Edhe Capidan ka




Fig. 5

6) Objektet me numër inventari 245 dhe 972.

7) Për krahasimin me Malësinë e Madhe shih objektet me numur inventari 470; 2913, 2914, 5142, etj. në fondet e sektorit të etnografisë.

përshkruar një sërëkushte<sup>8)</sup>, kurse Weigand, Thompson and Wace dhe Papahagi nuk e përmendin fare këtë.

Pastaj gratë vinin përparësen (*podhjaua* në të folmen e tyre), e cila më përpara bëhej prej cohe të kuqe dhe zbulurohej me qendisje të ndryshme, kurse sot bëhet po ashtu si fustani, prej kadifeje të zezë me pak zbulurime përfundi (fig. 6).

Mbi përparëse ngjishnin brezin (*kurao*), i cili mund të ishte 5-10 cm, i gjërë, prej lëkure, i punuar nga saraçët dhe i zbuluruar me disa komça, ose me një shtresë ruazash të punuar nga vetë gratë (fig. 7), që i aplikohet sipër pjesës prej lëkure; por ka edhe raste kur brezi bëhet thjesht prej ruazash me një shtresë astari nën të. Gratë mbathnin çorape prej leshi, të gjata deri në gju e të lidhura me gjalmë. Këto i punonin vetë gratë me pesë shtiza me fije leshi prej ngjyrash të ndryshme, duke filluar që nga maja. Pastaj vinin opingat e kuqe me xhufka të mëdha, të cilat më vonë u zëvëndësuan nga këpucë të zeza të thjeshta.

Një pjesë interesante e veshjes së grave është **limbaveta**, një lloj shalli i pambuktë, i gjatë rrëth 1,50 m., i cili sillej një ose dy herë rrëth qafës, duke lëshuar të dy krerët prapa. Edhe përkëtë pjesë të veshjes nuk flet asnjeri nga autorët e lartpërmendorur.



Fig. 6




Fig. 7

8) T. Capidan: *Farșeroșil*, București, 1931, f. 21.

Një copë mjaft interesante në veshjen e grave vllahe dhe që përdoret si veshje dimri, është dhe **polla**, siç e quajnë atë vllahët. (Fig. 8



Fig. 8

dhe skica 9). Ky ndoshta mund të jetë një shtrembërim i fjalës **poalë**. Kjo është një lloj shalli apo pelerinë në formë katërkëndëshi këndrejtë në përmasa afersisht 100 cm. x 72 cm. Bëhet me dy fletë e një të katërt shajak të zi. Është e zbukuruar anëve me rripa kadijeje të zezë ose blu, me shirita leshi me fije të zeza e ngjyrë vaji dhe vendevende më ruaza të vogla në ngjyrë të zezë, blu, bojë vaji e bojë qielli. Polla mbërthehet me një rrip të ngushtë shajaku, të gjatë 10-12 cm. Në skajin e rripit qepet një kapëse teli, që shërben për t'u mbërthyer me një iliq në pjesën koresponduese, që ndodhet në anën tjetër të pollës. Polla është një petk që hidhet supeve vetëm në dimër; kur gruaja është e ngarkuar në shpinë, ajo hidhet mbi ngarkesën. Nga forma e saj, ajo të kujton pa tjetër klamidën e grekëve të lashtë (që mbulonte gjithash tu të dy supet, duke u kapur rrëth qafës me një fibul, po nuk mund të mbulonte gjithë trupin, prandaj vishej zakonisht mbi tunikën) si edhe veshje të tjera të ngjashme të kohës antike si ishin abolla, sagum etj. (9).

Ngjashmëri si në formë ashtu edhe në përdorim polla paraqet me strukën e Malësisë së Vcgël, të cilën F. Nopcsa na e përshkruan si «një petk katërkëndësh, dy herë më i gjatë se i gjërë, i përbërë prej një pëlzure të leshtë me thekë në fund...», që malësorët «e veshin sidomos për shi, duke e hedhur në shpinë dhe mbi supe». Po ky autor e afrostrukturën e këtyre malësorëve me «col-in» rumun, ose «sarica-n» (10).

Këtë pjesë të veshjes nuk e ka përshkruar dhe as përmendur ndonjëri prej autorëve të cituar në shënimin Nr. 1.

Gratë vllahe i mbajnë flokët të ndara në mes e të thurura në dy gërshtë që lëshohen prapa. Nuset e reja mund të venë në flokët për zbukurim ndonjë krehër dhe karfica.

Zakonisht, gratë e mbajnë kokën të mbuluar me një shami të madhe të zezë, të lidhur, siç tregohet në fig. 10. Gratë e shkuara në mo-

9) Shih për këtë L. Heuzey — «Histoire du costume antique», Paris 1935, f. 115, fig. 61, në f. 122 dhe f. 130, dhe Ch. Daremberg — E. Saglio — «Dictionnaire des Antiquités Grecques et Romaines», Paris 1887, T. 1, f. 9; T. 10, f. 1008.

10) F. Nopcsa — «Albanien», Wien 1925, f. 174, 197.




Fig. 9

shë lidhin mbi të parën një shami të dytë, e cila vendoset në majë të kokës, duke lëshuar cipat drejt përpara, të kapur te përparja në bel, ose duke i lidhur prapa kokës. Mendoj se kjo mënyrë e të lidhurit të kokës është një ndikim relativist i vonë i ambientit shqiptar, sepse të gjitha plakat pak të shkuara në moshë që pyeta më thanë se më përpara nuk e mbështillnin kokën kështu. Gratë më të reja në moshë, në vend të shamsë së dytë, lidhin një shall leshi të punuar me dorë, kurse nuset e reja, kur dalin, nuk mbajnë fare shami në kokë, por i krehin flokët mirë dhe hedhin supeve një shall të mëndafshët, të punuar me dorë, me ngjyra të ndryshme (fig. 11).

Sipas përshkrimeve të atyre që kam pyetur, gratë vllëhe, deri rrëth vjetëve '30, kanë mbajtur në kokë çuparen<sup>11)</sup>, që bëhej me një geleche të zakonëshme burri, së cilës i hiqej fundi dhe rrëthi që mbe-



Fig. 10

<sup>11)</sup> Për këtë objekt T. Papahagi, në vep. e cit., zëri përkatës, jep këtë shpjegim: «couvre — chef des femmes des Färserot».

tej vishej me një copë të zezë, mbi të cilën lidhej një shami e qendisur me shumë ngjyra. Mbi këtë shami qepej kurora prej metali e larë në argjend. Këto kurora qenë zakonisht të punuara me të rrancur dhe me incizim dhe herë-herë kishin të aplikuar një yll në mes, dy selvi anëve e të tjera motive të zbukuruara me savat. Në fondet e sektorit të etnografisë ruhet vetëm një ekzemplar i tillë, kurve në fondet e muzeut lokal të Korçës janë shtatë copë, (12) nga të cilat po japim katër skica. (fig. 12). Si formë, këto kurora nuk janë veçse një hark i gjatë afersisht 30-32 cm. dhe i gjerë 6-7 cm. Çuparja qëndronte disi e mbështetur te shamia e zezë, e mbështjellë në një rrip 5-6 cm. të gjërrë, të cilin gratë vllehe e lidhnin në mes të ballit. Kjo shami e lidhur kështu në mes të ballit, me çipat që varen prapa, ishte një karakteristikë dalluese e grave vllehe, pas së cilës mund t'i njihje që në shikimin e parë. Një shami të tillë të zezë, të lidhur po në të njëjtën mënyrë, mbajnë gratë e Malësisë së Madhe. Por sot vetëm në të rrallë mund të takosh ndër vlehet e Drenovës dhe të Boboshticës plaka që e mbajnë ende këtë shami. Mendoj se çuparja është një element specifik i veshjes së grave vllehe; në veshjen e grave shqiptare nuk njohim ndonjë objekt të ngjashëm me të.



Fig. 11

Një element tjetër që duhet vënë në dukje është përdorimi i tatuzashit. Edhe T. Capidani përmend një zakon të tillë, por pa dhënë

(12) Objektit me numra inventari 23/1 — 23/7.




Fig. 12

hollësira<sup>13)</sup>. Ndër vlehet e sotëm ka akoma plaka që ruajnë në trupin e tyre shenja tatuazhi, të cilat ato i quajnë «vula». Plaka pothuaj njëqindjeçare Marina Niço në Boboshticë, kishte dy vizatime të thjeshta (skica 13) në të dy duart dhe një tjetër në mes të ballit. Në




Fig. 13

llëren e dorës së diathtë kishte të shënuar datëlindjen e saj: 1869. Ajo më tregoi se këto «vula» me thëngjill (**kärbun**, në të folmen vlla-

13) T. Capidan — «Les Macedo-Roumains», Bucarest, 1937, f. 17.

he) i ka bërë kur ishte 12 vjece. Shtypej thëngilli si miell, njomej me pak raki, pastaj merrej një kleçkë me majë dhe, duke e ngjyer në qullin e preqatit, bëhej vizatimi i dëshiruar, gjithnjë në llërë apo në ballë, por jo në ndonjë pjesë tjetër të trupit. Vizatimit i hidheshin dësa pika raki përsipër dhe pastaj çpojeh lëkura me gjilpërë sipas vijave të vizatuara. Përzierja e formuar nga pluhuri i thëngjillit, rakia dhe gjaku hynte në lëkurë duke lënë shenja për tërë jetën.

Sikurse e pamë më lart, në veshjen e grave vllahe të bie në sy përgjithësish përdorimi i ngjyrave të errëta me një mbizotërim të theksuar të ngjyrës së zezë. Kjo ngjyrë arrin të përdoret deri në këmishët e brendëshme. Zbukurimet e pjesëve të veshjes, siç u vu në dukje më sipër, janë të pakëta.

### Veshja e burrave

Deri rrëth vitit 1910 burrat vlehä janë veshur me tirq, apo kallce, prej shajaku të bardhë, këmishë të gjatë ose fustane dhe sipër me cibun e peshli. Kjo e fundit ishte prej shajaku të bardhë.

Ky variant i veshjes vlehä eshtë më i vjetri për të cilin munda të mbledh informata. Me qenë se ka dalë nga përdorimi prej kohësh, nuk e gjeta dot as në Drenovë as në Boboshticë, por një kostum i tillë ruhet në fondet e muzeut lokal të Korçës<sup>14)</sup>, megjithëse jo krejt i plotë, sepse i mungon këmisha e gjatë. Duke qenë se të dhënat që mblođha nga informatorët<sup>15)</sup> përputheshin plotësisht me këtë kostum, përshkrimin e kam bazuar në pjesët e tij, duke e ilustruar me fotografitë e një plaku vllah nga Dardha me një veshje të tillë, fotografuar në vitin 1960.<sup>16)</sup> Këtë variant të veshjes së burrit vllah e kanë përshkruar më 1892 Weigand dhe më 1913 Thompson and Wace.<sup>17)</sup> Në fillim vishej fanella, e cila preqatitë prej pëlhure vegle prej leshi të bardhë. Ishte e gjatë deri nën mes, me mëngë të gjata, e hapur përrapa pak në anën e djathtë. Te gjoksi dhe te dorëzat e mëngëve zbutur kurohej me pak qendisje këtë e qepnin vetë gratë. Sipër fanellës vinte këmisha prej kambriku të bardhë, e gjatë deri nën mes, me mëngë të gjata deri te llëra dhe shumë të gjëra që nga supi. Edhe kjo bëhej me material të blerë dhe e qepnin vetë gratë. Nga mëngët e këmishës duke sheshin mëngët e fanellës, që arrinin deri te kyçi i dorës. Poshtë vishesh të mbathurat, të cilat bëheshin ose prej pëlhure vegle prej preqatitura gjithnjë nga gratë. Vinin pastaj tirqet, që në të folmen e tyre vlehät u thonë çoriçi<sup>18)</sup>, të cilat bëheshin prej shajaku të bar-

14) Objektet me numëra inventari 272-278.

15) Për këtë më kanë folur Ndino Niça, nga katundi Drenovë dhe Tusha Niço, nga Boboshtica.

16) Fotografitë me numër 24 e 25 janë bërë nga Rr. Zojzi.

17) G. Weigand në vep. e cit. f. 260. Në f. 256 ka një fotografi që paraqet një çel-pak frashëriot të veshur me kostumin e lartpërmendur; A. J. B. Wace — M. S. Thompson «The Nomads of the Balkans», London, 1913, Kap. IV.

18) T. Papahagi në vep. e cit. bën këtë përshkrim për tirqit (cioariti): «Sorte de chausses en drap de menage blanc ou noir qui montent au-dessus des genoux, ou on les fixe à l'aide des jarretières nommées stringe, en bas sous le creux de la plante du pied on les fixe à l'aide de stelle et au-dessous des genoux à l'aide de caltavete...» Cioareci aromânilor au exact forma ciorapilor oraşenesti de damă, dar nu au talpi».

dhë, të rudë dhe që ishin të prera veref (skica 14) në formën e zakonëshme, këto ishin të gjata deri në rrëzë të kofshës, dhe këshin lart nga një iliq të gjatë, me anën e të cilit kapeshin me një gjalmë te brezi, për t'i mbajtur ngritur. Tirqet, me që ishin prerë veref, lejonin lëvizje të lehta të gjunjëve, megjithëse ishin të ngushta. Ato i priste dhe i qepte gjithnjë rrobaqepësi. Nën gju, për të qëndruar më mirë, lidheshin me dizga (në të folmen e vleħħve **kalciveti**), të punuara nga gratë. Fustani ngjishej në mes dhe arrinte deri mbi gjunjët. Béhej prej kambriku të bardhë dhe gjérësia e tij varej se sa i pasur

do të ishte ai që e mbante; por njëkohësisht gjérësia e tij varej edhe nga ajo se nga cili do të përdorej. Fustanet e dhëndërissë ishin përgjithësisht më të gjëra se ato të zakonëshmet dhe bliheshin të gatëshme në treg. Mbi këmishë vishej jeleku prej cohe blu, ose prej shajaku, me prerje krejt të thjeshtë. Vinte pastaj sipër tij cibuni (**shegun**, në të folmen e vleħħve), i gjatë baraz ose pak përmbi fustanin. Cibuni pregetitej prej shajaku të bardhë dhe, përveç dy-tri fijeve gajtani të bardhë lesi qepur anëve rreth e qark, nuk kishte për zbukurim veçse një motiv të thjeshtë sigmoid te gjoksi, të cilin, për ta vënnë më mirë në dukje, e vendosnin mbi një sfond të errët, zakonisht blu ose të zi. Ay nga mesi e poshtë kishte një gjérësi të konsiderueshme, që lëshohej në shumë kinda rreth trupit (skica 15 dhe fotua 16). Mbi cibun ngjishej brezi (**bér**)<sup>19</sup>, i gjatë 2-2.5 m, i cili ishte prej placë me ngjyra të ndryshme, që blihej në treg, dhe së fundi vishej peshlliu (**dullmiç**, në të folmen e vleħħve)<sup>20</sup>, prej shajaku të bardhë. Ky kishte prerjen karakteristike shqiptare, me mëngët të lëshuara prapa, të cilat shumë herë ishin mjaft të zbukuruara, këto kishin një funksion pothuaj krejt dekorativ, sepse visheshin shumë rrallë (foto 16). Në verë, kur nuk mbahej cibuni, peshlliu vishej mbi jelek. Në kokë burrat vleħħi mbanin feste të kuqe me xhufkë, ose edhe thjeshtë




Fig. 14

19) Me po këtë kuptim e po këtë formë edhe T. Papahagi, vep. e cit. (bär).

20) T. Papahagi në vep. e cit. e shpjegon: «Manteau de drap, court jusqu'a la taille, que portent les aroumains», me prejardhje nga «dulama» = dolloma.

21) Me këtë formë e po këtë kuptim e gjemë këtë fjalë dhe të T. Papahagi, vep. e cit. (njëjës: pārpode).




Fig. 15

të bardhë, të blerë në qytet. Çorapet e tyre (**përpoxi**, në të folmen vllëhe<sup>21)</sup>) ishin prej leshi të bardhë, të gjata deri te nyja e kömbës, ose deri nën gju, kurse opingat e tyre ishin të zeza me proka dhe me një xhufkë të madhe, të blera në Korçë, Delvinë, etj.

Siq shihet nga përshkrimi dhe nga fotografia me numër 17 që e vura për krahësim, veshja e vllëhve ishte e njëjtë me atë të banorëve të krahinës së Oparit. Për të kuptuar këtë ndikim të fortë duhet të kemi parasysh se vllëhët shpesh herë stanet dhe kullotat e tyre verore i kishin në malet e Oparit.

Banorët e Oparit kanë filluar ta lenë këtë veshje rrëth vjetëve 1900 e këtej, kurse vllëhët nuk e përdorën më këtë që nga fillimi i luftës së parë botërore, duke e zëvëndësuar në përgjithësi me një kostum shumë të ngjashëm dhe me të njëjtën prerje, porse ngjyra e shajakut ndryshon nga e bardhë në blu të errët<sup>(22)</sup>. Për këtë variant ka ndikuar, mendoj veshja e atëherëshme e fshatarëve të rrëthit të Korçës, të cilët filluan të lënë këtë kostum pas luftës së parë botërore, kurse vllëhët e mbajtën deri rrëth vjetëve 1925-1930.

<sup>22)</sup> Një kostum i tillë ruhet në fondet e Sektorit të etnografisë të Institutit të Historisë e Gjuhësisë. Shih objektet me numra inventari 2304, 3449, 3452, 4720, 6796.

Në veshjen e burrit vllah duhet përmendor edhe guna e dhirtë, lla-bania dhe një aksesor pothuaj i pamungueshëm siç është krraba.



Fig. 16

Guna (në të folmen e tyre **tëmbare**)<sup>(23)</sup> prebatjej me shajak të dhirtë (fig. 18) dhe kishte prerjen që tregohet në skicën 19: mëngët e saj nuk visheshin, por lëshoheshin prapa për bukuri; kapuci (**kaçula**) vihej në kokë vetëm kur binte shi ose borë. Këtyre gunave nuk u hynte shiu. Ishte shumë karakteristik qëndrimi i bariut në këto raste. Ai ulej këmbëkryq duke mbështetur faqen në një dorë, brryli i së cilës mbësh-tetej në gjurin përkatës, dhe kështu dremiste i rrëthuar nga kopeja që kulloste. Një variant i gunës është tallagania (**tälägane**)<sup>(24)</sup> më e tra-

23) T. Papahagi e shpjegon: «Manteau de poil de chèvre à capuchon; dhe shton këtë vërejtje: «Ca obiect etnografic aceasta mantă are o arie intinsa». Vep. e cit., zëri përkatës.

24) Në vep. e cit. të T. Papahagi për fjalën **tälägane** gjejmë këtë shpjegim: «Manteau de laine semblable à la tâmbare», alb. **tallagan**.

shë e rëndë; ajo e ka kapuçin të qepur pas jakës dhe mëngët e saj vishen. Gunën dhe tallaganen vlluhët i mbajnë edhe sot.

Si guna ashtu edhe tallagania janë veshje të përdorura gjerësisht në gjithë jugun e Shqipërisë.




Fig. 17

Llabania ishte një pjesë e veshjes që përdorej për t'u mbrojtur nga rrreshjet. Ajo ishte një kapuç që zgjatej prapa deri në fund të shpinës, duke mbrojtur kështu jo vetëm kokën, por edhe shpatullat e krejt shpinën. Po të kishe një ngarkesë në sup apo mbi shpinë (ndonjë trajstë ase hebe), llabania lëshohej mbi të. Ajo bëhej prej dy ose tri fletësh shajaku të dhirtë dhe kishte një prerje fare të thjeshtë. (Skica 20). Vihej përgjithësisht mbi rrobat e zakonëshme. Llabanen e përdorin gjerësisht edhe sot barinjtë labë dhe fshatarët e rrethit të Korçës. Me sa na tregon një zbulim arkeologik i kohëve të fundit, ajo është një pjesë e veshjes e dokumentuar mjaft herët në vendin tonë. Një bust i gdhëndur në gur, i gjetur në kalanë e Krotinës (Dimali antik, qytet ilir i themeluar në shekullin IV para erës sonë), paraqet një grua me një llabane në kokë, datuar në periudhën e herëshme he-



Fig. 18




Fig. 19

Mënga

lenistike<sup>25</sup>). Shumë e ngjashme me llabanen tonë është «gluga» rumune, e dokumentuar, edhe ajo, mjaft herët dhe që ruhet akoma në shumë vise të Rumanisë<sup>26</sup>.

Krrabön (kërrig, në të folmen e vllehve) barinjtë vllehë e punonin me dru ahu ose thane, kurse dorëzën e saj me dru bushi, të skalitur zakonisht në formën e një koke gjarpëri, mbi zverkun e të cilit ngandonjëherë shtrihet një njeri. (Skica 21).




Fig. 20




Fig. 21

Sic thamë, rrreth vjetëve 1925–1930 kostumi i burrave më cibun blu u zëvendësua nga një kostum krejt i ndryshëm. Ai përbëhej, përvèç këmishës e të mbathurave, nga një palë bolka (pantallona) të bardha prej shajaku me një prerje shumë të thjeshtë (skica 22), të cilat i qepnin vetë gratë. Prerja e tyre me materialin e vënë drejt së gjati (duke përdorur dy gjerësi të plota shajaku për çdo këmbë) dhe me një allticë për shtrat, paraqet ngajshmëri të madhe me veshjen e burrave të Moldavisë së Veriut, megjithëse bollkat e vllehve nuk janë aq të gjata se ato të rumunëve<sup>27</sup>). Veshja plotësohej sipër me një pallto shajaku të zi, qepur te rrobaqepësi, e cila ishte si një xhaketë e gjatë me mostra përparrë dhe me dy xhepa të mëdhenj (foto 23). Këto lloj palltosh u përhapën shumë në rrëthin e Korçës pas luftës së parë botërore. Në dimër, nën pallton, burri vishte një xhamadan shajaku

25) Shih B. Dautaj — Zbulimi i qytetit ilir Dimal, «Studime historike», 1965, Nr. 2, f. 98–102, fig. D.

26) F. B. Florescu — «Monumentul de la Adamklissi», f. 444–445, fig. 227, 228, 229, Bucuresti, 1959.

27) Krahaso prerjen me skicën e dhënë nga F. B. Florescu në: «Portul popular din Moldava de Nord», Bucuresti, 1956, f. 22.




Fig. 22



Fig. 23






Fig. 24

blu apo tē zi (si ai i palltos), me prerjen që shihet në skicën 24, tē ~~ai~~ lin shumë herë e qepnin vetë gratë.

Me kohë bollkat e bardha filluan t'i zëvendësojnë me pantallona shajaku blu apo tē zi, tē prera qillotë, siç i mbanin gjithë fshatarët e rrëthit të Korçës. Këtë kostum e veshin edhe në ditët tonë, burrat vleħħe tē fshatrave që kemi marrë në studim. Ata më tē rinxjētë nē mosħe, nē vend tē palltove prej shajaku, mbajnë xhaketa prej kadifeje, me prerjen e zakonëshme qytetare, kurse nē vēnd tē xhamadanëve prej shajaku mbajnë triko leshi tē thurura nga gratë.

\* \* \*

Vetë përshkrimi i materialit na sugjeron disa vërejtje më tē përgjithëshme nē lidhje me veshjet dhe pjesët e tyre. Kështu vemi re se morfologjia e veshjes popullore tē vleħħve éshtë pothuaj e njejtë me atë tē veshjeve popullore shqiptare tē krahinave nē tē cilat ata kanë banuar. Ky fakt ngre probleme tē rëndësishme mbi ndikimin etnografik reciprok tē këtyre dy popullsive, ndikim i kushtezuar nga bashkëjetesa e tyre relativisht e gjatë. Ky ndikim duhet ndjekur e studiuar me kujdes nē tē gjitha çfaqjet e tij, pasi vetëm nē këtë mënyrë do tē kemi mundësi ta interpretojmë problemin drejt.

Kështu, pér t'i kuptuar më mirë disa anë tē morfologjisë dhe zhvillimit tē kostumit tē vleħħve, duhen mbajtur parasysh raportet etnografike që kanë ekzistuar midis vleħħve dhe shqiptarëve tē krahinave ku ata veronin apo dimëronin. Pjesët që paraqesin ngjashmëri i kemi vénë nē dukje gjatë përshkrimit tē tyre. Shtegtimet blegtore ale kanë luajtur, pra, një rol tē rëndësishëm nē këtë drejtim. Megjithatë, ndikimet e zonave tē rrëthit tē Korçës janë më tē forta nē veshjen e burrave, kurse nē veshjen e grave ndikimi i kësaj zone éshtë më i vonë. Më i hershëm dhe i thellë nē veshjen e grave paraqitet ndikimi i rrëthit tē Delvinës. Kjo, ndofta, duhet lidhur edhe me tregjet ku vleħħet furnizoheshin me artikui veshmbathieje. Këto dëshmoinë pér lidhjet e ngushta që kanë këtyre popullsive gjatë ko-

hës. Këto lidhje kanë lehtësuar qarkullimin e disa elementeve të veshjes nga njëra popullsi te tjetra. Por nuk mund të thuhet se lidhjet me zonat e tanishme fqinje janë të vetmet. Siç e kam vënë në dukje gjatë përshkrimit të veshjeve të vlehave vihen re ngjashmëri edhe midis vlehave dhe Malësisë së Madhe, krahinë me të cilën sot i ndan një largësi e konsiderueshme. Por këto afërsi gjajnë shpjegimin e tyre historik në drejtimin e dikurshëm të shtegtimeve të vlehave nomadë<sup>28)</sup>.

Tipar tjetër i përgjithshëm që bie në sy janë ndryshimet e shumta që ka pësuar veshja e vlehave që nga fundi i shekullit të kaluar deri në ditët tona. Madje duhet të theksojmë se këto ndryshime kanë ndjekur, në përgjithësi, ndryshimet që ngjisnin në veshjen e shqiptarëve të krahinave ku ata jetonin.

Studuesit i tërheq vëmendjen fakti se ndër vlehet nuk ka asnje shenje të punimit të pëlhurave të pambukta pér t'i përdorur në pre-gatitjen e pjesëve të ndryshme të veshjes, qoftë edhe me fije pambuku të importuar. Në anën tjetër, gratë vlehe janë shquar pér endjen e lloj-lloj punimeve të leshta, veçanërisht të shajakut.

Duhet të vemë në dukje këtu faktin se numri i pjesëve të veshjes të prodhuaara krejtësisht brenda ekonomisë shtëpijake, kryesisht nga gratë, ka ardhur gjithnjë duke u zvogëluar. Materiali i preferuar prej vlehave pér të zëvendësuar shajakun e zi është kadifeja e zezë, e pambuktë, prodhim i industrisë sonë tekstile.

Një tjetër konstatim i rëndësishëm është mungesa e plotë e përdorimit, nga vlehet, të opingave prej lëkure kau të punuara vëtë. Megjithëse në Shqipëri përdorimi i llojeve të opingave prej lëkure të punuara nga vëtë fshatarët ka qenë i përhapur gjërësisht në shumë krahina, këta vlehet nuk kanë përdorur opinga të tillë, por kanë preferuar opingat e zeza të forta, me proka poshtë e me xhufka në majë, ndoshta si më të qëndrueshme pér jetën e tyre endacake. Këto opinga i punonin zanatçinjtë në qytet.

Nga gjithë pjesët e veshjes që përshkruhen dhe shqyrtohen në këtë artikull, vihet re se veshja e grave ka qenë disi më konservatore se ajo e burrave, sepse në të janë ruajtur disa elementë që paraqiten si më të vjetra. Këto janë çuparja, sërekushta, dhe sidomos polla. Në veshjen e burrave origjinë të vjetër ka llabania. Po ashtu, si një mbeturinë e prodhimit të dikurshëm shtëpijak më duket rasti i pantallonave të bardha prej shajaku, sepse vete prerja shumë e thjeshtë të sugjeron mendimin e vjetërsisë së tyre.

ANDROMAQI GJERGJI

28) Për drejtimet e shtegtimeve të vlehave shih G. von Hahn «Albanesische Studien» Jena, 1854, f. 16. T. Capidan «Farserojii», Bucureşti, 1931, f. 147, hartën përkatëse në artikullin e N. Dunăre: A juhtartas illetve pasztorkadas hagyomanyos tipusai a romanoknal (Tipet blektorale tradicionale të rumunëve), botuar në: «Ethnographia», LXXV 2, Budapest 1964, f. 268 etj.

## L'HABILLEMENT DES VALAQUES DANS LE DISTRICT DE KORÇE

Les matériaux exposés dans cet article sur les habits que porte la population valaque ont été recueillis par l'auteur en octobre 1963 parmi les valaques installés dans les villages de Drenove et Boboshtice, district de Korçë, ainsi que dans les fonds du musée local de la ville de Korçë.

Au début, on a décrit les habits de femmes, avec les changements qu'ils ont subis au cours des 30-40 dernières années. On a décrit 13 pièces de vêtements ainsi que des frisures et des tatouages, et relevé les analogies dans l'habillement de la population albanaise. C'est la même chose qu'on a fait pour les vêtements d'homme dont on a décrit 20 pièces.

En terminant l'auteur fait quelques observations générales. Ainsi nous voyons apparaître sous les yeux que la morphologie de l'habillement populaire des valaques est presque la même que celle de l'habillement populaire albanaise des régions qu'ils ont habitées. Donc pour comprendre parfaitement le développement de l'habillement des valaques, l'auteur estime qu'il faut tenir compte des rapports ethnographiques entre les valaques et les albanais des régions où ils passaient l'été ou hivernaient. On remarque que les influences des zones de la région de Korçë (Opar, Kolonia et plaine de Korçë) sont plus fortes dans l'habillement des hommes, tandis que dans celui des femmes l'influence de cette zone est plus retardataire et c'est l'influence de la région de Delvina qui la précède. Mais nous ne pouvons pas affirmer que les relations avec les zones actuelles voisines sont les seules, car certaines analogies sont remarquées dans l'habillement de Malesia e Madhe (district de Shkoder).

On remarque également que depuis la fin du siècle dernier, l'habillement des valaques a subi de profonds changements qui, dans l'ensemble, ont suivi les changements qui se produisaient dans l'habillement des albanais des régions où ils vivaient.

Il importe de souligner ici le fait que le nombre de pièces produites entièrement dans l'ambience de l'économie domestique, et dans l'essentiel par les femmes, n'a pas fait que diminuer. Le matériel préféré par les valaques pour remplacer le bure noir, est le velours noir en coton, fabriqué par notre industrie de textiles.

Une autre constatation qu'on pourrait faire est l'absence complète de l'emploi par les valaques des «opingues» (chaussure genre mocassin) en cuir de bœuf.

Dans toutes les pièces de vêtements décrites et examinées dans cet article l'on remarque que les vêtements de femmes ont été, dans une certaine mesure, plus conservés car ils ont gardé certains éléments qui semblent être plus révolus; ce sont: quparja, koça, sérékushta et polla. Tandis que pour le vêtement d'hommes, c'est la llabania qui remonte à une plus haute période. Telle une survivance de la production d'autrefois, peuvent être aussi les pantalons blancs en bure, car leur coupe très simple dit assez de leur ancienneté.

## КОСТЮМ КУЦОВЛАХОВ ОБЛАСТИ КОРЧИ

Материалы, представленные в этой статье о народном костюме куцовлахов, собраны автором в октябре 1963 г. у куцовлахов, поселившихся в деревнях Дренова и Бобоштица корчинской области, а также извлечены из фонда этнографического сектора и местного Корчинского музея.

В начале описывается женская одежда, с соответствующими изменениями последних 30—40 лет. Описаны 13 части одежды, а также завивка и татуировка, причём устанавливаются аналогии с одеждой албанского населения. Подобным же образом приводится мужская одежда с описанием 20 частей.

В заключении автором сделаны общие замечания. Таким образом бросается в глаза тот факт, что морфология народной одежды куцовлахов, является почти одинаковой с морфологией албанской народной одежды в тех краях, где они жили. Следовательно, для лучшего понимания процесса развития одежды куцовлахов, автор полагает, что следует иметь в виду этнографич-

кие отношения между куцовлахами и албанцами, в тех краях, где они жили или зимовали. Наблюдается ещё такой факт: влияния районов корчинской области (Опора, Колонии Корчинской равнины) проступают более сильными в мужской одежде, в то время как в женской одежде это влияние является более позднего происхождения. Наиболее ранним и глубоким в женской одежде выступает влияние области Дельвины. Но нельзя утверждать, что связи с настоящими соседними районами являются единственными, потому что некоторые аналогии наблюдаются и с одеждой Малеси э Мадье (область Шкодры).

Ещё бросается в глаза то, что с конца прошлого века и до настоящего времени одежда куцовлахов претерпела много изменений, в общих чертах идущих вслед за изменениями, происходившими в одежде албанцев тех краев, где они жили.

Следует отметить здесь тот факт, что число частей одежды, производимых полностью в пределах домашнего хозяйства, главным образом руками женщин, всё время уменьшается. Для замены чёрного сукна куцовлахами предпочтается чёрный хлопчато-бумажный бархат, который в последнее время выпускается нашей текстильной промышленностью.

Кроме того, можно ещё установить полное отсутствие у куцовлахов самодельных латней из бычьей шкуры.

Все части одежды, описанные и рассмотренные в данной статье, наводят на мысль, что женская одежда была в некоторой степени более консервативной, потому что она сохранила некоторые более старые элементы. В мужской одежде старой по своему происхождению является лэбана. Остатком прежнего домашнего производства могут быть белые брюки из сукна, потому что сама их очень простая кройка наводит на мысль о их старом происхождении.

## MJETET E PESHKIMIT NË BREGUN E BUNËS

Në kuadrin e ekspeditave të Sektorit të etnografisë për të grumbulluar materiale në lidhje me atlantin etnografik shqiptar, në tetor të vitit 1963 u bë një ekspeditë në Bregun e Bunës. Gjatë kësaj ekspedite, përveç mbledhjes së materialeve për temën «Enë e orendi shtëpijake», autorit të këtij artikulli i ranë në sy mjetet e peshkimit që janë përdorur në këtë zonë.

Zona etnografike e Bregut të Bunës shtrihet gjatë brigjeve të lumit Buna. Në të bëjnë pjesë fshatrat Daragjat, Shirq, Mushan, Grash, Sukat e Dajçit, Obot, Dajç, Samrisht i Syrëm, Samrisht i Poshtëm, Rushkull, Be'aj, Pentar, Mali i Gjymit, Krroq, Luarz, Rec dhe Veli-pojë. Të gjithë fshatrat, me përjashtim të Obotit dhe Krroqit, që ndodhen në anën e djathtë, shtrihen në anën e majtë të rrjedhës së Bunës. Pregu i Bunës në veri kufizohet me anën e Malit dhe Shtoin e Ulqinit, në lindje me Bregun e Drinit, në jugë me malin Kolaj dhe në perëndim me detin Adriatik.

Lumi Buna është mjaft i gjërë, ai lidh ligenin e Shkodrës me detin Adriatik. Sasia e ujit që zurret nuk është e njejtë: gjatë vjeshtës e pranverës ka ujë të mjaftë, kurse gjatë verës pakësitet. Me që liveni, nga i cili furnizohet me ujë, ndodhet në lartësi të vogël mbi nivelin e detit, rrjedha e këtij lumi është e ngadalëshme. Këto kushte e bëjnë këtë si të vetmin lumë të lundrueshmë të Shqipërisë. Deri në fillim të shekullit tonë, nëpër Bunë lundronin edhe vapore me ngarkesë të vogël, të cilët arrinin deri në tregun e Shkodrës, duke i dhënë këtij qyteti tiparet e një porti detar. Por përveç transportit të mallrave, ky lumë pati një rëndësi të madhe edhe për peshkim. Sasi të mëdha peshqish, sipas kushteve të jetës së tyre, zbritnin nga ligeni përmë det dhe njëkohësisht sasi të tjera ngjiteshin nga deti nëpër Bunë për në ligen.

Gjatë shekullit të kaluar, me derdhjen e një dege të Drinit-Drinasës-në Bunë, ky lumë i ndryshoi tiparet e tij. Drinasa në njérën anë shtoi sasinë e ujit dhe e nxitoi rrjedhën e Bunës, në anë tjetër, me llumin dhe rërën që solli, mbushi shtratin e saj. Nga kjo shtrati i Bunës nuk është më në gjëndje të përbledhë të gjithë sasinë e ujit dhe në vjeshtë e pranverë vërvhon fushat djathtas e majtas. Mbushja e shtratit pakësoi mundësitet e lundrimit të anijeve në pjesën e sipërme, ndërsa sjellja e ujrave të turbullta, shtimi i rrjedhës dhe pakësimi i thellësisë penguan edhe vajtjen e ardhjen e peshqve.

\* \* \*

Peshkimi në bregun e Bunës, me gjithë kushtet e favorëshme natyrore, nuk ka qenë aq i zhvilluar; me gjithatë, banorët e kësaj zone kanë trashëguar mjete peshkimi primitive, të cilat kanë një vlerë të veçantë për etnografinë.

Në këtë artikull do të bëjmë përshkrimin e materialit që mblo-dhëm gjatë ekspeditës, duke mos u ndalur në analizën historike të tij, pasi një gjë të tillë mendojmë ta bëjmë në të ardhmen, në një kuadër më të gjërë, kur të kemi grumbulluar një sasi të mjaftueshme materiali edhe nga krahinat e tjera të vendit.

Dhe tani po kalojmë në përshkrimin e mjeteve të peshkimit që janë përdorur në këtë zonë.<sup>1)</sup>

**Koshi**<sup>2)</sup> është një mjet peshkimi në formën e sferës, i cili




Fig. 1

është ndërtuar me shufra she'lgu. Në pjesën e fundit ka grykën që është e futur nga ana e brëndëshme. Ajo vjen duke u ngushtuar dhe lë hapur një vrimë të vogël me diametër 0.05 m. në të cilën hyjnë peshqit.

1) Fotografitë e këtij artikulli janë të autorit Skicat janë punuar nga Ikbale Bikaku.

2) Shkurtimisht për koshat kanë shkruar: Gjush Sheldia në artikullin: «Shiroka e gjuetia e peshkut në liqe të Shkodrës e në Lumin Buenë, Dri e Kir, botuar në «Hylli i Dritës», viti 1943, Nr. 9-12, f. 410; Injac Gj. Ndojaj: «Fauna ihtiologjike e ligenit të Shkodrës, në Buletinin teknik, Tiranë, 1943, Nr. 2, f. 185. Ky vetëm sa e përmend koshin si mjet peshkimi.

Franz Nopcsa në veprën e njohur «Albanien: Bauten Trachten Geräte Nordalbaniens», f. 113-114, shkruan shkurtimisht për koshat e Shqipërisë së veriut.

Në fondet e Sektorit të etnografisë ruhen disa kosa me forma të ndryshme që janë përdorur në krahinat e vendit tonë. Në Shirokë ruhet koshi me numër inventari 540 i ngjashëm me atë që kemi përshtuar; në Bajzë të Kastratit, — ai me numër inventari 7232; në fshatrat e Pogradecit — ai me numër inventari 854, në Shupenëzë (Dibër) ai me numër inventari 2673; në Nikaj — Mërtur — koshi me numër inventari 4478.

Zakonisht, koshi vendoset në vënde ku uji nuk lëviz (rrjedh) një deri një metër e gjysmë thelë fig. 2. Që të mos lëvizë nga vendi dhe të qëndrojë në fund, në njérën anë i vendosin gurë. Në pjesen e sipërme



Fig. 2

të tij lidhin një copë tel, të cilit në majë i venë një tufë me kashtë, për të treguar se në ç'vend ndodhet i zhystur. Për të têrhequr peshqit, grykën e koshit e lyejnë me brumë. Peshku, në kërkim të ushqimit, futet brenda, nga ku nuk mund të dalë më. Në shumicën e rasteve koshi vendoset në mbrëmje dhe nxirret në mëngjes.

Madhësia e koshave është e ndryshme. Koshi që kemi paraqitur ka këto përmasa: lartësia  $0,56\text{ ml}$ , perimetri në mesin e tij  $2,10\text{ m}$ , diametri i grykës në fillim  $0,32\text{ m}$  dhe në pjesën e fundit  $0,05$ .

Thurja e koshave nuk kërkon ndonjë mjeshtëri të madhe. Ato mund t'i ndërtojë çdo fshatar.

Me kosha gjaujnë më shumë njila dhe mlysha. Këto i gjaujnë në periudhën e dimrit, pasi peshq të tjerë në këtë kohë është vështirë të kapen, sepse ata nuk lëvizin nga të ftohtit.

**Kovna.** Për gjaujtjen e ngjalave në Bregun e Bunës përdorin një mjet peshkimi që quhet kovën. Kovna (fig. 3) ka formë vezake. Pjesa e sipërme e sajë vjen më e ngushtë se pjesa e poshtëme. Ndërtohen me thupra thane dhe mrine, por preferohen më shumë ato të thanës. Thuprat nuk thuren sikundër në koshat, por vendosen pothuaj paralel njera me tjetren, duke lënë ndërmjet tyre një boshllëk të vogël, që mund të shkojë deri në një centimetër. Thuprat lidhen së bashku me tel të hollë. Në pjesën e brëndëshme të kovnës, afër mesit, vendoset një rrëth druri, për të mos lejuar harkimin e kundërt të thuprave. Kovna përbëhet kryesisht nga pjesa e sipërme, e cila zakonisht është më e ngushtë se e poshtëmja. Kjo, që bregbunasit e quajnë gryka për **nxjerrjen e ngjalës**, ka një diametër prej  $0,05\text{ m}$ . Në



Fig. 3

kohën kur kovna vendoset në ujë, mbylljet me një shtupë (tapë) dru frashëri. Pjesa e poshtëme, ose **gryka e ngjalës**, është më e madhe, me diametër prej 0,12 m/ Në grykën e ngjalës vendosen 7 shpatëza fiku, të cilat, duke u lidhur njëra me tjetrën, formojnë një trup në formë koni me majë të prerë. Shpatëzat kanë formën e shigjetave dhe përfundojnë në fund me majë të mprehtë. Gjatësia e shpatëzave është 0,25 m. dhe gjërësia 0,04 m. Madhësia e kovnës ndryshon; kjo varet nga ai që e ndërton. Këtu po japid përmasat e kovnës së përshkuar dhe të kovnës që ruhet në fondet e Sektorit të etnografisë<sup>3)</sup>. E para ka këto përmasa: lartësia 0,90 m dhe perimetri i mesit 0,70 m. Madhësitë e pjesëve të tjera i kemi dhënë më lart. E dyta e ka lartësinë 1 m, perimetrin e mesit 0,72 m, diametrin e grykës së nxjerrjes së ngjalës 0,08 m dhe atë të grykës së ngjalës 0,20 m. Këto mjete peshkimi punohen nga vetë fshatarët.

Përdorimi i kovnës është i thjeshtë. Zakonisht e futin brenda në ujë që nuk lëviz një deri një metër e gjysmë thellë. fig. 4). Për të tërhequr ngjalat brenda në kovnë futin bërsakë (peshq të vegjël), të cilët ngjala i gujan shumë. Që kovna të mos lëvizë dhe të rrijë në fund i vendosin brenda gurë.

3) Objekti me numër inventari 2966.



Fig. 4

Karumja<sup>4)</sup>. Kjo është një vegël peshkimi që ka formën e një luge, dhe me të cilën gjuhet vetëm kapi. fig. 5. Skeleti i saj ndërtohet me thupra shelgu, ndërsa tri të katërtat e pjesës konvekse rrighthohen me tel, i thurur në formën e rjetës. Pjesët përbërëse të karumes janë, rrethi, që nuk është krejt i rrum-bullaktë, por vjen në formën e elipsit dhe ka këto përmasa: diametri i madh 1.18 m, diametri i vogël 0.86 m, bishti 2.60 m, shtylla e bishtit 0.64 m, gryka 0.64 m e gjatë e 0.45 m e gjerë dhe teli. E ndërtojnë vetë fshatarët, më shumë burrat.

Në periudhën e pranverës, kur kapi rreh (lëshon putargën), gjuhet me karume. Karakteristike për këtë lloj peshku është se ai, kur lëshon vezët, nuk shkon vetëm,

por në grupe prej 10-12,

dhe vezët i lëshon në vënde ku ka pak ujë, deri në dy pëllëmbë. Përveç kësaj, bën zhurmë, e cila dëgjohet që larg. Nga kjo kemi edhe shprehjen **rreh kapi**. Peshkatari, i cili rri në këmbë në pritje të gjahut, me të dëgjuar zhurmën, lëshon karumen në ujë, duke zënë brënda në të pjesën më të madhe të peshkut (fig. 6). Peshqit nxirren nga karumja me dorë, ose me karvariq.

**Gamra<sup>5)</sup>** Kjo është një vegël peshkimi e përbërë nga një fill mëndafshi dhe nga një gjëlpërë. Shresh përdoret pa gjëlpërë. Ndërtohet thjesht: merret një pe mëndafshi rreth 2-3 m i gjatë, në të cilin, me ndihmën e një gjëlpëre, ose të një theke fshese, shkohen një sasi trajzash (krimba të vegjël). Pas kësaj, peri mblidhet në formën e lëmshit, lidhet me një spango të gjatë dhe hidhet në ujë. Ngjala, në kërkim të ushqimit, shkon për të ngrënë krimbat dhe kështu i ngelin dhëmbët në gjëlpërë, ose në pe. Atëherë peshkatari çon gamrën ngadalë përpjetë, deri në sipërfaqe të ujit, dhe, me ndihmën e karvariqit, ose edhe me dorë, e hedh ngjalën në breg apo në lundër.

4) Gjush Sheldia në artikullin e cituar në «Hylli i Dritës», Nr. 9-12, f. 410, karumen e quan **rreth**.

5) Gamrën e përshkruan edhe Gjush Sheldia në artikullin e cituar, f. 34.




Fig. 5



Fig. 6

Me gamër zihet më shumë ngjala, e cila gjuhet sidomos kur uji  
është i turbullt. Ka patur raste që në një ditë janë zënë rreth 20-25 kg  
ngjala.

**Grep**<sup>6)</sup> Në breg të Bunës praktikohet edhe peshkimi me grep. Zakonisht peshkojnë me një grep, por nuk mungojnë rastet që në ujë të hedhin më shumë. Përdorimi i shumë grepave në të njëjtën kohë ka qenë përdorur sidomos para çlirimt. Grepat i lidhnin në spango në largësi deri një metër nga njëri tjetri. Kishte raste që hidhnin në ujë deri në 50 grepa. Zakonisht, grepat i vendosnin në vendet ku lumi ishte i qetë. I hidhnin në ujë natën dhe në mëngjez i mblidhnin. Për të tjerhequr peshqit, grepave u vinin gjuhëza (peshq të vegjël), ose krimba.

Peshkimi me shumë grepa është përdorur pothuaj në gjithë botën.

Është dokumentuar se grepit në vendin tonë ka gjetur përdorim qysh në epokën e eneolitit. Në gërmimet arkeologjike të vitit 1962, në vendbanimin prehistorik të Maliqit, janë zbuluar disa grepa prej kocës.

**Fuzhna**<sup>8)</sup>. Një mjet tjetër peshkimi që është përdorur në Bregun e Bunës është edhe fuzhna. Siç shihet edhe në figurën Nr. 7, ajo ka formën e pirunit me pesë ose shtatë gjemba. Gjembat janë me majë të mprehtë, për të çpuar më lehtë peshkun, dhe kanë formën e krrabës, apo të grepit, më mënyrë që peshku të mos bjerë. Zakonisht gjembi i mesit është më i gjatë se të tjerët 0,27 m, dy të anës janë 0,17 m ndërsa të tjerët 0,12 m. Gjatësia e qafës dhe e tytës së bishtit shkon deri në 0,17 m ajo e përgjithëshme 0,44 m ndërsa gjëresia 0,26 m. Bishti bëhet prej druri, me gjatësi 1,30 deri 2 m.

Në Bregun e Bunës fuzhnën e përdorin më shumë për peshkimin e krapit, të cilin e gjuajnë më shumë në kënetën e Murtepës. Këtu rritet një lloj bari që quhet likon. Në sipërfaqen e ujit likoni lëshon gjethet, të cilat kanë formën e kokës së lakinës. Mbi gjethë zhvillohet një kokër e kuqe me lule, të cilën e quajnë farë likoni. Krapit këtë lule e ha shumë dhe, kur del në sipërfaqë të ujit për t'u ushqyer peshkatari, i cili rri gati në lundër me fuzhnë në dorë, e qëllon. Peshkimi, zakonisht, bëhet ditën në pranverë dhe në fillim të verës, por ka raste që peshkohet edhe natën, kur ka hënë.

Fuzhna është një objekt shumë kohë përparrë. Nga ana arkeologjike është dokumentuar se ajo i përket periudhës së bronxit. Në Bosnjë, në Dolinën e Savës, është

6) Grepat përmenden edhe në artikujt e cituar të Injac Gj. Ndojës, f. 185, dhe të Gjush Sheldisë, në Nr. 9-12 po të «Hyllit të Dritës» f. 410.

7) Fr. Prendi — Raport mbi gërmimet arkeologjike në vendbanimin prehistorik të Maliqit. Arkivi i Sektorit të arkeologjisë.

8) Në artikujt e cituar të Injac Gj. Ndojajt, f. 185, dhe të Gjush Sheldisë (Nr. 9-12), f. 410, përmendet edhe fuzhna. Në fondet e sektorit të etnografisë ruhen dy fuzhna: ajo me numër inventari 1750 është e ngjashme me atë që kemi përshkruar dhe ka shtatë gjemba, kurse ajo me numër 1985 ka pesë gjemba me madhësi të njejtë. Gjëmbat e anshëm vinë në formë të harkuar.




Fig. 7

gjetur një fuzhnë peshku e kohës laten. (Shekujt IV-II para erës sotë) <sup>9)</sup>.

Karriqi <sup>10)</sup> është një vegël peshkimi e thurur me fije liri në formën e rrjetës fig. 8).




Fig. 8

Karriqi vendoset në **brena**. Këta janë katër shkopinj të gjatë deri në 2 m. secili dhe që lidhen me njeri-tjetrin, në formë kryqi, me litar prej druri ose me tel. Në mesin e brenëve (kryqa të brenave) lidhet **shuli**, që zakonisht është më i gjatë se brenat. Përveç shulit, në mesin e brenave lidhet edhe një litar pak më i gjatë se shuli.

Fshatarët e Bregut të Bunës me karriq zënë peshk gati gjithë vittin. Ata gjuajnë në disa mënyra: me lundra, duke qëndruar në këmb në breg (fig. 8 dhe në kalimere, fig. 8a). Kur peshkatari gjuan peshk me karriq duke përdorur për vozitje lundrën, atëhere; në shumicën e rasteve, zgjedh disa vende ku uji lëviz me ngadalë, ndërsa kur gjuan nga bregu, shkon në ato vende ku formohen pellgje të thella uji, që quhen **avarde**. Këto janë rripa toke të futura në formën e brylit në lumë dhe që e detyrojnë ujin të rrotullohet. Në avarde peshkatari gjuan edhe duke qëndruar në kalimere. **Kalimerja**<sup>11)</sup> është një shtrat i vogël, i ndërtuar me hunj, në cepin e sipërm të tokës dhe që, nganjëherë, mbu-

9) Vejsil Čurčić — «Die Volkstümliche Fischerei in Bosnien und Herzegowina W. B. H.», vol. 12. f. 507.

10) Në artikujt që janë cituar karriqin e pëershkruanë shkurtimisht edhe Injac Ndojaj (f. 184), e Gjush Sheldia (numër 1-3, f. 32). Në fondet e sektorit të etnografisë gjenden dy rjeta në formën e karriqit ajo me numër inventari 3759, që përdorej në Divjakë (Myzeqe), dhe ajo me numër 4309, që përdorej në Rëmbec (Korçë).

11) Sipas Gjush Sheldisë, i pari që e ka ndërtuar kalimeren ka qénë «Ejëll Vasa, ase, si e thërrasin atë shirokosit, nji ndër peshkatarët ma të vjetër qì rrnojnë». (Artikull i cituar, Nr. 1-3, f. 27).

lohet me kashtë ose me degë. (F. 8a). Zakonisht, kur gjuhet peshk nga bregu ose me lundër, karriqi mbahet nga shuli, i cili ka një pozicion

diagonal me brenat, ndërsa kur gjuhet nga kalimerja, shuli qëndron në mes të karriqit. Për të lehtesar përdorimin e karriqit, në kalimere vendoset në tokë një hu i gjatë, në të cilin shkojnë una-zën e shulit. Ky ndodhet në fund të tij dhe quhet levlar. Levlat mund të jetë prej druri ose prej metali. Në këtë rast peshkatare e mban karriqin me anë të litarit.

Në të tria rastet e përshkruara të gjuajtjes së peshkut me karriq, në gishtin tregues të dorës së djathtë mbahet një pe, që lidhet me rjetën dhe që tregon lëvizjen e peshkut në karriq.

Me karriq zënë më shumë kublën dhe qefu-




Fig. 8 a

llin. Prandaj për gjuajtjen e tyre ka edhe karriqë madhësia e syzeve të të cilëve ndryshon nga njeri-tjetri. Kështu, p.sh., gjerësia e syzës së karriqit të kublës është 0,035 m, ndërsa e qefullit 0,03 m.

Në përgjithësi karriqët ndërtohen nga vetë fshatarët, sidomos nga gratë.

**Pinari.** Një vegël peshkimi e përdorur mjaft në Bregun e Bunës është edhe pinari. Ky është një rjetë e bërë më fije lini në formë koni. Fig. 9.




Fig. 9

Peshku gjuhej me pinar kur binte shi dhë kanalet mbusheshin me ujë nga lumi ose nga kéneta. Ai hynte nëpërmjet kanaleve pér të kuillotur. Në kohën kur uji binte përsëri në shtratin e tij, fshatarët vendosnin pinarët në vijat e ujit. Peshku, duke notuar në drejtim të rrjedhës së ujit, hynte në pinar. Kur vendosej në kanal, pinari mbërthehej në tokë me kuja, ndërsa peshkatari e mbante me ndihmën e një copë litari të lidhur në grykën e pinarit.

Pinarët punoheshin në familje nga gratë dhe burrat. Nuk kanë madhësi të caktuar; gjatësia e tyre lëviz nga 3 deri në 4 m. ndërsa diametri nga 1 deri në 1,5 m.

Plumçi<sup>12)</sup> është një rjetë peshkimi në formën e ombrellës; është perimetër të saj vendosen një sasi plumbçash, nga të cilët ka marrë edhe emrin fig. 10). Në qendër të rjetës vihet një copë litar që shërben pér të mbajtur e ngritur plumçin kur është hedhur në ujë.

Madhësia e rjetës së pumbçit nuk është e caktuar, sipërfaqja e saj




Fig. 10

mund të shkojë deri në 30 metra katrore. Thuret me fije kërpi. Fshatarët e blinin në qytetin e Shkodrës.

Nga vetë ndërtimi, përdorimi i plumçit kërkon mjeshtëri të vëçantë. Zakonisht, hidhet në ujë në ato vende ku nuk ka mundësi të përdoret rjeta. Plumçin e hedhin në ujë nga lundra. Plumçat, duke rënduar, mblidhen në fund, duke zenë brenda të gjithë peshkun që gjëndet i përfshirë prej sipërfaqes së rjetës. Atëhere peshkatari tërheq litarin dhe plumçat shkojnë duke ngushtuar perimetrin e rjetës deri sa në sipërfaqe myallen fare. (Fig. 11). Peshku i zënë hidhet në lundër. Me plumç gjuajnë më shumë njila dhe mlysha.

12) Injac Gj. Ndojaj, art. i cit. 185 dhe Gjush Sheldia, po art. i cituar (numër 9-12, f. 410), shkruajnë pér plumçat.

Në fondet e Sektorit të Etnografisë gjëndet një plumç me numër inventari 2961, që përdoret në Shirokë.




Fig. 11

Koci ndërtohet nga vetë fshatarët me kallamë dhe e lidhin me tel të hollë. Largësia e kallamëve nga njeri-tjetri është sa trashësia e gishtit. Madhësia e kocit ndryshon. Diametri i tij mund të lëvizi prej 1,30 deri në 2 m. Gjerësia e fnerit shkon nga 0,15 deri në 0,20 m.

**Koci.** Një nga mënyrat e gjuajtjes së peshkut në pritë është edhe ajo me koc. Koci është një thurimë me kallama në formë të rrumbullaktë dhe me një vend të çarë që quhet **fner**, në të cilin hyjnë peshqit.

Zakonisht, mënyra e gjuajtjes me koc në Bregun e Bunës bëhej atëhere kur shtohej uji dhe hynte në kënetë. Fshatarët, në të tilla raste, ndërtonin në vende të ndryshme hendeqe me forma të rrumbullakta. Në grykën e hendekut vendosnin kocin. Kur uji fillonte të pakësohej dhe të zinte shtratin e tij, së bashku me të, nëpërmjet fnerit, futej edhe peshku, i cili nxirrej mandej nga koci me anë të karvariqt,

#### ABAZ DOJAKA

#### LA PECHE AU BREG DE BUNA

Les moyens de pêche au Breg de Buna est un petit article dans lequel sont décrits les instruments de pêche qu'emploi cette zone ethnographique.

Le Breg de Buna s'étend au sud-est de la ville de Shkoder et comprend dix-huit villages.

Le fleuve de Buna, sur les rives duquel s'étend cette zone, est assez large et navigable dans sa partie inférieure. Les bords de ce fleuve, revêtus d'une végétation caractéristique des fleuves méditerranéens et riches en humus, d'où le poisson peut extraire une bonne nourriture, souvent bas, sont exposés aux eaux formant des bassins qui abondent en poissons.

Malgré les conditions naturelles favorables, la pêche dans cette zone n'a pas été tellement développée. Les habitants des villages se servaient du poisson pris pour leurs besoins de famille, c'est pourquoi les moyens dont ils se servaient étaient rudimentaires.

L'article décrit presque tous les outils, s'arrêtant, dans certains cas, sur le progrès de leur développement historique et les comparant aux matériaux des autres pays.

L'auteur arrive à la conclusion que les moyens de pêche de jadis sont restés pour une bonne partie en usage même de nos jours.

## ОРУДИЯ РЫБОЛОВСТВА НА БЕРЕГУ р. БУНЫ

В этой краткой статье описаны орудия рыболовства, употребляемые в этнографической зоне, носящей название Берег р. Буны.

Берег Буны — это зона, расположенная на юго-западе города Шкодры и включающая 18 деревень.

Река Буна — это довольно широкая река, судоходная в своём нижнем течении. На берегах реки растет характерная растительность средиземноморских рек, и они богаты гумусом, поэтому там много пищи для рыб; часто берега затопляются рекой, при этом образуются пруды со стоячей водой, в которых много рыбы.

Несмотря на благоприятные природные условия, рыболовство в этой зоне не было очень развитым. Местные жители занимались рыболовством лишь в пределах своих частных семейных нужд, вследствие чего и их снасти были примитивными.

В статье описаны почти все орудия, а в некоторых случаях рассматривается процесс их исторического развития в сравнении с материалами других мест.

Автор приходит к выводу, что ряд орудий и снастей рыболовства, известных в этнографии, находит применение и в настоящее время.

## SHTËPITË E BANIMIT NË FSHATIN E POJANIT (Myzeqe)

Për studimin e arkitekturës popullore të vendit tonë një interes të veçantë paragjen edhe banesat fshatare të krahinës së Myzeqesë. Shtëpitë e banimit të kësaj krahine dallohen nga ato të krahinave të tjera, si nga forma e planimetrisë e nga teknika e ndërtimit, ashtu edhe nga materialet që janë përdorur për ndërtimin e tyre. Faktorët kryesorë që kanë sjellë këtë dallim janë pozicioni gjeografik, klima bregdetare, formacioni gjeologjik, vegjetacioni, si dhe kushtet ekonomiko-shoqërore në të cilat ka jetuar në të kaluarën popullsia fshatare e kësaj krahine.

Qëllimi i këtij artikulli është studimi i zhvillimit të formës së planimetrisë së banesës fshatare, i materialeve dhe teknikës së ndërtimit që është përdorur në përgjithësi në krahinën e Myzeqesë, duke marrë si bazë fshatin e Pojanit si dhe materialet e botuara nga autorë të ndryshëm mbi këtë krahinë. Fshati i Pojanit është marrë si bazë pasi në banesat e tij ruhen shumë mirë, edhe sot, elementet kryesore që karakterizojnë banesën fshatare të Myzeqesë.

Para se të fillojmë analizën e zhvillimit të formës së planimetrisë së banesës fshatare, po përmendim disa nga përshkrimet që kanë bërë për këto autorë të ndryshëm. Ja si ka shkruar autori i shekullit të kaluar, G.V. Hahn<sup>1)</sup> për banesat që ka gjetur në Myzeqe para vitit 1854: «Ndërtimet e fshatrave bujqësore nëpër të cilat të çon rruga kanë një pamje karakteristike. Oborret me shumë ndërtime rrëthohen të cilat njëra është për barin, kurse të tjerat shërbejnë për bagëtinë dhe ekonominë; konstruksioni bëhet prej druri, çatia prej kashte, murat prej kallamash, të cilat, në të shumtën e herëve, kanë një veshje me baltë ose baiga lopësh; vetëm ana e ngushtë nga ana e vatrës bëhet me qerpiçë. Zjarri digjet ashtu si edhe në shtëpitë fshatare greke, drejt përdrejt në tokë, 3-4 këmbë nga midisi i cdo muri... Ka dy dyer në mes të anëve më të gjata të shtëpisë, nga të cilat kryesorja mbyllët vetëm natën. Këto shërbejnë për ajr e dritë».

E. Vlora<sup>2)</sup> para vitit 1911 ka shkruar «Në Myzeqe mbizotëron një tip shtëpie i veçantë, të cilën mund ta quajmë tropik... Oborri i madh rrëthohet prej një gardhi kallamash ose ferrash; brenda tij ka 3 ose

1) G. V. Hahn — «Albanesische Studien», Jena, 1854, fq. 73.  
2) E. Vlora — «Von Berat zu Tomor» Wien, 1911.

më shumë kasolle të vogla, nga të cilat njëra shërben si banesë, njëra për stallë dhe tjetra për hambar, etj... Këto janë ndërtimë të varfëra një skelet druri me mur kallamesh të lyera me baltë e bajga dhe një çati me kashtë. Kanë dy dyer në anën për së gjati, që është 7-8 metra dhe që shërbejnë për dritë e ajr. Pajisja e brendëshme përbëhet nga shtresa, të cilat ditën mblidhen dhe vendosen te muri...»

Një tjetër autor, U. Rozati<sup>3)</sup> ka shkruar përpëra vitit 1915: «Në afërsi të Fierit banesat e fshatarëve janë, pa dyshim, më të mira. Fshatarët musulm'anë kanë dy ndërtesa të veçanta: selamllékun dhe haramin. I pari shërben për pritjen e mysafirëve dhe i dyti përdoret si banesë e vertetë e familjes... Fshatarët kristianë të Fierit kanë banesa të njëlljoja, por në një blok.»

M. Urban<sup>4)</sup> ka shkruar përpëra vitit 1938: «Fermat më primitive të fushave bregdetare dëshmojnë se mbrojtja më e mirë për bujkun paqëdashës ish vobegësia. Një banesë e shtrembër, godina për ekonominë, në gjëndje edhe më të trishtuar, rrrethojnë fermën; i gjithë vëndi është plot shkurre të egra e të dendura dhe me disa merqinja shkarpa.

Oborri është krejt i çrrëgullt dhe në fillim njeriu ka përshtypjen se hyn në një fermë të lënë pas dore...»

\* \* \*

Fshati i Pojanit gjëndet 11 km. në perëndim të qytetit të Fierit, në fushën që shtrihet në perëndim të kodrës mbi të cilën ka qenë ndërtuar në kohën antike qyteti i Apollonisë.

Për kohën e ndërtimit të fshatit të Pojanit nuk kemi gjetur ndonjë dokument konkret që të na ndihmojë në këtë drejtim. Sipas traditës gojore, ky fshat është ndërtuar aty nga shekulli i fundit i push-timit turk, nga 3-4 familje bujqësh të vendosur këtu për punimin e tokës.

Që nga krijimi i fshatit deri në vitin 1912 e gjithë kjo zonë dhe deri në Divjakë, gjithsejt 36 fshatra, ka qenë pronë e sulltanit të Turqisë. Të gjitha fshatrat e kësaj zone administroheshin nga nënpunës të shtetit turk, të cilët, në kohën e prodhimeve, organizonin korrjet e shirjet dhe mbledhnin nga fshatarët të gjitha detyrimet në natyrë.

Mënyra e jetesës familjare e shoqërore në fshatin e Pojanit ishte e njëlljtë me atë të fshatrave të tjera që shfrytëzoheshin nga sundimtarët turq.

Fshatarët merreshin kryesisht me bujqësi dhe me rritjen në natyrë të gjedhëve (lopë, që, buaj, kuaj, etj.). Ata ishin të detyruar t'i jepnin pronarit një të tretën e prodhimeve në natyrë, kurse nga dy të tretat që u mbeteshin i paguanin shtetit turk të gjitha taksat e tjera, duke përballuar njëkohësisht detyrimet për kryeplakun priftin, rojtatin etj.

Në këtë kohë fshatarësia kishte si pronë të saj vetëm shtëpinë si ndërtesë, pa tokën, veglat e punës, gjedhët, bagëtinë e imtë dhe shpendët shtëpijake.

3) U. Rosatti — «Relazione della commissione per lo studio dell' Albania». Roma, 1915.

4) M. Urban — «Die Siedlungen Südalbaniens». Ohringen, 1938.

Banorët e fshatit të Pojanit përbëhen nga tre grupe me origjinë të ndryshme — lalë, vllehë dhe kosovarë. Ata që quhen lalë janë vendës dhe, siç thamë, kanë krijuar fshatin e Pojanit. Sot ky grup përbëhet nga 22 familje, të cilat trashëgojnë mbiemrin e të parëve të tyre: Dimo (8 shtëpi), Parvazi (9 shtëpi) dhe Doraci (5 shtëpi).

Familjet e vllehve janë me prejardhje nga krahinat e Korçës e të Kolonjës dhe që janë vendosur këtu në kohë të ndryshme. Ata janë çobenj që dimëronin bagëtinë e tyre në kullotat e këtij fshati, ose nga familjet e atyre vllehve që merreshin me transportimin e mallrave me karvanë, kryesisht të atyre mallrave që eksportohen apo importohen nëpërmjet skelës së Semanit. Në të kaluarën vlehtë përdornin në familje të folmen e tyre arumune dhe, në të shumtën e rasteve, jepnin e merrnin ndërmjet tyre. Në këtë fshat sot numërohen gjithsejt 20 familje, të cilat, me përjashtim të pjestarëve me moshë të kaluar, kanë humbur gjuhën dhe zakonet e tyre, duke i zëvëndësuar me ato të vendësve.

Në fshatin e Pojanit, në vitin 1924 u vendosën rrëth 40 familje kosovare të emigruar nga fshatra të ndryshme të Kosovës. Sot në këtë fshat ka vetëm 9 familje kosovare; të tjerat janë shpërngulur në fshatra e qytete të ndryshme.

## I. — MATERIALET DHE TEKNIKA E NDËRTIMIT

Duke iu nënshtuar kushteve klimaterike, dhe sidomos atyre ekonomike e shoqërore në të cilat jetonin, banorët e këtij fshati, përdornin e banesës së tyre dhe të anekseve të saj, përdornin materiale që gjendeshin ose prodhoheshin në vend. Nga materialet më kryesore mund të përmendim lëndën e drurit, kallamët, zhukat, kashtën e piprit e baltën. Si lëndë druri më e preferuar ka qenë ajo e lisit, të cilën fshatarët e siguronin nga pyjet e shumta që kanë qenë në afërsi të fshatit. Kallamët i mbillnin nëpër ledhet e arave të tyre, kurse zhukat dhe kashtën e piprit i korrnin në kënetat rrotull fshatit.

Të gjitha këto materiale i përdornin pa iu bërë ndonjë punim paraprak, kështu që për preqatitjen e tyre nuk ndihej nevoja e specia-listeve, pra ato grumbullohen nga vetë fshatarët. Ndërtimi i banesës, si dhe i anekseve të saj, bëhej nga mjeshtrit e fshatit, ose të fshatrave përreth.

Ndërtimi i shtëpisë së banimit fillohej duke ngulur në tokë nga një kunj në të katër qoshet e saj. Në këtë mënyrë shënohej forma e banesës, e cila ishte gjithmonë një drejtkëndësh me gjatësi rrëth 22-47 pëllëmbë dhe gjerësi 20-25 pëllëmbë<sup>5)</sup> (4,40 — 9,40 m, x 4.00-5.00 m.). Në drejtimin e kunjave hapeshin gropat e thella 4-5 pëllëmbë, në të cilat futeshin furkat (trarë prej lisi ose mani). Për një shtëpi banimi me përmasat e mësipërme përdoreshin rrëth 12-20 furka për ndërtimin e pareteve (mureve perimetrale) dhe 4 furka për paretet e brendëshme (muret ndarëse)<sup>6)</sup>. Furkat në paretet e jashtme dhe të brendëshme nguelleshin me një largësi 6-7 pëllëmbë nga njera tjetra dhe lihesin të lar-

5) Deri vonë, në krahinën e Myzeqesë ka qenë në përdorim si njësi matjeje pëllëmba, që është baraz me 20 cm. Siç dihet, pëllëmba bën pjesë në sistemin metrik që ka qenë në përdorim qysh në kchët e lashta.

6) Kur banesa është me dy të ndara.

ta 10-16 pëllëmbë mbi tokë. Pasi nguleshin të gjitha furkat, ato lidheshin njera me tjetrën duke i mbërthyer në pjesën e sipërme me anën e përqarkëzve (trarë me trashësi të furkave). Përmbi përqarkëzit hidheshin trarët horizontalë të çatisë. Në mesin e këtyre të fundit vendoseshin në drejtimin vertical, 5-7 copë cungala, trarë, nga gjatësia e të cilëve caktohet njëkohësisht lartësia e çatisë, e cila arrin nga 5 deri në 8 pëllëmbë. Në këtë fshat këta trarë quhen priftërinj. Në pjesën e sipërme priftërinjtë mbërtheheshin me kulmakun dhe anës lidheshin me trarët horizontalë me anën e makazeve (edhe këta trarë janë të njëlljojtë me furkat). Makazët vendoseshin 6-10 pëllëmbë larg dhe lidheshin njeri me tjetrin me brezat, mbi të cilët mbërtheheshin qeprat (fig. 1). Në këtë mënyrë ndërtohej skeleti prej druri i shtëpisë së banimit.

Veshja e pareteve të skeletit bëhej me anën e kallameve, të cilët thuren nëpër 4-5 copë parvazë, që mbërthehen në drejtim horizontal ndërmjet hapësirave të furkave. Thurja e kallamëve bëhej nga lart poshtë dhe përpara mbulimit të çatisë. Kallamët thuren në drejtimin vertical, duke lënë midis tyre një boshillëk prej 1-2 gishtërinjsh (fig. 2) aq sa është trashësia e kallamave. Të gjithë kallamët futen një pëllëmbë thellë në tokë.


Për thurjen e skeletit (në drunjtë) të banesës përdorej edhe një mënyrë tjetër, e cila i përket një teknike pak më të zhvilluar se e para. Sipas kësaj mënyre, kallamët vendosen në drejtimin horizontal (fig. 3) dhe mbërthehen me gozhdë nëpër furkat me një largësi prej 4-5 gishtërinjsh njeri nga tjetri dhe në të dy faqet e pareteve, si jashtë ashtu edhe brënda. Boshillëku që krijohet në mes të kallamëve mbushet me llaç balte të përzier me gurë të vegjël. Kjo mënyrë pune zbatohet nga poshtë lart. Në të dy rastet paretet lyhen me baltë, si brënda ashtu edhe jashtë (fig. 4).

Çatia e shtëpisë është gjithmonë me katër ujra. Për mbulesën e saj veprohet duke shtruar përmbi qeprat, në drejtim të tërthortë me to, një rrezë prej kallamësh të hollë të thurur me zhukë. Mbi rrezën e kallamëve shtrohet kashta e piprit që përmëndëm më sipër. Kjo kashëtë, që arrin deri në një metër ojatësi, korret në këneta dhe vendoset duke e bërë deri një pëllëmbë të trashë. Vendoset duke filluar me radhë që nga streha e çatisë dhe duke u ngjitur në drejtim të kulmit. Shtruarja e saj bëhet në mënyrë që çdo shtresë të mbulojë dy të tretat shtresës që ka nën të dhe përsipër çdo shtresë vendosen një ose dy kallamë për së gjëri, të cilët qepen me qeprat e çatisë me fije zhuke, ose me purteka të holla prej shelgu. Që mbulesa e çatisë të jetë sa më e qëndrueshme kundrejt erërave të forta të dimrit, mbi të hidhen drurë të gjatë, të cilët, pasi lidhen me litare prej zhuke, hidhen përmbi kulmar në të katër faqet e çatisë. Çatia e mbuluar me kashtë prej pipri në mënyrën që e pëershruam, nuk pikon asnjëherë, sado i madh të jetë shiu, dhe qëndron për një kohë të gjatë, deri në 15 vjet.

Duke u bazuar në teknikën dhe në materialet që janë përdorur për ndërtimin e shtëpive, fshatarët i ndajnë këto në pesë grupe kryesore: 1) shtëpi me furka në dhë; 2) shtëpi me furka në gur; 3) shtëpi me furka në dhë ose gur të thurura me perikota mali<sup>7)</sup>; 4) shtëpi me mure prej guri; 5) shtëpi me mure prej perikotash maqine.

<sup>7)</sup> Perikota mali fshatarët quajnë copat e tullave të pjekura që i nxirtnin nga muret e ndërtuesave dhe nga muri rrëthues i qytetit antik të Apollonisë.

Fig. 1






Fig. 2





Fig. 3



**Fig. 4**

### **1. Shtëpi me furka në dhé.**

Në këtë grup hyjnë të gjitha ato shtëpi që e kanë të ndërtuar skeletin prej druri, duke futur në tokë furkat (shtyllat vertikale) dhe ku thurja e pareteve të jashtëme dhe të atyre ndarëse bëhet me kallamë të vendosur në drejtimin vertical. Kjo teknikë ndërtimi ka qënë përdorur gjërësisht në ketë fshat deri në vitin 1930.

### **2) Shtëpi me furka në gur.**

Shtëpitë e grupit të dytë, sikundër kuptohet edhe nga emri që u kanë vënë vetë fshatarët, — shtëpi me furka në gur, — dallohen nga ato të grupit të parë vetëm se furkat (shtyllat vertikale) të skeletit prej druri nuk futen në tokë, por vendosen përmbi bloqe gurësh katerkëndësh, ose të rrumbullaktë, me madhësi të ndryshme. Në këtë rast bloqet e gurëve vendosen duke gërmuar pak tokën, në mënyrë që të

vihen tē gjithë nē një nivel dhe nē një drejtim. Nē sipërfaqe tē çdo guri hapet një vrimë e rrumbullaktë, 4-6 cm. e thellë, dhe nē pjesën e poshtëme tē furkave, nē qendër tē sipërfaqes fundore tē tyre, mbërthehet nga një copë hekuri ose gozhdë farkëtari pa kokë, e cila lihet tē qëndrojë e dalë aq sa është thellësia e vrimës së hapur nē gur. Nē këtë mënyrë bëhet lidhja e furkave me gurët. Furkat lidhen njera me tjetrën nē pjesën e poshtëme me tabanët (trarë që vendosen nē drejtimin horizontal). Tabanët mbështeten mbi gurët dhe mbërthehen me furkat që kanë anës me gozhdë të mëdha. Zbrazësira që krijohet nën taban muroset me gurë e baltë. Shtëpitë e ndërtuara nē këtë mënyrë janë në




Fig. 5

përgjithësi tē thurura me kallamë tē vendosur horizontalisht, sipas mënyrës që shpjeguam.

### 3) Shtëpi me perikota mali

Në grupin e tretë hyjnë tē gjitha ato shtëpi nē tē cilat për ndërtimin e pareteve tē jashtëme dhe tē brendëshme përdoren perikota mali. Me qenë se copat e tullave që përdoren nē këtë rast janë me madhësi e forma tē ndryshme, muret e ndërtuara prej tyre nuk janë tē qendrueshme. Për këtë arësyen skeleti prej druri i ndërtuesës sigurohet

duke i lidhur furkat njera me tjetrën me trarë të vendosur në drejtimin diagonal dhe vetëm zbrazësirat që mbeten nga kjo lidhje në hapësirën ndërmjet furkave, mbushen me mur të ndërtuar me perikota mali të lidhura me llaç balte. (fig. 6).




Fig. 6

Sic shihet, ndërmjet shtëpive që bëjnë pjesë në grupet e përmendura gjemjë ndryshime vetëm përsa i perkthet mënyrës së ndërtimit dhe të materialeve që përdoren. Kjo tregon për një zhvillim gradual të teknikës së ndërtimit. Por në të tre grupet ne gjemjë banesën tipike të Myzeqesë, me të gjitha karakteristikat që e dallojnë atë.

#### **4) Shtëpi me mure prej guri**

Këto shtëpi, të cilat, sipas ndarjes sonë, hyjnë në grupin e katërt, janë ndërtuar me mure prej guri të lidhura me llaç balte dhe janë mbuluar me tjegulla në formë lugu. Në këtë mënyrë i kanë pas ndërtuar në fillim shtëpitë e banimit vlehtë. Shtëpitë e këtij grupei ndryshojnë nga ato vendëset jo vetëm përsa i përket teknikës së ndërtimit dhe materialeve që janë vënë në përdorim, por edhe nga ana e arkitekturës. Siç do të shohim në analizën që do t'u bëhet më poshtë, në këtë grup gjemjë tipet karakteristike të shtëpive të krahinave nga të cilat kanë ardhur vlehtë.

#### **5) Shtëpi me mure prej perikotash maqine.**

Në këtë grup hyjnë të gjitha shtëpitë e reja që janë ndërtuar pas kolektivizimit të fshatit, për ndërtimin e të cilave janë përdorur të gjitha materialet që përdoren në ndërtimet e ditëve tona, si tulla të pjekura, gëlqere, çimento, beton, hekur-beton, etj.

### **II.- ZHVILLIMI I FORMËS SË PLANIMETRISË SË BANESËS**

#### **1) Shtëpitë e lalëve**

Duke analizuar materialin grafik të mbledhur nga rilevimi i gjithë shtëpive të banimit të fshatit Pojan, si dhe të ndonjë shtëpie karakteristike të fshatrave të tjera të Myzeqesë, e shofim të arësyeshme që zhvillimin e formës së planimetrisë së banesës ta ndajmë në dy periudha. Periudha e parë përfshin kohën deri në kolektivizimin e fshatit dhe periudha e dytë atë pas kolektivizimit të tij.

Për trajtimin e procesit të zhvillimit të banesës para kolektivizimit, janë shfrytëzuar përshkrimet e pakëta të autorëve vendës dhe të huaj që përmendëm më lart. Por pa dyshim materialet themelore mbi analizën e të cilave do të mbështetemi për të ndjekur rrugën e zhvillimit të banesës fshatare në këtë krahinë, janë tipet e ndryshme të banave të vjetra që kanë mbetur ende, si në pojan ashtu edhe në disa fshatra përreth.

Për periudhën e parë vërejmë se prototipi i banesës fshatare që ishte në përdorim të gjërë në të kaluarën, ka qenë kasollja njëkthineshe. Këtë lloj ndërtese e kemi gjetur aty-këtu edhe sot, si në Pojan ashtu edhe në fshatra të tjera të Myzeqesë, veçse në kohën e sotme kjo nuk përdoret më për banim, po për të gatuar në stinën e verës, për depozitim e prodhimeve bujqësore, ose dhe për strehimin e bagëtisë.

Kasollja Myzeqare, me formën e saj të thjeshtë, me materialet dhe teknikën primitive që janë përdorur për ndërtimin e saj, na kujton banesën e kohës prehistorike, gjurmët e së cilës janë gjetur për herë të parë në vëndin tonë në gjermimet që u bënë gjatë vitit 1962-64 në vendbanimin eneolitik të Maliqit<sup>8)</sup>. Po të marrim parasysh faktin që banesa është e lidhur ngushtë me zhvillimin ekonomik e kultural të

**8) Frano Prendi — Raporti i gjermimeve të Maliqit, 1962 - 1963.**

njeriut që banon në të, atëhere shohim qartë gjendjen e mjeruar në të cilën ishte katandisur popullsia e këtij fshati, si dhe ajo e fshatarëve të tjerë pérreth, gjatë regjimeve të kaluara. Duhet të kemi parasysh se fshati Pojan gjendet në rrëzë të kodrës mbi të cilën ngríhej dikur madhështor qyteti antik i Apollonisë, monumentet, ndërtesat publike dhe shtëpitë e banimit të të cilat kanë qenë ndërtuar me një arkitekturë e teknikë të përsosur. Pra, rikthimi i popullsisë fshatare pérreth këtij qyteti në forma dhe teknikë ndërtimi kaq primitive tregon kryesisht shfrytëzimin barbar që i bëhej popullsisë vendëse gjatë pushtimeve të huaja, sidomos gjatë pushtimit otoman.

Në fazën fillestare të zhvillimit kasollja myzeqare ka patur një të ndarë me përmasa rrëth  $6 \times 4$  metra, e cila përdorej për strehimin e pjestarëve të familjes, pér gatimin e bukës e të gjellës, pér ngrënie si dhe pér pritjen e miqve të shtëpisë.

Ndërtimi i kasolles bëhej me teknikën dhe materialet që përshkruam në fillim. Ajo ka patur një hyrje të vetme të hapur, gjithmonë në rasteve hyrja bëhej midis sipërfaqes së murit të fasadës, ose në afërsi të qosheve të saj. Përbrënda kasolles ndërtöhej vatra e zjarrit, në formë disi të rrumbullaktë, përmbi dysheme. Vatra e zjarrit zinte vënd në mes të kasolles, ose në afërsi të mureve perimetrale të saj, dhe ishte gjithmonë pa oxhak; tymi i zjarrit delte jashtë nëpërmjet kashtës, me të cilën ishte bërë çatia. Kasollja në përgjithësi nuk ka patur dritare (fig. 7).







Fig. 7

Fig. 8

Në një fazë të dytë vërejmë se kasollja është zhvilluar në drejtimin horizontal. Duke shtuar sipërfaqen e banimit dhe numrin e kthi-nave, u krijuar banesa me dy të ndara. E ndara e dytë që shërbente zakonisht pér fjetje dhe pér pritjen e miqve. (fig. 8).

Banesa me dy të ndara është krijuar me ndërtimin e dy kasolleve ngjitur njera me tjetrën (në anën e mureve të shkurtëra). Planimetria e banesës në këtë rast merr formën e një drejtëkëndëshi të zgjatur, kurse të ndarat ruajnë formën dhe përmasat e mëparëshme, por në të shumtën e rasteve këto të fundit kanë formën katrore. Të dy të ndarat kanë hyrje të veçantë, nga përpara dhe nuk komunikojnë pérbrën-

da njera me tjetrën. E ndara ku është vatra e zjarrit quhet nga fshata-rët «matkë e shtëpisë» dhe e ndara tjetër «odë».

Ky variant me sa kemi vënë re, nuk zhvillohet më në drejtimin horizontal, as edhe në atë vertikal, por vazhdon të përdoret gjérësisht si i tillë, aq sa bëhet tip i veçantë banese. E. Vlora, siç e pamë, e konsideron këtë si tipin karakteristik të Myzeqesë<sup>9)</sup>. Ekzistenza e këtij tipi në Bregun e Matës, siç vërehet në fig. 9. të botuar nga Fr. Nopcsa<sup>10)</sup>, na shtyn të mendojmë se banesa të tilla kanë qenë ndërtuar në të gjithë fushën bregdetare të vendit tonë. Në figurën 8 kemi paraqitur një shtëpi të këtij tipi që gjendet në Pojan dhe që sot përdoret për strehimin e bagëtisë.




Fig. 9

Me ndërtimin e dy kasolleve afër njera-tjetrës, aq sa ndërmjet tyre të lihet një koridor i ngushtë (1,50-2,50 metra), dhe me mbulimin e të dy kasolleve me një çati të vetme, është krijuar gjithashtu banesa me dy të ndara kryesore (matkën e shtëpisë dhe odën) si dhe me një të ndarë të tretë ndërmjet tyre, e cila në fillim mendojmë të ketë shërbyer për ruajtjen e prodhimeve bujqësore dhe të veglave të punës. Kjo e ndarë quhet hajat.

Në fazën fillore të këtij tipi hajati ka qenë i hapur në gjithë gjérësinë dhe në të dy krahët e tij, duke krijuar në këtë mënyrë dy hyrje të mëdha, në fasadë dhe prapa banesës. Kjo është forma e banesës myzeqare që përshkruan Hahni dhe që e konsideron si tipin kryesor të kësaj krahine. Në figurën 10 riprodhohen planimetria dhe pamja e një banese të këtij tipi të botuar nga M. Urban<sup>11)</sup>.

9) E. Vlora, vep. e cit. faqe 60.

10) Fr. Nopcsa, vep. e cit. faqe 33.

11) M. B. Urban, vep. e cit., fq. 40.





Fig. 10

Në Pojan nuk kemi gjetur të ndërtuar ndonjë shtëpi me të gjitha karakteristikat e tipit të mësipërmë por fshatarët thonë se para njëzet vjetëve ekzistonin shumë banesa të tilla edhe në këtë fshat. Këto thënie vërtetohen edhe nga gjurmët e varianeve të këtij tipi që kemi gjetur në Pojan (fig. 11) sidhe në Topojë, fshat në perëndim të Pojanit, (fig. 12, pjesa A-B). Në planimetrinë e kësaj shtëpie kemi një gërshtim të tipit që përmendëm më lart me një tjetër tip, të cilin do ta analizojmë më vonë. Duke ndjekur rrugën e zhvillimit të këtij tipi, vërejmë se hajati në fasadë vazhdon të jetë i hapur, kurse në anën e prapme mbyllët, duke lënë vetëm një derë të vogël që shërben për komunikim me stallat e bagëtive dhe kopshtet.

Mbyllja e hajatit në anën e përparëshme, dmth në fasadë të banesës, është bërë në dy fazë. Në fazën e parë mbyllja bëhet në një të tretën e gjatësisë së tij. Në këtë mënyrë krijohet një tjetër e ndarë e vogël, hajat i hapur, i cili është ndërtuar që të mbrohet disi hyrja kryesore e shtëpisë nga shiu apo dielli (fig. 12, pjesa B-C). Faza e dytë, sipas mendimit tonë, është mbyllja e hajatit në një drejtëm me muret anësore të të ndarave që ka anës (fig. 13), Në banesat e këtij lloji vërejmë se mbrojtja e hyrjes kryesore të shtëpisë, nga konditat atmosferike, në të shumtën e rasteve bëhet duke ndërtuar një strehë në





Fig. 11

formë samari të dalë deri një metër përmbi hyrje. Kjo strehë në njerën anë lidhet me konstruksionin e çatisë dhe në tjetrën mbështetet në dy pajanda, të cilat mbërthehen në furkat vertikale majtas e djathtas hyrjes. Variante të tilla kemi gjetur të ndërtuara si në fshatra të ndryshme, ashtu edhe në qytetin e Fierit (fig. 14). Deri këtu mund të themi se merr fund zhvillimi i hajatit dhe elementi i ri që i shtohet fasadës së shtëpisë, streha mbi hyrje, zhvillohet duke u zmadhuar, si





Fig. 12

në gjerësi ashtu edhe në gjatësi, duke ndryshuar njëkohësisht formën dhe mbështetjen e saj. Në këtë rast streha kthehet në një çati të vogël me tri ujra, që mbështetet me dy furka (shtylla druri) të vendosura në drejtim vertikal 1.50 — 2.00 metra përpara hyrjes (fig. 15).

Në qoftë se ndalemi deri këtu dhe e konsiderojmë këtë si fazën përfundimtare të zhvillimit të këtij varianti dhe duke marrë njëkohësisht parasysh faktin që banesa të tilla rühen e ndërtohen me shumicë edhe sot, mund të themi se ky ka qenë dhe është edhe sot tipi kryesor i banesës fshatare (përdhese) të Myzeqesë, si dhe i shumë fshatrave fushore të vëndit tonë.

Për të parë zhvillimin e mëtejshëm në drejtimin vertikal të këtij tipi, po paraqesim (fig. 16, 17) një shtëpi që e kemi gjetur të ndërtuar në fshatin Shën-Pjetër dhe një fotografji të një shtëpie në Fier. Në këtë rast vërejnë se dyfishohen të ndarat e banimit dhe krijohet njëkohësisht edhe një e ndarë e re, një ballkon i mbyllur përmbi hyrjen kryesore të shtëpisë. Me qenë se ndërtimi i një shtëpie të tillë (dykatëshe) për kushtet fshatare ishte shumë i kushtueshëm, ajo në fshatra





Fig. 13

ndërtohej shumë rallë dhe nga fshatarë të pasur. Të tilla shtëpi shihen me shumicë në qytetet e Myzeqesë si në Fier, Lushnjë e gjetkë. Në figurën 18 po riprodhojmë një skicë të fotografisë të botuar nga Rosatti,<sup>12)</sup> ku shihet qartë faza fillore e krijimit të ballkonit të mbyllur.

Po ktheheni edhe një herë tek tipi i shtëpisë që përmendëm më sipër, me qëllim që të ndjekim rrugën e zhvillimit të formës së planimetrisë në drejtimin horizontal. Me sa kemi vënë re, shtimi i të ndarave në këtë drejtim është bërë gradualisht, në disa fazë. Përpjekjet e para janë bërë duke ndërtuar të ndarën që është në të djathtë të hyrjes pak më jashtë dhe në një drejtim me shtyllat që gjenden përparrë hyrje kryesore. Në këtë mënyrë shtohet sipërfaqja e banuar, aq sa përballë shtëpisë së zjarrit krijojen dy të ndara të vogla të cilat, zakonisht përdoren përfjetje e pritje. Në fazën e dytë e ndara e tretë ndërtohet e gjitha në të djathtë të hyrjes. Në të dy këto faza vërejmë se përparrë hyrje kryesore vendoset vetëm një shtyllë, ajo e krahut të majtë,

12) U. Rosatti, vep. e cit. fq. 6.

Fig. 14







Fig. 15





Fig. 16

Fig. 17






Fig. 18

kurse ajo e krahut të djathjtë zëvëndësohet me anën e murit të dhomës përbri. Në fazën e tretë ndërtohet edhe një e ndarë tjetër në krahun e majtë të hyrjes. Në këtë rast hyrja e banesës çvendoset nga qendra dhe ndërto përsëri si më parë, në fasadë. Kjo është faza e fundit e zhvillimit të planimetrisë në drejtimin horizontal. Në këtë mënyrë, pra, është arritur shtimi i sipërfaqes së banuar në shtëpitë përdhese (fig. 19).

Këto janë tipet dhe variantet e shtëpive të banimit që kanë qenë në përdorim gjatë periudhës së parë (sipas ndarjes që caktuam në fillim). Për ta përfunduar këtë periudhë na duhet të shtojmë edhe një tip banese tjetër, gjurmët e së cilës nuk i kemi gjetur dot në asnjë fshat, por që ruhet ende në kujtesën e shumë fshatarëve të kaluar nga mosha me tiparet karakteristike të saj. Sipas thënieve të fshatarit vendës Irakli Pervazi, në fshatin Vanaj, familja e vjehrrit të tij, e cila përpresa 25 vjetëve përbëhej nga 40 persona, kishte një shtëpi me një të ndarë të madhe në formën e një drejtkëndëshi dhe me vatrën e zjarrit në mes të saj. Në këtë të ndarë, që quhej matka e shtëpisë, gatuani dhe hanin bukë të gjithë pjestarët e familjes. Dhomat e gjumit ishin të ndërtuara me radhë rreth e qark matkës së shtëpisë. Këto dhoma të vogla, sa për të fjetur një çift, quhen postre dhe komunikonin me matkën e shtëpisë nëpërmjet një koridori të ngushtë të ndërtuar përreth saj. Në figurën 20 paraqesim planimetrinë e këtij tipi të rindërtuar sipas thënieve të fshatarit që përmëndëm.

Për ekzistencën e këtij tipi në Shqipërinë e mesme bën fjalë edhe Rozati<sup>13)</sup> i cili boton edhe një planimetri të një shtëpie të riprodhuar në figurën 21. I njëjti autor boton gjithashtu planimetrinë e banesës së një fshatari kristian<sup>14)</sup> në afërsi të Fierit, riprodhuar në figurën 22. Këtë tip banese e ka gjetur edhe A. Gjergji<sup>15)</sup> në fshatin

13) U. Rosatti, vep. e cit. fq. 137, fig. 6.

14) U. Rosatti, vep. e cit., faqe 138, fig. 7.

15) Skica m'u ofrua nga autorja, të cilën, me këtë rast, e falenderoj që më lejoj botimin.




Fig. 19

Krutje e Sipërme gjatë vitit 1953. Një skicë të planimetrisë së kësaj shtëpie të rindërtuar e paraqesim në figurën 23. Duke u bazuar në materialet e përmendura, vërejmë edhe një rrugë tjetër të zhvillimit të banesës në drejtimin horizontal, po në mënyrë rrethore, me qendër gjithmonë matkën e shtëpisë, apo vatrën e zjarrit. Të tilla shtëpi ndërtuin në të kaluarën familjet e mëdha që kishin ekonomi të përbashkët.




Fig. 20




Fig. 21




Fig. 22




Fig. 23

## 2) Shtëpitë e kosovarëve

Shtëpitë e banimit të emigrantëve kosovarë dallohen nga ato të vendësve. Së pari ato dallohen pasi janë të ndërtuara gati në periferi të fshatit dhe në mes të tokës aë u ishte dhënë për ta punuar në kohën e vendosjes së tyre në këtë fshat.

Por shtëpitë e banimit të kosovarëve dallohen më tepër mbasi ruajnë, si në pamjen e tyre të jashtëme ashtu edhe në zgjidhjen e vendos-






FIG. 24

jes e të ndarave të banimit në planimetri, të gjitha karakteristikat e vendit të tyre. Në pamjen e jashtëme shtëpitë kosovare të këtij fshati dallohen nga hajati i ngushtë e i gjatë që kanë të ndërtuar në të gjithë gjatësinë e fasadës, ose deri në gjysmën e saj. Kurse në planimetri të ndarat janë të vendosura në radhë njera pas tjetrës, duke i dhënë banesës, në vija të përgjithëshme, formën e një drejtkëndëshi shumë të zgjatur. Nga shtëpitë e kosovarëve që kemi gjetur të ndërtuara në këtë fshat, mund të themi se në të shumtën e rasteve dhoma e zjarrit është në mes të ndërtesës, në të djathë dhoma e fjetjes dhe në të majtë ajo e miqve; hajati në këto raste është ndërtuar në të gjithë gjatësinë e shtëpisë. Shtojmë këtu se shumë familje kosovare sot janë anëtare të kooperativës bujqësore dhe, si rrjedhim, shtëpitë e reja i kanë ndërtuar në parcelat që u ka dhënë kooperativa përbrenda fshatit.

Por nuk përjashtohen edhe raste shtëpish të vendosura ndryshe, sikundër vërehet edhe në figurat 25 e 26. Në këto banesa dhoma e fjetjes është vendosur në mes, në të djathë të saj ajo e zjarrit dhe në të majtë oda e miqve. Në këto shtëpi hajati është i ndarë në dy pjesë me anën e një kthine të vogël, që quhet çarranik, dhe që shërben për vendosjen e bulmetit. Sipas të thënave të vetë pronarit të shtëpisë, kjo ndarje e hajatit është bërë që të mos shiheshin nga mysafirët gratë e shtëpisë që punonin në dhomën e zjarrit. Për të nejtën arësy është vendosur edhe grazhdarja e misrit në drejtim të tërthortë me atë të shtëpisë, duke e ndarë në këtë mënyrë edhe oborrin në dy pjesë. Pjesa e hajatit që gjendet përpëra odës së miqve quhet hajati i burrave dhe ajo pjesë që është përpëra dhomës së fjetjes dhe shtëpisë së zjarrit quhet hajati i grave.

Dhoma e zjarrit në banesën kosovare i përgjigjet matkës së shtëpisë myzeqare dhe ka të nejtin përdorim. Përshtypje të madhe të bën oxhaku. Sikundër vërehet edhe në figurat 24 e 25, ai është madhëstor, aq sa përmusat e tij janë në disproporcione si me lartësinë e banesës ashtu edhe me sipërfaqen e dhomës së zjarrit. Ndërtimi i një oxhaku të tillë tregon qartë se ndërtuesit e tij vinë nga vende të ftohta dhe, me gjithëse tanimë kanë zbritur në Myzeqe, që ka klimë bregdetare, prap se prapë e «drojnë dimrin».

Shtojmë këtu se përpëra ardhjes së kosovarëve, fshatarët vendës të Myzeqesë nuk e njihnin oxhakun dhe se kosovarët, si mjeshtër të zotët që ishin, mundën që mënyrën e ndërtimit të oxhakut ta aplikonin edhe në muret e holla të kasolles myzeqare.

Mjeshtrit kosovarë, të detyruar nga kushtet ekonomike, sidhe nga mungesa e gurëve, në fillim shtëpitë e tyre i ndërtuan të thjeshta, por duke përdorur një teknikë më të përparuar nga ajo që përdorin vendësit. Kjo teknikë ndërtimi konsiston në vendosjen e shtyllave vertikale të skeletit të shtëpisë përmbi tabakët (trarë të vendosur horizontalisht me tokën). Tabanët mbështeteshin mbi një numër gurësh të ngulur në tokë rreth e qark shtëpisë. Lidhja e tyre, si në gjatësi ashtu edhe nëpër qoshet ku ata kryqëzohen, bëhet me anë klapash, kurse shtyllat vertikale preqatiten me majë në formë prizmatike dhe futen në vrimat e hapura mbi tabanët. Kjo mënyrë lidhjeje përsëritet edhe në anën e sipërme me përqarkëzat. Për thurjen e skeletit të shtëpisë në ndërtimet e para ata kanë përdorur gardhin, të thurur me purteka lajthie ose frashëri, në vend të kallamëve. Arësyja kryesore për





Fig. 25

këtë mendojmë të ketë qenë se ata duhet ta kenë përdorur gjërësisht këtë teknikë në vendin e tyre.

Përsa thamë më sipër, si për teknikën e ndërtimit ashtu edhe për formën e planimetrisë së shtëpisë kosovare, këto i përkasin periudhës së parë, pasi në periudhën e dytë, dmth. pas kolektivizimit, edhe kosovarët, më përmirësimin e gjendjes ekonomike, i ndërtojnë shtëpitë e reja me materiale dhe teknikën e re, si gjithë kooperativistët e tjerë.






Fig. 26

### 3) Shtëpitë e vlehvë

Sikundër thamë në fillim, vlehet kanë ardhur në këtë fshat që prej shumë vjetëve përpara, dhe sot nuk ruajnë pothuaj as edhe një gjurmë përsa i përket ndërtimit të shtëpive të banimit. Por nga të dhënat e fshatarëve të moçëm dihet se më përpara vlehet ato i ndërtimin me gurë, me një kat (përdhese), ose edhe me dy katë. Përpara 5-6 vjetësh ishte një shtëpi e madhe dykatëshe e ndërtuar para 100 vjetëve nga një vllah pasanik. Sipas të thënave të disa fshatarëve, kjo shtëpi ka qenë e njëllotë me një shtëpi që është edhe sot në fshatin Kryegjatë, 4 km, larg në drejtimin Jugëlindje të Pojanit (fig. 27). Sikundër shihet, kjo ndërtuesë nuk ka asnjë lidhje, si nga arkitektura ashtu edhe nga teknika e ndërtimit, me shtëpitë vendëse; pra, ajo i përket një perriudhe dhe një krahine tjetër. Për këtë ne nuk po e analizojmë këtë tip shtëpie, por e paraqitëm vetëm sa për të patur një ide mbi shtëpitë prej guri të vlehvë.

Vlektë, që prej shumë kohësh, janë ambientuar me klimën dha zakonet e vendit, aq sa është vështirë që një i huaj t'i dallojë menjëherë nga fshatarët vendës. Kjo vërtetohet në vitet e fundit edhe përsa i përket ndërtimit të banesave të tyre.

### III.- NDËRTIMI I BANESAVE PAS KOLEKTIVIZIMIT TË FSHATIT

Një nga problemet që doli menjëherë pas kolektivizimit të bujqësisë së në fshat, është edhe zgjidhja në mënyrë të drejtë e formave apo tipave të shtëpive të banimit, sidhe ndërtimi i tyre nëpër kooperativat bujqësore dhe fermat shtetërore. Por megjithë përpjekjet që janë bëjë deri tani nga organet kompetente, në këtë drejtim nuk na duket të fshatarët, në të shumtën e rasteve, i kanë ndërtuar shtëpitë e banimit duke u bazuar kryesisht në tipet karakteristike të arkitekturës vendëse, duke patur gjithmonë parasysh pozicionin gjeografik të fshatit, kushtet klimaterike, sidhe sigurimin e lëndës së parë për ndërtimin, në mënyrë që banesa t'i shërbejë plotësisht jetës së re. Një zgjidhje të drejtë të këtij problemi kaq të rëndësishëm na duket se e kanë arritur vetë fshatarët e Pojanit.

Gjatë dhjetë vjetëve të fundit, që si pas ndarjes sonë i përkasin periudhës pas kolektivizimit të bujqësisë, ashtu si çdo gjë ndryshoi në punën dhe në jetesën e fshatarëve, edhe banesa e tyre filloj të zhvillohet e të zbukurohet me një ritëm shumë të shpejtë. Po t'i krahasonjmë shtëpitë e reja që janë ndërtuar gjatë këtyre dhjetë vjetëve me kasollët e vjetra, do të shohim shumë qartë se ajo që nuk u arrit gjatë qindra vjetëve, u realizua menjëherë brenda dhjetë vjetëve të fundit. Ndërsa, siç thamë më përpara, kasollja myzeqare na sillte ndër mend. banesën prehistorike, shtëpitë e reja të Pojanit mund të krahasonhen me ato të qyteteve tona.

Kooperativa bujqësore e Pojanit ka krijuar skuadrën e specialishtëve muratorë dhe marangozë, për t'u ardhur në ndihmë anëtarëve të saj për të ndërtuar shtëpi të reja, ndërtuesat publike, si shkollën, kllabin, dyqanet e ushqimit e të veshmbathjes e të tjera. Deri sot janë





FIG. 27

ndërtuar 35 shtëpi nga mjeshtrit e kooperativës, si dhe një shkollë shtetëveçare, një dyqan për artikuj të përzier dhe klub i fshatit.

Në ndërtimin e shtëpive të reja, në të shumtën e rasteve, janë ruajtur format karakteristike dhe planimetritë e shtëpive të vjetra, por është përmirësuar shumë si materiali ashtu edhe teknika e ndërtimit. Të gjitha shtëpitë vendosen sipas planit rregullues të fshatit, duke i ndërtuar në të dyja anët e rrugëve kryesore të tij. Përpara shtëpisë shihet kopshti me pemë e lule dhe prapa tyre kopshtet personale, ku mbillen zarzavatet e ndryshme, ndërtohen kotecët e pulave, etj.

Për ndërtimin e shtëpive të reja tanimë përdoren gjërësisht materiale shumë më rezistente nga të parat, si tulla të pjekura, llaç, etj, gëlqerja përdoret për ndërtimin e mureve, për suvatin brenda e jash-të. Sherbetimi me gëlqere të ngjyrosur brenda dhe jashtë gjithë shtëpisë është bërë një gjë e zakonshme. Në shumë shtëpi është përdorur si betoni ashtu edhe hekur-betoni; në brezat perimetralë, veçanërisht, janë përdorur arkitrarët mbi dyer e dritare, etj. Lënda e drurit përdoret me shumicë e sharruar për ndërtimin e konstruksioneve të çative, tavaneve e dyshemeve dhe e zdrukthëtar për shtrimin e dyshemeve, ndërtimin e dyerve e të dritareve, etj.

Në të shumtën e rasteve, për t'u mbrojtur sa më mirë nga lagëshngritur nga sipërfaqja e tokës 0,80 deri 1 metër lartësi. Dhomat janë të gjitha të ndriçuara nga dy ose edhe më shumë dritare të mëdha, të myllura me xhamë dhe të zbukuruara me perde. Në çdo dhomë ka varrobash, komo, etj. Të gjitha këto tregojnë një përmirësim shumë të madh dhe rrënjosor të mënyrës së jetesës, si pasojë e shtimit të të ar-

Sikundër thamë më përpara, shtëpitë e reja janë ndërtuar në banonjë zhvillim të theksuar përsa i përket formës së planimetrisë. Një zhvillim i përparuar vërehet në përdorimin e materialeve të ndërtibanesës fshatare, duke e bërë që të mos dallohet fare nga shtëpitë e qytetit.

Duke iu përshtatur kushteve të jetesës dhe punës që kryejnë sot zakonisht me dy të ndara dhe me ndonjë aneks në afersi, në anën e më shumë se një kurorë. Në shtëpitë me tri dhoma që janë ndërtuar duke patur për bazë planimetrinë e shtëpive të vjetra që përmendëm, sore. Në këto raste vihet re se, me ngritjen e shtëpisë përbëhi një zollohet në drejtim të krahut të majtë të hyrjes deri në qoshen e shtëpisë. Ngjitia në këtë verandë bëhet me anën e një palë shkallëve prej guri, me tre-katër bazamakë, të cilët, zakonisht, vendosen në drejtim të hyrë fshat.

Për të treguar gërrhetimin e dy tipeve të shtëpive të vjetra që përmendëm, po paraqesim një shtëpi (fig. 12) të ndërtuar në fshatin është krijuar duke bashkuar tipin e vjetër, që karakterizohet nga ha-






Fig. 28




Fig. 29

jati i hapur në fasadë të shtëpisë, me atë që paraqet fazën e tretë të zhvillimit të hajatit. Në këtë rast tipi i parë krijohet në qoftë se marrim në planimetri të dyja të ndarat A-B së bashku me hajatin e hapur, që janë në të majtë të hyrjes, dhe tipi i dytë krijohet në qoftë se marrim të dyja dhomat B-C në të majtë e në të djathtë të hyrjes kryesore. Kombinime të ngjashme me këtë i gjemë edhe në shtëpitë që paraqiten në figurat 29 dhe 30.

Në një rast tjeter (fig. 31) vërejmë një gërshtetim të zhvilluar në një drejtim tjeter dhe me një tip të vetëm. Këtu duket qartë arësyja e ndërtimit të kësaj shtëpie me tri hyrje. Qëllimi kryesor është që në një të ardhme të ketë mundësi që ajo të rđahet në tre pjestare, duke marrë secili pjesë gati të barabartë.

\* \* \*

Si përfundim mund të themi se në banesat fshatare të krahinës së Myzeqesë gjemë tipe shtëpish të cilat na paraqesin faza të ndryshme të një zhvillimi gradual të banesës së parë që është ndërtuar në këtë krahinë që në kohët më të lashta, të cilën sot, në ditët tona, fshatarët e quajnë kasolle. Dokumentacionin grafik të këtij zhvillimi e paraqesim në tabelat I, II dhe III.

Në tabelën I paraqiten dy drejtime të cilat tregojnë me radhë etapat e ndryshme për krijimin e dy tipeve kryesore të banesës fshatare të Myzeqesë. Në tabelën II tregohet zhvillimi në drejtimin horizontal dhe atë vertikal, me qëllim kryesor dyfishimin e sipërfaçes dhe të ndarave të banimit. Në tabelën III tregohen fazat e zhvillimit përfundimtar të arritura nga mjeshtërit popullorë në krijimin e banesës së re **koooperativiste**.

Koço Zheku

**Shënim:** Rilevimi i shtëpive dhe përpunimi i tyre janë bërë nga autorë, ndërsa fotografimi dhe stampimi janë bërë në Laboratorin e Universitetit Shtetëror të Tiranës nga Halit Gjiriti.






Fig. 30











Fig. 31







## LES MAISONS D'HABITATION DANS LE VILLAGE DE POJAN — MYZEQE

Dans cet article l'auteur traite du développement de l'habitation rurale dans la province de Myzeqe, étudiant essentiellement les maisons d'habitation du village de Pojan, district de Fieri, ainsi que quelque autre habitation caractéristique des villages environnants.

Les habitations rurales de cette province, selon l'opinion de l'auteur, présentent un intérêt particulier pour l'étude de l'architecture populaire albanaise; elles diffèrent des habitations des autres provinces soit par la planimétrie soit par la technique du matériel de construction. Les principaux facteurs qui ont influé sur la formation de l'habitation sont les conditions économiques-sociales, la position géographique, la végétation, etc.

Dans la première partie de cet article on cite les descriptions de divers auteurs relatives aux habitations populaires de Myzeqe.

Le village de Pojan se trouve 11 km. à l'ouest de la ville de Fieri, au pied de la colline sur laquelle a été bâtie la ville antique d'Apollonia. Les habitants du village sont divisés en trois groupes: 1) Les Lale, originaires du pays; 2) Les Velleh (valaques) venus de la province de Korçe et Kolonia; 3) Les Kossovars ayant émigré en 1925.

Les habitants de Myzeqe se sont occupés essentiellement d'agriculture et d'élevage (bovins).

Les maisons d'habitation étaient construites par les paysans eux-mêmes qui employaient les matériaux se trouvant sur place, bois de charpente, ajoncs, jonc, de la paille et de la terre argileuse. Les habitations ont toujours eu la forme rectangulaire. En se basant sur la technique et les matériaux employés, les habitations étaient divisées en cinq groupes: 1) habitations au squelette de gros pieux enfouis dans le sol et cloisonnés d'ajoncs de torchis à l'intérieur comme à l'extérieur; 2) habitations au squelette de gros pieux posés sur des pierres, enveloppées d'ajoncs des deux côtés et enduites du torchis à l'intérieur comme à l'extérieur; 3) habitations au squelette de gros pieux introduits dans le sol ou appuyés sur des pierres, empilées de petits morceaux de briques dites *perikota mali*, que les paysans prennent dans les ruines de la ville antique d'Apollonia; 4) habitations construites en pierres; 5) habitations construites en briques cuites.

En analysant les types de maisons existant encore de nos jours ainsi que les sources écrites, l'auteur a divisé le développement de la forme planimétrique en deux périodes: avant et après la collectivisation de l'agriculture. La forme ancienne était la chaumière comprenant une seule pièce, aux dimensions 4 x 6 m., avec un foyer pour faire le feu installé au milieu. La chaumière disposait d'une seule porte d'entrée installée à l'un des murs de la longueur. L'habitation aux deux pièces qui forme le second type a été obtenue par la construction de deux chaumières contigues. Les deux ambiances ont des portes d'entrées séparées à l'extérieur. L'endroit où on allume le feu s'appelle par les paysans *vatra e shtëpisë*; l'autre ambience, qu'on appelle «*odë*», sert pour recevoir les amis et pour se coucher.

La troisième ambience s'obtient par la construction de deux chaumières rapprochées l'une de l'autre, laissant un espace au milieu qu'on a appelé «*hajat*». A la phase du commencement, ce type d'habitation avait son «*hajat*» ouvert des deux côtés; sa clôture a été effectuée pendant quelques phases. La phase définitive de ce développement est l'habitation formée de deux pièces et d'un «*hajat*» clos par une entrée principale, protégée par un auvent très saillant, soutenu par deux poteaux et par une entrée secondaire dans l'autre partie du «*hajat*». Ce type qui existe encore de nos jours, est le type principal de l'habitation rurale à Myzeqe ainsi que dans plusieurs villages de la campagne albanaise. Le développement de ce type dans la direction verticale s'obtient en répétant au deuxième étage la même planimétrie.

Les étapes de développement graduel de l'habitation rurale de la province de Myzeqe sont graphiquement présentées par le tableau I, II, III.

## ЖИЛЫЕ ДОМА В ДЕРЕВНЕ ПОЯНИ МЮЗЕКЬЕ

В данной статье автор занимается вопросом о развитии крестьянского жилья, области Мюзекье, исследуя главным образом дома деревни Поян около г. Фиери, а также отдельные характерные дома других окружных деревень.

Крестьянское жильё этой области, по мнению автора, представляет особый интерес в исследованиях об албанской народной архитектуре. Она отличается от жилья других областей как планиметрией, так и техникой и строительным материалом. Главными факторами, повлиявшими на создание жилья Мюзекье являются общественно-экономические условия, географическое положение, растительность и т.д.

В первой части статьи приводятся описания народного жилья Мюзекье различными авторами.

Деревня Поян расположена в 11 км. на западе от города Фиери, у подножья холма, на котором возвышался древний город Аполлония. Население села состоит из трех групп: 1. яали — местные жители; 2. куцовлахи, пришедшие из областей Корчи и Колонии; 3. Косовары — эмигрировавших около 1925 г. Жители сел Мюзекье занимались главным образом сельским хозяйством и выращивали крупный скот.

Жильё дома строились самими крестьянами, которые пользовались при этом местными материалами: древесиной, тростником, соломой и глиной. Дома всегда имели форму прямоугольника. Исходя из примененной техники и материалов можно выделить пять групп: 1. дома с остовом из развилок, включенных в землю, оплетенных тростником и обмазанных глиной снаружи и внутри. 2. Дома с остовом из развилок, установленных на камнях, обнесенные тростником с двух сторон и обмазанных глиной снаружи и внутри. 3. Дома с остовом из развилок, включенных в землю или установленных на камнях, застроенные обломками кирпичей, выведенных из античного города Аполлония. 4. Каменные дома. 5. Дома из обожженного кирпича.

Анализируя типы жилых домов, существующих в настоящее время и привлекая данные из письменных источников, автор делит развитие планиметрической формы на два периода: до и после колLECTIVизации сельского хозяйства. Более старой формы жилья является хата из одного помещения размерами 4x6 м., с очагом для разведения костра в самой середине.

В хате был единственный вход, прорубленный в одну из продольных стен. Жилье из двух помещений, представляющий собой второй тип, получилось в результате пристройки одной хаты к другой. Оба помещения имеют отдельные входы; первое помещение, где находится место для разведения костра, называется крестьянами маткой дома, второе называется одой и служит одновременно гостиной и спальней.

Третье помещение получилось в результате постройки двух хат близко одна к другой, с промежутком между ними, который получил название „хаят” — сени. В начале сени такого типа домов были открытыми с двух сторон, и только позднее они оказались за-

крытыми. Итак, последним этапом этого развития является жилье из двух помещений с закрытыми сенями между ними, с крыльцом главного входа защищенным алиной, "стrehой", на двух столбах.

Имеется еще второй вход с другой стороны сен. Этот тип и в настоящее время является главным типом крестьянского жилья, Мюзекье, а также других равнинных деревень нашей страны. Развитие этого типа в вертикальном направлении получается повторением на втором этапе той же планиметрии.

Этапы постоянного развития крестьянского жилья области Мюзекье графически изображены на таблицах I, II, III.

## LOJNAT POPULLORE TË RRETHIT TË SHKODRËS

Loja në çdo kohë ka qenë dhe asht e kandëshme për fëmijt e të rritunit. Nëpërmjet saj përsosen lëvizjet trupore, fitohen cilësira të dobishme, si shkakhtësia, guximi, shpejtësia, mpreftësia, rezistenca, forca, elasticiteti, orientimi, etj.

Në lojë fëmija mëson të luftojë ose të mbrohet; ai bahet ma i disiplinuem, edukohet jo vetëm fizikisht, por edhe moralisht. Loja asht një pasqyrë besnike e jetës së brendëshme të tij, një përcjellse e fuqishme e fëmijës në ambientin kolektiv dhe shoqnor.

Populli shqiptar ka krijuar lojnat e veta. Këto mund të janë të lehta dhe të vështira. Në to vihet re aftësia krijuar e zbatuese e popullit tonë; nga brendia e tyne kuptohen lloje aspektesh ngajeta e tij.

Në këtë artikull ne do të pasqyrojmë disa nga lojnat e fëmijve dhe të rive të rrethit të Shkodrës. Ato na paraqiten të shumëllojshme. Disa herë ndryshojnë prej fshatit në fshat, prej lagjes në lagje, prej krahinës në krahinë. Njikohësia nuk duhet mohue edhe qenia e këtyre lojnavës në popujt e tjera.

Qëllimi ynë kryesor asht me nxjerrë në dritë mjaft prej tyne, të cilat i përkasin jetës së fëmijve dhe të të rritunve të këtij rrethi.

Grumbullimi dhe sistemimi i lojnavës, si edhe përpunimi i tyne, do të jetë nji punë e dobishme për edukimin e fëmijve tanë, mbasi lojnat popullore puqen mirë me natyrën dhe psiqikën e mbarë popullit.

• • •

Qi lexuesit të kenë një ide mbi ambientin ku janë zhvilluar lojnat, po japim nji panoramë të shkurtër të qytetit.

Gjeografikisht Shkodra asht nji qytet i hapët, i përbamë pjesërisht me shtëpi të vjetra, me dhoma e çardaqe të mëdha, oborre të rrethueme me mure të nalta, pataloke e fusha të gjana, ka lehtësue zhvillimin e lojnavës. Kodra e Rrencit, Tepës, Qafës, Luguçesmes janë si nji gjysëm hark i vogël që rrëthojnë nji pjesë të qytetit, bashkë me fushat e gjana buzë lumejve Kir, Dri e Bunë dhe të ligjenit.

Çdo lagje e qytetit kishte nji pataloq. Në këto pataloqe fëmijt e të rritunit zhvillojshin lojnat e tyne. Këto vende ishin tërheqëse, gadi-gadi si të ishin krijuar për atë punë.

Sa i bukur ishte pataloku i lagjes Tepe në hijen e fojletave, ku të gjithë fëmijt e lagjes mblidheshin për të luejtë lojna të ndryshme! Ndër pataloqe të tjera po përmendim atë të Vegsharit, të Draçinit. Perashit, Arrës së Madhe, Ballabanës, Kirasit, Dudasit, Rusit të Madh,

Rus-Maxhar, etj. Këto sheshe ishin vendet ma të preferueme të fëmijve dhe të të rritunve.

Ende sot gjen si mbeturina në çdo lagje të qytetit apo të katundit ndonji patalok, si p.sh. në hijen e çinarve, manave ose foljetave, etj., ku fërnijt dhe të rrijt e kohëve të kalueme zhvillojshin lojnat e tyne plot gaz e hare. Në ditët tona pataloqet e dikurshme u zëvendësuan me kandet e shumta sportive, që ngrihen herë mbas herë me kujdesin e ndihmën e partisë e të pushtetit për nevojat e organizatave të pionierit e të rrissë të këtij rrithi.

Në këto pataloqe janë zhvillue lojna të ndryshme, ndeshje të vërteta sportive shtëpi më shtëpi e lagje më lagje. Këto lojna qenë të ndryshme jo vetëm si mbas moshës e sekshit, por ato ndryshojshin edhe në mes qytetit e fshatit.

Në Pazarin e Vjetër, në Kryepazar, në Skelë të Peshkut, në Lamë të Drithnave, në Fushë të Bunës, te Ura e Bunës, te ura e voeve, në kohën e vet, shegertat e vegjël dhe të rritunit zhvillojshin lojnat e vendit.

Në lëndinën e bukur të patalokut të Tabakëve, në hijen e tre çinarve, në skaj të qytetit, bri shkambijve të mëdhenj të kështjellës, fëmijt dhe të rritunit e lagjeve për reth mblidheshin për të zhvillue lojnat e tyne.

Janë pikërisht këto vënde ku janë zhvillue e zhvillohen lojna për të cilat do të flasim në këtë artikull. Natyrisht, na nuk i kemi grumbullue të gjitha, por këto formojnë një pjesë të tyne dhe mund të plotsohen ose të tregohen variante të ndryshme nga të gjithë ata që i njofin.

Shtojmë se një pjesë e lojnave që ne do të shtjellojmë ma poshtë, janë lojna të luetjuna në fëmini nga vetë autori. Pjesa tjetër asht mbledhun nga goja e popullit dhe nga vrojtimet direkte të fëmijve në lojë e sipër.

Na, për me i bamë të kjarta lojnat popullore të këtij rrithi, menojmë ti ndajmë në dy grupe kryesore: **në kolektive pa skuadra** dhe **në kolektive me skuadra**.

Mbi këto grupe lojnash do të flasim ma imtësish në paragrafët përkatës.

## I. LOJNA KOLEKTIVE PA SKUADRA

Lojnat pa skuadra i quejmë kolektive, për arsyen se vepron i gjithë kolektivi.

Në lojë secili provon forcat e tij dhe në lëvizjet që ban ndjen kënaqësi. Lojnat pa skuadra luheshin nga fëmijt e të rritunit nën udhëheqjen e një lojtari të cilin e zgjidhshin së bashku, për të drejtue lojën. Fëmijt e të rriturit këto lojna i organizoheshin vetë, tue iu nënshtrue rregullave që caktonte kolektivi. Këto rregulla respektoheshin nga të gjithë, mbasi ishin ndërtue në mënyrë të tillë që nuk preknin interesat e pjesëmarrësve.

Qëllimi i këtyre lojnave ishte i përbashkët për të gjithë lojtarët. Në këto lojna çdo pjestar përpinqej me forcat e tij të dilte fitues. Ky grup kryesor i lojnave kishte qëllim që të edukonte fëmijt e të rritunit për të qenë të vetëdijshëm në kryemjen e detyrave dhe i mësonë ata me qenë kambëngulës në arritjen e objektivave të lojës.

Qi t'i japim lexuesit nji pasqyrë të qartë të lojnavë po i klasifi-kojmë ato në lojna: lëvizëse, imituese, komike dhe fjalësh.

A) **Lojnat lëvizëse.** Këto i ndihmojnë fëmijt për të vu në veprim aparatin lëvizës të tyne, në mënyrë që lëvizjet t'i drejtojnë me ndër-gjegje për nji qëllim të caktuem. Në këto lojna ata zhvillojnë trupin, muskulaturën, aftësitë e tyne fizike, si shkathtësinë, elasticitetin, dhe aftësitë e tyne shpirtnore, si imprehtësinë, durimin, vullnetin squet-sinë, etj.

Në këtë grup bajnë pjesë lojnat për meshkuj, ato për femna dhe lojnat për meshkuj e femna bashkë.

Lojnat për meshkuj janë këto: Shkop e dojkë, Top e gropë, Ruejtja e kësulës, Harushë, Bindërbin, Shtiza, Kësul buke, Peshku në rrjetë, Bleta, Ruejtës, Kush e ndron harapin Arra me kokra, Arra me pilë, Arra me pilë e pura, Arra me gropë, Lepuri e zagari, Rrathësh, Hedhja e gurit mbrapa, Bujku, Turrë me shkrepse, Turrë nën hali, Unaza në pe, Mëshefja e unazës, Kush të ra tek të ra dhe Nandësh (degerxhim); ato që luhen nga femnat janë: Me të kapërcyme, Top e pesë, Top e murë, Konop, Vizë, Konopi i gjatë: kurse në lojnat për meshkuj e femna bashk' përfshihen: Katër caqesh, Bullicë, Talaçë, Galic, Gjeje symbyllas kush të ra, Dhelpnë topalle, Mëshefa kukë, Ajrum-cicirum, Ras e buq, Shamija në rreth, Top e rreke katër coqesh, Nicash (guralecash), Shtregullash, Ashikësh, etj.

### 1. «Shkop e dojkë»

Luhet me dojkë<sup>1)</sup> e shkopij të gjatë rreth 80 cm. Në të marrin pjesë 6-8 lojtarë meshkuj me moshë 10 vjeç e nalt, në oborre të shtëpi-ve ose pataloqe të lagjeve. Zakonisht e luejnë në dimën.

Para se të fillohet loja fëmijt caktojnë vëndin dhe hapin në tokë nji gropë të madhe me nji perimetër afro 40 cm. e me thellësi rreth 20 cm. Për reth saj, në nji largësi prej nji metri çelin nji gropë ma pak noga sa janë lojtarët.

Loja fillohet tue qit short se kush do të hyjë i pari. Shorti qitet në këtë mënyrë: në nji vijë të shënueme larg gropës lojtarët rrjeshtohen tue kapë shkopin me gishtin e madh e diftues; tue e mbajtë në naltësinë e supit, e hedhin drejt gropës së madhe. Ai që bie ma larg se gropë hyn në lojë. Lojtari merr dojkën në dorë dhe shkon te caku i vet, kurse të tjerët zanë gropat e veta dhe secili e mbulon atë me njanë kam bë e rri gati me shkop me ruejt gropën. Ai që ka dojkën synon ta fusë atë në gropën e madhe. Mbasi e hudhë rrëshqanas ose pak nalt, të tjerët e ruejnë dhe ia presin atë tue ia largue larg e ma larg me shkopij. Në qoftë se dojka e hedhun nuk takohet nga ruejtësit, ajo qëndron në atë vend ku ka ra. Për ta largue dojkën nga vëndi ku asht, ndënjani nga lojtarët detyrohet ta vejë vehten në rrezik, tue mbetur pa shkop. Ai i jep shkopit të vet me krahë rreshqanas drejt dojkës, i cili e takon ose nuk e takon. Në rast se nuk bahet takimi, ai lojtar qëndron pa shkop deri sa dojka të ketë shkue larg. Atëherë ai me vrapi shkon e merr shkopin e tij.

1) Dojka asht nji copë dru e rrumbullakët.

Secili lojtar kujdeset mos tē zbulojë gropën e vet se ia zen msheftas ai qì hudh dojkën. Nëqoftëse dojka futet në gropën e madhe, atëherë çdo njani, simbas rregullit, ndrron gropën e vet me shokun dhe hedhësi i dojkës ban çmos tē zajë nji gropë. Kur ky e zen nji gropë me kam-bë, atëherë ai qì mbetet jashtë merr dojkën dhe ban po atë punë qì bani shoku i vet ma parë. Ka raste qì njani mund tē rrekët në lojë aq shumë sa tē mërzitet dhe tē qajë.




Fig. 1

## 2. «Top e gropë»

Luhej nga fëmijt meshkuj, tē moshës 8-10 vjeç. Zhvillohet në nji vend tē rrafshëtë bri nji muri, në stinën e pranverës dhe, nganjihërë, edhe në stinën e dimnit. Në tokë çelen gropë tē vogla në madhësi tē topit, larg njana-tjetrës rrëth 20 cm. në vijë tē drejtë. Mbas çelen gropat, ato rrëthohen me tulla. Mandej bahet nji vijë larg gropave afro 6 metra, qì quhet «cak».

Në këtë lojë marrin pjesë 6-8 lojtarë. Ata qesin short në mes tyne se cili do tē fillojë i pari, i dyti e kështu me radhë. Mbas shortit zgjidhen edhe gropat. Për ketë lojë përdoret nji top lecke, ose llastiku. Lojtarë qì do tē qesi i pari, e merr atë në dorë dhe shkon para vijës së caktueme, ndërsa tē tjerët zanë vend para gropave. Lojtarë hundh topin rrëshqanasi në drejtim tē gropave; në rast se topi i hedhun nuk hyn në gropë, atëherë e merr ai qì asht i dyti. E kundërtë po që se topi hyn në gropë tē ndonjanit, ai me tē shpejtë e merr atë nga gropë për tē goditun shokët, tē cilët vrapijnë qì tē mos goditen. Pranë gropës së lojtarit qì goditet vihet nji gur. Në rast se me topin nuk goditet njeri, guri i vihet atij qì gjuejti. Loja vazhdon përsëri tue e hedhë topin ash-tu si e hodhi i pari. Ai nga lojtarët qì plotëson dhjetë gurët, largohet nga loja. Këtij i jepet dënim i tue e vue me fytyrë nga muri në largësi 6 metra e sejçili nga lojtarët e gjuen me nga dhjetë topa në shpinë. Lojtarë qì asht në mur nuk duhet tē lëvizi.



Fig. 2

### 3. «Ruejtja e Kësulës»

Kjo lojë luhej nga 8-10 fëmijë të moshës 10 vjeç e nalt në një vend të sheshët, zakonisht në dimën.

Ma parë caktohet vendi tue bamë në tokë një rrëth me një diametër prej afro 10 metrash. Në katër-pesë pika të rrëthit vendosen gurë të vegjël dhe në qendër një rrëth tjetër i vogël me një diametër prej afro 1 m. Pastaj hidhet short «shi e diell»<sup>2)</sup> se cili do të hyjë i pari




Fig. 3

2) Shorti «shi e diell» zhvillohet në këtë mënyrë: Merret një copë tjegull, e cila është një anë laget me pështymë e quhet shi, kurse nga arka tjetër lihet e terun e quhet diell. Atëherë e hedhin radhas nalt tue i thanë njani tjetrit: «G'ka kërkon, shi a diell?» Në qoftë se bie nga ana që kërkon, p.sh., diell, atëherë fiton; në rast të kundërt, humbet ky e fiton tjetri.

në lojë. Lojtari qì hyn i pari merr kësulën dhe e ven në mes të rrëthit të vogël, pér me e ruejtun. Të tjerët vendosen përjashta rrëthit të madh. Kur fillon loja, ata brenda rrëthit të madh përpiqen të marrin kësulën. Kur ruejtsi habitet a lodhet nga veprimet e shumicës dhe ma i shkathiti ia merr kësulën, atëherë ai sulmon me goditë atë qì ia mori dhe kështu e detyron të goditunin me ndrrue rolet tue fillue loja përsëri.

Kur qëllon qì lojtarët ia marrin kësulën me kambë atëherë ajo mund të vijë rrötull nëpër kambë të lojtarëve pa dalë jasht rrëthit të madh. Në këtë gjendje ruejtësi vrapon mbas atij qì ka kësulën pér ta goditë në moment qì, e ka në kambë para se t'ia kalojë tjetrit.

#### 4. «Harushë»

Luhej nga djemtë e moshës 10-14 vjeç në nji fushë, ose lendinë, zakonisht në stinën e pranverës dhe të vjeshtës. Marrin pjesë 10-20 lojtarë. Para se të luhet kjo lojë, fëmijt bajnë nji rrëth me gurë me diametër afro 4 m., ose me viza. Ky asht vendi ku rrin «harusha». Ndërsa vendi i lojtarëve të tjerë asht në formë katërkandëshi me dimensione 20-30 m.

Mbas kësaj qitet short në mes lojtarëve, ose caktohet njani nga vetë ata qì të hyjë në lojë me lujt pjesën e harushës. Ky rri brenda rrëthit, kurse të tjerë shpërndahen në fushë brenda kandrejtit.

Lojtarët e shpëndamë nëpër fushë i aviten «harushës» dhe e ngacmojnë. Në këtë rasë «harusha» del nga strofka e msyn të kapë ndonjanin. Kur ajo prek ndonjanën atëherë ai quhet i zanë nga ajo dhe e merr e e çon në strofkën e vet. Pastaj del prapë të gjuejë e në qoftë se prek përsëri ndonji tjetër, edhe këtë e çon në strofkë. Del përsëri me gjuejtë por këtë herë me të gjithë ata qì ka zanë. Në këtë rast lojabhet ma e gjallë e tërheqëse. Lojtari — harushë tash ka mundësi të kapë ma shumë nga lojtarët e tjerë e t'i çojë në strofkën e vet. Kështu rritet numri i anës së harushës e paksohen ngacmuesit e saj, deri sa mbetet vetëm i fundit, i cili quhet fitues. Kur mbrrinë kjo gjëndje, ndrrohen, rolet: «harusha bahet lojtar dhe fituesi «harushë».




Fig. 4.

### 5. «Bindërbinë»

Luhej me qeleshe nga djemtë e moshës 12 vjeç e nalt. Kjo lojë zhvillohej në pranverë në vend të sheshtë, patalok ose oborr. Në të marrin pjesë 5-10 lojtarë, të cilët, para se të fillojnë, qesin short përmë caktue se cili do të hyjë i pari në lojë. Mbas shortit, të gjithë shkojnë e zanë vendet e tyne: kërcyesat rreshtohen njani mbas tjetrit përballë atij lojtari që ka ul kurrizin dhe ka mbështet dy duert në gjunjët e veta. Ky i fundit kambët i mban të hapuna afër 50 cm., me qëllim qi të mos rrëzohet kur të tjerët e kërcejnë me radhë.

I pari që kërcen ka në dorë qeleshen. Në kërcim e sipër ai vendos dy duert në kurrizin e shokut dhe i len qeleshen. Pastaj vazhdon i dyti, i cili kërcen tue vendosë duert në shpinë, por me kujdes të madh që të mos rrëzojë qeleshen. Kush rrëzon qeleshen; ai hyn në lojë. Kur ndonjani dëshiron me shpëtue shokun e ulun, ose, përkundrazi, ta lodi ma tepër, atëhere, në kërcim e sipër, përpinqet të lëvizë qeleshen në vënde të ndryshme të kurrizit, herë ma mirë e herë ma keq. Këto raste e bajnë lojën ma të gjallë, e ma tërheqëse, sepse lëvizja e qeleshës ka pasoja të mira ose të këqija përmë kërcyesit dhe përmë ulësin.




Fig. 5

### 6. «Shtiza»

E luejshin më tepër barijt 10 vjeç e nalt, tue mbajtë shkopij të gjatë rreth 1,5 m. Në këtë lojë marrin pjesë 10-15 lojtarë. Vendin e saj e caktojnë tue shënuë nji vijë në tokë që quhet cak. Rreth 20 m. larg kësaj vije vihet nji qeleshe si shejë.

Mbas kësaj lojtarët qitin short se cili do të hudhë shtizën i pari, i dyti e kështu me radhë. Pastaj secili prej tyne shkon me zanë vend afër vijës së caktueme dhe kështu vihen në gadishmëni, tue mbajtë shkopin në mes me gishtin e madh dhe gishtin diftues. I pari që gjuen, në se i bien qeleshës, fiton pesë pikë; në se i afrohet shumë afër, dy: pak ma larg, nji.

Ai që fiton pikë ma shumë del fitues, kurse të tjerët humbasin. Lojtarë që gjuen nuk duhet të shkelë vijën e qitjes; në rast të kundër humbet të drejtën e hudhjes.




Fig. 6

#### 7. «Kësulë-Bukë»

Edhe kjo luhej nga barijt në moshë 10-12 vjeç e nalt. Marrin pjesë 10-15 vetë. Zakonisht luhej në pranverë apo në vjeshtë. Para se të fillojnë, lojtarët bajnë një rrith me një diametër 20 m.,




Fig. 17

në mes të cilit vendosin nji kësulë. Kur fillojnë me luejtë, ata nuk duhet të dalin jashtë tij.

Pastaj qitit short ose caktojnë me dëshirë se kush do ta ruejë kësulen me turrë (shami e përdredhme dhe e bame nyje në cep). Lojtarët, me anën e lëvizjeve të shkathta përpiqen me çdo mënyrë t'i rrëmbejnë kësulen. Por ruejtsi mundohet me goditë me turrë. Kur ndodh qi lojtari ia merr kësulen pa u goditë, ia hedhin njani-tjetrit. Ruejtsi i ndjek me goditë me turrë ndërsa ata e kanë kësulen ndër kambë. Në qoftë se ruejtsi godit në kambë lojtarin që ka kësulen ndryshon rolin me të. Ruejtsi i kësulës nuk duhet ta shkelë me kambë atë; ai duhet të lëvizë rrëth saj. Rojtarët nuk duhet të dalin jasht vendit të caktuem për lojë.

#### 8. «Peshku në rrjetë»

Edhe kjo luhej nga djemtë e moshës 10 vjeç e nalt në stinën e pranverës, dhe po në ato vënde ku luheshin të tjerat qi i përmëndëm ma parë.

Për këtë lojë, në të cilën marrin pjesë 8-10 lojtarë, përdoret nji brez afro 3-4 m, i gjatë, i cili në mes lidhet vjegë (nji rrëth pak ma i madh se madhësia e kambës). Para se të fillojë loja, qitet short, ose caktohen dy vetë me mbajtë brezin në distancë 10 m. nga shokët e tjerë. Dy lojtarët qì mbajnë brezin ulen përballë njani-tjetrit e rrjinë gati. Lojtarët vrapijnë nji nga nji, tue futun e tue hequn me shpejtësi njanën kambë në vjegë, kurse dy të ulunit e térheqin atë për me i zanë ndonji kambë. Në qoftë se ndonjani zihet, veçohet, ndërsa të tjerët vazhdojnë lojën. Por nëqoftëse ndokush vrapon pa e futun kambën në vjeg, atëherë ai ndrron rolin me nji nga ata qì mban brezin. Ndodh qi ndonji lojtari i pengohet aq shumë kamba sa mund të rrëzohet. Në këtë rasë lojtarët arrijnë në kulmin e gëzimit dhe qeshin me të, tue thanë «u zu peshku në rrjetë».




Fig. 8

### 9. «Bleta»

Zhvillohej nga djemtë e moshës 14 vjeç e nalt, në nji vend të vogël, dhe luhej jo vetëm në stinën e pranverës, por edhe në stinat e tjera të vitit.

Marrin pjesë tre veta, të cilët qesin short se cili do të hyjë në lojë. Atij qi i bie shorti me hy në lojë, quhet «bletë». Ky qëndron në mes dy lojtarëve me kambë të hapuna sa gjanësia e shpatullave dhe shuplakat e duerve i vendos afër gojës. Pastaj zhugat si bleta: zh-zh-zh. Ndërkajq, lojtari i anës së djathë e shtrin shuplakën e majtë mbi kokën e «bletës», kurse të djathët e nxjerr përpara pér ta qëllue ajo. Po këtë punë ban edhe lojtari i anës të kundërt. Pastaj fillon loja. Bleta zhugat herë në njanën anë e herë në tjetrën, tue qëllue shuplakat përkatëse të njanit ose të tjetrit kundërshtar, por në anën tjetër ulet pér me u mbrojtë nga ato që përpigjen t'i rrëzojnë kësulen. Në rast se ndonjani ia heq atë, atëhere ky ia zen vendin asaj dhe bleta ndrron gjithashtu rol me të.




Fig. 9

### 10. «Ruejtës»

Luhej me breza nga djemtë e moshës 10-14 vjeç dhe vetëm në stinën e pranverës, në fusha, e në pataloqe të lagjeve.

Në të marrin pjesë 10-20 lojtarë. Në vendin ku do të luhet loja bahet nji rrëth me diametër 10 m. Para se të fillojnë, qesin short se cili do të bahet ruejtës dhe cili do të rrijë në qendër pér me mbajtë njanën anë të brezit. Lojtarët lidhin brezat e tyne me njani-tjetrin. Atij qi i bie shorti pér në qendër, zen vendin në mes të rrëthit dhe këtu kap njanin skaj të brezit, ndërsa ruejtsi në skajin tjetër të tij bahet gati pér ta ruejtë. Kur fillon loja, lojtarët lëvizin rrëth e rrötull, në mënyrë që të habisin ruejtsin me lloj-lloj mënyrash. Ka raste që godasin shokun e tij

me dorë. Ndërkaq, ruejtsi mpron tue sulmue pa lëshue brezin nga dora. Në rast se ai godit ndonji nga lojtarët qi ngacmojnë, atëherë bahet ndrrimi i roleve me shokun e ruejtsit, ose me vetë atë.




Fig. 10

### 11. «Kush e ndron harapin»

E lujshin fëmijt (meshkuj) të moshës 8-10 vjeç në çdo stinë të vitit dhe po në ato vende si edhe të tjerat qi u përmendën ma nalt.

Para se të fillojë loja, vizatohet nji kuadrat i madh me dimensione 20-30 m. Në skajin e kuadratit shënohet me nji vijë vendi ku rrin «harapi». Pjesa tjeter e kuadratit mbetet për lojtarët e tjerë. Pastaj qitet short se cili do të hyjë në lojë.

Sapo fillon loja, nji lojtar thrret me za të naltë: «Kush e ndron harapin?». Të gjithë me nji za përgjigjen: «Askush». Kur «harapi» dëgjon kështu, lëshohet me vrap në turmë për të goditë ndonjanin. Ndërkaq, secili prej tyne vrapon qi të mbrohet.

Në qoftë se «harapi» godet ndonjanin nga lojtarët jashta cakut, atëherë e merr dhe e çon në vendin e vet. Lojtari i zanun del jashta lojet. Loja përsëritet deri sa «harapi» i godit të gjithë.

### Lojnat me arra

Me arra luheshin nji tok lojnash të ndryshme nga fëmijt e moshës 10-15, por ka raste që luejshin edhe të rrítunit. Luhej zakonisht në vjeshtë, në stinën e arrave. Në çdo lagje ose rrugë të qytetit, në oborre të shkollave të vjetra apo në pazar, mbas dugajësh, mblidheshin tufa-tu-




Fig. 11

fa fëmijt, secili me arra në xhepa, apo në nji torbë të varun në brez, me lujtë aïrash.

Nga arrat zgjidhshin atë ma të madhen, ma të randën dhe ma të fortën qi e quejshin «koç». Ky shërbente për të gjuejtë arrat. Për koçin fëmijt tregojshin nji kujdes të madh. Kështu, ato e férkojshin arrën në tulla a tjegulla qi lëvozhga e saj të bahesh sa më e lëmuet në mënyrë që të rrotullohesh sa ma mirë. I çelnin nji brimë në nji anë dhe nga ajo i nxirrshin thelbin dhe pastaj e mbushnin me saçma të vogla, qi të randohej e mos të rrotullohej tue shkarpërcye. Në fund e mbështillshin me dyllë qi t'i rritej vëllimi që në gjuejtje të godiste ma shumë arra.

## 12. «Arra me kokra»

Kjo luhej ma tepër prej të vegjëlve dhe atyne që kishin ma pak arra.

Si mbas vendimit qi mirrnin në fillim të lojës, çdo lojtar ven nga nji, dy apo tri arra në rrjesht, njanën pranë tjetërës. 5-6 m. larg prej rrjeshtit të arrave vihet nji gur apo tullë, qi quhet «cak». Prej rrjeshtit të arrave koçat hidhen në drejtim të cakut dhe kush bjen ma afërtij, qit i pari, pastaj me radhë caktohet i dyti, i treti, etj. Këtij vepri-mi i thonë «me ki».

Prej cakut qëllohen arrat rëshqanas (tue u rrutullue koçi), ose pingul (tue gjuitë fluturimthi), dhe ai qì qëllon merr të gjitha arrat që goditen. Në ras se nuk godit, nuk merr gja dhe e len koçin në vendin kundalet. Pastaj qet i dyti, i treti e me radhë. Në mbarim të turit të parë, në qoftë se arrat nuk goditen të gjitha, veprohet tue fillue me goditë arrat nga vendi ku kanë ramun koçat. I pari fillon ai të cilit i ka shkue koçi ma larg. Në kthesë praktikohet edhe nji rregull: Lojtari qi dishron kur qëllon nga caku i fillimit thotë «pikë e çka të marr» dhe, pavarë-

sisht ku i ndalet koçi, larg apo afér, ngel i fundit në qëllesën e kthimit dhe me të drejtë që të qëllojë nga afér arrat qì ngelen. Në qoftëse ato goditen nga shokët e tij, ai ngel pa gja.




fig. 11 a

### 13. «Arra me pilë»

Kjo ndryshon nga e para vetëm pér numrin e arrave. Luhej prej djelmoshave ma të rritun dhe qì kishin ma shumë arra.

Pilë arrash quhet kur vendosen 3 arra në tokë njena pranë tjetrës dhe sipë: tyne vehet nji arrë e katërt. Në disa raste bëhen edhe bile treshe e pilë dyshe, tue vu dy apo nji arrë poshtë e nji sipër.

Edhe pér lojën me pilë zbatohen rregullat e lojës në rresht, apo me pura, por në vënd të nji arre, vehet nji pilë arrash.




Fig. 12

#### 14. «Arra me purâ»

Edhe kjo luhej prej djelmoshash ma të rritun dhe atyne që kishin arra ma shumë. Ndryshon nga e para vetëm në rregullat.

Si vihen arrat në rrjesht, shkoqet nji prej tyne dhe vehet pak ma larg rrjeshtit. Kjo quhet «purâ».

Goditjet në këtë rast janë të ndryshme: kush vret purânin, merr të gjitha arrat. Rastisë në këtë lojë që ai mos me i lanë shokët me gjuejtë. Kush vret arrën e parë, të dytë, të tretë, etj., merr të gjitha arrat që vinë në varg mbas saj.

Edhe në këtë lojë zbatohen rregullat e lojës së parë në të kime.




Fig. 13

#### 15. «Arra me gropë».

Kjo luhej nga djemtë e moshës 14 vjeç e nalt në stinën e vjeshtës. Për këtë lojë marrin pjesë 4-6 vetë, para së gjithash çelet bri nji muri nji gropë e madhe me rreze 40 cm. dhe e thellë 30 cm. Larg saj afro 4-5 m. caktohet vendi për të hedhur arrat. Njani nga ata ruen gropën, kurse të tjerët përpiken të futin aty arrat. Në qoftë se arrat që futen në gropë janë çift, ai që ruen gropën detyrohet me i dhanë aq arra sa janë aty, p.sh. 10,20 30 ose ma tepër. Në qoftë se janë tek, i merr lojtari ruejtës i gropës. Arrat e hedhura numrohen me gjith ato që nuk futen në gropë.




Fig. 14

## 16. «Zagari e lepuri»

Edhe kjo, si të tjerat, luhej ma tepër në stinën e pranverës e të vjeshtës nga fëmijët meshkuj të moshës 7-10 vjeç, në fushë patalok ose oborr.

Në këtë lojë marrin pjesë 20-30 lojtarë, të cilët ndahen në dy grupë për me formue dy rrethe, tuë u lidhë dorëpërdorë njani me tjetrin. Para se të fillojë loja, caktohen dy veta me anë të shortit, ose me dëshirë, që të luejnë njani rolin e zagarit dhe tjetri atë të lepurit. Kur të jenë përfundue dy rrethe, atëherë në njanin rreth hyn «zagari» dhe në tjetrin «lepuri».

Mbasandaj, me komandë ose me fërshëllime, të gjithë rrotullohen me shpejtësi dhe, mbas dy-tri rrotullimesh, jepet urdhëri përsëri nga lojtari i rrethit që të shpérndahen, për me formue rrathët në një vend tjeter. Kur shpérndahen, «lepuri» e «zagari» duhet të ruejnë gjendjen, d.m.th. të mos mbeten jasht rrethit, mbasi kështu quhen të mundun; vendin e tyne e zejnë të tjerët kur rrathët formohen pa pasë ato brenda.




Fig. 15

## 17. «Rrathësh»

Luhej nga fëmijt (meshkuj) të moshës 5-7 vjeç. Në këtë moshë fëmijt kanë dëshirë me vrapue zbathun, sidomos në ditë pranvere. Ata e luejnë ketë me rrathë metal, ose druni, që i sigurojnë nga shekat (fusijat). Ka raste që këta rrathë i bajnë vetë. Veç këtyne, ata bajnë gjithashtu vetë edhe telin e gjatë 60 cm., të cilin në fund e lakojnë tue e bamen në formën e U-së. Pastaj këtë e vendosin në fund të rrethit dhe luejnë.




Fig. 16

### 18. «Hedhja e gurit mbrapa»

Kjo luhej në vend të hapët në dimën nga djelmoshat e moshës 14 vjeç e nalt, sidomos në katund e malësi.

Në këtë lojë marrin pjesë 6-8 veta. Para se të fillojë loja, secili merr nga nji guri të madh në duer, afro 3-4 kg. Pastaj caktohet vendi i lojës me nji vijë të gjatë në tokë, ose me gurë të vegjël, të cilët vlejnë si cak. Si të qitet short në mes lojtarëve secili do ta hedhi i pari, atëherë ky ban dy-tri herë përkuljen e trupit para e mbrapa dhe, ma në fund, e hedh gurin mbi kokë, tue shtrimë krahët përpëra e tue ba nji hark me trupin e tij mbrapa. Aty ku bje guri asht sheja dalluese për të. Pastaj vazhdoni i dyti, i treti e kështu me radhë të gjithë veprojnë sikurse i pari. Ai që e hedh gurin ma larg, fiton 10 pikë. Në qoftë se gjatë lojës ndonjani prej lojtarëve fiton ma shumë pikë se të tjerët, atëherë ai fiton lojën.




Fig. 17

### 19. «Bujku»

Luhej me brezë nga djelmoshat e moshës 8-14 vjeç, në stinën e pranverës në fushë ose patalok.

Në këtë lojë marrin pjesë 10 lojtarë. Ma parë këta qesin short në mes tyne për ulësin e ruejtsin. Mbas kësaj, ulësi ulet ndejun kambëkryq, tue mbajtë në dorë njanin skaj të brezit, kurse ruejtsi i tij kap skajin tjetër. Të tjerët shpërndahen për rreth. Kur njoftohet gatishmëria nga ruejtsi, fillon loja.

Tash secili që asht përreth përpinqet me habitë ruejtsin dhe më goditë ulësin me shputë shpinës. Por ndërkaq, edhe ky, tue ruejtun shokun, mundohet me gjetë rast për me goditë ndonjanin nga lojtarët e tjerë. Në rast se e godet, atëherë i godituni hyn në lojë dhe ai që asht këtu bahet ruejtës.




Fig. 18

### 20. «Turrë<sup>3)</sup> me shkrepse»

Kjo luhet me shkrepse e me turrë nga fëmijt e moshës 10-14 vjeç, por edhe nga të riyt. Zakonisht, e luejshin në oda të mëdha, në netët e gjatë të dimnit, në gostina e festa.

Para se loja të fillojë, shkrepset i punohet ana e turrës, tue gërvishëtë pak njanën nga anët që ka zhivën, kurse tjetren e lanë ashtu siç asht. E para quhet «turrë», ndërsa tjetra shpëtim. Pastaj gërvishtet njana anë e kutisë ku futen shkrepset, kurse tjetra lihet ashtu siç asht. E para nga këto quhet «dhetshe», kurse tjetra «pesshe». Pas kësaj caktohet a shtihet short për lojtarin që ka me fillue i pari. Si të jetë caktue ky dhe shkrepset të jetë vuë me turrë në tokë, atëherë fillon loja.

<sup>3)</sup> Quhet turrë, ose torkë, nji peshqir i bamë në formë gërshtete.

I pari merr shkrepse nga toka tue e kapun atë në dy skajet e saj me gishtin e madh e atë diftues dhe pastaj e hedh mirë nalt, sa të rrötullohet tri herë në ajr dhe të bjerë në tokë rrëshqanas. Në rast se nuk hudhet kështu, përsëritet, ose lojtari humbet të drejtën e lojës dhe vazhdon i dyti. Në qoftë se këtij ose të parit i qëndron shkrepse nga ana e turrës, ai merr turrën në dorë. Në qoftë se bie nga pesa, atëherë i qëllon të gjithë lojtarët e tjerë nga pesë herë me turrë në shuplakën e dorës. Pastaj e ven shkrepse përsëri në tokë për lojtarin pasues. Edhe ky vepron si i pari dhe ndjek po ato rregulla që u thanë për te. Vazhdon tjetri. Në qoftë se këtij i bie nga ana e shpëtimit, shpëton nga turra; por po që se nuk i bie gja, atëherë i qëllohet shuplaka një herë. Në qoftë se tjetrit pas këtij i bie dhjeta, ai merr turrën nga shoku dhe u bie të gjithve nga dhjetë herë, me përjashtim të lojtarit që ka «shpëtimin» dhe atij që ka «turrën».




Fig. 19

## 21. «Turra nën hali»

Edhe kjo luhesh me turrë nga djelmoshat e moshës 14 vjeç e nalt. Këtë lojë e kanë luejtun edhe burrat, në netët e dimnit, në dhomat e mëdhaja të shtëpijave të qytetit e katundeve.

Në këtë lojë marrin pjesë 10-15 veta, të cilët, para se të fillojnë, qësin short në mes tyne për të caktue se cili do të hyjë në lojë. Pastaj secili ulet ndejun në hali (qylym), tue formue kështu të gjithë nji rrëth. Kambët i mbajnë pak të thyeme në gjunjë dhe secili bashkon në qendër shputat e tij me ato të shokëve. Pastaj, mbi këto ulet ndejun ai që humb shortin, me shpinën nga ai që ka turrën. Në këtë gjëndje fillon loja.

Ai që ka turrën i bie në shpinë dhe me shpejtësi e kalon atë nën shalë për t'ia dhanë shokut, e ky të tjerëve, pa u diktue. Ndërkaq, lojtari që goditet kthehet shpejt nga ai që e godit dhe përpinqet me i marrë turrën, për me ndrrue rolin me të. Tjetri, kur i bie me turrë, kthehet

përsëri andej nga i bie e kështu vjen vërdallë mbi kambët e shokëve pér me gjetun e me kapë turrën; kur e kap ndrron vend me atë qì zihet me te në dorë.




Fig. 20

## 22. «Unaza në pe»

Luhej nga djelmoshat e moshës 14 vjeç e nalt. Të rritunit qì mblidheshin në rede odash, e luejshin këtë lojë në dimën pér reth mindereve, kurse në pranverë në lendinë.

E luejnë 10-15 lojtarë me unazë e nji copë spango të gjatë afër dy metra e ca, simbas numrit të lojtarëve. Si zakonisht edhe pér këtë caktohet ose shtihet short se kush do hyjë në lojë. Pastaj të gjithë formojnë nji rrëth, në të cilin sikush ulet kambëkryq, me duer të çueme deri në naltësinë e supave. Kështu mbajnë nalt unazën të varun në spango.

Tashti ai qì asht në lojë hyn në mes tyne, kurse lojtarët e tjerë përpiken me shpejtësi të madhe të lëvizin unazën në spango. Ndërkaoq i pari vëren lëvizjet e duerve të shokëve, në mënyrë qì të shofë unazën se cili lojtar e ka. Në qoftë se ky arrin ta shikojë atë në duert e ndonjanit, atëherë bahet ndrrimi në mes këtyre të dyve.




Fig. 21

### 23. «Mëshefja e unazës»

Edhe kjo luhej me unazë e më turre në redë odash nga djelmoshat e moshës 14 vjeç e nalt, luhej gjithashtu edhe nga burrat e qytetit e të katundit, të cilët i luejshin afro 10-20 vetë në netët e gjata të dimnit, në gostina e festa.

Si për të tjerat, edhe për këtë lojë qitet short secili do ta mbajë turrën dhe do ta mshef unazën dhe cili do të jetë gjetësi i saj. Në këtë lojë asnji nuk duhet të tregojë se kush e ka unazën, ndërsa mëshefsi nuk duhet ta mbajë atë në grusht. Kur të tjerët rrjeshtohen të gjithë në mindere, tue qenë ulun kambëkryq ose simbas dëshirës sé tyne, fillon loja.

Ai që ka unazën e mshef atë ndër duert e lojtarëve të tjerë, të cilët vendosin duert në gjunjë në formë grushti pak të hapuna, në një kohë kur gjetsi kishte shpinën nga ato. Mshefsi vendos dorën me unazë në grushtet e secilit lojtar. Ndërkaj, ja len atë njanit pa e diktue kush. Mbasi bahet mshefja, ai thotë «gjeje». Gjetsi menjicherë mendon e mendon, pastaj shikon lojtarët në sy, me qëllim që të kuptojë nga lëvizjet e tyne se cili e ka unazën. Në fund thotë: «Filani e ka». Në qoftë se nuk e gjen, atëherë ai që ka turrën i bie me të në shuplakën e dorës. Pastaj fillon përsëri, tue thanë: «E ka ai». E po të mos e gjejë këtë herë, i bihet prap me turrë. Kur e gjen, atëherë ndrron rolin me atë që ka unazën.

### 24. «Kush të ra, tek të ra»

Luhej me turrë nga djelmoshat e moshës 12 vjeç e nalt në dhomë e në netët e gjata të dimnit.

Në këtë lojë marrin pjesë 6-8 lojtarë, të cilët, para se të fillojnë, bajnë një rrëth. Asht rregull që asnjanë mos të tregojë se cilit lojtar i asht drejtue turra. Pasi qesin short, ose bahet caktimi i tre vetëve, njanë prej këtyre mban turrën, tjetri futet në rrëth dhe i treti ruen. Ai që




Fig. 22

Esht nē lojë qëndron nē gjunjë me kurriz tē përkulun para e me fytyrë tē mbështetun tek i treti, i cili e ruen qì mos tē shohë se ku drejtohet tura nga ai qì qëllon. Ndërkaq, tē tjerët rreshtohen kambékryq pér rrëth dhe fillojnë lojën.

Tash ai qì ka turrrën nē dorë i bie ulësit tri herë nē shpinë, tue i thanë: «Kush tē ra, tek tē ra, turra nē kë asht»: dhe shpejt ia drejton atë ndenjanit prej shokëve. Ulësi, i cili nuk shef, nē qoftë se përgjigjet se cilit lojtar i asht drejtue turra, atëherë ndrron rolin me atë qì ka turrrën nē dorë. Në rast se ky nuk e gjen dot, mbetet nē lojë deri sa ta gjejë nē radhët e ardhshme, ose deri nē fund tē saj.

### 25. «Degërxhim (Nandësh)»

Në këtë lojë, e cila luhej nē çdo stinë tē vitit nga djelmoshat e moshës 10 vjeç e nalt dhe nga tē rijt, marrin pjesë dy vetë.

Para se tē fillojë, loja merren gurë e tjegulla tē vogla dhe karton. Pastaj nē këtë tē fundit bahet nji katror i madh, i cili ndahet nē tre katrcrë ma tē vegjël. Shpesh kjo punë bahet nē tokë. Kur luhet me kartona, atëherë katrorëve tē këtij i shënohet nē mes nga nji vijë. Dhe si tē ketë marrë njani copat e vogla tē tjegullave e tjetri gurët e vegjël, fillon loja, tue vue i pari ai qì ka tjegullat.

Ky e ven njanën tjegull nē skaj tē njanit katorr, ose nē mes. Pas tij luen tjetri, i cili, zakonisht, e ndjek pas tē parin. Tash secili mendon me ba treshe me gurët e tij, ose tē ndryjë (tē mbyllë) kundërshtarin.

Kur vendosen tre gurët e njanit nē tre vendet e nji vije, atëherë asht formue treshja. Si tē arrihet kjo, fituesi i merr kundërshtarit nē fushë atë gur qì mendon ai, me përjashtim tē treshes. Lojtari ban treshen e thotë. «Tresh me hangër nji vesh». Gjatë vendosjes së gurëve nē fushën e lojës mundet mos me u ba asnji tresh. Kur merr fund vendosja e tyne, atëherë ajo vazhdon, tue lëvizë i pari gjithnjë ai qì ka tjegullën. Lëvizja e gurëve bahet ndër vende qì janë bosh, ose tue zanë vendin qì lëshon kundërshtari. Ka raste qì lëvizjet e tyne tē jenë tē shumta, por pa treshe dhe e kundërtat: me nji ose dy lëvizje bahet treshja. Kjo lojë vazhdon deri sa mundësit t'i fitohen tē gjithë gurët. Kur ndonjani mbyllët nga mundësi dhe i munduni nuk ka nga tē lëvizë, atëherë ky i fundit dorëzohet dhe lojën e fiton tjetri. Në anë tjetër, kjo lojë quhet e fitueme edhe kur bahet «cic-micë», d.m.th. kur janë dy treshe afër njana-tjetrës. Kështu çilet e mbyllët herë njani tresh e herë tjetri, deri sa merr fund loja. Kësaj i thonë madje «Çil e mbyll».




Fig. 23

## 26. «Me të kapërcyme»

Luhej në pranverë nga vajzat e moshës 7-9 vjeç, në nji vend të vogël, oborr ose fushë të sheshtë.

Marrin pjesë 8-10 vajza, këto ma parë qesin short në mes tyne për caktimin e dy lojtareve, të cilat ulen përballë njana-tjetrës. Si të dihen se kush janë këto, atëherë shkojnë e ulen tue shtrimun kambët me shputa ndaj njana-tjetrës. Pastaj secila vendos radhas herë njanen pëllambë e herë tjetër. Ndërkaoq, të tjerat rrjeshtohen disa hapa larg këtyne dhe me radhë fillojnë me kërcye.

Mbas çdo kërcimi si grup, vihen nji ose dy pëllambë mbi të tjerat. Kur ndonjana prej atyne qi kërcen takon pëllambën, ndrron rol me personin e asaj. Ka raste qi naltësia e kërcimit mund të shkojë deri 70-80 cm.




Fig. 24

## 27. «Top e Pesë»

Edhe kjo luhej zakonisht në dimën nga vajzat e moshës 7-10 vjeç, në nji vend të rrafshëtë dhe afër ndonji muri.

Në këtë lojë marrin pjesë 6-8 lojtare, të cilat ma parë caktojnë vendin e lojës në formë katrori dhe vijën ku do të hidhet topi (caku).

Si qesin short në mes tyne se kujt do t'i mbetet topi, fillojnë e luejnë tue hedhë njana topin në mur deri në pesë herë pa ranë në tokë dhe në nji kohë kur të tjerat janë pranë saj. Të pestën herë, kur e zetopin me dorë, shoqet shpërndahen shpejt e shpejt, sepse ajo që ka topin i qëllon këto me shpejtësi. Në qoftë se ndonjana qëllohet me top, ajo përsëri fillon lojën; në rast të kundërt, e humbet. Kur topi hidhet në mur nga lojtarja dhe i bie në tokë, ajo s'ka të drejtë ta marri ma, por e merr tjetra qi asht ma afër për me qëllue shoqet e saj.



Fig. 25

### 28. «Top e mur»

Luhej me top tē vogël lecke ose llastiku nga vajzat e moshës 8-10 vjeç në nji vend tē sheshët dhe bri nji muri tē lëmuem.

Në këtë lojë marrin pjesë 5-10 vajza, tē cilat, si ma parë, qesin short në mes tyne se cila do tē fillojë e para. Ajo qì ka radhën e para, shkon para murit afér 2 m., kurse tē tjerat rrijnë pranë saj.

Kur fillon loja, e para merr topin në dorë dhe e hedh në mur. Tue e përplasë me shuplakë disa herë dhe tue e hedhë me dorë topin në mur kjo ze e kendon:

Hidhe topin larg në mur,  
Rishtas shkon e vjen në dorë;  
Hera-herë bjen në pullaz,  
Më qet idhnim e me ban maraz;  
Shkon e vjen për bukuri,  
Në duart e mijë kthehet përsëri.




Fig. 26

Sapo mbaron këto vargje, e kap topin me shpejtësi dhe kthehet me qëllue ndonjanën nga shoqet, të cilat në këtë kohë kanë marrë vrap për t'iu largue «rrrezikut». Ajo qi qëllohet ndrron rolin me të, përndryshe në lojë mbetet e para. Kur topi bie në tokë, në kohën kur lojtarja e përplas në mur, atëherë secila synon ta kapë e të qëllojë ndonjanën nga shoqet për me e futë në lojë. Në qoftë se në rasën e parë dhe në këtë të dytën ajo qi ka topin gjuen pa fitim, atëherë topin merr ajo qi ka radhën, sipas shortit.

### 29. «Konopi»

Kjo lojë luhej me konop (litar), ose brez, në pranverë dhe dimër nga vajza të moshës 8-12 vjeç në nji vend të sheshtë, oborr, rrugë a patalok.

Si për të tjerat, edhe për këtë lojë qitet short se cila lojtare do të mbajë konopin. Mbasi caktohen dy lojtarët, të cilat marrin në dorë secila njanin skaj të konopit, largohen larg njana-tjetrës, aq sa asht i gjatë ai. Pastaj fillon loja.

Ato qi kanë konopin e luejnë atë nga nalt poshtë, në formë rrethi. Në këtë rast të tjerat, nji nga nji ose ma tepër; zanë e kércejnë në nji mënyrë që mos të pengohen në kërcim e sipër. Në qoftë se ndonjanës i ecën mbarë, atëherë luen tue këndue, ose tue numrue muejt e vtit. Kur numron këta të fundit, arrin deri në 12 kapërcime, pastaj del jasht për t'i lanë radhë tjetrës, ose të tjerave. Ajo qi pengohet ose takohet nga konopi, hyn në lojë, tue u ndrrue me nji tjetër që mban konopin. Në qoftë se takojnë grupat atëherë këto të dyja dalin jasht dhe konopin e marrin dy të tjera.




Fig. 27

### 30. «Vizë»

Luhej nga 4-6 vajza të moshës 8-10 vjeç në stinën e pranverës. Nuk ka oborr ose patalok në të cilët të mos ketë të shënuem nji apo disa kandrejtë rreth 6-8 m. të gjatë e afro 2 m. të gjanë dhe që ndahen nga

nji vijë, e cila i ndan gjithashtu këta në 2-4 katrörë, ose drejtkandësh të tjerë.

Loja fillon tue qitë short për radhën e parë, të dytë, etj. Pastaj se cila merr rrasikën (rrasën) e saj e fillon lojën. Si e para ashtu edhe të tjerat, kur luejnë, hedhin rrasiken në kuadratin a drejtkandëshin e parë. Pastaj me nji kambë e kalon atë kuadrat më kuadrat, deri sa e qet jashtë. Pas kësaj, vazhdon me kuadratin a drejt-kandëshin e dytë, të tretin, të katërtin e kështu me radhë, deri në fund. Mbasi mbaron të gjitha këto, merr rrasikën dhe e ven nenë glijen (kupës së gjunit), të cilén e përkul apostafat dhe, ashtu siç asht, kërcen edhe nji herë nëpër kuadratet a drejtkandëshat e vegjël pa i ranë rrasika në tokë. Në qoftë se i bie, humb lojën dhe e përsërit aty ku e ka lanë; po qe se e kryen atë me fitim, atëherë e merr, por tash e ven rrasikën në majë të kokës, pastaj ecën ngadalë nëpër rrugën e parë, tue pasë kujdes që mos t'i bjerë rrasika në tokë. Kur e ban edhe këtë, atëherë ze e myll sytë me këtë, atëherë fiton lojën dhe vazhdon përsëri nga fillimi. Si e para edhe të tjerat mund ta humbin lojën edhe kur u bie rrasika nga gjuni. Po kur t'i vijë radha, ajo e përsërit lojën aty ku humbi. Në qoftë se lojtares i bie rrasika nga koka, apo shkel vijën symbylltas, ajo humbet gjithashtu dhe kur t'i vijë radha e përsërit aty ku humbi.




Fig. 28

### 31. «Konopi i gjatë»

Edhe kjo luhet nga vajza të moshës 8-10 vjeç në stinën e pranverës, në patalogje, oborre ose rrugica. Asht mjaft e bukur e tërheqëse përfemnat.

Në këtë lojë marrin pjesë 8-10 lojtare, të cilat, para se të fillojnë, zgjedhin dy ma të shkathatat si udhëheqëse. Pasi kapen për dore dhe rrjeshtchen në vijë të drejtë, në anë tjetër, dhe kur njana udhëheqëse vihet në krye të rrjeshtit (koka) dhe tjetra në fund të tij, atëherë fillon loja, tue pyet njana udhëheqëse e tue u përgjigjë tjetra:

- Konopi i gjatë?
- Lepe, sulltan.
- Ku i ke dhëntë?
- Në mal.
- Çka hajnë e çka pijnë?
- Rrush e bedena.
- Ç'farë fuqie kanë?
- Të madhe.
- Me çka i mban?
- Me të gjitha të mirat.
- A bjen zilja me hy a me dalë?
- Me hy.
- A hyjmë a dalim?
- Hyjmë.

Pastaj e fundit ban pyetje tue hy e tue dalë nëpër krahët e shoqeve që nga koka e deri në fund të rrethit e tue folë: »Baj sumbaçë, lejla me lule. Ooh, ooh, ooh! c'po lidhim Kimeten me konop!». Dhe mbasi e «lidh» atë në krah, vazhdon tjetrën e kështu me radhë, tue ligjëruet përmes ato fjalë e me emnin që ka secila. Kur mbaron me këtë punë, atëherë u jep shtytjen të gjithave. Në këtë rast secila shpërndahet në shechin e caktuem, udhëheqësja tjetër që «u lidh» e para vrapon që të qëllojë tashti ndonjanën. Porsa e qëllon, ndrron rolin me të e kështu lojat fillon me një udhëheqëse të re.



Fig. 20

### 32. «Katër caqesh»

Luhej nga fëmijt (meshkuj e femna) të moshës 8-12 vjeç, në stinën e dimnit.

Në ketë lojë marrin pjesë 5 veta, të cilët ma parë qesin short në mes tyne se kush do të futet në lojë. Mbasandaj bajnë një katror  $8 \times 8$  m., në skajet e të cilët vendosin nga një gur të vogël si cak. Kur të jenë gati, sikush vendoset në cakun e tij dhe në qendrën e kuadratit qëndron një lojtar. Pasi fillon loja, çdo njani nga lojtarët përpinqet me shokun fqinj të ndrrojnë vendin. Por ndërkaq ruejtsi, sapo i dikton lëvizjet të parit ose tjetrit, vrapon t'i zajë vendin. Kur ja mbrrin kësaj atëherë tjetri mbetet jasht dhe ze e luen rolin e tij. Ndrrimet e caqeve bahan në vijë të drejtë dhe diagonale, gjithnjë në marrëveshje me shokun përkatës. Në qoftë se ky i fundit tradhëton, atëherë hyn në lojë.




fig. 30

### 33. «Bullicë

Edhe kjo lojë luhej nga fëmijt (meshkuj e femna) të moshës 6-8 vjeç, në një vend të sheshtë, oborr ose fushë, në kohë të pranverës.

Marrin pjesë 20-30 fëmijë, të cilët ma parë pregatisin vendin e lojës, në formën e katrorit ( $20-30 \text{ m}^2$ ). Pastaj, në skaj të tij shënojnë një rrëth të vogël me diametër afro 1 m. Ky asht vendi i «buellicës»; të tjerët, kur të luejnë, duhet të lëvizin vetëm brenda sipërfaqes së kuadratit. Si të jetë pregatitur vendi, qitet shorti në mes tyne për «buellicën». Ajo që «fiton» këtë rol, shkon menjherë në rrithin e «vet», siç u tregue ma sipër, dhe mbasi bahan të gjithë gati, fillon loja.

Tash secili ze e ngacmon «buellicën», e cila menjherë msyen ndonjanin me e kap. Por këto shpërndahen nëpër fush. Në rast se «buellica» qëllon ndonjanin prej tyne, atëherë e merr atë dhe e çon në vendin e saj. Në qoftë se brenda një kohe të shkurtën arrin të kapi pesë lojtarë, atëherë ndrohen rolet me atë që u godit i pari.




fig. 31

### 34. «Ta laçë galic»

Luhej në sheshe a vende të hapta nga fëmijt (meshkuj e femna) të moshës 7-10 vjeç, pothuajse në të gjitha stinët e vitit.

Në këtë lojë marrin pjesë 10-20 lojtarë. Në fillim zgjidhet vendi brenda të cilit do të zhvillohet loja. Pastaj qitet shorti se kush do të jetë i pari, ose ai që ka dëshirë thotë me za të naltë: «Unë jam në lojë». Asht rregull që loja të mos quhet në qoftëse ai i cili qëllon ndonjanin nuk thotë si ma sipër. Përkundrazi, kolektivi atij i tërheq vëmëndjen tek lajmërimi. Kur secili bahet gati, fillon loja.

Lojtari që asht në lojë, porsa i afrohet një tjetri, mundohet ta qëllojë me dorë, por ai ulet me të shpejtë galic. Në qoftëse i pari qëllon, atëherë ndrrohen rolet. Tash edhe ai që merr radhën, njofton me za si shoku para tij. «Unë jam në lojë».

Kjo lojë luhet edhe në shtyllë ose në mur. Edhe në këto raste zbatohen po ato rregulla e veprime si në rasën e sipërme, vetëm se këtu lojtarët caktojnë një shtyllë ose mur për me u mbrojtun. Kur ai që asht në lojë vrapon me qëllue ndonjanin, atëherë ky i fundit ve dorën në shtyllë ose në mur dhe lojtari që asht në lojë nuk mund të godasë. Në rast se e qëllon pa arritur në mur ose në shtyllë, ai hyn në lojë.




Fig. 32

### 35. «Gjeje symbyllas kush të ra»

Edhe kjo luhej pothuajse në çdo stinë të vitit nga fëmijt meshkuj e femna të moshës 6-8 vjeç, në oborr apo çardak. Asht rregull që në këtë lojë asnjanë nga lojtarët nuk duhet të japë ndonji shejë për atë që qëllon, përndryshe hyn vetë në lojë.

Marrin pjesë 10-15 lojtarë, të cilët, para se të fillojnë, zgjedhin udhëheqësin a udhëheqësen e lojës. Ky ose ajo mund të jetë ma i rrunti dhe ma i shkathiti. Mbasi qesin short në mes tyne se cili do të hyjë në lojë, fillojnë kur ky i fundit mbyll sytë dhe qëndron pranë udhëheqësit a udhëheqëses, ndërsa të tjerët vendosen përballë tij të ulun kam-békryq.

Udhëheqësi fton njanin, i cili afrohet lehtas dhe, mbasi e qëllon me dorë në shpinë lojtarin qi ka sytë e mbyllun, largohet me lehtësi në veridin e vet. Sapo futet ndër shokë e shoqe, udhëheqësi ia çel sytë këtij apo asaj dhe e pyet:

— Kush të ra? Gjeje!

Ai, pa ba fjalë, niset tek të tjerët dhe përpinqet të gjejë atë që e qëlloi. Në se e gjen, e merr për hunde dhe e çon tek udhëheqësi. Në rast se jo, vazhdon përsëri loja.

### 36. «Dhelpra topalle»

Luhej nga fëmijt meshkuj e femra të moshës 8-10 vjeç në një vend të sheshtë — patalok, oborr ose fushë.

Edhe për këtë lojë ma parë bahet në tokë nji kuadrat me brinjë  $10 \times 20$  m. dhe në skaj të tij shënohet një rrëth i vogël me diametër afro 2 m. Këtu rrin «dhelpna», ndërsa në kuadrat rrijnë lojtarët e tjerë. Në këtë lojë marrin pjesë 10-20 veta, të cilët, para se të fillojnë, qesin short me «shi e diell» se cili do të hyjë në lojë. Shorti qitet tue marrë nji copë tjegull, e cila në njanën anë laget me pështhymë dhe në tjetren lihet e terun. Lojtari që ka ketë, e hedh nalt, ndërsa tjetri kërkon ose shi ose diell në nji kohë kur tjegulla asht në ajr. Në qoftë se atij i bie shorti që kërkon, atëherë fiton i pari. Kështu vazhdohet pastaj edhe me të tjerët, deri sa të fundit t'i mbetet roli i dhelpnës. Pas kësaj shkojnë nëpër vendet: «dhelpna» futet në rrëth, kurse lojtarët e tjerë shpërndahen nëpër kuadrat. Asht rregull që asnji nga këta nuk duhet të dalë jasht kuadratit kur «dhelpna» vrapon si topalle me nji kambë që të kapë ndonjanin.

Ndërkaq, ata që janë në fushë herë i afrohen, herë i largohen, tue e tallë ose tue e ngacmues. Në qoftë se «dhelpna» lodhet, atëherë lojtarët e tjerë i vihen mbrapa, tue i thanë disa herë: «Dhelpna u lodh, neve s'na kapi». Mbas shplodhet ca, ajo del përsëri nga strofka dhe vepron si në radhën e parë. Në rast se këtë herë kap ndonjanin, ndryshon rolin me të.




Fig. 33

### 37. «Mëshefa Kukë»

Luhej në çdo stinë të vitit nga fëmijt (meshkuj e femna) të moshës 5-7 vjeç, në oborre, kopshte, hajate e ahra të mëdhaja, ku fëmijt kanë mundësi me u strukë (mëshefë) ma mirë. Kur luejshin në dhomat e mëdha, mshifeshin mbas arkave dhe musandrave.

Në këtë lojë marrin pjesë 6-10 lojtarë, të cilët ma parë qesin short në mes tyne për me përcaktue lojtarin qi do të mbyllë sytë nga muri. Pastaj, ose dhe ma përparrë caktojnë vendin e lojës. Asht rregull që lojtari që del jashtë vendit të caktuem, ndrron rol me atë që mbylli syt para tij. Si të jenë të gjithë gati, fillojnë.

I pari shkon te muri dhe përballë tij mbyll sytë me dy duer, tue numrue me za nji deri në tridhjet. Kur thotë numrin e fundit, njofton përsëri me za: «I hapa». Pastaj pyet: «A jeni mshefë?» Pas kësaj, njani apo dy prej tyne bërtasin me za të naltë: «Kukë-kukë». Me të ndigjue kështu, ky çel sytë e fillon me kërkue. Ndërkaq, ata që janë mëshefë pak si larg dy nga dy, bisedojnë me za të ulët me ankth e dyshim se mos tjetri po i gjen. Kurse nji tjetër ma larg qit kryer me pa se ku asht ai që mbylli sytë. Në qoftë se nuk e shef njeri, atëherë del me ja lanë me fjalën «pas», tue pështye vendin e kërkuesit. Po kur ky i fundit e gjen ndonjanin, menjisherë therret me za: «Agim (ose emër tjetër, si ta ketë), dil se të pashë. Je aty mbas arkës». Ai del nga vendi i mshefun. Lojtarë kërkues vazhdon lojën deri sa të gjejë edhe të tjerët. Në qoftë se ndonjani mundet me dalë nga vendi i tij pa u diktue nga kërkuesi dhe shkon në cakun e numrimit tue thanë «paso», atëherë lojtari i gjetun i pari shpëton dhe kërkuesi rrin përsëri në lojë.



Fig. 34

### 38. «Ajrum-Cicirum»

Luhej nga fëmijt e moshës 5 vjeç e nalt, ma tepër në netët e dimnit, në odë zjarri.

Në këtë lojë, kur luejnë fmijë të vegjël, zakonisht merr pjesë gjyshi, ose gjyshi. Këta, para se të fillojnë, mblidhen të gjithë dhe sekush me radhë vendos dorën e djathtë të shtrime para gjyshes, pastaj kjo fillon e kap me gishtin e saj shtypës dhe at diftues gishtat e tyne me radhë tue thanë:

Ajrum-cicirum,  
 Pare-pare gjeli sum;  
 Sut e sut tare,  
 Are gomare,  
 Pis-pis kati,  
 Ha nji bukë e t'i këput!

Në qoftë se fjala e fundit «këput» thuhet n'atë kohë kur shtypsi dhe distuesi i gjyshes bien mbi njanin gisht të fmijës, atëherë ky e mbledh menjëherë atë. Mirpo gjyshja vazhdon përsëri:

Aj rexha, pi-pi-rexha,  
 Hallakate ti përgjegja,  
 Ajde, piri-de,  
 Pér'i pisk, hiq nji gisht!

Në këtë rasë fëmja mbledh atë gisht qi përket kur gjyshja ze në gojë fjalën «hiq». Mbas mblidhet edhe ky gisht, loja vazhdon deri sa të mbeten dy gishta. Tashti gjyshja vazhdon lojën, tue hapë mbi to herë njanën shuplakë e herë tjetrën dhe tue thanë:

Arka-arka,  
 Dyshif shuplaka;  
 Ti cil, ai mbyll.

Loja quhet e fituejme kur fëmijës i bie fjala «mbyll».




Fig. 35

### 39. «Rras e Buq»

Kjo luhej në pranverë me rrasa të lëmueme e me buq (gurë të ve-gjël të rrumbullakët) nga fëmijt meshkuj e femra të moshës 8-10 vjeç. Mblidhen 8-10 veta në nji vend të sheshtë. Ma parë, edhe për këtë lojë shënohet një rreth i vogël në tokë me nji diametër afér 50 cm. Pash-taj, 8-10 hapa larg tij vihet nji gur a cak për me ki. Ma në fund qesin short kështu: pasi rrjeshtohet secili tek rrethi me rrasën e vet në dorë, fillojnë nji nga një për me ki. Të kimunit bahet tue i hedhun rrasat rrëshqanas drejt gurit. Ai qì ka rrasën ma afér tij, hedh i pari, kurse tjetri qì e ka ma larg, hyn në lojë. Ky tash dihet se asht ruejtsi i buqit.

Kur ky shkon në rreth e të tjerët në cak, fillon loja, tue gjuejtë buqin secili sipas radhës e tue hedhun rrasën rrëshqanas. Të gjithë synojnë qì buqin ta qëllojnë me fuqi për me e largue sa ma larg rrethit. Kur ky del jashtë tij, ruejtsi vrapon me e marrë dhe me e vu prapë në rreth. Tash gjuejtsi i parë përpinqet ta marrë rrasën e vetpara se të vihet buqi në mes të rrethit. Por në qoftëse ruejtsi ven buqin para se të merret rrasa, atëherë lojtari vrapon në këtë mënyrë: merr rrasën e vet me njanën kambë dhe e ven në trinën e saj. Si ta ketë hjedhë nalt e ta ketë pritun me të dy duert, shkon në cak të gjuejë përsëri. Nëqoftëse rrasa bie në tokë, ai detyrohet ta marrë me shpejtësi dhe të largohet, ose hyn në lojë. Këtë radhë ai gjuen qì të shpëtojë shokët, kur ruejtsi vrapon pas buqit, lojtarët marrin rrasat dhe ikin. Në qoftëse ky nuk qëllohet dot, atëherë të gjitha rrasat mbeten në lojë. Tash secili rropatet me lëvizje e me rrena të marrë rrasën e vet. Por ruejtsi i ruen me kujdes të madh dhe, kur gjen rasën e volitshëm, qëllon ndonjanin qì të ndrrøjë rolin me të. Nëqoftëse ky ia merr rrasën pa u qëllue, atëherë shkon në cak dhe gjuen buqin për me shpëtue shokët e kështu. me radhë.




Fig. 36

#### 40. «Shamia në rrëth»

Luhej me shami të madhe të bame turrë. Luhej nga fëmijt (meshkujt e femrat) të moshës 8-10 vjeç në stinën e pranverës në fushë, patalok ose uhor.

Marrin pjesë 15-20 lojtarë, të cilët, mbasi qesin short se kush do të hyjë në lojë, bajnë nji rrëth të kapun dorë më dorë. Ai qì ka turrën në dorë rrëtullohet jashtë rrëthit dhe, pa e kuptue, qëllon shpinën e njanit me turrë. Mandej lëshon atë për tokë, vrapon qì mos të goditet, vjen, qark deri sa i zen vendin shokut qì e ndjek me e qëllue. Lojtari qì ka turrën vazhdon lojën si i pari.




Fig. 37

#### 41. «Top e rrekë — katër caqesh»

Luhej në pranverë e vjeshtë nga fëmijt (meshkuj e femra) të moshës 8-12 vjeç.

Marrin pjesë 5 veta. Para se të fillojnë, shënojnë nji rrëth në tokë afërsisht 4 m<sup>2</sup>. Në skajet e tij vendos pastaj secili nga nji gur, qì shërbën si cak ku rri vetë lojtari. Kur të kenë qitun short se kush do të hyjë në lojë, vendosen për vendet dhe pastaj fillojnë.

Ai qì rrini mes të rrëthit, përpinqet të kapë topin kur të tjerët ia pasojnë njani-tjetrit. Në rast se lojtari i mesit e kap topin afër cakut te ndonjanës, ai ëherë ndrron rolin me të. Veç kësaj rase, rolet ndrrohen edhe kur ndonjanës i bie topi në tokë.




Fig. 38

#### 42. «Nicash» (guralecash)

Luhej nē pranverë nga 4-6 vajza të moshës 10-12 vjeç, ose nga djem të moshës 8-10 vjeç.

Vajzat e vogla, para se të fillojnë, zgjedhin gurë të vegjël e të rrumbullaktë. Si t'i grumbullojnë pesë gurë, ato ulen kambëkryq nē nji vend të terun dhe qesin short se cila do të fillojë e para, e dyta, etj.

E para, mbasi merr pesë gurë nē dorë, i hedh së nalti nē tokë. Pastaj merr njanin dhe e hedh nalt. Kur guri asht nalt, merr me shpejtësi nji nga toka dhe pastaj pret tjetrit. Nē këtë mënyrë ajo vepron deri sa përfundon «njishet», katër gurët. Përsëri hedh gurët nē tokë. Nē këtë rast ajo i merr ata dy nga toka, tue veprue si ma parë. Kjo quhet «dyshe». Pastaj ban «treshen» tue marrë tre gurë përnjiherë nga toka dhe një gur e merr nē fund. Nē fund ban «gogën», tue marrë të katër gurët përnjiherë. Mbas kësaj loje ajo vazhdon me fshesën, gjylpanëni dhe urën.

Kur ban fshesën, të gjithë gurët i mban nē dorë, me përjashtim të njanit, të cilin e hedh nalt. Kur ky asht nē ajër, ajo fshin tokën me gishtin dëftues. Pastaj shpejt bahet gati me pritë atë qi hudhi nalt.

Edhe pér gjylpanën vepron nē përgjithësi si nē rasën e parë, veç se tash vetëm e pret gurin qi hedh mbasi e mbështet dëftuesin nē tokë.

Kur ban urën mbështet dy gishtat (gishtin e madh dhe dëftuesin) nē tokë. I hedh të pesë gurët përpara urës dhe u lyp lojtarëve njanin. Këta i japid atë qi asht ma vështirë të kalojë nën urë. Pastaj hedh gurin nalt dhe fillon t'i kalojë gurët nën urë me shpejtësi e saktësi deri nē fund. Mbas edhe ky veprim kryhet nji tjetër vendos pëllëmbën nē tokë. Në mezin e gishtave vendos gurët; të cilët i merr nji nga nji.

Kur edhe kjo kryhet mirë, atëherë fiton lojën. Në goftë se i bie ndonji herë guri në tokë, humbet radhën, të cilën e përsërit mbas të tjerëve po në atë vend ku ka mbetun.




Fig. 39

### 43. «Shtregullash»

Asht nji lojë tradicionale e festave të Shengjergjit, e cila fillon dy tri javë para e mbaron dy-tri javë mbrapa festës. Merrte pjesë në këto lojna i tanë populli, me fëmijë, të rritun e pleq, meshkuj e femna. E bajshin me radhë shpi më shpi dhe qëllonte edhe lagje më lagje. Shoqnoheshin me kangë e pije. Kaq ishin zhvillue këto lojna sa populli krijoi edhe nji seri kangësh të veçanta për to, qì quhen «kangë shtregullash». Në këto festa bahej edhe nji farë paraqitjeje djelmsh e yajzash, qì përfundojshin në fejesa.

Çdo shtëpi kishte manin e vet në mes të oborrit, qì shërbente për shtregulla. Aty mblidhej e tanë lagja: nji natë te njani e nji natë te tjetri. Por edhe ndër patalogje të lagjeve kishte druj të mëdhej si çinarë (rrapa) e të tjerë, qì shërbeshin për shtregulla. Aty mblidheshin populli i dy-tri lagjeve dhe baheshin shtregulla ma të mëdha.

Shtregullat bahan në këtë mënyrë: merret nji konop i gjatë dhe hidhet në nji degë të fcrtë e të naltë të pemës. Poshtë lidhen dy krenat dhe mbi të veshet nji post, shilte ose jastik. Hypin me radhë fëmijë, të rij e të reja, por dhe ndonji plak tip i gëzueshëm. Herë njani herë tjatri hidhen me litar sa djathtas e majtas, ndërsa të tjerët e përcjellin me kangë. Kështu kalojshin mboramjet deri në orët e vona.

Fëmijët e vegjël bajshin shtregulla të vogla ditën me shokët e tyne. Kangët qì ata këndojschin ishin të ndryshme. Ma tepër ishin vjersha qì thuheshin me atë kantilenen e zakonshme, si:

## I

Hov'i madh, hov'i vogël  
 Qi shetit nëpër Shkodër,  
 Nën molië, nën dardhë,  
 Nën nji kumbull kokër-bardhë.  
 Ulu, Syme (emni i asaj qi lëkundesh), qofsh e bardhë!  
 Hop, hop!

## II

Hov'i madh, hov'i vogël  
 Shkon e vjen nëpër Shkodër.  
 Re, re, zoja re,  
 Ma qit diellin sa të flejë!  
 Nën man-sot bajram,  
 Nën fik-kol ashik,  
 Nën kumbull-kokër-sumbull.  
 Ulu, Kasëm, në saxhade,  
 Pije kafen limonade,  
 Me simite me kajmak!  
 Hopa — hopa!




Fig. 40

#### 44. «Me tre ashikë» (tridhet e nji)

Luhej nga djem e vajza 10 vjeç e nalt në netet e dimnit, në rrrethet familjare.

Lojtarët formojnë nji rrreth tue ndejun zakonisht kambëkryq. Lojen e fillon lojtari ma i vogël, ose ndonji mik. Ai që e fillon merr ashikët në dorë, i luen disa herë në shuplakë dhe pastaj i hedh nga nalt poshtë. Në qoftë se tre ashikët qëndrojnë në pozicionin nga faqja laterale e ngushtë e gropume dhe në formë të gërmës «S», «Begu» fitonte 30 pikë, d.m.th. çdo faqe laterale e kësaj forme është baraz me 10 pikë. Në rast se atij ashikët i qëndrojnë në pozicionin nga faqja laterale e ngushtë e sheshtë, fiton 2 pikë, d.m.th. çdo faqe është nga nji pik «qeti». Kështu që nji «Beg» 10 pikë dhe dy «qeta» 2 pikë bajnë 12 pikë. Ai vazhdon përsëri hedhjen. Në se grumbullon «14 pikë», lojtari rrin, sepse këto janë të forta. Në qoftë se nuk mbush «14 pikë», ai vazhdon derisa afrohet në nji shumë pikësh pak a shumë të madhe: 27-29-30, të cilat, edhe këto janë të forta në lojë. Lojtari që rrin në njanen nga këto pikë ka shpresë ta fitojë lojën. Pas tij vazhdon lojen ai që asht brinjas. Në rast se ky ban 31 pikë, fiton lojen. Në qoftë se nji lojtar që qëndron «14 pikë» dhe nji tjetër para tij e arrin, ky i fundit detyrohet mos të qëndrojë, mbasi ka qëndrue tjetri para tij. Lojtarët që grumbullojnë 26-27-28-29-30 pikë fitojnë lojën në rast se asnji lojtar tjetër nuk mbledh 14 pikë, ose 31 pikë.




Fig. 41

#### B — Lojnat imituuese

Janë ato lojna gjatë të cilave njeriu ven re aftësinë imituuese a të dranatizimit të nji gjaje që u ban përshtypje fëmijve dhe të rijve. Në përmjet tyne zhvillohen shkathtësia, guximi, vullneti dhe squetësia. Këtu po përmendun disa prej tyne: **Shpendë e kafshë, Mjeshtrit, Bisedë me leprin, Shtëpijash (hakonenash), Çapka, Kumbujsh.**

#### 45. «Shpendë e kafshë»

Luhej me turrë në pranverë, sidomos në netët e gjata të dimnit, si nga djelmit e moshës 8-14 vjeç edhe nga burrat, të cilët mblidheshin në dhoma të mëdhaja, ose në ndonji lendenë, aborr, etj.

Në këtë lojë marrin pjesë 8-10 lojtarë, të cilët, para se të fillojnë, zgjedhin udhëheqësin; të tjerët formojnë rrëthin, dhe ulen kam-békryq. Kur udhëheqësi hyn në mes të rrëthit, fillon loja. Të gjithë vendosin duer në dysheme. Ndërkaq udhëheqësi fillon lojën duke thanë: «Fluturon, fluturon gomari» dhe çon duert përpjetë pér të rrejtë të tjerët. Tash, në qoftë se habitet kush i çon duert nalt si ai, atëherë udhëheqësi e pyet me ironi: «Pse, fluturon gomari?» dhe e qëllon nji ose disa herë me turrë në shuplakë. Ai vazhdon pastaj të thotë se fluturon zogu dhe duert e tij i mban në tokë. Po gaboi ndonjani tue lanë duert në tokë, ndëshkohet.

#### 46. «Mjeshtrit»

Edhe kjo luhej me turrë nga djemt e moshës 10-14 vjeç dhe të rriturit, të cilët mblidheshin pas darke, sidomos në netët e gjata të dimnit, gostina e festa dhe luenin kështu në rede odash, ose jasht (në verë), në patalok të terun.

Mbasi shtihet short dhe caktohet kryemjeshtri, i cili emërtion se-cilin me emrin e nji zanati, fillon loja.

Kryemjeshtri imiton nianën nga zejet. Në këtë rast, ai që asht, p.sh., «kovaç» imiton kryemjeshtrin, i cili, mbas pak, len këtë e fillon si zdrukthtar, këpuçar, ose si ai që i bie fyellit, lahutës, etj., kësh-tu me rradhë ay imiton sa njenët dhe tjetrën zeje. Lojtari që mban emnin e zejës përkatëse, po të ketë pasë vëmendje tek ai, fillon e imiton atë, ndryshtë qëllohet me turrë prej kryemjeshtrit pér pavëmendje.

#### 47. «Bisedë me lepurin»

Luhej me 10-20 vetë nga fëmijt (meshkuj) të moshës 5-7 vjeç, zakonisht në stinën e pranverës, në patalok, oborr ose në fusha.

Në këtë lojë ai që luen rolin e lepurit duhet të imitojë mirë atë sa herë që ia bie rasa. Para se të fillojnë lojën qesin short se kush do të jetë «ljetpri» e kush pyetsi. Kur të tjerët formojnë nji rrëth, atëherë këta të dy futen në mes dhe ma parë përshtendet ljetpuri e pastaj bisedohet me të.

- Pér shumë mot, lepur! A je si je? A je ljetpur a s'je ljetpur?
  - Lepur jam, posi s'jam!
  - Po në je lepur veshët i ke?
  - Veshët i kam, posi s'i kam!
  - Po si i ke e ku i ke?
  - Qe njanin, por dhe tjetrin!
  - Po në je lepur kambët i ke?
  - Kambët i kam, posi s'i kam, kapërcej me këto e rri.
  - Po si kërcen e si rrin?
- Pastaj ljetpuri, tue kapërcye e tue ndejt, përgjigjet:

— Ja kështu kapërcej e kështu rri...

Ndërkaq, fëmijt, kur shofin ljeprurin si kapërcen, thonë: «Sa bu-kur kërceka lepuri!»

#### 48. «Shtëpijash»

Luhej në pranverë nga vajza të moshës 5-7 vjeç.

Pasi mblidhen në ndonjë oborr, kopësht, etj., vajzat luejnë tue imitue nanën e babën e tyne. Por qysh ma parë ato kanë ndamun punët dhe kanë mbledhun e grumbullue në vendin e lojës shkopij, copa tjegullash e me këto fillojnë lojën.

Ma parë ndërtojnë shtëpinë, me odën e miqve e të fjetjes, guzhinën dhe çardakun; pastaj e pajisin odën e miqve me orenditë, si mindere të zbukurueme me lloj-lloj copa basmash të bukura, me hali (qylym) basme, të cilin e venë në mes të saj. Madje, përreth saj vendosen edhe copa tjegullash e gurë të vegjël për me dhanë përfytyrimin e odës me çinia e sende të tjera të bukura. Stolisin dhomën e fjetjes me jastikë të vegjël, qepun me copa basmash nga prindët e tyne. Ma në fund, stolisin guzhinën, bajnë gjellët tue i përfytyrue me copat e tjegullave, me barë, ose me baltë, etj.

Mbasi të jenë bamë këto punë, ndahanë në dy grupe njani grup-pritë dhe tjetri-mysafirë. Por edhe pritset ndajnë punën në mes tyne: njana rregullon odën, tjetra ban me hangër, dhe e treta luen rolin e djalit të vogël qi u thotë të tjerave se «po shkoj në pazar me ble ndonji send për mysafirët».

Kur janë rregullue të gjitha këto vijnë miqt. Sapo i shofin, pritsit u dalin përparrë me i pritun. Përshendetën me ta, tue i thanë nje-na-tjetrës «si jeni, si shkon, a lodheni, a keni punue gja», etj. Si i ulin miqt në vendin e duhun, bisedojnë me ta rreth familjarve dhe punë të tyne. Pastaj u bajnë kafe e kështu mbaron vizita.

#### 49. «Çapka»

Luhej zakonisht në pranverë nga femrat e moshës 5-7 vjeç, në patalok, oborre e fusha të teruna.

Para se të fillojnë lojën fëmijt sigurojnë nji shami të madhe, nji tepsi të vogël dhe nji shkop. Pastaj, ma e madhja e ma e shkathta cak-tohet si «çapkë», kurse nji tjetër zgjidhet si udhëheqëse. Fill mbas kësaj, të tjerat kapen për dore dhe formojnë nji rrëth. Ndërkaq, «Çapka», personi i mbuluem me shami e me shkop si sqep përbrenda, futet në mes të rrëthit në nji kohë me atë qi ka tepsinë në dorë. Kur gjithçka asht në rregull, «Çapkës» i bahan pyetje nga ana e udhëheqses. Në rast se kësaj i pëlqen pyetja, ajo përgjigjet tue i ranë tri herë teprisë me «sqep»; në rast se jo, çon kokën mbrapa. Pyetjet zakonisht bahan për lojtarët e tjera, për shembull:

— Si asht Aishja, e bukur apo e keqe?

Në rast se i pëlqen, i bie me sqepin e saj të madh teprisë.

Udhëheqësja e pyet:

Si asht Gjystina, e bukur apo e keqe?

Çapka, në rast se nuk i pëlqen ajo, çon kokën mbrapa.

Loja vazhdon kështu me pyetje e përgjigje deri në fund. Vajzat kënaqen me lëvizjet imituese të lojtares (çapkës), e cila nuk sheh, por, simba: dëshirës së saj, dallon njanën e tjetrën pér të mirë apér të keqe.




Fig. 42

### 50. «Kungujsh»

Luhej nga fëmijt (meshkuj e femna) të moshës 6-8 vjeç po në atë kohë e vende si në lojën që trajtuem ma sipër.

Në këtë lojë marrin pjesë 10-15 vetë. Zakonisht, ai qì hyn në lojë asht ma i rritshmi dhe ma i shkathti, kurse në rolin e farës së kungullit zgjidhet nji fëmijë i vogël me moshë 4-5 vjeç. Përveç këtyre, caktohen edhe dy udhëheqës, njani prej të cilëve qëndron me lojtarët, ndërsa tjetri ikën larg, mbasi atje do të fillojë lojën tue kërkue farën. Ndërkakq, të tjerët ulen kambëkryq në vijë të drejtë. Në mes qëndron udhëheqësi, kurse mbrapa qëndron «i strukun ai qì quhet garë». Pasi bahan gati, fillon loja.

Ai qì asht larg i drejtohet atij qì asht në mes (udhëheqësit) tue pyetur:

— A i keni lidhë qejtë?

— Po, — përgjigjet ai — C'ka urdhnoni?

— Ju lutem, baba më ka dërgue të më jepni pak farë kungulli, se do të mbjellë arën.

Kur ky i lutet kështu, atëherë udhëheqësi i tyne u ban me shejë lojtarëve të tjerë të shkojnë me vrap me e zanë atë. Kurse ai qì kërkoi kthehet në vëndin e vet. Kur të parët të jenë grumbullue të gjithë nëpër vende, vjen e kërkon përsëri farën. Këtë radhë udhëheqësi i tyne i thotë:

— Urchëroni e zgjidhni.

Dhe së bashku me të kalon sa në nji anë në tjetrën me zgjedhë, tue i ra me grusht në kokë se cilit e tue thanë:

— Ky nuk asht pjek, ky po; merre me vehte!

Ata qì zgjidhen tash shkojnë me udhëheqësin tjetër, i cili vjen e kërkon deri sa i merr të gjithë e mbetet vetëm udhëheqësi me fa-

rën e kungullit. Tash kërkuesi vjen për të fundit herë dhe merr «farën». Kur e merr edhe këtë, ai që mbetet tash vrapon nëpër fushë, mbasi të gjithë e ndjekin për me e kapun. Kur kapet, loja merr fund.




Fig. 43

C) **Lojna komike** — edhe në këto lojna njeriu shikon jo vetëm vjetitë e përmendura në rasat e tjera, por edhe argëtimin e fëmijve e të të rritnëve me lloj-lloj mënyrash. Po përshkruejmë disa prej tyre: Dy çinija, gjoja (gjuetia) dhe filxhanash.

### 51. «Dy çinija»

Luhej në netë dimni, në dasma e gostina, nga djemtë e moshës 14 vjeç e nalt.

Marrin pjesë dy lojtarë, ndërsa të tjerët shikojnë. Ai që e din këtë lojë ma parë, thërret: «Kush dëshiron me luejtë dyçinijash». Kush nga lojtarët din lojën zakonisht, nuk përgjigjet; ndonjani, që don me e mësue, çohet ta provojë. Ndërkaq, ai që thirri mban dy çinija në dorë. Atë që e ka të nxime, ia jep atij (pjesëmarësit në lojë), kurse të bardhën e rban vetë. Pa i lanë atij shkas që t'i shkojë mendja me e kontrollue, i ven kusht: «do të baish si baj unë» dhe fillon lojën. Ai që ka çininë e bardhë, fillon të bajë gjeste, në mënyrë që mos të kuptohet nga tjetri. Mbyll sytë i thotë atij (dhe ai mbyll sytë):

- Vene dorën nën çini
  - Dhe ai e ve.
  - Fshije fundin,
  - Ai e fshin,
  - Vene dorën në fytyrë
- Ai e ve.

Por nga ky veprim lojtari asht nxi. Mbasi çel sytë, shokët shku-  
len së qeshuni, kurse ky habitet. Pastaj shpejt e kupton se asht për-  
lye me të nxime e qesh bashkë me ta.




Fig. 44

## 52. «Gjoja e lepurit»

Edhe kjo luhej në dimën, në dasma e gostina, ma tepër nga bu-  
rrat e ma rrallë nga djemtë e moshës 14 vjeç e nalt, të cilët mbli-  
dhehin në rede odash.

Në këtë lojë marrin pjesë pesë vetë. Njani prej tyne quhet «gjah-  
tari», tjetri «lepur» dhe tre të tjeterë — «zagarët». Lojtarët shkojnë  
në nji odë tjetër për me veshun rroba të këqija. Të tje-  
rët ulen kambékryq në minderët, ose përreth odës, dhe presin me shi-  
kue «gjojën».

Ma parë vjen ljepruri i veshun me rrobe të kqija, me dy qeleshe si  
veshë të gjatë të lidhun në kokë dhe me nji «bisht» (copë poste). Ashtu  
si hyn përpiqet të mshifet nga zagarët e gjahtarit, të cilët luejnë rolet  
përkatëse në nji mënyrë aq qesharake sa gjithkush shqyhet së qeshuri.  
Bukurin e kësaj loje e shton ma në fund gjuetari, i cili, ashtu siç asht i  
veshun me rroba të këqija, me kallçi (çizme) dhe me cifte (nji shkop me  
spango), ngjet vrapi në odë mbas zagarëve, të cilët shkojnë tue nuhatë  
«gjurmet» e lepurit. Shpesh ai bahet gati me gjuejt, por lepuri largohet  
në nji vend tjetër. Nganjiherë zagarët ia bijnë pranë, por atij i shkrep  
pushka.

Në këtë rasë zagarët vijnë pranë gjahtarit dhe i lehin. Ma në fund  
gjuen: «pam-pam». Ndërkaq, i biye shamis me «çiften» dhe kjo nxjerr  
«tym» (pluhur). Të gjithë sa janë aty qeshin, edhe përpiken të mos ty-  
mosen. Ai që asht ma afër tymoset ma keq se të gjithë. Në këtë rasë të  
gjithë qeshin.

### 53. «Filxhanash» ose «Kapuçash»

Luhej si nga djemtë e moshës 14-18 vjeç ashtu edhe nga burrat, të cilët mblidheshin në netët e dimnit, ose në dasma e gostina.

Marrin pjesë tetë deri dhjetë vetë, të cilët ndahen në dy grupe ulun kambékryq, disa hapa larg njani-tjetrit në mes të odës.

Mbasi të jetë sigurue 4-12 filxhana, qeleshe (kapucë), shputa ose facoleta, kokrra (copë druni), unaza etj., qesin short dy vetë prej tyne se kush do ta mshefë ma parë kokrën. Pastaj njani prej tyne ulet në gjunjë dhe mshef kokrën. Ndërkaq, kundërshtarët mundohen me kuptue lëvizjen e dorës dhe se në cilin filxhan e len atë. Pastaj ai që fshehu kokrën del në shesh dhe e thotë:

— Gjejeni se cili filxhan e ka.

Të gjithë kundërshtarët mendohen që mos të ngrejnë ndonji filxhan kot e pa unazë. Ai që e ndjen vehten të sigurtë, ngre dy filxhana e thotë: «teste». Në rast se e gjen kokrën, grupi i tij fiton dhjetë pikë dhe ndron rrol me tjetrin. Nëqoftëse nuk e gjen, ai vijon e për se cilin filxhan që ngre thotë: «ja bosh, ja për ty».

Nëqoftëse kokra gjindet në filxhanin e parë mbas testes e nuk thuhet shprehja e sipërme, ana që e ka mshef fiton dhjetë pika dhe kështu vazhdon loja. Nëqoftëse ajo gjindet mbasi ngrihen disa filxhanë bosh, atëherë ana kundërshtare fiton aq pikë sa filxhanë mbeten pas dhe plus atë që kish filxhanin, kurse tjetra tri pikë. Nëqoftëse ngrihen aq shumë filxhanë sa të mbesin ende dy, atëherë ai që ngre të parafundit, thotë: «Për mue»; në qoftë se e gjen, fiton dhe merr filxhanët.

Ajo skuadër që plotëson 100 pikë del fituese. Loja e tregueme asht luejtë në qytet, ndërsa në malsina bahet ma serioze, tue qitun bejte ta-lëse njanit apo tjetrit grup:

— Qysh se nisën sonte lojën,  
Mirë e dijtëm, se u këndojmë.  
Ran do sorra n'ato ferra,  
Ai K.K. po lan menela<sup>1)</sup>  
Lanë menela e i qet me u terë,  
shkon K.K. e u merr erë.  
More burrë, a vrave sorrën?  
Luje mirë, ta nxisha dorën!  
Ku i kam pamun nji kta burra?  
N'krye të pazarit nën do çulla.  
Cili kje ai që shtiu?  
.....

K.K. ka ndenjun në bryl,  
E merr kokrën teste gjyl.  
.....

More djalë, nga je nisë?  
Në Kakarriq me kallajisë!  
A mund bane kurfare qari,  
sa me ble nji zog gomarit?  
Kenka terr e nuk po shofim,  
Po kta burra si s'po i njofim,  
Si nuk po del kurkush me u lutë!  
.....

1) Menela — tesha.

A t'i falim a mos t'i falim?  
 Dałshin mendsh e marrshin malin!  
 Po thotë mali nuk i due,  
 Kjofshin falë dreqit mallkue!




Fig. 45

Ç) **Lojna fjalësh.** Edhe këto luejnë po atë rol si të tjerat. Ndryshe nga të tjerat në këto lojna vihet re cili nga lojtarët do ta mundë tjetrin me fjalë. Zhvillohen në përgjithësi po në ato ambiente familjare që pamë në disa lojna të tjera. Në kët nëndamje po përmëndim disa prej tyne, të cilat janë ma interesante si lojnat: **Rapatule, Gjeli, Fluturoi zogu, Qiri mbi qiri, Nëna e fëmija, etj.**

#### 54. «Rapatule»

Luhej pothuejse në çdo stinë, në dasma e festa të tjera: nga djemtë e moshës 10-14 vjeç ashtu edhe nga të rriturit.

Marrin pjesë mjaft lojtarë, por ma kryesori asht vetëm njani, ai i cili caktohet si udhëheqës. Kur loja fillon, ky zakonisht mban në dorë nji lule, ose nji shami të bukur, ose edhe ndonji send tjetër. Të tjerët shikojnë se çdo të bajë me të. Mbasi të jenë ulun rrëth kambë-kryq në nji vënd të terun, fillon loja. Fjalën e parë e merr udhëheqësi, kurse tjetri përgjigjet.

- Na këtë lule, — thotë udhëheqësi,
- Ç'asht kjo lule? — përgjigjet i pari
- Me nji rapatule nji me çue, nji me ul.

Kur ia jep të parit, atëherë ai e ngren nji dorë nalt e tjetrën e mban posht.

Pastaj udhëheqësi ia jep lulen të dytit me dy rapatule.

- Ç'asht kjo lule? — pyet lojtar.

Kur ai merr përgjigjen e tij, i çon të dyja duerët përpjetë. Po kështu veprohet edhe me të tretin:

— Ç'asht kjo lule?

— Me tri rapatule,

Porsa merr këtë përgjigje, i treti, përvç dy duerve, ngren edhe nji kambë.

Tash secili qëndron siç asht, dhe loja vazhdon me të tjerët tue luejtë kambët, duerët, kokën, trupin, etj., deri sa të japë urdhën udhëheqësi për me pushue.

### 55. «Gjeli»

Luhej nga djemt e moshës 12 vjeç e nalt, në netët e dimnit dhe në raste festash e gostinash. Marrin pjesë disa veta, por njani, ma i shothti, del para shokëve tue thanë: «Kam nji gjel e dëshiroj ta pjestoj me ju. Pra, zgjidhni», Secili merr pjesë në ndamjen e gjelit: njani merr kokën, tjetri krahun, nji tjetër kambën, sqepin e kështu me radhë, deri sa gjeli asht nda i gjithë pjesë-pjesë.

Mbasi asht bamë ndarja, fillon loja. Atë çka thotë udhëheqësi, asht i detyruem ta thotë secili për pjesën e vet. Unë kokën do ta ha, — thotë udhëheqësi. Unë..... do ta ha, — përgjigjen të tjerët shpejt e me radhë, etj. Udhëheqësi vazhdon tue u shprehë në një mënyrë tjetër. Për shembull: «Unë gjuej me kokë». Të tjerët vazhdojnë për pjesët e tyne si ma parë. Fjalët dalin të ndryshme, me kuptim e pa kuptim, mjafton që të kënaqin spektatorët.

### 56. «Fluturoj zogu»

Luhej në çdo stinë nga fëmijt meshkuj të moshës 8-10 vjeç, por edhe nga të rriturit. Për zhvillimin e lojës mjafton nji vend i vogël i terun, sa për të ndenjur. Mbasi zgjidhet udhëheqësi i lojës ai i caktton emna pemësh çdo njanit prej lojtarëve, p.sh. njanit kumbull, tjetrit mollë, dardhë, fik, pjeshkë, zerdeli, etj. Kjo varet nga numri i pjesëmarrësve. Mbasi ka caktuar emrat çdo njanit prej lojtarëve udhëheqësi i lojës thotë: «Fluturoi zogu dhe ra në dardhë». Ai qì ka kët emën i përgjigjet me të shpejtë: «Në dardhë nuk e la unë». Udhëheqësi pyet: «Ku e çon, në mollë?». Ai qì ka emrin mollë përgjigjet: «Nuk e la unë, por e çoj në fik». Dhe kështu loja vazhdon deri në fund me shpejtësi. Ai qì gabon në përgjigje, del jasht. Kur mbeten vetëm dy lojtarë, këta caktojnë dënimet për secilin lojtar.

Dënimet mund të jepen nga ata qì mund të imitohen kafshët ose shpendët dhe kjo zbatohet pa u kundërshtue nga lojtarët.

### 57. «Qiri mbi qiri»

Luhej nga djemt e moshës 10 vjeç e nalt, zakonisht në netët e gjata të dimnit.

Marrin pjesë dy veta, të cilët ma parë qesin short se cili do të fillojë pyetjen i pari dhe cili do të përgjigjet. Loja fillon me shpejtësi:

— Na kët qiri,

— Ç'asht ky qiri?

— Qiri mbi qiri.

— Fitili, fitili!

Fitilin e hangri miu,

Miun e hangri maca,

Maca kércej në tra,

Traut i dha zjarrin,  
 Zjarrin e ndali ujët,  
 Ujin e pijnë buejtë,  
 Buejtë punojnë arën,  
 Na i qitën? farën,  
 Farën e hangri zogu,  
 Zogu hypi në ferrë,  
 Ferrën e preu këmesa,  
 Këmesa shkoi te kovaçi,  
 .....

Ai qi gabon del jasht lojës. Pastaj vazhdon i treti. Edhe ky në se  
 gabon, del jashtë e kështu me radhë. Ai që fiton jep po atë dënim qì  
 u tha në lojën e sipërme.

### 58. «Nana e fëmija»

Kjo luhej nga fëmijët (meshkuj e femra) të moshës 7-10 vjeç. Në  
 këtë lojë vetëm dy lojtarë janë kryesorë nga të cilët njani luen rolin  
 e nanës dhe tjetri atë të fëmijës. Mbas këtyne zgjidhet udhëheqësi, i  
 cili u cakton lojtarëve të tjerë emna të ndryshëm. Çdo herë qì «fëmija»  
 i kërkon s'amës kulaçin, ajo s'ja jep po s'i pruni atë qì don. Ja, p.sh.,  
 si luhet ajo në këtë rasë prej tyne:

- Nanë, më jep kulaçin.
- Jo, s'ta jap.
- Pse s'ma jep?
- Pse s'më ke dhanë shtangën,
- Shtangën kush e ka?
- E ka lisi.

Fëmija shkon te lisi dhe i kërkon atë qì i duhet:

- Lis, më jep shtangën.
- Jo, s'ta jap.
- Pse s'ma jep?
- Pse s'ma ke dhanë puplën.
- Puplën kush e ka?
- E ka orli,

Mbasi shkon tek ky, i drejtobet:

- Orl, ma jep puplën.
- Jo, s'ta jap.
- Pse s'ma jep?
- Pse s'ma ke dhanë qingjin.
- Qingjin kush e ka?
- E ka çobani,

Fëmija shkon tek ai e ia kërkon:

- Çoban, ma jep qingjin.
- Jo, s'ta jap.
- Pse s'ma jep?
- Pse s'më ke dhanë bukë.
- Bukën kush e ka?
- E ka ara.

Tash ai shkon dhe e kërkon tek kjo:

- Arë, ma jep bukën!
- Jo, s'ta jap.
- Pse s'ma jep?

— Pse s'ma ke dhanë plehun?

— Plehun kush e ka?

— E ka dhija.

Atëherë shkon e kërkon tek kjo:

— Dhi, ma jep plehun.

— Jo, s'ta jap.

— Pse s'ma jep?

— Pse s'më ke dhanë krypën.

— Krypën kush e ka?

— Krypën e ka deti.

Fill pas kësaj shkon tek «deti»:

— Det, ma jep krypën!

— Jo, s'ta jap.

— Pse s'ma jep?

— Pse s'ma ke dhanë shiun.

Sapo merr ketë përgjigje fëmija ligjëron prej këtej e deri te filimi.

Shiun ia dhashë detit, deti ma dha krypën; krypën ia Dhashë dhisë, dhija ma dha plehun, plehun ia dhashë arës, ara ma dha bukën, bukën ia dhashë çobanit, çobani ma dha qingjin, qingjin ia dhashë Orlit, orli ma dha puplën, puplën ia dhashë lisit, lisi ma dha shtangën, shtangën ia dhashë nanës, nana ma dha kulaçin me djathë e nji shputë qafës.

## II. Lojnat kolektive me skuadra

Në këtë grup lojnash, lojtarët veprojnë në mënyrë të përbashkët dhe nji gabim i lojtarit shkakton humbjen e lojës. E randësishme ashtu tē theksojmë se në lojnat me skuadra secili lojtar përpinqet më vehte për t'ia arritë qëllimit të skuadrës së tij. Në lojnat me skuadra lojtarët veprojnë njisoj, por vetëm simbas nji radhe tē caktueme. Këtu lojtari vetë asht i detyruem tē ndajë kohën ma tē përshtatëshme për fillimin e veprimeve tē tij për tē ndihmues shokun.

Në këtë grup përfshihen vetëm lojnat që ndihmojnë në zhvillimin e mirë e harmonik tē trupit dhe në edukimin e nji vargu vetish, siç janë vëmendja, squetsia, gjykimi. Edhe në këtë nëndarje gjejmë lojna, për meshkuj e femna, si për shembull lojnat: Jesir, Top e kalë, Bajrak, Shpatulla, Pushtimi i kalasë, Loçkë lokë, Gu-gu, Shejash, Kaladibrane, Top e rrasë, Kush e merr shaminë, etj., tē cilat po i përshkruejmë ma poshtë:

### 59 «Jesir»

Ajo luhesh nga fëmijët (meshkuj) tē moshës 10 vjeç e nalt, në di-mën dhe pranverë, në fushë ose patalok tē gjanë rrëth 20-40 m, tē gjatë 60-80 m, në formën e drejtëkandshit, i cili ndahesh në mes me nji vijë. Pastaj fundoret e drejtëkandshit shënoheshin me nji vijë me gjanësi 2 m, për me qëndrue grupet. Këto quheshin vendet e mbrojtjes, ku kundërshtarët s'mund tē qëllojshin. Në mezin e drejtëkandëshit, në vijat anësore tē tij, shënojshin nga nji kuadrat me sipërfaqe rrëth 1 m<sup>2</sup>. Këta ishin vendet e robve. Në skajet e vijave fundore tē drejtëkandëshit vejshin flamurin e grupit (nji facoletë) mbi një shkop tē ngulun në tokë. Në këtë lojë merrshin pjesë 30 veta tē ndamë në dy skuadra tē barabarta.

Ishte rregull qi lojtarët po të delnin jashtë fushës, konsiderohe-shin «robën». «Robnit» e liruem kishin të drejtë të sulmojshin kur merrshin cak. Skuadra e humbun ishte e detyrueme të mbante në shpinë fituesit, tue i çue nga njana anë në tjetërën.

Loja fillon kështu:

Dy lojtarë ma të shkathëtit qitnin short në mes tyne për të zgjedhë shokët. Mbasi zgjidheshin këta, dy kapidanat rreshtohen me grupet e tyne në vijat fundore të fushës së betejës, përballë njani-tjetrit. Në këtë lojë ka randësi të madhe rendi me të cilin kundërshtarët i dalin shoqi-shoqit. Lojtari i nji skuadre qì del mbrapa, asht gjith herë ma i fortë se ai që ka dalë para.

Por edhe ai qì ka dalë mund të bahet ma i fortë se kundërshtari në qoftë se mundet me u kthye në «cak» e me dalë prap. Lojtarët e skuadrave dalin, njani mbas tjetrit, tue kqyrë radhën, në mënyrë qì mos të kapen rob. Ata dalin e kthehen prap në vendet e tyne për të marrë «cak». Kur mësymjet janë të shumta dhe simbas radhës, ndigjohet nji «za»: «E ka Dauti». Për nji çast loja ndërpritet, fituesi e merr «robin» dhe e len në vendin e caktuem. Si të ketë mërrjitet «robi» në vend, gjithë lojtarët kthehen në «cak» e rreshtohen si në fillim të lojës.

Në të dytën mësymje lëvizjet bahan si në të parën, me ndryshim se ksaj herë e qet lojtarin në fushë grapi qì humbi. Loja shkon tue u ashpërsue, mbasi skuadra qì humbi lojtarin kërkon me e shpëtue atë. Thuhet se shpëton nji rob, kur nji shok i skuadrës së tij mbërrin te ai gjatë mësymjes dhe e prek me dorë. Në këtë rast asnji nuk mund të zihet rob në fushë. Ai, sa qëllon robin, bërtet: «E mora! E mora!». Ndalet loja e të gjithë lojtarët kthehen ndër vendet e tyne. Kur zihen dy rob, ata kapen dora-doras: ndodh qì mund të zihen edhe shumë rob, prej njanës skuadër, ose edhe prej dyja skuadrave. Kapidani i kujdesëshëm cakton menjherë dy a ma shumë roje të shpejta, qì të rrinë gadi me ia pre rrugën e me i ra atij qì don me i shpëtue.

Kur skuadrat kanë ma shumë rob, loja bahet ma e gjallë, sepse lojatarët e tyne mendojnë ma mirë për të shpëtue «robët». Po ia duelën me prekë mjaft prej tyne pa iu ra kush atëhere aq rob skuadra i shpëton.

Kur njena anë ka mbetë me nji lojtar të vetëm, p.sh. me atë qì ruen flamurin, ky do të mësynjë për me shpëtue shokët e robnuem dhe pastaj kthehet prap në vend për me ruejt flamurin. Në rast se i merret flamuri dhe shokët e tij që janë rob atëhere loja merr fund.




Fig. 46

## 60. «Top e kalë»

Edhe kjo luhej me top lecke ose llastiku nga djemtë e moshës 14 vjeç e nalt, në patalok, fushë ose oborre të mëdhenj në stinën e pranverës.

Marrin pjesë 10-20 lojtarë, gjithmonë çift, të cilët, para se të fillojnë, caktojnë vendin e lojës. Masandaj zgjidhen me dëshirë dy udhëheqësat. Këta, mbasi shtijnë short se cili do të fillojë të zgjedhe i pari lojtarë dhe cila skuadër do të hyjë në lojë, shpërndahen secili në vend të vet. Skuadra që fiton shortin formon një rrëth dhe secili qëndron hipun anës tjetrës. Por mbas gjithë ktyne udhëheqësi i kalorësve fillon lojën.

Topi i pasohet kalorsit pranë; ky, nëqoftëse e pret, ia jep tjetrit. Por ka raste që njani ia jep topin tjetrit në lloj-lloj mënyrash. Në rast se topi bije në tokë, kalorësit, me të shpejtë, ulen dhe veprojnë për me u mbrojtë nga ata. Në qoftëse të brendëshmit qëllojnë ndonjanin, atëherë ndrrchen rolet. Kalorësit nuk duhet të kalojnë kufinin e caktuem të lojës; kurse ulësit nuk duhet të pengojnë kalorësit kur ato zgresin, ose ku janë sipër.




fig. 47

## 61. «Shpatulla»

Luhej me dojkë dhe shpatulla druni (në krye e ngushtë dhe në fund e gjanë), që i përngjan pirajkës. Marrin pjesë djemt e moshës 12 vjeç e nalt, në fushë, oborr ose patalok. Në kët lojë marrin pjesë katër veta, të cilët, para se të fillojnë, bajnë dy gropë me diametër rrëth

30 cm. dhe me largësi 10-12 m. përballë njana-tjetrës. Mbasi bahan dy nga dy dhe qesin short se cili çift do të marrë dojkën dhe shpatullat, shkojnë nëpër vende. Loja fillon atëherë kur ata me dojkë e shpatulla zanë vend pranë gropave dhe të tjerët rrijnë gati në mes tyne.

Njani prej atyne qi ka dojkën ia hedh me shpatull tjetrit. Ndërkaj, kundërshtarët përpiken ta kapin qoftë në tokë qoftë në ajr, përmë e hudhë në gropën e atij qi asht ma afër. Mirpo edhe këtu gjen pengesë nga ruejtsi i saj, i cili lëviz shpatullën sa në nji anë në tjetrën, qi të mos e lejojë dojkën të futet në grüpë. Në qoftë se dojka futet brenda, atëherë ndrrohen rolet në mes dy grupeve.

## 62. «Pushtimi i kalasë»

Luhej në çdo stinë nga djemtë e moshës 10 vjeç e nalt, në nji vend të naltë, në fushë ose oborr.

Marrin pjesë 10 ose 20 veta, të cilët ma parë bajnë «kalanë», e cila asht nji rrith me diametër 10 m. ose zgjedhin nji vend kodër. Mbasi ndahen në dy skuadra të barabarta dhe për secilin nga këta caktohen udhëheqësa, qitet short se cila skuadër do të ruejë dhe cila do të sulmojë kalanë. Pastaj zanë vendet: ruejtsit futen në rrith, kurse sulmuesit qëndrojnë jashtë tij.

Loja fillon me sulmin e atyne qi janë jashtë «kalasë», por nxirren jashtë saj me gjoksat e ruejtsve, të cilët mobilizojnë të gjitha forcat e tyne qi kundërshtarët mos t'i lanë brenda. Në qoftë se sulmuesit i nxjerrin ruejtsit jashtë «kalasë», atëherë ndrrojnë rolet. Mbës disa ndeshjes ajo skuadër që qëndron në kala quhet fituese.




fig. 48

### 63. «Shejash»

Luhej në pranverë nga fëmijët e moshës 8-10 vjeç, pranë lumejve ose ndonji kodre me gurë. Edhe në këtë lojë përbamja e dy skuadave dhe e të shtimunit shortë ngjan si në dy lojnat qì përshkruem ma parë.

Para se të luejnë, pjestarët e secilës skuadre venë në anën e tyne shejat — rrasa ose kutija teneqesh. Të dy rreshtat e këtyne shejave vendosen 2 m. larg njani tjetrit, kurse largësia në mes këtyne rrasave ose kutijave asht rrëth 20 cm. Pastaj, 10 metra larg tyne babet vija (caku), prej ku do të bahet gjuejtja. Veç kësaj, çdo grup merr tre gurë në dorë për me gjuejtin shejat dhe fillojnë mbas radhës.

Çdo lojtar qì gjuen fiton aq pikë sa rrasa ose teneqe rrëzon. Në qoftë se skuadra qì gjuejti e para mbaroi së gjuejtuni, atëherë fillon skuadra tjetër. Del fitues ajo skuadër qì ka rrëzue rrafsh me tokën ma tepër sheja




fig. 49

### 64. «Loçkë me lok»

Luhej në çdo stinë nga djemtë e moshës 10-12 vjeç në patalok, fushë, ose oborr.

Marrin pjesë dy skuadra me nga 10-20 veta secila, të cilat, para se të fillojnë bajnë me gurë të vegjël lokun (rrethin) me nji perimetër prej afro 30 m; pastaj zgjedhin shokët me short dhe po me short njana skuadër futet në lok dhe tjetra mbetet jashtë saj me loçkë (top i bamë me lesh dhije).

Sapo fillon loja, skuadra qì ka loçkën i afrohet lokut tue thanë: «Ci-ci-puci, kush e ka? Unë e kam, due me i ra». Dhe ai qì ka topin: gjuen. Nëqoftëse e qëllon ndonjanin qì asht në rrëth, e nxjerr jasht loje; dhe në qoftë se ndonjani nga ata të rrëthit e pret topin me do-

rë, atëhere ai qì gjuejti del vetë jasht loje, kështu veprohet edhe për ata qì gjuejnë nga rrëthi. Në qoftëse lojtarët e njanës anë nxirren nji nga nji jasht loje, atëhere fitorja i mbetet anës tjetër.



fig 50

### 65. «Gu-gu»

Edhe kjo luhej në çdo stinë nga djemtë e moshës 14 vjeç e nalt, në vend të sheshtë afér murit ose ndonji peme.

Marrin pjesë aq skuadra e persona qì u përmenden për lojën «Llogë me lok» dhe shtihen po aqë shorte. Lojtarët e skuadrës qì ulen kapen në mes njani me tjetrin e lidhen duke u mbështetë në mur ose në pemë, tue formue kështu ledhin; kurse hypsat shkojnë disa hapë larg tyne dhe bahan gati. Zakonisht loja fillon me cilindo nga hypsat. Të gjithë hidhen shpejt e shpejt fluturim njani mbas tjetrit, deri te ai qì asht në rrazë të murit. Mbasi të kenë kërcye të gjithë mbi ledhin, atëhere udhëheqësi i tyne, tue ngrehun nji, dy deri pesë gishta përpjetë, thotë.

Gu-gu, pici-gu,  
Kam nji kalë pa martu.  
Sa desh, sa lesh,  
Sa gishta kam përpjetë?

Udhëheqësi i anës së ulun, i cili zakonisht asht i pari nga fundi, përgjigjet: «Janë katër». Në rast se e gjen, atëherë ndrrohen rolet; në rast se jo, grupi i tij vazhdon të jetë ende në lojë:




fig. 51

### 66. «Bajrak»

Luhej në çdo stinë nga fëmijët (meshkuj) të moshës 8-12 vjeç në çdo patalok të lagjeve të qytetit, në fushat ose lendenat e katundeve.

Marrin pjesë 20-30 lojtarë, të cilët, mbasi shënojnë në tokë nji rrith me diametër 10-12 m., në qëndër të tij vendosin shkopin me flamur (nji shami çfardo). Udhëheqësit e tyne qesin short se cila skuadër do të ruejë flamurin. Pastaj secili shkon në vendin e vet. Lojtarët e të dyja skuadrave venë sheja dalluese. Udhëheqësi i atyne qì ruejnë flamurin brenda rrithit, cakton nji lojtar posaçërisht për këtë punë dhe shokët e tjerë të tij i shpërndan nëpër rrith. Kur të jenë të gjithë gati, fillon loja.

Msyen ana kundërshtare, e cila ka si qëllim të fundit me rrëmbye flamurin. Nëqoftëse gjatë përpjekjeve të saj ndonjani qëllon ndonji kundërshtar, qoftë ky i grupit qì ruen flamurin ose jo, del nga loja. Kundërmsymja e ruejtsve mund të vazhdojë deri në kufi. Në qoftëse kundërshtarët msyejnë përsëri nji nga nji ose si skuadër, etëherë ruejtsat përpiken t'i nxjerrin jashtë rrithit, ose ndonjanin fare jashtë loje. Nëqoftëse në lojë e sipër ana kundërshtare nxjerr jashtë loje gjithë ruejtsit, atëherë ruejtsi i posaçëm i flamurit mund të kundërmsyjë anmikun edhe jashtë rrithit, tue pasë kujdes gjithmonë se mos ndokush tjetër i merr flamurin. Kur ndodh kështu, dy skuadrat ndrojnë

në rolet. Po kur ndodh që ruejtsat qëllojnë gjithë lojtarët e anës tjetër. atëherë loja përsëritet si në gjëndjen e parë të skuadrave.




fig. 52

#### 67. «Kala dibranç»

Luhej me breza ose rrypa pantallonash nga djemtë e moshës 14 vjeç e nalt, në stinën e pranverës, në patalok, oborr ose lendeninë.

Marrin pjesë 10-20 lojtarë, të ndamë në dy skuadra. Prej këtyne, lojtarët ma të shkathët qesin short dv herë (me çift a tek), nji herë pér me zgjedhun shokët dhe nji herë tjetër pér skuadrën qì do të hyjë në lojë. Ruejtsi duhet të sillet rrëth kalasë. Kalaja nuk duhet të lëvizë përsa kohë qì ka përsipër kundërshtarët. Ruejtsi duhet të goditë para se me hypë kush në kala. Në rast se ky lëshon brezin në goditje e sipër, goditja nuk quhet. Në rast se hypësit rrëzojnë kalanë, atëherë loja përsëritet. Ai qì humb shortin i çon shokët në mes të fushës dhe u thotë qì të formojnë «kalanë» tue u kapun krahësh e tue ulun kurrizin. Kur ruejtsi i kalasë merr brezin dhe ia jep njanin skaj të tij njanit prej shokëve të kalasë pér me e shtrëngue fort ndër duert e veta dhe tjetrin e mban vetë, thotë «gati» dhe vjen rrotul me ruejtë, qì mos t'i hypi kush në kala. Nëqoftëse ndonjani prej anës tjetër kërcen aty në mënyrë të zakonëshme, apo me «kërcim peshku», përpinqet me shkue në majë të saj pér me u lanë shokëve vend të lirë. Ka ras-

te qì ky zbre e kérçen përséri. Por négoftëse ky, në kohën kur don tè kérçejë në kala, qëllohet me dorë nga ruejtsi (dikur qëllohet me kambë në gjunjë e poshtë kundërshtari), atëherë ndrohen rolet.




fig. 53

### 68. «Top e rrekë»

Luhej në çdo stinë me top lecke ose llastiku nga fëmijët (meshkuj) tè moshës 8-10 vjeç, pranë nji muri me nji shesh tè rrashftë përpara.

Marrin pjesë 10-20 lojtarë tè ndamë në dy skuadra. Dy lojtarë nga ma tè shkathhit qesin short për me zgjedhë shokët e skuadrës së vet. Mbasandaj qitet përséri short për me përcaktue se cila skuadër do tè hyjë në lojë e para, caktojnë vëndin e lojës dhe shënojnë nji vije tè trashë me nji largësi nga muri afër 6-8 m. Skuadra, qì fiton shortin rrin në mes tè vijës dhe murit, ndërsa tjetra qëndron jashtë vijës.

Kur fillon skuadra qì ka topin dhe afrohet pranë vijës, ia kalon atë, herë njanit e herë tjetrit lojtar tè vet. Ndërkajq, skuadra tjetër lar gohet nga pak për me u mbrojtun. Sapo tè parët arrijnë në vijë, vë në re, se cili nga kundërshtarët asht ma afër. Kur ai qì ka topin e gjuen tue e që'lue në trup, ky lojtar nxerret jashtë loje. Në se topi shkon huq, atëherë e merr skuadra tjetër dhe ban po atë lojë si e para.

Loja vazhdon kështu deri sa niana skuadër fiton lojën, tue i nxjerr jashtë tè gjithë lojtarët e skuadrës tjetër.

### 69. «Top e rrasha»

Edhe kjo luhej me top lecke ose llastiku në çdo stinë nga fëmijët (meshkuj e femra) tè moshës 8-10 vjeç.

Marrin pjesë 10-20 lojtarë, tè cilët ndahen në dy skuadra tè barabarta. Para se të fillohet, sigurohen 5-6 rrasha tè vogla ose tjegulla,

dhe caktchet vendi i lojës. Në vendin e caktuem shënohet nji rrëth i vogël me rreze 30 cm. dhe larg tij afro 6-8 m. shënohet nji vijë, e cila vlen për cak. Në fund qitet short për me zgjedhë lojtarët dhe pér me përcaktue se cila skuadër do të hyjë në lojë.

Kur fillon loja, njana skuadër vendos rrasat njana mbi tjetrën në rrëth, kurse tjetra fillon me radhë të hudhë topin rrëshqanas drejt pér me qëllue rrasat. Kur këto qëllohen nga ndonjani atëherë shokët e tjerë të tij përpiken t'i venë me të shpejtë në vend në nji kohë kur ata pranë rrasave vrapijnë me marrë topin e me qëllue ata qì shëmben rrasat. Nëqoftëse ai qì gjuen nuk qëllon ndonji nga kundërshtarët, digjet dhe del jashtë loje; në qoftëse qëllon, ai qì qëllohet, digjet. Në fund fiton ajo skuadër që djeg tjetrën.

#### 60. «Kush e merr shaminë»

Luhej nga fëmijët (meshkuj e femra) e moshës 8-12 vjeç në nji vend të sheshtë-patalok, fushë ose oborr.

Në këtë lojë marrin pjesë 20-30 lojtarë. Vendi duhet të jetë 60-80 m i gjatë dhe 30 m i gjanë. Pér kufijt e tij vihen gurë. Veç kësaj, lojtarët shënojnë me vijë edhe vendin ku do të rrijnë. Mbasi shtijnë short pér zgjedhjen e lojtarëve, të dyja skuadrat rreshtohen pastaj në dy vijat e tyne përkatëse. Në mezin e fushës njani nga lojtarët ngul një dru me shami. Kur bahan gati, çdo udhëheqës skuadre qet nga nji lojtar pér me marrë shaminë. Por të dy këta përpiken ma parë me u ruejt nga njani-tjetri. Kur njani gjen rast dhe e merr pa e kapun tjetri qì e ndjek pas, atëherë ndjeksi bahet rob. Po në qoftë se ky e kap atë me shami në dorë, atëherë ky i fundit bahet rob i skuadërës tjetër. Në rast se lojtarët e të dyja skuadrave arrijnë në një kohë para shkçpit qì ka shaminë, ata, me lëvizje të rrejshme, mundohen t'ia marrin shaminë njani-tjetrit. Ai qì asht ma i shkathët, merr shaminë dhe vrapon me shpejtësi drejt cakut të vet. Loja vazhdon tue qitun me radhë lojtarët. Skuadra qì ka ma tepër «rob» fiton lojën. Skuadra qì humbet shkon në vendin e skuadrës fituese, i merr lojtarët në kurriz e i çon deri në anën e vet.

ENVER BUSHATI




Fig. 54

## LES JEUX POPULAIRES DANS LE DISTRICT DE SHKODER

Dans cet article il est question des jeux populaires dans le district de Shkoder. Notre but a été de mettre en lumière plusieurs de ces jeux qui appartiennent à la vie des enfants et des adultes.

Dans les jeux populaires abordés dans cet article, on remarque la capacité créatrice et remarquable du peuple. Il a su si bien et si joliment créer des jeux dont le fond laisse entr'voir différents aspects de la vie du peuple, de la psychologie des enfants.

On a exposé en bref un panorama de la ville antique aux traditions historiques-ethnographiques. On a décrit les *pataloge* (petites places de quartier), Tepe-Draç — Vegshar — Perash — Arra Madhe — Ara Pashës — Ballabane, Kiras, etc., etc. qui étaient les lieux de loisir des enfants et des adultes.

En dehors des *pataloge*, on a décrit les — oborr (cours) — hajat (espèce d'avent), çardaqe (longs couloirs) et chambres des maisons où les enfants et les adultes ont joué.

Les jeux présentés ne figurent pas tous — mais ceux qui y sont forment tout un corps.

Le travail est réparti en deux groupes principaux:

- I. — Jeux collectifs sans équipes;
- II. — Jeux collectifs avec équipes.

Les jeux collectifs sans équipes ont été classés en sous-groupes.

- a) Jeux individuels; b) Jeux imitatifs; c) Jeux comiques; d) Jeux de mots.

Dans le groupe des jeux individuels sont présents des jeux joués exclusivement par les hommes, comme par exemple le jeu au bâton, la garde du chapeau, etc. Des jeux joués seulement par les femmes, comme «Top e pesë» (ball et cinq), «Konopi gjatë», «vizë», etc. jeux qui ont été joués par les deux sexes, comme «Kater caqesh», «Bullice», etc.

b) On a traité les jeux tels que «Shpend à kafshe», etc.

c) On a décrit des jeux qu'on a joués dans les cercles de famille, tels «Dy cijnjat» et «Gjuetija e ljeputit».

d) On a traité les jeux tels que «Rripatulla», «Nana e fëmija», etc.

II. Les jeux collectifs avec équipes. Ce groupe comprend les jeux qui étaient joués seulement par les garçons, tels «Jesir», «Top e Kalë», «Gu-gu», etc.

Dans ce groupe sont présents aussi deux jeux joués par les garçons et filles, comme «Shkop e cingël», «Top e rasa», etc.

## НАРОДНЫЕ ИГРЫ ШКОДЕРСКОЙ ОБЛАСТИ

В данной статье рассматриваются народные игры области г. Шкодры. Целью автора было ознакомление со многими играми из жизни детей, а также и взрослых.

В народных играх, изложенных в статье, проявляется замечательная творческая способность народа. Это — искусно и тонко созданные игры, изображающие разные стороны народной жизни и детской психологии. В них выступает умелость и находчивость в создании, редкое психическое мастерство, интересы взрослых и детей.

В работе дается краткое описание этого древнего города, с историко-этнографическими традициями. Описаны площадки для игр — «патальоги», которые явились местами развлечений и игр для детей и взрослых. Кроме того описаны дворы, сени и помещения домов, в которых играли взрослые и дети.

Приведенные игры не включают исключительно все, но они представляют собой одно целое.

Игры делятся на две основные группы:

- I. Коллективные игры без команд.

## II. Коллективные игры с командами.

Коллективные игры без команд подразделяются далее на 4 подгруппы: а) Индивидуальные игры. Из них приводятся игры, в которых участвовали только мужчины (как например, игра в чижики и т.д.). Далее приводятся игры с участием лишь женщин, а потом и смешанные игры.

б) Подражательные игры.

в) Комические игры — которые игрались в семейном кругу.

г) Игры слов.

Коллективные игры с командами включают в себя игры, в которых принимают участие только мужчины, а также смешанные игры, в которых участвуют как мужчины, так и женщины.

## KODIKU I MANASTIRIT TË SHËN KOZMAIT PËR KONTRATAT E FEJESAVE

Këtë regjistër, ku janë shënuar kontratat e fejesave nga viti 1819 deri më 1843, po e quajmë «Kodik i manastirit të Shën Kozmait për kontratat e fejesave», pasi në të janë regjistruar të gjitha kontratat e fejesave që hynin në juridikcionin e këtij manastiri.

Manastiri i Shën Kozmait, i pajisur me këtë kodik, si dhe me kodikë të tjerë<sup>1)</sup> e libra fetare nga Joasafi<sup>2)</sup>, është ndërtuar pranë kishës së Shën Mërisë në fshatin Kolkondas, rrëth 10 km larg Fierit, për të kujtuar murgun Kozma. Ky murg ishte mik i Ali Pashë Tepelenës dhe u vra nga njerëzit e Ahmet kurt Pashës së Beratit në kohën kur po kthehej nga predikimet që kishte bërë në Myzeqe. Manastiri u ndërtua pikërisht në afersitë e lumit Seman, ku u gjend trupi i mytut në ujë i murgut Kozma, të cilin pas vdekjes, të krishterët e quajtën «dëshmor i ri i krishterimit» dhe e mbiquajtën Shën Kozma. Manastiri u ndërtua aty nga viti 1813-1814, me ndihma të mbledhura nga popullsia kristiane e Beratit dhe Myzeqesë, pas thirrjes që Ali Pashë Tepelena u bëri me anë të këtyre dy letrave që po ribotojmë këtu poshtë<sup>3)</sup>.

### Letra e parë:

«Ju, rumë të nahijes së Beratit, myzeqarë dhe vleħħe grabovarë, katunde dhc ċifliq, ju lajméroj se ja ku vura një epitrop që të më ndreqë manastirin e plakut Kozma; ndihmova edhe unë me aspra e të ndihmoni dhe ju si t'ju thotë dhespoti, me qëllim që të ndreqet ky manastir. Për ata që nuk do të japin ndihmën e tyre do të më mbetet hatéri dhe pastaj do t'i paguajnë dyfish.

Sikundér ju urdhëroj ashtu të bëni pas këtij vendimi.

Në Gjirokastër, më 12 shtator 1813.»

1) Sipas V. Lules, në këtë manastir ka patur edhe kodikë të tjerë, në njerin prej të cilëve ishin shënuar të hyrat e të dalat e manastirit për vitin 1870.

2) Të gjitha librat fetare të marrura nga ky manastir, të cilat ruhen në mitropolinë e Beratit, mbajnë të shkruar me dorë emrin e Joasafit.

3) Letrat janë bëtuar për herë të parë në vitin 1868 nga

A. Αλεξανδρης περιγραφή τῆς ιερᾶς μητροπόλεως Βελεγράδων ἐν Κερκύρᾳ, 1868 f. 82

## Letra e dytë:

«Hair duvaxhitë e mij mitropolit i Beratit Kolë Mitro dhe Haxhi Janko. Ju përshëndes dhe ju kalizoj se i mora vesh sa më shkruat dhe u informova me anë të igumenit. U gëzova shumë që u kujdesët për plakun Kozma. Ja tek po vinë aty tani igumeni dhe Nikolla bashkë me kryemjeshtrin dhe të vini të ndreqni edhe kullat e manastirit, i cili të bëhet më i mirë nga të gjitha manastiret. Me ardhjen time aty dëshiroi ta gjej të mbaruar. Pra, të kujdeseni të gjithë që ta ndreqni dhe të gjithë rumët e Beratit, të mëdhenj e të vegjël, të ndihmojnë. Po i shkruaj edhe Ibrahim Arapit t'ju ndihmojë në çdo punë. Të beni si ju snkruej. Ju përshëndes.

«Në Janinë, më 12 shtator 1814»

Për miqësinë e Ali Pashë Tepelenës me murgun Kozma pleqtë myzeqarë ruajnë këtë gojëdhanë:

Shën Kozmai, gjatë një udhëtimi në Tepelenë, takon me Ali Pashanë, i cili, në këtë kohë, ishte bez jo i dëgjuar. Si profit, ky i tregoi pashait të ardhmen me këto fjalë: Do të bëhesh pasha i madh. Do të marrësh Janinën dhe selinë e Kurt Pashait të Beratit. Do t'i zgjerosh shumë kufijtë e pashallëkut tënd me mjekrën e kuqe në Stamboll. Pas disa vjetësh, kur Ali Pashai pa se profecitë e Shën Kozmait po vertetoheshin, e bëri mik të tij, por pa e kuptuar shprehjen e fundit «me mjekrën e kuqe në Stamboll», që donte të thoshte fundin tragjik të jetës së tij, d.m.th. se turqit do ta vrishnin dhe kokën e prerë me mjekrën e skuqur në gjak do ta dërgonin në Stamboll.

Në Myzeqe, murgun Kozma e besonin edhe si parashikues të ngjarjeve me rëndësi. Prandaj pas çdo ngjarjeje që ndodhë ose që mendonin se do të ndodhë, besimtarët pleq thoshnin: «E ka thënë Shën Kozmai». «Hieromonahu Kozma, — shkruan Gj. HaxhiMihali, — në atë kohë të egër dhe të errët, përvëç këshillave fetare, popullit i jepte edhe këshilla njerëzore...<sup>4)</sup>; «... midis këshillave të tjera u rekomandonte nxeh të edhe çeljen e shkollave të veçanta<sup>5)</sup>. «... shkolla e parë në këtë kështjellë (Berat) u cel më 1780, një vit pas ardhjes së hieromonahut Kozma<sup>6)</sup>.

Aty nga fundi i shekullit XVIII, shtypjet dhe raprezaljet e qeveritarëve turq kundër të krishterëve të vendit tonë kishin bërë që krahina të tëra të ndërronin fenë e krishterë dhe të përqafonin fenë e pushtuesit. Për të shpëtuar nga kjo situatë, doli në Shqipërinë e jugut murgu Kozma, i cili, midis predikimeve fetare, këshillonte banorët të kishin dashuri midis tyre dhe të çelnin shkolla për të shpëtuar nga prapambetja. Gjithashtu, ai predikonte edhe thjeshtësinë në stolisjen e grave; kjo vihet në dukje në nji libër fetar, ku është shënuar: «1777, muaji gusht 22. Ditë e martë. Erdhi asqeti dhe na predikoi tri ditë, i quajtur Kozma Hieromonah, dhe preu florinjtë e grave». Në këto veprime, me sa duket, murgu Kozma gëzonte përkrahjen e Kurt Pashës së Beratit, i cili i kishte dhuruar murgut një fron për të hipur kur predikonte përpëra popullit. Gjithashtu, gëzonte edhe përkrahjen

4) «Dituria», 1927, f. 338.

5) Po aty, f. 338.

6) Po aty, f. 336.

ë Ali Pashë Tepelenës. Por më vonë murgu u vra nga njerëzit e Kurt Pashës dhe pas vdekjes gjëzoi nderimin e madh që i bëri Ali Pasha, duke ndërtuar për kujtim të tij manastirin në Kolkondas. Ky intezim që tregonte Ali Pasha për murgun Kozma na bën të themi se ay mund të ketë qënë këshilltar i fshehtë i Ali Pashë Tepelenës dhe i shërbente në veprimet e tij, sidomos kundër Kurt Pashës së Beratit. Mund që edhe për këtë shkak kryesor u vra nga njerëzit e këtij të fundit.

\* \* \*

Kodiku për kontratat e fejesës u ruajt në manastirin e Shën Kozmait deri në vitin 1957. Për të parën herë kodiku u diktua në vitin 1951<sup>7)</sup>.

Kodiku është i mbështjellë me tre kapakë. Kapaku i jashtëm është prej pergamene me ngjyrë krem, por i zverdhur nga koha, sidomos sipërfaqja e jashtëme ka marrë ngjyrë si në bezhë. Mbi sipërfaqen e këtij kapaku janë formuar kuadrate me anë të dy vizave të holla paralele ngjyrë kafe. Pjesa e fundit e tij, në anën kryesore, paloset me një gjerësi prej 5,5 cm., në mënyrë që të mbyllë regjistrin; pastaj, përreth, nga brenda, bëhet një palosje tjetër e ngushtë me gjerësi 2 cm., ku janë shkruar disa shënime të një kontrate fejese. Pjesa e sipërme e fletës së parë të këtij kapaku është e grisur së gjati dhe mungon gati gjysma. Mbi pjesën e pagrisur lezohen këto shënime të shkëputura në gjuhën greke: «Ky regjistër... i të shenjtit të Belegradit, Joasafit... martesat».

Kapaku i mesit është prej kartoni të bardhë, pjesa kryesore e të cilët paloset sikurse edhe kapaku i jashtëm.

Kapaku i brendshëm është prej letre të bardhë me ngjyrë gri. Në fletën e parë të tij, midis sipërfaqes, gjemjë të shkruar në dy rrështa ketë shënim të plotë: «Ky regjistër i përket të shënxit të Belegradit, Joasafit për kontratat e martesës», ndërsa prapa fletës së dytë janë shkruar këto shënime të parregullta: «Unë Kola» dhe «Unë Petro shkruaj».

Fletët e kodikut janë prej letre të bardhë, pak të zverdhura nga koha, të trasha, pak të ashpra dhe pa vija, me format  $15,5 \times 22,5$  cm. Ka 96 fletë të ndara në 5 fashikuj, që kanë qenë të qepur së bashku me spango, kurse sot janë të shkëputura, dhe 7 fletë të veçanta me përmasa të vogla.

Fashikulli i parë përmban 19 fletë. Në krye të fletës së parë janë shënuar tre kryqe, të cilat të kujtojnë vazhdimin nga një regjistër i mëparshëm. Pas këtyre është shkruar ky shënim: «Regjistër i prikokontratave të martesave». Dhe më poshtë është shkruar kontrata e parë, që mban datën 30 prill 1819 dhe zë krejt faqen. Në krejt fashi-

7) Diktuesi ka qenë Vangjel Lule, ish sekretar-llogaritar i kishës ortodokse të Fierit. Kodikun në fjalë kryesia e Zëvëndësisë së Fierit e dërgoi në Episkopatën e Beratit, ku ndodhet edhe sot. Sipas përbajtjes në shkresën përcjellëse, kodiku përmante 96 fletë të bashkuara dhe 12 fletë të veçanta. Në vitin 1962, me rekomandimin e episkopit të Beratit, munda ta marr këtë kodik nga Dhimitër Beduli me këto karakteristika: 96 fletë të ndara në 5 fashikuj dhe 7 fletë të veçanta. Gjithashtu, Dh. Beduli mbi fletët e kodikut kish shënuar me lapës kopiativ numrat renderorë të kontratave.

kullin janë regjistruar, deri në dhjetor të vitit 1820, gjithsejt 46 kontrata.

Fashikulli i dytë ka 20 fletë me 49 kontrata. Tri kontratat e para janë të muajit dhjetor të vitit 1820, kurse të tjerat të vitit 1821.

Fashikulli i tretë ka 22 fletë, në të cilat janë regjistruar 61 kontrata fejese. Kontrata e parë fillon me datën 9 nëndor 1821 dhe e fundit mban datën 21 gusht 1823.

Fashikulli i katërt përmban 20 fletë. Fleta e 13-të është krejt e pashkruar, kurse fletët e tjera, ashtu si në krejt kodikun, janë të shkruara në dy faqet. Herë në njëren faqe është shkruar një kontratë e vetme, herë dy ose më shumë. Gjithashtu, është përdorur e njejtë ngjyrë shkrimi si në gjithë kontratat e regjistruarë në fashikujt e tjerë, me përashtim të kontratave Nr. 158, 159, 160 që janë shkruar me një ngjyrë kafe të çelur gati si në ngjyrë portokalli. Nuk ka rregull në regjistrimin e datave. Në tetë kontratat e para nuk ka asnje datë, kurse e nënta mban datën tetor 1823. Pastaj vazhdojnë me vitet 1824 e 1825. E fundit ka datën 24 tetor 1825.

Fashikulli i pestë ka 17 fletë. Në këndin e sipërm të krahut të majtë fashikulli ka tri vrima të ngrëna nga mola. Në këtë fashikull janë regjistruar 74 kontrata fejese. Edhe këtu nuk ka rregull në regjistrimin e datave. Në vend të datës shpesh herë shkruhet «në të njëjtin muaj», ose «në të njëtin vit»; ndërsa në kontratën Nr. 240, bashkë me datën 26 prill 1827, gjejmë edhe këtë shënim: «të vitit shpëtimtar». Regjistrimi i kontratave këtu fillon me vitin 1825 dhe kontrata e fundit ka datën 19 tetor 1843. Është për t'u shënuar se në të gjithë kodikun nuk gjejmë asnje kontratë të shkruar gjatë viteve 1835, 1836, 1841 dhe 1842.

Në shtatë fletët e veçanta janë regjistruar 12 kontrata fejese të viteve 1824 dhe 1825. Në njëren nga këto fletë, me format 20x14,5 cm, në faqen e parë janë regjistruar 2 kontrata fejese pa datë, kurse në faqen tjetër është shkruar me një shkrim jo fort të lexueshmë dhe me gabime një dëftese, siç mund të kuptoher, për dhënjen e një huaje me interes<sup>8</sup>). Kurse në një fletë tjetër të veçantë, me format 14 x 9.5 cm., janë mbajtur shënimë llogarie përmarrjen e taksës së shkrimit të kontratave. Kështu sipas këtij shënnimi për çdo kontratë «martese» merrej një taksë fikse prej 3 groshësh.

I gjithë kodiku është i shkruar në gjuhën greke<sup>9</sup>), me shkrim do-re. Për shkrimin e tij janë përdorur ngjyrat e zezë dhe kafe, diku e errët dhe diku e zbardhur. Regjistrimet janë bërë nga persona të ndryshëm sikundër shifet nga kaligrafitë e përdorura, ose edhe sikundër kanë shënuar ata vetë mbi kapakun e këtij kodiku: «Unë Kola», «Unë Petro shkruaj». Shkruesit, duke mos njojur mirë gjuhën greke, përveç që shkruajnë me gabime ortografike, por edhe veshjet i emërtojnë me emrat e përdorura nga vetë vendësit.

\* \* \*

Kodiku, si një dokument me karakter juridik i së dreitës zakonore, ka rëndësi historike dhe etnografike për vendin tonë. Siç dihet, në

8) Shih përkthimin «Kodiku i Manastirit të Shën Kozmait» (kumtesë) Studime historike 1965, Nr. 3. f. 176.

9) Përkthimi u bë nga Koço Bozhori.

këtë kohë Turqia ruante ende mënyrën e vjetër juridike të mbështetur në ligjet fetare të shariatit. Popujve të besimit kristian nën sundimin turk sulltanët u kishin njohur të drejtën të administroheshin sipas zakoneve dhe kanuneve të tyre. Kështu, elementi ortodoks, i udhëhequr nga kisha greke, formoi një qendër që kishte si organ drejtues mitropolinë. Mitropolitët merreshin si me çështjet fetare, ashtu edhe me ato civile. Krahina e Myzeqesë nga pikëpamja administrative kishat, bënte pjesë në mitropolinë e Beratit, me dhespot Joasafin. Mitropolitët i pajisnin kishat e manastiret e dioqezës së tyre me regjistra të ndryshëm, të quajtur kodikë<sup>10)</sup>. Në këta kodikë regjistroheshin çështje të ndryshme, si veprime llogarije mbi të hyrat e të dalat e kishës ose manastirit, lindjet, martesat, çkurorëzimet, vdekjet, testamentet, etj. Dhespoti i Beratit, Joasafi, kish pajisur me të tillë kodikë edhe manastirin e Shën Kozmait. Kodikun në fjalë ai e quante pronë personale të tij. Kjo vihet në dukje nga ky shënim i shkruar mbi kapakun e kodikut: «Ky regjistër i përket të shenjitit të Belegradit Joasafit...» Joasafi kishte një burim të ardhurash, të cilat i siguronte nga populli nëpermjet shkrimit të kontratave në kodik. Kështu, sipas shënimive në fletën e veçantë për çdo kontratë «martese» merrej një taksë fiksë prej 3 groshësh.

Kodiku për kontratat e martesës, ose prikokontratat e martesës, siç shkruhet në kodik,<sup>11)</sup> është një dokument me vlerë për studimin e zakonit të kontratës së fejesës, të veshjes dhe të onomastikës në krahinën e Myzeqesë gjatë gjysmës së parë të shekullit XIX. Prandaj nga ky kodik po nxjerrim këtu disa shënime të ndara sipas karakterit të tyre.

## I. KODIKU SI BURIM I ZAKONIT TË KONTRATËS SË FEJESËS NË KRAHINËN E MYZEQESË.

Zakoni i regjistrimit të një kontratë fejese në Myzeqe e ka burimin, ndcshta, para shkruarjes së këtij dokumenti, d.m.th. para shekullit XIX, dhe me disa ndryshime, ruhej deri në vitet e para të cilimit të vendit nga elementi autokton kristian i fshatarsisë së krahinës së Myzeqesë. Bile aty-këtu vihet re si mbeturinë edhe në këto vitet e fundit.<sup>12)</sup>

Kështu, sipas këtij zakoni, ditën e fejesës, në prani të përfqaësuesve të të fejuarve, lajmësit dhe dëshmitarëve, shkruhej një akt-marrëveshje për fejesën e çiftit dhe pajën. Gjithashtu, po në këtë akt-marrëveshje regjistrohej shuma e të hollave që, sipas kodikut, quhej «dhuratë para martese» (shih kontratën Nr. 1), ose agërliq e agrilllik (kontratat Nr. 24 dhe Nr. 175), si dhe rrobat e nuses, të emërtuara copë për copë, që pala e dhëndërit detyrohej t'i bënte asaj. Po kështu, regjistrohej edhe paja që bënte nusja për veten e saj dhe peshqeshet që do të sillte në familjen e burrit. Sipas këtij dokumenti, përfqaësues të të fejuarve, zakonisht, ishin vetë prindët, babai ose, ngando-

10) Shih kontratën Nr. 275.

11) Sipas kultit fetar ortodoks, martesa legalizohej vetëm pas ceremonisë së kurorëzimit fetar. Prandaj, kontratat e këtij kodiku janë kontrata fejese ose kontrata përmarrëveshjen e pajës së martesës, dhe jo thjesht kontrata martese.

12) Ll. Mitrushi — «Dasma në lalët e Myzeqesë», Etnografia Shqiptare Nr. 2, viti 1963, f. 182-183.

njëherë, edhe nëna, véllezërit, xhaxhallarët, kushérinjtë dhe, në mun- gesë të tyre, një person tjetër që kujdesej pér ata, si p.sh., sipas kon- tratës Nr. 141, Jorgj Mucani është vegil (përfaqësues) i shërbëtorit të tij Todo. Por aty-këtu gjejmë edhe kontrata në emër të vetë të feju- arve, pa përfaqësues, siç shihet në kontratën Nr. 226.

Zakoni që pala e dhëndërit t'i bënte nuses rrrobat e martesës dhe të jepte një shumë parash përdorej nga banorët autoktonë të Myzeqe- së prej të cilëve e morën edhe të ardhurit në këtë krahinë. Këta shkruan- nin në fund të kontratës: «Sipas dokeve dhe zakoneve të myzeqa- rëve» (Shih kontratën Nr. 183).

Në këtë kodik gjejmë edhe kontrata martese të ardhësve në My- zeqe, zakoni i të cilëve është i ndryshëm nga ai i myzeqarëve. Ardhësit kishin zakon që kontratën e fejesës ta bënte përfaqësuesi i vajzës dhe jo ai i djalit, siç ndodhë te Myzeqarët. Gjithashtu, pala e vajzës sipas kërkesës së palës së burrit e bënte vetë pajën e vajzës dhe i jepte një shumë të hollash palës së dhëndërit, me të cilët ata bën rrrobat e nusërisë (shih kontratën Nr. 193); ose, në raste të tjera, ana e vaj- zës nuk i jepte të holla dhëndërit, por detyrohej t'i bënte vetë rrrobat e nusërisë. (Kontratë Nr. 194).

Ky zakon i ardhësve duket se ndikoi, aty nga çereku i parë i she- kullit tonë, edhe në disa banorë autoktonë të Myzeqesë, sidomos në qytetin e Fierit, dhe më rrallë në fshatarët në gjendje ekonomike të mirë. Kështu, kur këta donin të martonin vajzat e tyre me djem që kishin mjeshtëri ose shkollë, ja bënvetë gjithë pajën e rrrobat e nusërisë vajzës së tyre. Veç kësaj, i jepnin dhëndërit edhe një shumë të hollash, ose pasuri tjetër, si tokë, ullinj, etj., që regjistroheshin në emër të gruas.

Në kodik, përveç regjistrimit të veshjeve dhe të një sasie të ho- llash të shprehura në grosh, aspra dhe para, që sipas shpjegimit të pleqve myzeqarë përdoreshin pér të preqatitur nusja pajën e hollë të saj dhe peshqeshet që do çonte në shtëpinë e burrit, nuk takojmë ndonjë rast pér dhënie ose marrje të ndonjë pasurie tjetër nga asnjera palë e të martuarve.

Në disa kontrata të këtij kodiku vihet re dhe ky shënim: «Pran- daj e regjistroj në këtë kodik pér siguri». Siç shihet edhe nga këto llo- je kontratash, qëllimi i regjistrimit në kodik ka qenë i dyfishtë. Nga njëra anë, të legalizohej fejesa dhe, nga ana tjetër, të mbahej premtimi nga të dy palët kontratuase pér preqatitjen e pajës së nuses.

## II. VESHJA E GRUAS MYZEQARE NË GJYSMËN E PARË TË SHEKULLIT XIX SIPAS KODIKUT.

Një burim tjetër me shumë rëndësi në këtë kodik është veshja e gruas myzeqare, që dëshmon njëkohësisht edhe pér mënyrën e marrë- dhënieve ekonomike-shoqërore e kulturale të kësaj krahine në gjys- mën e parë të shekullit XIX.

Siç shihet në kontratat e kodikut, pjesa më e madhe e veshjes së gruas përbëhet prej tekstileve industriale të importuara, kurse vë- tëm një pjesë e vogël, siç janë guna e peshlliri prej shajaku dhe bre- zi prej leshi, janë prodhim vendi shtëpijak. Por edhe këto ngadonjë- herë zëvendësohen nga tekstile të importuara, si p.sh. guna prej sha- jaku, që u përdor nga gruaja myzeqare e fshatit deri në 30 vjetët e

shekullit XX, zëvendësohej me xhyben prej cohe të qendisur me arsi ndikim i veshjes së gruas së pasur qytetare.

Myzeqeja, si një vend bujqësor e blegtoral, me mbeturina të theksuara të ekonomisë natyrore, prodhimet industriale i sillte nga Evropa dhe vende të tjera të largëta nëpërmjet tregjeve të Shqipërisë së jugut, dhe sidomos të atij të Beratit, që ishte qendra administrative e kësaj krahine dhe një qytet mjaft i zhvilluar nga ana zejtare e tregëtare. «Në Shqipërinë e jugut, pas sundimit të Ali Pashë Tepelenës, i cili theu fuqinë e feudalëve të këtij vendi, shkruan Hahni,<sup>13)</sup>, filloi edhe një lulëzim i gjendjes ekonomike, sepse që prej kësaj kohe tregëtia u zhvillua edhe më tepër, bile kërkoi edhe tregje të reja...» Kështu, si gjithë qytetet e tjera të Shqipërisë së jugut, edhe tregëtarët e qytetit të Beratit, nëpërmjet rrugëve tokësore, blinin mallrat industriale që u nevojiteshin në fabrikat e Selanikut, Thesalisë e Stambollit, ose nëpërmjet rrugëve detare (siç dihet, Berati përdorte skelën e Semanit në Myzeqe dhe skelën e Vlorës) për të eksportuar mallra në natyrë. Berati mblidhе prodhimet bujqësore e blegtorelle nga Myzeqeja dhe e furnizonte atë me prodhime artizanati të punuara në vend, ose të importuara nga industria e huaj. Mallra tekstili të importuara nga Evropa ose vende të tjera, sipas pajës së regjistruar në kodik, kanë qenë këto tekstile: coha, kadifja, attlazi, cipa, pëlhura, shami, pëlhura allaxha. Gjithashtu, importoheshin edhe çapare të ndryshme prej mëndafshi ose ari dhe fije ari për qendisjen e rrobave.

Mjeshtërija e qëndisjes me fije ari dhe ajo e punimit të argjendit nuk ka traditë në Myzeqe, prandaj të gjitha veshjet, si jeleqe, xhybet, etj., të qëndisura me fije ari, gjithashtu edhe brezat, paftat dhe kopsat prej argjendi për zbukurimin e jeleqeve duhet të janë punuar nga mjeshtrit beratas, kurse qëndisjet e jeleqeve të thjeshtë për të cilët janë përdorur edhe fijet e vëndit, janë punime të vetë gruas myzeqare, e cila e ka ruajtur këtë traditë deri vonë, si në zbukurimin e gunës me gjatanë ashtu edhe në qendisjen e jeleqeve dhe përparseve.

Gjithashtu, kodiku na jep material të mjaftë për të nxjerrë mënyrën e veshjes së gruas myzeqare në gjysmën e parë të shekullit XIX, të cilat dëshmojnë njëkohësisht edhe për gjëndjen ekonomike e shoqërore të atyre që martoheshin. Pra, duke u bazuar në listën e llojeve të rrobave, mësojmë se veshja e nuses myzeqare gjatë periudhës 1819-1843 përbëhej nga këto copë: jelek, peshli, shegunë, flokatë, xhybe, dolloma, beteni, anteri, futa, podhja, fustan, brez, mëngë, qeleshe, napë, alikri, pushali, gjerdan me rupe, kopsë, këpucë, dhe vëthë. Pasi shumë herë këto veshje ndryshojnë në material, ngjyrë e zbukurime, po nxjerrim këtu një listë me emrat e tyre të veçantë, duke dhënë edhe disa shpjegime për ato emra veshjesh që mundëm të grumbullojmë nga disa pleq të Myzeqesë<sup>14)</sup>. Shpjegimet e nxjerra po i vemë në kllapa.

1) Jelek — veshje e sipërme, me gjatësi mbi bel; pa mëngë: mbërthehej përpara.

13) G. Hahn — Albanesische Studien. f. 55.

14) Shpjegimet për veshjet i kemi nxjerrë nga Taq Sopiqoti, banues në Fier, i datësindjes 1894, me mjeshtëri rrobaqepës; Uan Çomo, banues në Libofshë, i datësindjes 1888, me mjeshtëri rrobaqepës, etj.

Për të pregititur jekët janë përdorur coha, kadifeja, atllazi dhe cipa (copë e pambuktë me lule); kurse për zbukurime janë përdorur çaparët (shiritat) prej ari ose mëndafshi me kopsa prej argjendi. Jekët kanë qenë të ndryshëm. Për ta kemi këta emra:

- 1) Jelek cohe moriko (jelek prej stofe me ngjyrë blu).
  - 2) Jelek cohe aliko (me ngjyrë vishnjë).
  - 3) Jelek cohe me çapar (me shiritë).
  - 4) Jelek mavi me gjysmë çapar.
  - 5) Jelek cohe me çapar të artë.
  - 6) Jelek manushaqe me çapar të mëndafshëtë.
  - 7) Jelek me çapar jakino.
  - 8) Jelek me çapar gaidiko.
  - 9) Jelek kazmiri (stofë leshi) me çapar jaki.
  - 10) Jelek cohe me fije të arta (qendisur me fije ari).
  - 11) Jelek cohe me fije të Tiranës (qendisur me fije të blera në Tiranë).
  - 12) Jelek cohe me harxhe të vendit (materiali zbukurues është i prodhuar ose blerë në vend).
  - 13) Jelek mavi me çapar Janine (i ardhur nga Janina).
  - 14) Jelek cohe me harxhe javjotata.
  - 15) Jelek allaxha.
  - 16) Jelek shami (pëlhurë me vija)
  - 17) Jelek samallaxhi.
  - 18) Jelek fermili (fermele qendisur me ar).
  - 19) Jelek atllazi.
  - 20) Jelek kadife me kopsa argjendi.
  - 21) Jelek cipul (basmë me lule).
  - 22) Jelek trandafili (me ngjyrë trandafili).
  - 23) Jelek kumburli (me kopsa).
- II. Peshli — veshje e sipërme me gjatësi nën bel, me mëngë të gjata: mbërthehej përpara.
- 1) Peshli shajaku.
  - 2) Peshli i bardhë.
  - 3) Peshli shami.
  - 4) Peshli sakëz.
  - 5) Peshli citari.
- III. Shegun — veshje e sipërme, e gjatë nën gju, pa mëngë:
- 1) Shegun shajaku (e dërstilur).
  - 2) Shegun vilari, vilariko (copë e paqepur).
- IV. Futa — përparrëse me pak zbukurime. Përdorej për në shtëpi.
- V. Podhiqe — përparrëse me zbukurime. Përdorej më tepër për vizita, ose në shtëpi në ditë festash:
- 1) Podhiqe të kuqe.
  - 2) Podhiqe stofe me çapar të mirë.
  - 3) Podhiqe boheni.
  - 4) Podhiqe nerame.
- VI. Anteri — veshje gruaje e shkurtër deri në bel, me mëngë të gjata:
- 1) Anteri pëlhure.
  - 2) Anteri e bardhë.
  - 3) Anteri shami.
  - 4) Anteri sakizi.
  - 5) Anteri shajaku.

VII. Mitan — si peshliri:

1) Mitan basme tē mirë.

VIII. Xhybe — veshje e sipérme e gjatë nën gju, me mëngë tē gjata, ose pa mëngë:

1) Xhybe moriko me harxhe tē arta.

2) Xhybe celuri me harxhe tē arta.

3) Xhybe bojë gjaku me harxhe tē arta.

4) Xhybe xinxifli me harxhe menekshe (xhybe vishnjë me shiritë tē verdhë).

5) Xhybe stofe me harxhe tē arta.

6) Xhybe perlo.

7) Xhybe shami allaxha (mëndafsh me vija dhe lule).

IX. Dolloma — një lloj rrobe e gjatë dhe e gjërë:

1) Dolloma me lule mëndafshi dhe harxhe tē arta.

2) Dolloma xinxifli (vishnje) me harxhe tē arta.

3) Dolloma citri.

X. Beteni — një lloj xhybeje.

XI. Mëngë:

1) Mëngë stofe.

2) Mëngë perlo.

XII. Brez:

1) Brez leshi i ngjyrosur.

2) Brez aliko.

3) Brez argjendi.

4) Brez jetesiko.

XIII. Qeleposh — një lloj feste

1) Qeleposh me tē arta (qendisur me fije ari dhe qepur pare ari).

2) Qeleposh mistariko.

3) Fes me zimbiliqe ari (me tertir).

XIV. Napa — shami tē holla pér kokë.

XV. Pushali — një lloj peshqiri që e hidhnin gratë në kokë.

XVI. Alikri e bardhë.

XVII. Kopse — paftë pér tē mbërthyer brezin:

1) kopsë argjendi.

XVIII. Gjerdan me rupe — varg me para sërmi pér zbukurimin e gjoksit. Kurse pér veshien e çobankave (vllehve), e cila ndryshon nga ajo e banorëve vendës, kemi këto veçanti: xhup, xhube, kapllama, politika, petheni, brez argjëndi.

\* \* \*

## KODIKU SI BURIM I ONOMASTIKËS NË KRAHINËN E MYZEQESE

Një anë tjetër e vlerës së këtij dokumenti është edhe përdorimi i onomastikës, prandaj po nxjerrim këtu një listë me emra tē meshkujve e fëmreve dhe mbiemra tē familjeve.

Sic shihet, në listat e poshtëshënuara shumica e emrave që gjejmë këtu janë me prejardhje kristiane, kurse trajta e shkurtuar e tyre lidhet me formën dialektore tē kësaj krahine.

1) Emra të plotë të gjinisë mashkullore dhe shkurtimet përkatëse të tyre:

Anastas (Stasi, Tasi, Taçi, Nasto), Avram, Avakum, Angjel, Argjir, Brusi, Bushi, Daniel (Danil, Dani, Nili), David, Doko, Dushi, Dhamo, Dhimitër (Dhimo, Dimo, Mitro), Efthimi, Filko, Filip (Lipe), Jani (Jan-ko), Naci, Nako), Jakov, Josaf, Josif, Gjergj (Gjergji, Jori, Jorgo, Xho-  
xhi), Gjini (Gjika), Gjoni (Gjoka), Haris, Kalem, Kapo, Kostandin (Kosta, Kota), Ksan, Lame, Lasko, Liako (shkurtim i emrit Ilia), Lla-  
zar, Llup, Malo, Marko, Martiko, Marin, Mërtir, Mërkur, Mihal (Miho, Mile), Mina, Misto, Naun, Ndini, Nikolla (Niko, Koli, Koliç), Ndoni (shkurtim i emrit Andon), Pjetër (Petro, Peti, Petush), Prend (Prendush), Prof, Ristan (Risto), Sako, Savo, Simion (Simon, Mone, Monk), Semin, Sotir, Spiro, Stroni, Stavri, Stefan (Stefa, Fani), Shan-  
ko, Shatko, Tiçi, Tishi, Tili, Theodhor (Dhori). Todi, Todo (shkurtim i emrit Todri). Trifon, Thanas (Nasi, Nasho), Thano, Thoma, Thonian, Uan (shkurtim i emrit Joan). Vasil, Vreto, Zarko.

2) Emra të plotë femrash dhe shkurtimet përkatëse të tyre:

Agni, Aspri, Anastasi (Stasa, Stasina, Stasini), Areti, Anthria, Ci-na, Della, Djella, Doka, Dhespina, Ekaterina (Katerina), Eleni (Leni), Fana, File, Hanai, Gjelina, Janka, Jerkia, Kajana, Kasana, Kostina, Konda, Korona, Kota (shkurtim i emerit Kostandina), Lia, Lina, Lule, Maria (Marina, Marika), Magdelena, Noga, Niqi (shkurtim i emrit El-piniqi), Patra, Pina, Prenda, Qyrana, Ristana, Ristea (shkurtim i em-rit Aristea), Rusen, Saveta (Sava), Sagista, Sana. Stavrina (Stavratia, Stavra), Stanie, Stefa, Sofa, (Shkurtim i emrit Sofie) Tala, Tana, Tilie, Thanana, Theodhora, Vasilia (Vasa, Sila), Zoga, Zambeta.

Mbiemrat e familjeve, sipas përbajtjes së tyre, po i ndajmë në këto kategorit:

a) Mbiemra familjesh me prejardhje nga emra personash

Argjiri, Avrami, Bani, Bitri, Brusi, Bushi, Çuni, Danili, Davidi, Dimo, Dodo, Doko, Duda, Dushi, Dhamo, Dhima, Dhimitri, Filipi, Foti, Goga, Gori, Gjergji Gjergjushi, Gjika, Gjini, Gjinos, Gjoka, Hilia, Hilës, Janko, Jakovi, Jani, Jorgji, Joti, Kiço, Kita, Koça, Koçi, Kola, Konda, Kosta, Kostandini, Lako, Laze, Leka, Lena, Lipe, Loni, Mara, Mari, Marini, Marko, Mërtiri, Mërkuri, Miço, Miho, Mihali, Mile, Milo, Mina, Minos, Mita, Miti, Mitro, Mone, Moni, Monka, Naçi, Naka, Nako, Nano, Nasi, Naska, Nauni, Nikolla, Ndino, Ndoni, Ndreko, Ndreu, Pali, Panda, Pasko, Peti, Peto, Petro, Petushi, Piro, Pjetri, Postoli, Prendi, Prendushi, Profka, Qyrana, Rista, Ristani, Risto, Rusi, Semin, Simeoni, Simoni, Sinani, Stasa, Stefani, Stoja, Tase, Tasi, Todo, Todri, Thani, Thanasi, Thimo, Thoma, Vasili, Xoxa, Zizi Zaharia.

b) Mbiemra familjesh me prejardhje nga emra bimësh, kafshësh e shpendësh.

Arra, Bifi, Dashi, Driza, Lule, Macoku, Rrapi, Turtulli, Zogu.

c) Mbiemra familjesh të rrjedhura nga vëçori fizike

Ballkuqi, Çakërrri, Çala, Doraci, Gjata, Korroveshi, Kryemadhi, Qerozi, Qorri, Sakati, Shqepa, Shurdhi, Vogli.

c) Mbiemra familjesh me prejardhje nga toponime

Baltëza, Gega, Golemi, Grambi, Laça, Libofsha, Lushnjari, Matka, Muçani, Mujallisi, Muzaqi, Nika, Rithi, Sinambeli, Sheqi, Shkëmbi, Toska, Varibobi Verria, Vërlaci.

d) Mbiemra familjesh me prejardhje mjeshtërie ose ofiqi

Baba, Babi, Bakalli, Baxhos, Bojës, Bojaxhiu, Cobani, Cullai, Dau-llëa, Dyqanı, Dyqanxhiu, Dhaskali, Dhespoti, Kauri, Kovaçi, Kordha, Kulari, Mullisi, Papakosta, Papajosifi, Papajorgji, Papandoni, Paparusi, Papasimoni, Papapetri, Papathanasi, Papavrami, Pelari, Plaku, Prifti, Saraçi, Subashi, Shtëmbari, Zografi.

dh) Mbiemra familjesh me kuptim tallës ose përbuzës:

Kopil<sup>15)</sup> Laço,<sup>16)</sup> Lecka,<sup>17)</sup> Llosho,<sup>18)</sup> Partalli,<sup>19)</sup> Shamshallo,<sup>20)</sup> Zoranjaku<sup>21).</sup>

e) Mbiemra familjesh që nuk u dihet prejardhja:

Alimashi, Ardes, Baliaka, Basko, Belia, Beri, Benda, Bide, Biri; Bitaraqi, Burdizi, Cavilli, Ciligjini, Ciku, Çako, Çela, Çiles, Çuko, Çukallari, Daka, Dangës, Dapi, Didi, Dika, Dimiri, Dino, Dori, Draçi, Dumi, Duta, Eliaka, Gonaraku, Grusha, Guriko, Gurmaçi, Gjeka, Haxhullës, Hodiku, Hutës, Hydra, Hydri, Iska, Jetos, Juga. Kanea, Kapo, Karpizi, Keri, Kostini, Kurti, Kuta, Kyrjo, Laska, Langa, Lile, Lioshi, Lievenaku, Linonjari, Maçi, Matalioti, Mandro, Mati, Mesali, Milori, Mineka, Minka, Nushi, Ndrio, Pari, Peledi, Pipa, Pira, Prites, Posniari, Rapalioti, Sara, Sema, Sintës, Skalisti, Skarpeta, Sota, Stafa, Stamo, Strati, Stringa, Sukulli, Shani, Shabeli, Shafka, Shagoni, Shqevi, Shuli, Shuti, Taule, Timiri, Toka, Trasi, Tushës, Verdi, Xhalia, Zaka. Zarka, Zigina, Zurko. Zuta.

\* \* \*

Në këtë kodik gjejmë edhe materiale toponomastike që u përkasin 86 fshatrave të juridiksionit të Manastirit të Shën Kozmait. Sot 12 prej tyre nuk gjenden fare. Këtu të bën përshtypje emri Muzaqi, i cili na duket se dëften për vendbanimin e familjes princërore mes-

Në Myzeqe mbiemrat tallës apo përbuzës të shënuar më sipër sot kanë këto kuptime:

15) Kopile, me kuptimin përbuzës, quheshin vajzat që shërbenin në shtëpitë e familjeve të pasura.

16) Laço quhet një njeri i djallëzuar.

17) Lecka, njeri që vishej me rroba të grisura.

18) Llosho, njeri që nga veshja dhe pamja duket jo i zgjuar.


19) Partalli quhet një njeri që vishet me shallvare të gjëra që i varen në trup.

«Të ranë partallet» — shprehen në Myzeqe kur duan të tallin një njeri të veshur keq. tē tij.

20) Shamshallo, njeri që vishej keq, me rroba të gjera që nuk i përshtaten trupit

21) Zoranjaku, njeri i gjatë e i hollë si zorrë; ose njeri që ha shumë dhe nuk ndjen të ngopur.

jetare të Muzakajve. Përsa i përket emrit të tij, në Lushnjë mësova se kështu ishte quajtur një lagje në Bubullimë, kurse në Çiflik të Madh e nxorrën afër Libofshës, por ku konkretisht nuk dihet. Mendova se mund të gjeja ndonjë gjurmë nga përdorimi i mbiemrit Muzaqi, të cilin e gjejmë disa herë në kodik, por edhe si mbiemrë nuk përdoret më në Myzeqe<sup>22)</sup>. Në Çiflik të Madh më treguan gjithashtu se familjet me mbiemrin Bualli më parë kanë patur atë Muzaqi. Po kështu, edhe një pjesë e familjes Sota që ka lidhje gjaku me familjet Shtëmbari, më parë është quajtur Shtëmbari, por këto ndryshime i bënë pas një kryengritjeje që u bë në Myzeqe. Kryengritësit u mblodhën në Pojan, por aty u diktuan nga turqit dhe shumë prej tyre u vranë. Pjesa që shpëtoi, bashkë me familjet e tyre, iku nga Myzeqeja, kurse të tjerët nga soji i pjesëmarrësve në kryengritje ndrruan mbiemrin për tu shpëtuar ndjekjeve. Kështu, supozohet se Muzaqët u quajtën Bualli dhe një pjesë e familjes Shtëmbari u quajtë Sota.



Harta me emrat e fshatrave në juridikcionin e manastirit të Shën Kozmait

22) Sot në Bubullimë arsimtari Petro Muzaka dhe infermieri Pal Muzaka rrjetdhin nga familja «Bualli». Ata i ndërruan mbiemrat e tyre në Muzaka në kohën e regjistrimit të populisë në vitin 1930.

**Toponimet e fshatrave që gjenden edhe sot në Myzeqe.** (Disa nga këto toporime kanë pësuar edhe ndryshime, prandaj ndryshimet e sotme po i vemë në kllapa, përkrah toponimit të parë).

Alibean, Arëz, Bufas, Baltëz, Bubullimë, Bishanaqi (Bishanaka), Bishan, Çiflik i Madh, Çiflik i Ri, Çeligrad, Darnanes (Dërmënës), Dau-las, Frashër, Fier, Fikasi (Fikthi), Grambi (Grëmbi), Grecalli, Gryka, Hasalli, Hendani, Hodani (Hadani), Hoxharaj, Hamili, Jokalli (Gjokalli), Kolkondas, Kortukalli, Korkutasi (Kërkutasi), Krutja e Poshtëme, Krye-gjatë, Kolonjë, Kadipashai, Kallmi, Libofsha, Matka, Mujalli, Metaj, Metani, (Metaj), Marinëz, Mbrostar, Nikas, Nikaj (Nikas), Novoselë, Petovë, Petoshani, Petoshaj (Petova), Poro, Pojan, Qenas (Afrimi), Remas, Radostinë, Rustamaj, Rustaman (Rusaman), Rumeni (Raman), Rupan (Rupaj), Rusan (Rusinjë), Seman, Sinambeli (Sinan-Bejlli), Shko-zë, Shterpan, Sheqisht, Sheqi Madh, Sheqi, Shenepremte, Topojë, Vërrri, Vajkan, Varibobi (Varibop).

**b) Toponimet e fshatrave që sot nuk gjenden në Myzeqe:**

Gestaran, Gipsa, Laçaj,<sup>23)</sup> Litna, Muzaqi, Muxani, Pariaza, Pan-troniti, Rithi, Sedova, Skota, Strumbeli.

\* \* \*

Këtu, nga 315 kontrata fejese që ka kodiku, po botojmë vetëm 155 kontrata të përkthyera, kurse pjesa tjetër ruhet si përkthim në arkivin e Sektorit të etnografisë.

Llambrini Mitrushi

---

23) Nga informatat e marra në Myzeqe për listën e emrave të fshatrave që sot nuk gjenden, nuk mundëm të nxjerrim gjë as nga kujtesa e pleqve. Shpjegim gjetëm vetëm për fshatin Laçaj, që sot është i pabanuar dhe ku gjendet vetëm kisha e Shenepremtes. Kjo kishë është një ndërtesë e vogël e ndërtuar me gurë, nën shkallët e së cilës kalonte një lumë i vjetër. Kisha është quajtur edhe «shtëpia e djalilit». Pranë kësaj kishe ndodhej edhe këneta po me emrin Laçaj.

## Fashikulli i parë

### REGJISTER I PRIKOKONTRATAVE TË MARTESAVE

1819, prill 30

1) Me mirëdashjen e atit, me bashkëveprimin e birit dhe me fuqinë e Shpirtit të Shenjt. Sot unë, Sotir Gjino, nga Korkutasi, fejoj nipin tim, Thomanë, me bijën e Papa Avramit nga Kolkondasi, Sotirën, për grua legale, dhe i jap asaj dhuratë para martesës 150 grosh, d.m.th. njëqind e pesëdhjet, dhe rrobat si më poshtë:

Të djalit:

- 2: jekë prej stofe të mirë.
- 1: peshli.
- 1: shegun shajaku.
- 1: qeleposh dhe brez argjendi.
- 1: pushali, futa dhe brez.
- 1: gjerdan me rupe.
- 2: palë këpucë.
- 6: palë këpucë.

+ Jam dakord

Të nuses:

Prikën sipas zakonit bashkë me shtrojet, këmishët dhe ndërresat.

+ Jam dakord

Unë, Sotir Gjino, veqil i djalit. Unë, babai i vajzës, Papa Avram + Dëshmitar: Markua i Jank. Shkes dhe dëshmitar: Vasil i Gjinosis. Dhespotit.

Dëshmitar: Nikoll Doda

U uroj atyre shëndet dhe bekimin e Avramit dhe qoftë për dëshmi.

1819, 1 maj

2) Unë, Bitri Golemi, fejoj sot nipin tim, Davidin, me bijën e gjetur të Kosta Davidit, bijë e Mitros, Sotirën, për grua legale, dhe i jap asaj rrobat e mëposhtëme, sic shënohen:

Rrobat e dhëndrit për nusen:

- 2: jekë prej stofe
- 1: shegun shajaku.
- 1: peshli shami.
- 1: qeleposh dhe podhja.
- 1: pushali, futa dhe brez.
- 1: kopse argjendi dhe gjerdan.
- 1: palë këpucë dhe këpucë me qafa.

Ato të nuses:

Prikën sipas zakonit bashkë me shtrojet.

Jam dakord.

Unë, Kosta David, veqil i vajzës, Dëshmitar dhe shkes: Mark Dodo

Dëshmitar: Dimo Kola.

Unë, Bitri Golemi, veqil i djalit, jam dakord.

εἰ μάστιχος τὸν γεννοαρχίν τὸν ανανεῶν

2018: 2018/2

f. 120v. "Vocatio", congregetur et est i. formam et ipsius  
orationis. In oratione ipsius vocatio yllos, sed negetur  
decoloratio. In enclisis ut dicitur, p. h. yllos et  
omni alijs. Iste usq; noster vocatio. Sed vocation  
yrras non. q. dico deo yocatione vocari ad h. ylebra  
150. q. d. Enclisis omni h. q. la grecorum. q. u. n.  
yccipit.

are words

45 *edagm.*

- 2: γέρανα πέτυνε μηδε  
 1: οντι .  
 1: οντον απάν .  
 1: ημερίδιον . γεράει ἀναπόνηστον .  
 1: στρεψτη δέλι . γεράει =  
 1: γεράλινη μη φένε .  
 2: γεράει ουδέποτε .  
 6: γεράει ουδέποτε .  
 + εγώ δωρεύγοντο λαζανάτας ουδέποτε  
 5αργό .  
 + ομάδρας ή πλάκανα τίταν  
 περγές .  
 + οθόνας ή αλτής ούτε . γεράει ουδέποτε .  
 ή γεράζει .

U uroj atyre jetë të mirë, fëmijë të mirë dhe bekimin e Avramit, të shchin bij dhe bija.

#### 1819 4 maj

3) Unë, Subash Prendi Baljaka, fejoj sot Markon, birin e Nas Miles, me të bijën e Jorgj Kolë Seminit, Savën, për grua legale, duke premtuar dhe duke qenë dakord t'i bëj rrobat sipas zakonit të vendit, kur do të mundem. Pak nga pak, duke shkuar edhe gjendjen e dhëndërit dhe duke bërë edhe rrobat e nuses dhe nuk do t'i bëj dosido (rastësisht) asgjë.

Jam dakord  
Nëna e vajzës unë, Stefa.  
Dëshmitar: Semin Subashi  
Dëshmitar: Monka Cika

Jam dakord  
Veqili i djalit, Prend Subashi  
Ndin Çobani, Shkes dëshmitar.

U uroj atyre jetë të mirë, fëmijë të mirë dhe bekimin e Avramit, të shohin bij e bija.

#### 1819 15 maj

4) Unë, Sotir Bushi, veqil i Nili Dudës, bëj të ditur sot se fejohet Nili me të motrën e Kolë Semës, Vasilinë, për grua legale, dhe i jap asaj dhuratë para martese 200 grosh dhe gjithë rrobat.

U uroj atyre jetë të gjatë dhe bekimin e Avramit.

Dëshmoj unë, Sotir Bushi,  
nga Çifliku i Madh, veqil i Nili

Dëshmoj unë, Kolë Sema,  
veqil i gruas.  
dhe shkes.

Në të njëjtin muaj, 20

5) Unë, Qirko Janko, fejoj sot djalin tim, Mitron, me bijën e Nasto Jorgjit, Koronën, për grue legale dhe i jap asaj rrobat sipas marrëveshjes dhe dhuratë para martesës 60 grosh.

1: petheni prej stofe  
1: kapllama  
1: brez argjendi  
Jam dakord  
babë i djalit Qirko  
Dëshmitar: mësuesi Naun

Prikën sipas zakonit dhe një palë veshje sipas takatit të tij.  
Jam dakord  
unë, Janko Stamo, veqil i vajzës.  
Dëshmitar: Misha Buçi

Në të njëjtin muaj, 31

6) Unë, Jorgji Postoli, bëj të ditur sot se fejoj vëllanë tim, Davidin, me vajzën e Simon Çukos, Lulen, për grua legale.

I jap asaj dhuratë para martesës dyqindepesëdhjetë grosh dhe veshjet e mëposhtëme:

Të dhëndërít:

2: jelekë prej stofe.  
1: anteri,  
1: shajak.  
1: futë.  
1: brez aliko.  
1: pôdhiqe.  
1: pushali.  
1: palë kopsa argjendi.

Të nuses:

1: shegun.  
1: qeleposh.  
1: jelek.  
1: brez aliko.

Uroj jetë të gjatë e bekimin e Avramit dhe qoftë për fakt.

Jam dakord  
unë, Jorgji, veqil i vëllait tim David unë, Simon Cuko, i ati i vajzës

Unë shkesi Janko, dëshmitar  
Dëshmitar: Papadhimitër  
dhe dëshmitar: Papajorgji.

Në vitin 1819, qershori 15

7) Në emër të Atit, të Birit dhe të Shpirtit të Shënjtë, unë, Prenda, grua e të ndjerit Gjon Rista Laçka, dëshirova personalisht të martohem me Koli Seminin dhe të vë kurorë pa kërkuar prej tij dhuratë para martesës, sipas zakonit të vendit, por vetëm rrobat e mëposhtëme:

1: anteri sakiziko  
1: flokatë.  
1: palë këpucë.  
1: brez lesi të ngjyrosur.  
1: futë të verdhë.

Përveç këtyre dhe të tjerat e burrit tim të mëparshëm, do t'i bëjë ai pa u ankuar. Dhëntë Zoti të jetojmë bashkë në paqe dhe mirëkuptim të plotë.

Jam dakord, veqili i saj Jani i Avram Brusit.  
Jam dakord, veqili: Sotir, djali i Kolë Shqevit.  
.....papa ..... dëshmitar

Dëshmitar: Abaz.....

Dëshmitar: Papavrami

1819, korrik 19

